RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

TË PËRPUTHSHMËRISË

NË

UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SHA

TIRANË, korrik 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-8**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	7-8
II.	**HYRJA**	**9-12**
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	9
2.	Identifikimi i çështjes	9
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4.	Përgjegjësitë e audituesve	10
5.	Kriteret e vlerësimit	10-11
6.	Standardet e auditimit	11
7.	Metodat e auditimit	1112
8.	Dokumentimi i auditimit	12
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**13-212**
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	13
2	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	13-212
2.1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	13-15
2.2	Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko - financiar të shoqërisë.	15-31
2.3	Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.	31-45
2.4	Mbajtja e evidencave në kontabilitet, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit	45-69
2.5	Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).	69-75
2.6	Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	75-189
2.7	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i strukturës së audititit të brendshëm.	189-198
2.8	Zbatimi i standardeve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë të ndotur.	198-212
IV.	**REKOMANDIME**	**212-224**

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i subjektit të auditimit

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA (në vijim shënuar si UKK SHA) është regjistruar më datën 13.11.2017 pranë QKB-së me NIPT L72320034A, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë (UKT) SHA, si rezultat i ndarjes së kësaj shoqërie.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Paqesori, Frutikulturë, Kamëz Tiranë. Shoqëria është subjekti i rregjistruar në TVSH. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit janë publikuar në rubrikën 28 të ekstraktit të regjistrit tregtar.

Shoqëria ushtron aktivitet tregtar në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjes së ujit. Mirëmbajtje e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impiantëve të pastrimit të tyre.

Kapitali i Shoqerisë zotërohet 100% nga aksioneri i vetëm, Bashkia Kamëz. Më 31 Dhjetor 2024, kapitali fillestar përbëhet nga 1,928,337 aksione, me vlerë nominale Lekë 1000 për aksion, me vlerë totale për 1,928,337,500 Lekë, i njëjtë me kapitalin e regjistruar më 31 Dhjetor 2023. Kapitali fillestar prej 289,024,000 Lekë është krijuar nga ndarja e shoqërisë UKT Tiranë. Me datë 16.06.2022 kapitali i shoqërisë UKK SHA është zmadhuar për shumen 1,639,313,500 Lekë, që përfaqëson fondet neto të transferuara nga Ndërmarja Ujësjellës Kanalizime Kamëz (entitet publik) me datë 31.12.2019, vlerë e cila në pasqyrat financiare të vitit 2021 është raportuar në rubrikën 'Rezerva të tjera". Procedurat ligjore për zmadhimin e kapitalit nga rezervat e NUKK dhe regjistrimin e aksioneve me vlerë 1,928,337,500 Lekë kanë përfunduar më 16.06.2022.

Me vendim nr. 04, datë 04.04.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit të vetëm të UKK SHA janë miratuar pasqyrat financiare (PF) të vitit 2019 të reformuara (përshtatura) të Ndërmarjes UK-Bashkia Kamëz nga ndërmarrje publike në formatin e PF të një shoqërië aksionare dhe raporti i auditimit për këto pasqyra. Gjithashtu u miratuan PF të bashkuara (konsloliduara) të Ndërmarjes UK-Bashkia Kamëz me UKK SHA me datë 31.12.2019.

Sistemi i administrimit është me një nivel dhe përbëhet nga një administrator dhe tre anëtarë të Këshillit të Administrimit.

Në bazë të Marrëveshjes së Ndarjes në datën 27.09.2017 u vendos që UKT SHA të ndahet dhe shoqëritë pritëse që u krijuan rishtazi nga ky proces ishin si më poshtë:

1. Shoqëria Ujësjellësi-Kanalizime Bashkia Tiranë SHA,
2. Shoqëria Ujësjellësi-Kanalizime Bashkia Kamëz SHA,
3. Shoqëria Ujësjellësi-Kanalizime Bashkia Vorë SHA.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë që ndahet do të merreshin përsipër nga shoqëritë pritëse sipas zonës së juridikisionit të bashkive respektive.

Formalisht ndarja është kryer në datën 20 Nëntor 2017 sipas raportit të ndarjes, në bazë të bilancit të pa-audituar të shoqërisë në datën 31 dhjetor 2016. Raporti i ndarjes nga eksperti është lëshuar në datën 16 Shkurt 2017.

Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Bashkia Kamëz SHA nuk e ka pranuar vendimin e Asamblese së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqerisë UKT SHA "Per miratimin e Projekt marreveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vore dhe Kamez nga shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane SHA" dhe ka hapur proces gjyqesor per pavlefshmerine e ketij vendimi. Si rezultat UKB

Kamza nuk ka marre ne dorezim pasurinë e transferuar dhe si rezultat vlerat përkatëse janë pasqyruar ne bilancin e Ujesjelles Kanalizime Tiranë deri me date 31 Tetor 2020.
Në raportin e Ndarjes, është pasqyruar Pasqyra e Pozicioni Financiar të shoqërisë UKT SHA më 20 Nëntor 2017, si dhe ndarja e pasurisë për tu tranferuar te shoqëritë pritëse po në të njëjtën datë, si në tabelën e mëposhtme.
-UKK SHA ushtron aktivitetin në Bashkinë Kamëz me një popullsi prej rreth 151,000 banorë duke furnizuar me ujë higjienikisht të pastër një popullsi prej rreth 83% (pasi sipas raportimit ka një popullsi jo aktive pa konsum uji prej rreth 10 %), një numër mesatarisht prej rreth 33,951 klientësh në fund të Dhjetor 2025, me mbulim furnizimi me ujë të pijshëm rreth 83 % të popullsisë.
-UKK SHA është e organizuar në tre departamente: Departamenti Administrativ, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Teknik për vitet 2023, 2024, Gusht 2025. Në Gusht 2025 dhe në vazhdim me dy departamente: Departamenti tregtar dhe Departamenti teknik, brenda të cilëve ka sektor dhe njësi, me një numër prej 310 punonjësish gjithsej, bazuar në Vendimin e Asamblesë nr. 5, datë 18.08.2025 dhe Vendimin e Këshillit Administratimit nr.7, datë 18.08.2025 "Për disa ndryshime në strukturën organizative". Numri i punonjësve për 1000 lidhje është mesatarisht 4.93 në vitin 2023 dhe 5.33 në vitin 2024.
Sipas raporteve të UKK SHA ujë pa të ardhura lëviz nga 71 % në vitin 2023 në 67 % në vitin 2024 dhe në 60% në vitin 2025; vlera totale e ujit të faturuar në vitin 2025 është 518,450,217 lekë dhe vlera e arkëtuar është 557,560,274 lekë ose 107 %, pra shlyerje edhe detyrimeve të prapambetura nga likuidimi me këste.
Sipas raporteve të UKK SHA, totali vjetor i të ardhurave për vitin 2024 është rreth 518,450 mijë lekë dhe totali vjetor i shpenzimeve për këtë vit është rreth 572,960 mijë lekë, nga të cilat rreth 53.7 % shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore; 21.7 % amortizim, 4 % shpenzime për energji elektrike dhe 20.6 % të tjera.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.
UKK SHA është shoqëri publike me rëndësi të veçantë, jo vetëm për shërbimin që ofron për furnizimin me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm; grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura e mirëmbajtjen e këtyre sistemeve, por edhe nga shtrirja territoriale një numët të konsiderueshëm të popullsisë, si edhe për kohën e furnizimit me ujë dhe cilësinë e ujit që ofron, krahas shpenzimeve për kryerjen e këtij aktiviteti.

Nga vetë rëndësia që ka UK Kamëz, të cilat rrjedhin prej detyrave dhe përgjegjësive që ka, rrjedh edhe rëndësia që ka auditimi i saj për Kontrollin e Lartë të Shtetit, me qëllim përcaktimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, mbi të cilin zhvillon veprimtarinë, përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë, evidentimin e parregullsive dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e tyre etj. Për më tepër, që auditimi kryhet pas riorganizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, me qëllim përmirësimin sigurimit të furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për të plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, si dhe duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve[1].

[1] VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", kreu I, pika 1

c. Qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet auditimeve, synon përdorimin me efektivitet, efiçencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e autoriteteve publike dhe publikut, nëpërmjet publikimit të raporteve të tij.

Qëllimi i këtij auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore të UK Kamëz, për periudhën e aktivitetit 01.01.2023 deri më 31.12.2025. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimin e gjendjes, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat si: verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem etj. Siguria e arsyeshme e auditimit ka ardhur kryesisht si rezultat i testeve thelbësore (punës mbi dokumentacion), edhe për arsye se shoqëria e riorganizuar auditohet për herë të parë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe risku vlerësohet në nivelin mesatar.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se subjekti për periudhën objekt auditimi paraqet problematika dhe mangësi në disa drejtime të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 30 gjetje dhe janë dhënë 34 rekomandime, nga këro 5 gjetje dhe 5 rekomandime për masa organizative, 5 gjetje dhe 5 rekomandime për shpërblim dëmi, 4 gjetje dhe 4 rekomandime për elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike.

2. Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Hartimi i programeve ekonomikë të zhvillimit të shoqërive nuk është kryer për periudha afatmesme dhe afatgjata bazuar në objektivat e caktuara nga organet drejtuese.
- mungon një analizë e hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë me tregues analitik për nivelin e arritjeve të treguesve cilësor të prodhim furnizimit, shpërndarjes dhe arkëtimit të ardhurave;
- Në programet ekonomike për vitet 2023-2024-2025 është parashikuar zëri i shpenzimeve "Fondi i vecantë për të përndjekurit politik" në shumën 3,500 mijë lekë në vit, në total 10,500 mijë lekë, shumë e cila nuk është transferuar për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë;
- Nuk ka përllogaritje të sasisë së ujit që humbet nga lidhjet e paligjshme që janë në rrjetin aktual që administrohet nga shoqëria, pasi janë futur në humbje dhe shpërdorimet e ujit nga lidhjet e paligjshme dhe nga mosfaturimi i ujit, të cilat janë konsideruar si humbje tekniko-ekonomike në masën 60-70%;
- Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria analitike 411 "Klientë për mallra, produkte e shërbime" paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 867,558,586 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 941,493,879 lekë. Pra kërkesat për arkëtim në vitin 2024 kanë pësuar rritje prej 73,935,293 lekë ose në masën 8.5 % krahasuar me vitin 2023, ku peshën kryesore të debitorëve

ndaj UKK SHA e zënë abonentët familjarë në masën 97 %, privatët dhe institucionet shtetërore në masën 3 %.
- UK Kamëz nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka takime të dokumentuara të GMS, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit. Njësia e Auditit të Brendshëm, pavarësisht se është në strukturë, është jo funksionale duke mos kryer asnjë aktivitet si dhe duke mos pasur asnjë punonjës në strukturë, duke i munguar si hallkë e kontrollit të brendshëm të njësisë, si dhe për vitet objekt auditimi, nuk disponohet asnjë raport nga kjo njësi
- Nga auditimi i 17 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara për vitet 2023-2025, u konstatua se në 8 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT.
- Nga auditimi i 17 procedurave të prokurimit publik për vitet 2023-2025 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 10 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit.
- Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik për periudhën 2023-2025, rezultoi se dosjet e prokurimeve nga struktura përgjegjëse për prokurimet, nuk ishin të inventarizuara dhe të arkivuara duke sjellë si pasojë, parregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit.
- Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të 5 kontratave për punë publike dhe konkretisht "*Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a*", "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku", "Rehabilitim KUN-je, Rr Argjinatura deri tek Azili i Pleqëve (Rr. "Teuta", Kamëz), "Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz" dhe "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i vjetër Kamëz", rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e UK Kamëz, në vlerën 2,828,720 lekë pa TVSH.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore
- Administratori i Shoqërisë Ujësjellës, Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Departamentik Ekonomik të marrin masa që programet ekonomike të hartohen për periudha afatmesme, ndërsa ato vjetore të paraqiten në afat për miratim në Këshillin e Administrimit. pranë ministrisë përgjegjëse dhe Prefektit të Qarkut
- Administratori i Shoqërisë Ujësjellës, Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Departamentik Ekonomik të marrin masa që fondet e planifikuara në programet ekonomike për "Fondi i vecantë për të përndjekurit politik"ti transferohen për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë
- Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kamëz" SHA, Këshilli Administrimit nëpërmjet Departamentit Ekonomik edhe Departamentit Teknik, të analizojnë treguesit ekonomik - financiar dhe rezultatet e arritura, për të hartuar programe ekonomike referuar mundësive dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të shoqërisë, duke synuar uljen e kostos, minimizimin e humbjeve, rritjen e të ardhurave me qëllim përmirësimin e performances së saj
- Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA nëpërmjet Departamentit Ekonomik të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumave debitore të abonentëve, duke evidentuar vonesat në kohë të pagesave dhe penalitetet për to.
- Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një strategjie për menaxhimin e risqeve dhe masave konkrete për minimizimin e tyre për aktivet afatgjata,

miratimin e një rregulloreje me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi. Të merren masa të menjëhershme për funksionalizimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm, duke siguruar plotësimin e strukturës me personel të kualifikuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Titullari i Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës
- Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat e nevojshme për përzgjedhjen e procedurave te prokurimit, në hartimin e fondit limit, specifikimeve teknike dhe vendosjen e kritereve të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet me objektin që prokurohet.
- Personi përgjegjës për prokurimet të marrë masa për inventarizimin, numerizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit, me qëllim sistemimin arkivor të dokumentacionit, minimizimin e riskut të cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit.
- Titullari i UKK SHA, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, me qëllim kërkimin për shpërblimit e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 2,828,720 lekë pa TVSH.

3. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit

I. Opinion i modifikuar (kualifikuar) mbi auditimin e përputhshmërisë

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë Ujësjellës Kanalizimeve Kamëz SHA, me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2025 dhe në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar disa parregullsi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, situatë e cila justifikon dhënien e një opinioni të **kualifikuar[2].**

Baza për dhënien e opinionit:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesve". Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinioni. Opinioni mbështetet mbi parregullsitë e konstatuara si vijon:

[2]SNA-705-Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të 5 kontratave për punë publike, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e UK Kamëz, në vlerën 2,828,720 lekë pa TVSH.
- Hartimi i programeve ekonomikë të zhvillimit të shoqërisë nuk është kryer për periudha afatmesme dhe afatgjata bazuar në objektivat e caktuara nga organet drejtuese.
- Mungon një analizë e hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë me tregues analitik për nivelin e arritjeve të treguesve cilësor të prodhim furnizimit, shpërndarjes dhe arkëtimit të ardhurave;
- Në programet ekonomike për vitet 2023-2024-2025 është parashikuar zëri i shpenzimeve "Fondi i veçantë për të përndjekurit politik" në shumën 3,500 mijë lekë në vit, në total 10,500 mijë lekë, shumë e cila nuk është transferuar për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë;
- UK Kamëz nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka takime të dokumentuara të GMS dhe nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit. Njësia e Auditit të Brendshëm, nuk ka funksionuar edhe pse është pjese e strukturës nuk ka patur punonjës
- Nga auditimi i 17 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara për vitet 2023-2025, u konstatua se në 8 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.
- Nga auditimi i 17 procedurave të prokurimit publik për vitet 2023-2025 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 10 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit.
- Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik për periudhën 2023-2025, rezultoi se dosjet e prokurimeve nga struktura përgjegjëse për prokurimet, nuk inventarizohen dhe arkivohen duke sjellë si pasojë, parregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1051/2, datë 12.11.2025, të ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 12.11.2025 deri më datë 27.02.2026, në subjektin UK Kamëz u krye Auditimi i Përputhshmërisë, i cili mbuloi periudhën prej 01.01.2023 deri më 31.12.2025, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. S. M. (P. Grupi),
2. E. Ll., auditues,
3. I. Sh., auditues,
4. A. Z., auditues,
5. Sh. H., auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objekti dhe qëllimi i auditimit: Në auditimin e përputhshmërisë objektivi është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, si dhe opinionit mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit.

Qëllimi i auditimit është të vlerësohen dhe evidentohen shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si dhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Gjithashtu, synohet ndërmarrja e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve; dhënia e rekomandimeve për përmirësime të punës.

Gjithashtu, rëndësia e këtij auditimi qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese të fondeve dhe pasurisë publike, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e drejtuesve dhe stafeve të shoqërive publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

2. Identifikimi i çështjes: Sipas veprimtarisë së subjektit UK Kamëz, janë vlerësuar fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimet e auditimit, të miratuara në programin e auditimit, si më poshtë:

- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.
- Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko - financiar të shoqërisë.
- Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.
- Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).
- Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.
- Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i strukturës së auditit të brendshëm.

- Zbatimi i standardeve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë të ndotur.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Drejtimi i SHRUK Kamëz është përgjegjës që të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj (shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve, mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, shërbimin e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura etj.) brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Veç këtyre, është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e pasurisë publike dhe të burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, administrimi i vlerave materiale dhe monetare, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimin e kontratave të punimeve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi etj.

Gjithashtu, strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së aktivitetit të shoqërisë së audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të jap opinion për këtë.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e UKK SHA është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion për këtë qëllim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional, si dhe kanë respektuar kërkesat etike gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit.

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadri rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të shoqërisë, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë që auditohet) dhe kryesisht:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar;
- Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 "Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura si titull ekzekutiv", i ndryshuar;

- Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”;
- Ligji nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”
- Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK”;
- VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 870, datë 14.12.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” i ndryshuar;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e UKK Kamëz;
- Akte të tjera ligjore/nënligjore mbi të cilat bazohet funksionimi i shoqërisë.

6. Standardet e auditimit:

ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200 “*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*”; INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si dhe manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH etj.

7. Metodat e auditimit: Është përdorur metoda me auditim me zgjedhje sipas vlerësimit të audituesit dhe çështjes së audituar. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale sasiore dhe cilësore dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin

profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zëra të ndryshëm të aktivitetit ekonomik dhe financiar të subjektit.
Për arritjen e konkluzionit dhe opinionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:
- *Kontrolli aritmetik*. u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë gabime. Gjithashtu, kjo teknikë u përdor dhe në rastet e tjera të çështjeve të auditimit ku ka lindur e nevojshme;
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*, konstaton nëse shifrat e shpenzimeve kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar;
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj., duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "*jashtë normales*", që përbëjnë tregues të parregullsive të ndryshme. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij, në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 07, datë 17.01.2024, të ndryshuar; në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit në terren, sipas Akt - konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara dhe të shqyrtuara, observacioneve të subjektit nën auditim, si dhe Projekt Raportit të dërguar dhe observacioneve përkatëse, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.

UK Kamëz është themeluar në zbatim të VKM nr. 302 datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", nëpërmjet marrëveshjes së datës 28.06.2022 midis Bashkisë Kamëz dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me nr. 1 prot., datë 02.09.2022.

Shoqëria funksionon e organizuar me sistemin e administrimit me dy nivele: këshilli mbikëqyrës dhe një administrator, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre dy organeve.

Statuti i Shoqërisë është miratuar me Vendimin nr. 11 prot., datë 13.11.2017, ku janë përcaktuar objekti i veprimtarisë, kapitali, organet drejtuese të shoqërisë, kompetencat e Asamblesë, Këshillit Mbikëqyrës, drejtuesve të shoqërisë etj.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, me vendimin datë 09.07.2024 ka emëruar 3 anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorin e Shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës me Vendim nr. 3, datë 27.09.2022 administruar në UKK me nr. 16/5 prot., të po kësaj date ka miratuar strukturën e shoqërisë me 271 punonjës. Struktura e re dhe ndryshimi i numrit të punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 2, datë 11.04.2023, sipas të cilit shoqëria përbëhet nga 278 punonjës.

Veprimtaria e UK Kamëz rregullohet nga ligji bazë nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore të funksionimit të shoqërive publike në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

2- Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori) vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

UK Kamëz sh.a. është një shoqëri me kapital 100 % shtetëror, e themeluar me Vendimin nr. 11, datë 13.11.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve të Shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" Sh.A, e cila vepron në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Asambleja e Aksionarëve:

Kompetencat e Asamblesë janë të sanksionuara në ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nenin 81 e vijues dhe në statutin e UK Kamëz sh.a miratuar me vendimin nr. 11 të cituar më sipër, i ndryshuar me vendimin nr. 14, datë 30.12.2021 "Për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz".

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA përbëhet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, z. R. S. (Kryetar i Bashkisë Kamëz).

Për periudhën objekti auditimi 01.01.2023 – 31.12.2025, janë marrë 33 vendime. Me Vendim Nr.1, datë 10.01.2023, Asambleja e Përgjithshme pasi shqyrtoi të gjitha çështjet, vendosi:

-Lirimin nga detyra të Administratorit të UKK Sh.A z. E. M., dhe me Vendimin nr. 2, datë 10.01.2023 emërimin në detyrë si Administrator z. Sh. L.

-Për vitin 2023, krahas 2 vendimeve të mësipërme, janë marrë në total 10 Vendime nga Asambleja e Përgjithshme;

-Për vitin 2024, janë marrë 12 vendime nga Asambleja e Përgjithshme;

-Për vitin 2025, janë marrë 11 vendime nga Asambleja e Përgjithshme;

Rezulton se Vendimet e marra janë përgjegjësi e këtij organi dhe janë në përputhje me nenin 81 "Të drejtat dhe detyrimet" të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe nenit 7 "Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme" të Statutit të Shoqërisë.

Këshilli i Administrimit:
Këshilli i Administrimit përbëhet nga 3 anëtarë, nga të cilët Administratori i Shoqërisë dhe 2 anëtar të zgjedhur, nga të cilët njëri prej tyre zgjidhet Kryetar i këtij organi. Këshilli i Administrimit, referuar pikës 5 të nenit 11 të Statutit, mund të emërojë edhe një sekretar jashtë anëtarëve të tij.
Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA për periudhën objekt auditimi përbëhet prej 3 anëtarë të cilët janë z. P. Gj. i ndryshuar me zj. F. M, z. R. H, z. E. M. i ndryshuar me z. Sh. L. Përbërja e KA dhe numri i anëtarëve është në përputhje me nenin 155 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nenin 11 dhe 12 të Statutit të Shoqërisë.
Lidhur me mandatin e anëtarit R. H, rezulton se është emëruar në detyrë me urdhrin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të datës 03.10.2022. Referuar nenit 155 pika 2 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërisë tregtare", përcaktohet se afati i emërimit nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet, dhe nenit 12 të Statutit të Shoqërisë i cili përcakton se *Anëtarët e Këshillit të Administrimit janë persona fizikë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat **3 vjeçar...***
Sa më sipër, prej datës 3.10.2025, vijimi në detyrën e anëtarit të KA është jashtë mandatit ligjor.
Gjithashtu, konstatohet se në nenin 16 të Statutit "Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit", përcaktohet se *Mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon në rastet e mëposhtme: a) me mbarimin e mandatit të administratorit.*
Përmbajtja e mësipërme e këtij neni të Statutit, nuk është e mbështetur ligjërisht dhe është e pazbatueshme, pasi mandatit i anëtarit nuk lidhet drejtpërdrejtë me mandatin e administratorit.
Për periudhën objekt auditimi 2023 – 2025, janë marrë 44 Vendime, nga të cilët:
-Për vitin 2023 janë marrë 13 Vendime nga Këshilli i Administrimit;
-Për vitin 2024 janë marrë 14 Vendime nga Këshilli i Administrimit;
-Për vitin 2025 janë marrë 17 Vendime nga Këshilli i Administrimit.

Rezulton se Vendimet e marra janë përgjegjësi e këtij organi dhe janë në përputhje me nenin 154 "Të drejtat dhe detyrimet" të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe nenit 13 "Kompetencat e Këshillit të Administrimit" të Statutit të Shoqërisë.
Janë bërë takime të përmuajshme, të cilat përgjithësisht kanë për objekt *Raportet mbi ecurinë e shoqërisë, treguesit e performancës dhe analizës financiare sipas muajve*.
Referuar pikës 6 të nenit 14 të Statutit, KA mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e këshillit të pranishëm. Rezulton se nuk ka një regjistër të posaçëm, por në fund të praktikave të takimeve, ka një fletë me përshkrimin Regjistri i takimit i cili firmoset nga anëtarët.
Janë mbajtur procesverbalet e takimeve ku pasqyrohen të dhënat e takimit, data dhe çështjet e diskutuara.

Administratori:

Administratori i shoqërisë, drejton dhe përfaqëson shoqërinë lidhur me vënien në zbatim të politikave tregtare, Siguron mbajtjen dhe administrimin e duhur të librave dhe dokumenteve të kontabilitetit të shoqërisë. Kujdeset për përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore, bilancin dhe raportin e performancës. Administratori zgjidhet nga këshilli administrativ i shoqërisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit përcaktohen në statutin e Shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare". Administratori është përfaqësuesi dhe drejtuesi ekzekutiv i shoqërisë. Administratori i shoqërisë përgjigjet për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të shoqërisë nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në mënyrë të ligjshme me efektivitet dhe eficencë.
Deri më datë 10.01.2023, Administrator i Shoqërisë ka qenë z. G. M, i liruar me vendimin nr. 1, datë 10.01.2023.
Me vendimin nr. 2, datë 10.01.2023 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, është emëruar z. E. M.
Me vendimin nr. 5856, datë 09.07.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, është emëruar në detyrë z. Sh.L, i cili vijon të jetë në detyrë.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.2 Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko - financiar të shoqërisë.
Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Programet e miratuara dhe ndryshimet e kryera gjatë viteve 2023, 2024 dhe 2025
- Raportet e performancës së veprimtarisë së shoqërisë, shoqëruar me analizat faktoriale për realizimin e shpenzimeve dhe të ardhurave.

Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, është shoqëri që kryen shërbim publik në fushën e furnizimit dhe të shitjes me ujë të pijshëm për konsumatorët. Në nenin 2, të Statutit të Shoqërisë **është përcaktuar se objekti i shoqërisë është:**
Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; Mirëmbjtja e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumëtorëve; Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura; Mirëmbajtje e sistemeve të ujrave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre; Për të realizuar këto objektiva shoqëria, brenda caqeve të prashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion financiar tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj.
Në hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" dhe Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", dhe statutit të shoqërisë.

❖ ***<u>Hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar</u>.***

- *<u>Afatet e miratimit të programeve ekonomike</u>*

Për vitin 2023 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.10, datë 01.12.2022 "Për miratimin e planit ekonomiko-financiar të vitit 2023 të Ujësjellës

Kanalizime Kamëz SHA", i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 08, datë 01.12.2022.
Për vitin 2024 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 12, datë 18.12.2023 "Për miratimin e planit ekonomiko-financiar të vitit 2024 të Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA", i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 08, datë 19.12.2023.
Për vitin 2025 programi ekonomik është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 23.12.2024 "Për miratimin e planit ekonomiko-financiar të vitit 2025 të Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA", i konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 07, datë 27.12.2024.
Konkluzion: Për vitet 2024 dhe 2025 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve. Konkretisht: Për vitin 2024 plani ekonomiko-financiar është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr.12, datë 18.12.2023 dhe konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 08, datë 19.12.2023. Për vitin 2025 plani ekonomiko-financiar është miratuar me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 23.12.2024 dhe konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve me vendim nr. 07, datë 27.12.2024. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) nr. 15, datë 2.5.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror", kapitulli III, pika 2, ku është përcakruar se: *"Drejtoritë e shoqërive ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionin shpjegues pranë këshillave mbikëqyrëse, brenda datës 1 dhjetor të çdo viti*".

- *Rregullshmëria e hartimit të programeve ekonomike vjetore*.

Hartimi i programeve ekonomike është bazuar në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me udhëzimet në zbatim të tij, Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore"; Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi i MEZHTTS nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror".
Programet ekonomike vjetore janë mbështetur dhe janë pjesë e plan-biznesit 2022-2026 të miratuar vendimin e Këshillit Administrativ nr. 07, datë 12.10.2022 të konfirmuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me vendimin nr. 06, datë 14.11.2022. Plan-Biznesi ka shërbyer si dokument strategjik në drejtim të përcaktimit dhe realizimit të objektivave shoqërisë në plan afatgjatë.
Programet ekonomike vjetore për vitet 2023, 2024 dhe 2025, janë hartuar dhe përgatitur bazuar në realizimet faktike të treguesve të vitit paraardhës dhe mbi bazën e realizimit të pritshëm të vitit aktual. Gjatë procesit të planifikimit të shpenzimeve është mbështetur në nivele krahasimi me vitet e mëparshme si dhe në parashikimet e shpenzimeve për vitin në vazhdim, me qëllim për të përballuar nevojat e domosdoshme gjatë ushtrimit të aktivitetit dhe për një funksionimin normal të shoqërisë.
Hartimi i programeve ekonomike vjetore është kryer nga Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorët të cilët kanë hartuar kërkesat për financim sipas nevojave në fushat që ato mbulojnë, në funksion të përmirësimit të proceseve të punës, të cilt nuk janë të shoqëruar me shpjegime argumentuese.

▪ **Ndryshimet** e programeve ekonomike për periudhën objekt auditimi, të argumentuara paraqiten:

Për vitin 2023 me VKA nr.02, datë 20.06.2023 miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve me vendimin nr.05, datë 21.06.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.10, datë 01.12.2022 "Për miratimin e planit ekonomiko-financiar për vitin 2023 të Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA"është bërë ndryshimi në buxhet për shumën 2,300,000 lekë në zërin "shpenzime operative", e cila përbëhet nga:

- shtesë në nënzërin "Shërbim ndricuesish me ujë të pijshëm me autobot" në shumën 1,000,000 lekë.
- shtesë në nënzërin "Blerje ndriçuesish për depot e ujit të UKK SHA" në shumën 300,000 lekë.

Për vitin 2024 me VKA nr.06, datë 31.07.2024 miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve me vendimin nr.05, datë 31.07.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.08, datë 19.12.2022 "Për miratimin e planit ekonomiko-financiar për vitin 2024 të Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA"është bërë ndryshimi në buxhet për shumën 23,096,913 lekë në zërin "Investime kapitale", e cila përbëhet nga:

- shtesë në nënzërin "Rehabilitim dhe ndërtim i linjes Kun, rruga Argjinatura-Azili i Pleqve-Rrruga Teuta" në shumën 18,056,345 lekë, ku për objektin në shumën 17,429,918 lekë, për mbikëqyerje në shumën 544,719 lekë dhe për kolaudim në shumën 81,708 lekë.
- shtesë në nënzërin "Rehabilitim dhe ndërtim i linjes Burimi nr.3, Bovillë" në shumën 999,198 lekë për objektin e punimeve.
- shtesë në zërin "Gërmim, mbushje dhe transport dheu sëbashku me shtrim linje (l=500ml) e puseta" në shumën 4,041,370 lekë lekë.

Për vitin 2025 me VKA nr. 04, datë 18.07.2025 miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve me vendimin nr. 03, datë 25.07.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.07, datë 27.12.2024 "Për miratimin e planit ekonomiko-financiar për vitin 2025 të Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA"është bërë ndryshimi në buxhet për shumën 11,384,242 lekë në investime kapitale në zërin "Ndërtim të linjës së ujësjellësit të transmetimit dhe shpërndarjes + rrjet kanalizimesh në Laknas e Valias", e cila përbëhet nga:

- shtesë në nënzërin "Projektim linje ujësjellësi transmetimi dhe shpërndarje + rrjet kanalizimesh në Laknas e Valias" në shumën 5,557,330 lekë.
- shtesë në nënzërin " Mbikëqyerje dhe kolaudim të punimeve për investimin me objekt: "Ndërtim të linjës së ujësjellësit të transmetimit dhe shpërndarjes + rrjet kanalizimesh në Laknas e Valias" në shumën 4,260,620 lekë
- shtesë në nënzërin oponenca teknike në shumën 522,380 lekë
- shtesë në nënzërin vlerësimi i ndikimit në mjedis në shumën 100,000 lekë
- shtesë në nënzërin testimi i puseve Valias mbi prurjen e ujit në shumën 700,000 lekë
- shtesë në nënzërin raporti i studimit hidrologjik në shumën 243,912 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, miratimin, realizimin dhe raportimin e programeve ekonomike u konstatua se nuk janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1,2,3 dhe 4, me VKM nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" Kreu 1, pika 8, Lidhja nr.1, neni 18, pika 7/ç, me Ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" i ndryshuar nenet14/b,f, 20 dhe 31/1.a. 22, me "Rregulloren e liçencimit për procedurat e dhënies dhe rinovimit të liçencave profesionale

për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (e ndryshuar)", miratuar me vendim të KKRRU nr. 29, datë 08.12.2009, ndryshuar me vendim të KKRR nr. 30, datë 07.12.2012 ndryshuar me vendim të KKRR nr. 50, datë 30.12.2013, nenet 17, 29, 30, me Kontratën e Shërbimeve Ujësjellës Kanalizime, miratuar me vendim të (Komisionit Kombëtar Rregullator) KKRR nr. 25, datë 08.07.2015 "Kontratë për shërbime Ujësjellës-Kanalizime e përditësuar", nenet 7, 8 dhe 10 pasi:

- Hartimi i programeve ekonomikë të zhvillimit të shoqërive nuk është kryer për periudha afatmesme dhe afatgjata bazuar në objektivat e caktuara nga organet drejtuese.
- Programet e zhvillimit të shoqërisë pas miratimit nga Këshilli Administrimit nuk janë miratuar pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve dhe prefektit të qarkut.
- Për disa zëra shpenzimesh planifikimet nuk janë bazuar në realizimet e viteve paraardhëse, duke u programuar me rezerva dhe jo sipas nevojave reale, pasi kanë rezultuar me mosrealizime të theksuara, si dhe mungon analiza ekonomike për rezultatet e arritura.
- Programet ekonomike janë paraqitur për miratim në Këshillin Administrimit thjesht, duke përshkruar të dhënat tabelore, ku në relacionet shpjeguese mungon një analizë të hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë me tregues analitik për nivelin e arritjeve të treguesve cilësor të prodhim furnizimit, shpërndarjes dhe arkëtimit të ardhurave.
- Raportimi në Entin Rregullator të Ujit (ERRU) mbi realizimin e treguesve ekonomik e financiar dhe të performancës për vitet 2023 dhe 2024 me email-et përkatëse të datave 04.01.2024 dhe 23.01.2025 nuk përputhet me raportimin vjetor financiar dhe jo financiar që paraqitet në Këshillin Administrimit. Raportimet periodike mujore të shoqërisë, janë të vakta, vetëm me të dhëna në tabela, pa analiza të hollësishme mbi shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në arritjen e objektivave të shoqërisë, si dhe nuk janë propozuar masat për të rregulluar gjendjen në të ardhmen. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.25/2018, datë "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 17 dhe 18.
- Paketa fiskale e miratuar me vendimet nr. 6 dhe 7, datë 01.11.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve "Për miratimin e tarifave të shërbimeve, i ndryshuar për vitin 2024 dhe në vazhdim të Ujësjellës Knanlizime Kamëz sha" nuk është miratuar në Entin Rregullator të Ujit (ERRU).

- *Analiza e treguesve të realizimit të programeve ekonomike*

Parashikimi dhe realizimi i programeve ekonomike sipas viteve në lidhje me shpenzimet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Parashikimi dhe realizimi i programeve ekonomike 2023-2025

Në lekë

		Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025		
Nr.	EMERTIMI	Plani	Realizimi	% e realiz	Plani	Realizimi	% e realiz	Plani	Realizimi	% e realiz
1	**Lende e pare e materiale tjera**									
	Kimikate	3,360,000	2,622,600	78%	3,360,000	1,222,000	36%	1,800,000	1,350,000	75%
	Blerje Tuba,materiale	31,917,491	31,917,491	100%	25,000,000	25,000,000	100	27,000,000	27,000,000	100%
	Vegla pune dhe uniforma	2,400,000	2,350,300	98%	1,300,000	1,170,000	90%	1,500,000	734,000	49%
	Matesa dhe kaseta	2,200,000	2,105,380	96%	3,500,000	3,421,960	98%	5,000,000	4,396,295	88%
	Blerje reagent	0		0%						
	Sinjalistika	100,000	99,000	99%	180,000	178,000	99%	400,000	155,400	39%
	Blerje asfalt I ftohte/beton	2,000,000	1,898,230	95%	3,500,000	3,331,680	95%	2,500,000	2,400,000	96%
	TOTAL 1 (kosto direkte)	**41,977,491**	**40,993,001**	**98%**	**36,840,000**	**34,323,640**	**93%**	**41,400,000**	**36,035,695**	**87%**
2	**Kosto Operative**									
	Energji elektrike	26,400,000	21,448,219	81%	24,000,000	23,247,637	97%	30,000,000	22,808,710	76%
	Karburant	7,200,000	5,228,800	73%	8,000,000	7,321,086	92%	12,000,000	11,553,638	96%
	Sherbime, riparime, mirembajtj kondicionim	1,000,000	622,000	62%	700,000	597,000	85%	1,000,000	712,500	71%

	Blerje Uji dhe Godina	96,000,000	76,355,172	80%	85,000,000	55,086,917	65%	60,000,000	56,059,524	93%
	Qira zyrash	480,000	480,000	100%	480,000	480,000	100	480,000	360,000	75%
	Mobilje zyrash	250,000	192,667	77%				500,000	272,000	54%
	Mirembajtje Printera dhe kompjutera	800,000	748,000	94%	800,000	780,000	98%	3,200,000	2,655,800	83%
	Mirembajtje sistem faturimi	1,800,000	1,710,000	95%	1,700,000	26,000	2%	1,700,000	1,655,000	57%
	Mirembajtje sistem pompimi	500,000	438,000	88%	100,000	99,400	99%	1,500,000	978,000	97%
	Riparim kapakesh	100,000	83,166	83%						
	zhbllokim bot sonde	600,000	600,000	100%	2,400,000	2,210,000	92%	800,000		0%
	Mirembajtje depo	500,000	480,000	96%	500,000	494,000	99%	-		
	Siguracion e kolaudim makinash	240,000	199,439	83%	100,000	88,999	89%	200,000	56,970	28%
	Shtypshkronja letra me vlere					80,000		-		
	Shpenzime kancelarie	2,029,995	1,465,627	72%	1,400,000	669,651	48%	1,800,000	1,055,900	59%
	Riparim depo							1,500,000		
	Shpenzime postare telekom	1,236,000	738,894	60%	1,000,000	566,013	57%	800,000	602,396	75%
	Fotokopje dhe printera riparime	1,700,000	1,562,000	92%				1,000,000	611,000	61%
	Mjete me Qera	3,000,000	2,980,000	99%						
	Analiza Uji	341,089	99,795	29%	200,000	229,587	115	250,000	276,081	110%
	Materiale Higjenike	500,000	412,500	83%	500,000	250,000	50%	500,000	344,000	69%
	Blerje vaj+filtra, goma e pjesë këmbimi	1,000,000	647,800	65%	1,000,000	845,800	85%	1,800,000	1,559,000	87%
	Sherbim torno	100,000	99,000	99%	200,000		0%	200,000		0%
	Sherbime bankare	360,000	118,570	33%	200,000	155,877	78%	200,000	130,762	65%
	Sistem fiskalizimi	377,948	16,000	4%						
	Shërbim internet	240,000	100,000	42%	200,000	192,000	96%	300,000	198,000	66%
	Shpenzime konsulence financiare e ligjore	1,200,000		0%	1,560,000	-	0%	-		
	Shpenzime gjyqësore për tituj ekzekutiv	96,000		0%	240,000	-	0%	240,000		0%
	Shpenzime gjyqësore për gjygje të humbur	600,000	73,445	12%	2,004,000	440,713	22%	1,004,000	213,360	21%
	Shpenzime Auditimi	1,440,000	1,440,000	100%	1,560,000	1,440,000	92%	1,560,000	1,386,000	89%
	DDD (Dezinfektim,dezinsektim,deratezim)	100,000	98,439	98%	400,000	270,000	68%	100,000	100,000	100%
	Shpenzime Interesi dhe kredi	30,000,000	13,824,204	9%	25,200,000	1,366,304	5%	25,000,000		0%
	Kolaudim dhe Mbikqyrje	158,911	123,366	78%				1,091,423	872,417	80%
	TOTAL 2	**180,349,943**	**132,385,103**	**73%**	**157,884,000**	**96,936,984**	**61%**	**148,275,423**	**104,461,058**	**71%**
3	**Shpenzime personeli**									
	Fondi I pagave gjithsej	188,463,990	181,284,097	96%	220,440,000	209,748,712	95%	266,016,000	265,711,929	99%
	Sigurime shoqerore & Shendetesore	38,394,135	31,144,333	81%	36,813,480	33,705,700	92%	44,424,672	40,714,818	92%
	Te tjera personeli	10,501,156	10,501,156	100%	7,378,007	735,855	10%	2,192,361	1,272,722	58%
	TOTAL 3	**237,359,281**	**222,929,586**	**94%**	**264,631,487**	**244,190,267**	**92%**	**312,633,033**	**307,699,469**	**98%**
	Total 1+ Total 2+Total 3	**459,686,715**	**396,307,690**		**459,355,487**	**375,450,891**		**502,308,456**	**448,196,222**	
4	**Fondi Rezerve**									
	Fondi Rezerve	9,694,133	0	0%	5,647,487	0	0%	5,647,487	0	0%
	Fondi I vecantë për ish të përndjekur politik	3,500,000			3,500,000			3,500,000		
	TOTAL 4	**13,194,133**	**0**	**0%**	**9,147,487**	**0**	**0%**	**9,147,487**	**0**	**0%**
5	**Investimi Kapital**									
	Rrjete,Mjete etj	28,539,360	23,956,455	84%	21,300,595	14,979,450	70%	31,150,000	28,575,813	92%
	TOTAL 5	**28,539,360**	**23,956,455**	**84%**	**21,300,595**	**14,979,450**	**70%**	**31,150,000**	**28,575,813**	**92%**
	TOTALI	**501,420,208**	**420,264,145**	**84%**	**489,803,569**	**390,430,341**	**80%**	**542,605,943**	**476,772,035**	**88%**

Burimi: UK Kamëz

Referuar treguesve të programit ekonomik rezulton se shpenzimet për **vitin 2023** janë realizuar në shumën 420,264 mijë lekë nga 501,420 mijë lekë të planifikuara ose në masën 84%, për **vitin 2024** janë realizuar në shumën 390,430 mijë lekë nga 489,803 mijë lekë të planifikuara ose në masën 80%, për **vitin 2025** janë realizuar në shumën 476,772 mijë lekë nga 542,605 mijë lekë të planifikuara ose në masën 88%. Gjatë viteve nga analiza e zërave të shpenzimeve të planit ekonomik vihet re se:

- Zëri "**Shpenzime personeli"** përfshijnë paga, shtesa dhe sigurimet shoqërore & shëndetësorë ka peshën më të madhe në totalin e shpenzimeve të parashikuara në masën 47.3% për vitin 2023, në masën 54% për vitin 2024 dhe në masën 57.6 % për vitin 2025. Ndërsa kundrejt shpenzimeve faktike në masën 53% në vitin 2023, në masën 61% në vitin 2024 dhe në masën 64% në vitin 2025.

Ecuria e shpenzimeve për personelin për periudhën objekt auditimi paraqitet: në **vitin 2023** janë parashikuar 237,359 mijë lekë dhe janë realizuar 222,9230 mijë lekë ose në masën 94%, në **vitin 2024** janë parashikuar në shumën 264,631 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 244,190 mijë lekë ose në masën 92% dhe në **vitin 2025** janë parashikuar 312,633 mijë lekë dhe janë realizuar

në shumën 307,699 mijë lekë ose në masën 98%. Pra kemi një trend rritje të këtyre shpenzimeve nga viti në vit.

Shoqëria "UK Kamëz" sha ka **rritur ndjeshëm numrin e stafit** me 309 punonjës **në vitin 2025** krahasuar me vitin 2023 që kanë qenë 250 dhe me 280 në vitin 2024 (referuar numrit mesatar faktik të punonjësve). Pra numri i stafit për 1000 lidhje UK është mbi normën e pranueshme prej 4.6 të përcaktuar nga ERRU, pasi ky koeficient për UKK sha për vitin 2023 është 4.93%, për vitin 2024 është 5.33% dhe për vitin 2025 është 5.54%. Shoqëria duhet të rishikojë dhe të analizojë hollësisht numrin e punonjësve dhe pozicionet në organigramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesa reale për çdo pozicion pune. Në total rritja e numrit të stafit, por edhe rishikimi i nivelit të pagave ka sjellë rritjen e përmendur më sipër të Kostove të Punës. Menaxhimi i Burimeve njerëzore duhet të jetë prioritet për stafin menaxhues të Shoqërisë, pasi kostot e punës kundrejt kostos direkte të operimit & mirëmbajtjes zënë respektivisht për vitin 2023 një peshë prej 56% , për vitin 2024 një peshë prej 65% dhe për vitin 2025 një peshë prej 69%. Ndërsa kostot e punës kundrejt kostos totale zënë respektivisht rreth 53% në vitin 2023, rreth 60.5 % për vitin 2024 dhe rreth 64.5% për vitin 2025. Numri i stafit duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë. Përcaktimi i numrit të punonjësve për 1000 lidhje UK paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Numri i punonjësve për 1000 lidhje 2023-2025

Emërtimi	**Viti 2023**		**Viti 2024**		**Viti 2025**	
	Plan	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**
Numer kontratash UK	28 000	28 210	30 000	30 026	33 000	33,951
Numer kontratash KUN		22,439		22,497		22,213
Numer punonjësish		250		280		309
Punonjës 1000 lidhje UK		**4.93**		**5.33**		**5.54**

Burimi: UK Kamëz

Zëri **"Shpenzime për lëndë të parë dhe materiale të tjera"** zë një peshë në totalin e shpenzimeve të parashikuara në masën 8.3 % për vitin 2023, në masën 7.5%, për vitin 2024 dhe në masën 7.6 % për vitin 2025. Ndërsa kundrejt shpenzimeve faktike në masën 9% për vitin 2023-2024 dhe në masën 7.5% në vitin 2025.

Ecuria e "shpenzimeve për lëndë të parë dhe materiale të tjera" për periudhën objekt auditimi paraqitet: në **vitin 2023** janë parashikuar 41,977 mijë lekë dhe janë realizuar 40,993 mijë lekë oe në masën 98%, në **vitin 2024** janë parashikuar në shumën 36,840 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 34,323 mijë lekë ose në masën 93% dhe në **vitin 2025** janë parashikuar 41,400 mijë lekë dhe janë realizuar në shumën 36,035 mijë lekë ose në masën 87%. Këto shpenzime për të tre vitet janë pothuajse në të njëjtat nivele.

- Peshën më të madhe e zënë "shpenzimet për blerje tuba, rekorderi dhe materiale" që zë 65 % të këtyre shpenzimeve dhe janë realizuar në masën 100%, të cilat në fakt kanë ardhur duke u ulur si shpenzime nga viti në vit. Kështu në vitin 2023 janë realizuar në shumën 31,917 mijë lekë, në vitin 2024 në shumën 25,000 mijë lekë dhe në vitin 2025 në shumën 27,000 mijë lekë.
- Shpenzime në rritje nga viti në vit janë "shpenzimet për matësa dhe kaseta" të cilat janë realizuar në të njëjtin nivel në të tre vitet rreth 96%, ku për vitin janë realizuar në shumën 2,105 mijë lekë, në vitin 2024 në shumën 3,422 mijë lekë dhe në vitin 2025 në shumën 4,396 mijë lekë.
- Në të njëjtat nivele janë ruajtur "shpenzimet për blerje asfalt i ftohtë/beton" të cilat janë realizuar në të njëjtin nivel në të tre vitet rreth 95%, ku për vitin janë realizuar në shumën 1,898 mijë lekë, në vitin 2024 në shumën 3,331 mijë lekë dhe në vitin 2025 në shumën 2,400 mijë lekë.
- Ndërsa "shpenzime për kimikate" në vitin 2023 janë realizuar në shumën 2,623 mijë lekë nga 3,360 mijë lekë të parashikuara ose në masën 78%, në vitin 2024 janë realizuar në shumën 1,222

mijë lekë nga 3,360 mijë lekë ose në masën 36%, në vitin 2025 janë realizuar 1,350 mijë lekë nga 1,800 mijë lekë të parashkuara ose në masën 75%. Pra ky zë shpenzimesh është parashikuar me rezerva përtej nevojave reale.

- Zëri "**Kosto operative"** ku përfshihen shpenzimet për energji elektrike, mirëmbajtje dhe riparime etj, konstatohet një realizim i ulët krahasuar me planifikimin, ku për vitin 2023 janë realizuar në shumën 132,385 mijë lekë nga 180,349 mijë lekë të planifikuara ose në masën 73%, për vitin 2024 janë realizuar 96,936 mijë lekë nga 157,885 mijë lekë ose në masën 61%, për vitin 2025 janë realizuar në shumën 104,461 mijë lekë nga 148,275 mijë lekë të planifikuara ose në masën 71%. Shpenzimet operative zënë një peshë në totalin e shpenzimeve të parashikuara në masën 30% për vitin 2023, në masën 27% për vitin 2024 dhe në masën 27.3 % për vitin 2025. Ndërsa kundrejt shpenzimeve faktike në masën 32% në vitin 2023 dhe në masën 24% në vitin 2024 dhe në masën 21.9% në vititn 2025. Shpenzimet që zënë peshë më të madhe në kostot operative janë:

✓ Peshën më të madhe e zënë **"Shpenzimet për blerje uji për abonentë dhe godinën e UKK"** që zënë 53 % të shpenzimeve operative të parashikuara dhe rreth 57% të shpenzimeve operative faktike, të cilat në fakt kanë ardhur duke ulur nga viti në vit. "Shpenzimet për blerje uji dhe godina" në vititn 2023 janë realizuar në shumën 76,355 mijë lekë nga 96,000 mijë lekë të parshikuara ose në masën 80%, në vitin 2024 janë realizuar në shumën 55,086 mijë lekë nga 85,000 lekë të parashikuara ose në masën 65% dhe në vitin 2025 janë realizuar në shumën 56,059 mijë lekë nga 60,000 lekë të parashikuara ose në masën 93%.

✓ **"Shpenzimet për energji elektrike"**zënë një peshë prej 15% për vitet 2023-2024 dhe 20% për vitin 2025 kundrejt shpenzimeve operative të parashikuara. Kundrejt shpenzimeve operative faktike zënë masën 15% në vitin 2023, masën 23% në vitin 2024 dhe masën 21.8% në vitin 2025. Këto shpenzime kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit për arsye të rritjes së cmimit të energjisë. "Shpenzimet për energji elektrike" për vitin 2023 janë realizuar në shumën 21,448 mijë lekë nga 26,400 mijë lekë të parashikuara ose në masën 81%, për vitin 2024 janë realizuar në shumën 23,248 mijë lekë nga 24,000 mijë lekë të parashikuara ose në masën 97%, në vitin 2025 janë realizuar në shumën 22,808 mijë lekë nga 30,000 mijë lekë të parashikuara ose në masën 76% për arsye të mbërritjes me vonesë të faturave.

✓ "**Shpenzime për interesa dhe kredi"** përfshijnë principalin dhe interesin që shoqëria ka për kreditë që disponon, konkretisht ky zë ka një peshë në totalin e shpenzimeve të parashikuara në masën 5.9% për vitin 2023, në masën 5% për vitin 2024 dhe në masën 4.6 % për vitin 2025. Këto shpenzime për vitin 2023 janë realizuar në shumën 13,824 mijë lekë nga 30,000 mijë lekë të parashikuara ose në masën 9%, për vitin 2024 janë realizuar në shumën 1,366 mijë lekë nga 25,200 mijë lekë të parashikuara ose në masën 5%, në vitin 2025 janë realizuar në shumën 0 lekë nga 25,000 mijë lekë ose në masën 0%. Ky mosrealizim i theksuar ka ardhur nga mospagesa e detyrimeve për shlyerjen e kësteve të kredisë sipas transheve të përcaktuara dhe të kërkuara nga Ministria e Financave si palë e nënshkrimit të huasë.

✓ **"Shpenzime për karburant"** zënë një peshë prej 5% për vitet 2023-2024 dhe 8% për vitin 2025 kundrejt shpenzimeve opative të parashikuara. Kundrejt shpenzimeve operative faktike zënë masën 4% në vitin 2023, masën 8% në vitin 2024 dhe masën 16% në vitin 2025. Këto shpenzime kanë duke u rritur nga viti në vit. "Shpenzimet për karburant" për vitin 2023 janë realizuar në shumën 5,229 mijë lekë nga 7,200 mijë lekë të parashikuara ose në masën 73%, për vitin 2024 janë realizuar në shumën 7,321 mijë lekë nga 8,000 mijë lekë të parashikuara ose në masën 92%, në vitin 2025 janë realizuar në shumën 11,554 mijë lekë nga 12,000 mijë lekë ose në masën 96%.

✓ Gjithashtu vihet re se ka realizime në nivele të ulëta të një pjese të shpenzimeve si: "*Shpenzime për mobilje zyrash*" në vitin 2023 në masën 77% dhe në vitin 2025 në masën 9754%; *"Shpenzime kancelarie*" në vitin 2023 në masën 72%, në vitin 2024 në masën 48% dhe në vitin 2025 në masën 59%; *Shpenzime postare telekom*" në vitin 2023 në masën 60%, në vitin 2024 në masën 57% dhe në vitin 2025 në masën 75%; *"Shpenzime analiza uji"* në vitin 2023 në masën 29%, në vitin 2024 në masën 115% dhe në vitin 2025 në masën 78%; *"Shpenzime materiale higjenike*" në vitin 2023 në masën 83%, në vitin 2024 në masën 50% dhe në vitin 2025 në masën 69%; *"Shërbime, riparime, mirëmbajtje kondicionim"* në vitin 2023 në masën 62%, në vitin 2024 në masën 85% dhe në vitin 2025 në masën 71%; *"Shpenzime për blerje vaj+filtra, goma e tjera pjesë këmbimi"* në vitin 2023 në masën 65%, në vitin 2024 në masën 85% dhe në vitin 2025 në masën 87%; *"Shpenzime për shërbim interneti*" në vitin 2023 në masën 42%, në vitin 2024 në masën 96% dhe në vitin 2025 në masën 66%; *"Shpenzime konsulence financiare dhe ligjore"* në vitin 2023 në masën 0%, në vitin 2024 në masën 0%; *"Shpenzime gjyqësore për gjygje të humbura"* në vitin 2023 në masën 12%, në vitin 2024 në masën 22 % dhe në vitin 2025 në masën 21%; *"Shpenzime për (Dezinfektim, dezinsektim, deratezim"* në vitin 2023 në masën 98%, në vitin 2024 në masën 68 % dhe në vitin 2025 në masën 100%.

- Zëri **"Shpenzime për investime kapitale"** ka një peshë në totalin e shpenzimeve të parashikuara në masën 5.7% për vitin 2023, në maën 4.3% për vitin 2024 dhe në maën 5.8 % për vitin 2025. Këto shpenzime për **vitin 2023** janë realizuar në shumën 23,956 mijë lekë nga 28,539 mijë lekë të parashikuara ose në masën 84%, për **vitin 2024** janë realizuar në shumën 14,979 mijë lekë nga 21,301 mijë lekë të parashikuara ose në masën 70%, në **vitin 2025** janë realizuar në shumën 28,576 mijë lekë nga 31,150 mijë lekë ose në masën 92%. Pra investimet në të 3 vitet zënë një peshë të papërfillshme në programin ekonomik, dhe ato investime të kryera janë me financim nga buxheti i shtetit, fakt që tregon se kjo shoqëri nuk kapacitete për rritjen edhe përmirësimin e shërbimit ndaj klienteve, kur sistemet dhe rrjrtet e ujësjllësit janë të amortizuara dhe kanë nevojë reale për investime kapitale. Në nivel projekti sipas viteve paraqiten si më poshtë:

- **Në vitin 2023** është parashikuar projektit me objekt: "Ndërtim-Rikonstruksion rrjeti Ujësjellësi Lagja Zall Mner" bashkë me projektim, supervizim dhe kolaudim në vlerë totale 25,189,595 lekë financimi i të cilit do të kryhet gjatë vitit ushtrimor 2023 nga buxheti i shtetit e cila i detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Parashikimi i projektit "Ndërtim-Rikonstruksion rrjeti Ujësjellësi Lagja Zall Mner"

Nr	Emërtimi i i nvestimit	Vlera e parashikuar në programin ekonomik pa tvsh	Vlera e kontratës së lidhur pa tvsh	Financuar Viti 2023	Financuar Viti 2024	Financuar Viti 2025
1	Ndërtim-Rikonstruksion rrjeti Ujësjellësi Lagja Zall Mner	22,420,437	20,456,455	15,456,455	3,977,177	1,022,822 -garanci
2	Projektim	2,098,553				
3	Supervizim, kolaudim punimesh	670,370	538,090		538,090	
	Totali	**25,189,360**	**20,994,545**	**15,456,455**	**4,515,267**	**1,022,822**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Ndërsa nga të ardhurat e veta janë parashikuar investime me objekt: "Blerje kompjuterash dhe printerash" në vlerën 1,700,00 lekë dhe "Mobilje zyrash" në vlerën 250,000 lekë

- **Në vitin 2024** është parashikuar realizimi i projektit me objekt: "Investimi Kun-je rruga Argjinatuara deri te Azili i Pleqve (rruga Teuta)" në vlerën 21,300,595 lekë financimi i të cilit është parashikuar të kryhet gjatë dy viteve ushtrimore 2024-2025.

Tabela: Parashikimi i projektit "Investimi Kun-je rruga Argjinatuara deri te Azili i Pleqve (rruga Teuta)"

Nr	Emërtimi i i nvestimit	Vlera e parashikuar në program ekonomik pa tvsh	Vlera e kontratës së lidhur pa rvsh	Financuar Viti 2024	Financuar Viti 2025	Mbetur për tu financuar viti 2026
1	Investim Kun rruga Argjinatura deri te Azili i Pleqve (rrug Teuta)"	21,300,595	14,979,450		11,666,666	3,312,784
2	Mbikqyrje punimesh	544,719	502.817			502,817
3	Kolaudim punimesh	81,708	80,000		80,000	
	Totali					

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

- **Në vitin 2025** është parashikuar realizimi i projektit me objekt: "Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujsjellësit nga Impianti i Bovillës-Depo Maloku, Bashkia Kamëz" në vlerën 60,983,375 lekë lekë pa Tvsh dhe projekti me objekt: "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz" në vlerën 495,914,580 lekë pa Tvsh, financimi i të cilave do të kryhet gjatë dy viteve ushtrimore 2025-2026 nga AKUK (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve).

Tabela: Parashikimi i projekteve viti 2025

Lekë

Nr	Emërtimi i i nvestimit	Vlera e parashikuar në program ekonomik Lekë pa tvsh	Vlera e kontratës së lidhur lekë pa tvsh	Financuar Viti 2025 lekë pa tvsh	Mbetur për tu financuar viti 2026 lekë pa tvsh
1	Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujsjellësit nga Impianti i Bovillës-Depo Maloku, Bashkia Kamëz	60,938,375	50,819,479	41,422,805	9,396,674
	Projektim	-	1,239,417	-	1,239,417
	Supervizim, kolaudim punimesh		185,913		185,913
2	"Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz	495,914,580	495,914,580	285,623,475	210,291,105
	Projektim	-	4,576,703	2,292,043	2,284,660
	Supervizim, kolaudim punimesh	-	686,505	-	686,505
	Totali	**556,852,955**	**553,422,597**	**329,338,323**	**224,084,274**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

- Zëri "**Fondi Rezervë" dhe "Fondi i veçantë për të përndjekurit politik"** ka peshën prej 2.6% mbi totalin e shpenzimeve të parashikuara për vitin 2023, në masën 1.9% për vitin 2024 dhe në masën 1.7 % për vitin 2025.

- **"Fondi rezervë"** për vitin 2023 është parashikuar në shumën 9,694 mijë lekë, për vitin 2024 në shumën 5,647 mijë lekë dhe për vitin 2025 në shumën 5,647 mijë lekë, ku në fakt ky fond nuk është përdorur në të tre vitet objekt audititmi.

Konkluzion: "**Fondi i vecantë për të përndjekurit politik"** për vitet 2023-2024-2025 është parashikuar 3,500 mijë lekë në vit, në total 10,500 mijë lekë, shumë e cila nuk është derdhur për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë, në kundërshtim me shkronjën "b" të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë" dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë" e cila përcakton: "*pika b) shuma prej një për qind mbi fondin e pagave, që do të derdhin ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore."*

❖ Të ardhurat

Parashikimi dhe realizimi i programeve ekonomike sipas viteve në lidhje me të ardhurat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Parashikimi dhe realizimi i programeve ekonomike lidhur me të ardhurat 2023-2025

Njësia Lekë

Emertimi	Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025		
	Planifikimi	Faturimet	Ne %	Planifikimi	Faturimet	Ne %	Planifikimi	Faturimet	Ne %
Familjarët	376,447,000	307,737,117	82%	372,444,679	328,197,394	88%	291,911,181	259,487,970	89%
Privatët/Buxhetor	87,107,000	54,615,038	63%	74,874,193	62,356,268	83%	65,108,276	58,780,622	90%
Taksa	129,406,564	129,406,564	100%	140,190,471	140,190,471	100%	132,938,443	132,938,443	100%
Të tjera	37,866,000	37, 218,477	98%	31,334,400	78,441,331	250%	52,648,044	67,243,182	127%
Shuma	**630,826,564**	**528,977,196**	**84%**	**618,843,743**	**609,185,464**	**98%**	**542,605,944**	**518,450,217**	**96%**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Referuar treguesve te programit ekonomik rezulton se te ardhurat për **vitin 2023** janë faturuar në shumën 528,977 mijë lekë nga 630,827 mijë lekë të planifikuara ose në masën 84%, për **vitin 2024** janë faturuar në shumën 609,185 mijë lekë nga 518,843 mijë lekë të planifikuara ose në masën 98%, për **vitin 2025** janë faturuar në shumën 518,450 mijë lekë nga 542,605 mijë lekë të planifikuara ose në masën 96%. Më hollësisht gjendja e kërkesave për arkëtim sipas faturimit dhe të arkëtimit të ujit të pijshëm në periudhën e audituar paraqitet si më poshtë.

Tabela: Gjendja e kërkesave për arkëtim sipas faturimit dhe të arkëtimit të ujit të pijshëm 2023-2025

Emertimi	Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025		
	Faturimet	Arketimet	% e realiz	Faturimet	Arketimet	% e realiz	Faturimet	Arketimet	% e realiz
Familjarët	307 737 117	272 313 247	88%	328 197 394	303 503 576	92%	259 487 970	305 341 687	117%
Privatët/Buxhetor	54 615 038	51 074 612	94%	62 356 268	67 970 631	109%	58 780 622	63 901 820	108%
Taksa	129 406 564	97 587 964	75%	140 190 471	108 891 453	78%	132 938 443	123 183 554	93%
Të tjera	37 218 477	37 218 477	100%	78 441 331	74 941 331	96%	67 243 182	65 133 213	97%
Shuma	**528 977 196**	**458 194 300**	**87%**	**609 185 464**	**555 306 991**	**91%**	**518 450 217**	**557 560 274**	**107%**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e pasqyrave të mësipërme vërehet se arkëtimi i të ardhurave nga shitja e ujit të pijshëm për vitin 2023, 2024 dhe vitin 2025, ka pasur rritje nga viti në vit, ku në vitin 2023 është realizuar arkëtimi për kategorinë abonent "familjarë"në masën 88 % dhe në vitin 2024 është realizuar arkëtimi për kategorinë abonent "familjarë"në masën 92% dhe në vitin 2025 është realizuar arkëtimi për kategorinë abonent "familjarë"në masën 98%.

Në vitin 2023 është realizuar arkëtimi për kategorinë abonent "Privatë/Buxhetor"në masën 94 % dhe në vitin 2024 është realizuar arkëtimi për kategorinë abonent "Privatë/Buxhetor"në masën 109 % dhe në vitin 2025 është realizuar arkëtimi për kategorinë abonent "Privatë/Buxhetor"në masën 108 %.

Gjithashtu pjesë e rritjes së debisë në nivel total të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a kanë ndikuar edhe taksat familjare që faturohen nga shoqëria si agjent tatimor i Bashkisë Kamëz SHA Ato paraqiten në vlera 75%-79% arkëtim të faturimeve.

Analiza e performancës së Shoqërisë "UK Kamëz" SHA

Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit krahasuar me vitin 2023 (fillimi i periudhës së auditimit). Megjithatë

arkëtimi i vitit ushtrimor është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj.

- Treguesit e performancës të publikuara nga ERRU, në bazë të raportimeve për vitin korent të bëra nga Ujësjellës Kanalizime Kamëz sha në janar të vitit pasaardhës për periudhën e auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Treguesit e performancës 2023-2025

Nr.	Treguesit e Performancës	2023	2024	Tregues I pranueshëm nga ERRU	Niveli i performancës nga UKK sha
1	Ujë pa të ardhura (%)	71.5	67.1	30	Performance e dobet
2	Mbulimi I Kostove O & M (%)	83.3	91.2	100	Pranueshme
3	Mbulimi I Kostove Totale (%)	65	71.5	80	Pranueshme
4	Norma e Arkëtimit të përgjithshëm (%)	89	91	82	Pranueshme
5	Norma e Arkëtimit Korente (%)	76.6	77.9	82	Pranueshme
6	Niveli I matjes (%)	85.1	85.3	85	Pranueshme
7	Efiçenca e Stafit (nr)	4.79	4.88	4.6.10	Mire
8	Kohëzgjatja e furnizimit me ujë (Orë)	4	4	18	Performance e dobet
9	Mbulimi me kanalizime KUN (%)	78.6	76.28	75	Mire
10	Mbulimi me furnizim me ujë	89	87	85	Mirë

Burimi: Nga publikimi i ERRU të të dhënve të UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Konkluzion: Raportimi në Entin Rregullator të Ujit (ERRU) mbi realizimin e treguesve ekonomik e financiar dhe të performancës për vitet 2023 dhe 2024 me email-et përkatëse të datave 04.01.2024 dhe 23.01.2025 nuk përputhet me raportimin vjetor financiar dhe jo financiar që paraqitet në Këshillin Administrimit. Raportimet periodike mujore të shoqërisë, janë të padetajuara, vetëm me të dhëna në tabela, pa analiza të hollësishme mbi shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në arritjen e objektivave të shoqërisë, si dhe nuk janë propozuar masat për të rregulluar gjendjen në të ardhmen. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.25/2018 datë "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 17 dhe 18, me Ligjin nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" i ndryshuar nenet 14/b,f, 20 dhe 31/1.a., me "Rregulloren e liçencimit për procedurat e dhënies dhe rinovimit të liçencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (e ndryshuar)", miratuar me vendim të KKRRU nr. 29, datë 08.12.2009, ndryshuar me vendim të KKRR nr. 30, datë 07.12.2012 ndryshuar me vendim të KKRR nr. 50, datë 30.12.2013, nenet 17, 29, 30.

Shënim: Nga auditimi i dokumentacionit financiar dhe teknik në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet dhe prodhimit, blerjes dhe furnizimit me ujë rezultojnë se, treguesit e performancës për vitin ushtrimor (korent) janë përmirësuar pas saktësimit të shumave me mbylljen e pasqyrave financiare me 31 mars të vitit pasardhës të trajtuara më poshtë:

- *Treguesit e mbulimit të kostove të O&M (Kostot e Operim & Mirëmbajtjes) dhe ato Totale*

Mbulimi i kostove O&M është një tregues i performancës financiare që paraqet raportin e të ardhurave të realizuara nga aktiviteti dhe mbulimin prej tyre të kostove operative që nevojiten për funksionimin e aktivitetit. UKK sha ndodhet në zonën e performancs së pranueshme nga ERRU dhe ka pasur rritje të nivelit të kësaj performance. Ky tregues është themelor për qëndrueshmërinë financiare.

Mbulimi i kostove Totale është një tregues i performancës financiare i cili paraqet raportin për të cilat të ardhurat e realizuara nga aktiviteti mbulojn kostot totale që nevojiten për funksionimin e aktivitetit. UKK sha ndodhet në zonën e performancës së pranueshme nga ERRU dhe ka pasur

rritje të nivelit të ksaj performance. Parashikimi dhe realizimi i treguesve kryesorë, paraqitet si mëposhtë:

Tabela: Parashikimi dhe realizimi i treguesve kryesorë 2023-2025

000/lekë

	Emërtimi	Viti 2023			Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Kosto e punës	237,359	222,929	94	264,631	244,190	92	312,633	307,699	98
	Kosto e energjisë	26,400	21,448	81	24,000	23,247	97	30,000	22,808	76
	Kosto e riparimit	4,700	3,998	85	3,800	1,996	52	5,550	4,603	82.9
	Kosto kimikateve	3,360	2,622	78	3.360	1,222	36	1,800	1,350	75
	Kosto te tjera + të kontraktuara	150,668	126,259	83.7	133,721	96,109	72	115,259	100,182	86.9
	Kosto e karburanteve	7,200	5,228	73	8,000	7,321	92	12,000	11,554	96
	Kosto Kredie dhe interesi	30,000	13,824	46	25,200	1,366	5.4	25,000	0	0
I	**Kosto Direkte e Operimit**	**459,687**	**396,308**	**86**	**459,356**	**375,451**	**81.7**	**502,242**	**448,195**	**89.2**
	Shuma pa amortizimin	459,687	396,308	86	459,356	388,451	84.5	462,774	418,799	90.4
	Amortizimi		98,262			113,423			124,765	
II	**Kosto Totale**	**459,687**	**494,570**		**459,356**	**501,874**		**462,774**	**543,564**	
	Familjarë	307,737	272,313	88	328,197	303,503	92	291,911	259,487	89
	Buxhetor/Privatët	54,615	51,074	94	62,356	67,970	109	65,108	58,780	90
	Taksa	129,406	97,587	75	140,190	108,891	78	132,938	132,938	100
	Të tjera	37,218	37,218	100	78,441	74,941	96	52,648	67,243	127
III	**Shuma e faturuar**	**528,977**	**458,977**	**87**	**609,185**	**555,306**	**91**	**542,605**	**518,450**	**96**
	Shuma subvencion + të ardhura te tjera									
IV	**Totali te ardhura nga faturimi**	**528,977**	**458,194**	**87**	**609,185**	**555,306**	**91**	**518,450**	**557,560**	**90**
	Arkëtime nga Shitja uji (viti koherent)		388,866			443,103			369,243	
	Arkëtime nga Shitja (faturat prapamb)		32,110			37,262			24,001	
	Arkëtime nga Shërbime të Tjera		37,218			74,941			164,316	
	Arkëtime Total		**458,194**			**555,306**			**557,560**	
	Grand nga AKUM									

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Referuar treguesve të parashikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton se:

- Mbulimi kostove nga të ardhurat sipas parashikimit në programin ekonomik

Për **vitin 2023** kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 107% nga të ardhurat e vitit, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 86%.

Për **vitin 2024** kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 133% nga të ardhurat e vitit, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 103%.

Për **vitin 2025** kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 117% nga të ardhurat e vitit 2025, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 99.8%.

- Mbulimi kostove nga të ardhurat sipas faktit në programin ekonomik

Për **vitin 2023** kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 116% nga të ardhurat e vitit, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 92%.

Për **vitin 2024** kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 143% nga të ardhurat e vitit, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 111%.

Për **vitin 2025** kostoja direkte e operimit është mbuluar në masën 117% nga të ardhurat e vitit 2025, ndërsa kostoja totale është mbuluar në masën 99.8%.

Për të tre vitet 2023-2024-2025 kostoja direkte e operimit dhe kostoja totale është mbuluar në masën mbi 100% nga të ardhurat, pra mbi nivelin e kërkesave të përcaktuara në "Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022 – 2030", ku për vitin 2023 ky tregues parashikohet në nivelin 90%. Në mënyrë të përmbledhur këta tregues të shprehur në vlerë absolute paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Parashikimi dhe realizimi i treguesve kryesorë në vlerë absolute 2023-2025

000/lekë

Emërtimi	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Plan(fat)	Fakt (arket)	Plan(fat)	Fakt (arket)	Plan(fat)	Fakt (arket)
Arketim Total	528,977	458,194	609,185	555,306	518,450	557,560
Kosto Direkte	459,687	396,308	459,356	388,451	462,774	418,799
Deficit/suficit	+69,290	+61,886	+149,829	+166,855	+55,676	+138,761

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

❖ *Analiza e treguesve mbi arkëtimet nga shitja e ujit.*

✓ **Norma e Arkëtimit** është shprehje në % e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës-kanalizime. Ky tregues paraqet efektivitetin e shoqërisë për të garantuar likujditetin e tyre dhe varet kryesisht nga faktorë manaxherial.Shoqëria krahas arkëtimit të faturave korente bën përpjekje edhe për arkëtimin e debive të prapambetura duke përdorur mekanizma si lidhje akt-marrëveshjeve shoqëri-klient, për pagesën e tyre me këste.

Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se **norma e arkëtimit** është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë, e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese, konkretisht:

Tabela: Arkëtimet për vitet 2023-2024-2025 sipas abonentëve

Përshkrimi	Njësia matëse	Vlerat e arkëtimeve sipas viteve		
		Fakt 2023	Fakt 2024	Fakt 2025
Lidhjet e Ujit te Regjistruara	**numri**			
Familjare		26,201	27,822	31,337
Ente Private		1,928	2,112	2,509
Institucione Buxhetore		81	92	105
Lidhje Ujësjellësi Aktive	**numër**			
Familjare		25,643	27,198	28,832
Te Ardhura	**Në lekë**			
Komponenti Fiks i Tarifes	"			
Familjare	"	28,033,000	32,226,000	35,486,700
Ente Private	"	4,471,000	4,876,000	5,671,300
Institucione Buxhetore	"	192,000	211,000	126,000
Shitje Ujë	"			
Familjare	"	248,074,117	262,298,394	189,094,238
Ente Private	"	37,015,038	42,058,268	38,804,862
Institucione Buxhetore	"	8,613,000	10,561,000	8,500,000
Kanalizime	"			
Familjare	"	31,630,000	33,673,000	34,907,040
Ente Private	"	3,319,000	3,378,000	4,654,460
Institucione Buxhetore	"	1,005,000	1,272,000	1,024,000
Te Ardhura sipas kategori Konsumator në mënyrë të përmbledhur (faturimet)	"			
Familjare	"	307,737,117	328,197,394	259,487,970
Ente Private	"	44,805,038	50,312,268	49,130,622
Institucione Buxhetore	"	9,810,000	12,044,000	9,650,000
Taksa	"	129,406,564	140,190,471	132,938,443
Të tjera	"	37,218,477	78,441,331	67,243,182
Te Ardhura nga Shitja (nga tarifa)	"	**528,977,196**	**609,185,464**	**518,450,217**
Norma e Arketimit te Faturave (%/Vit)	"	86.6%	**91.2%**	**107%**
Arkëtime nga Shitja (viti korent)	"	**388,865,254**	**443,102,858**	**369,243,274**
Arkëtime nga Shitja (faturat prapambetura)	"	**32,110,569**	**37,262,802**	**24,001,000**
Arkëtime nga Shërbime të Tjera	"	**37,218,477**	**74,941,331**	**164,316,000**
Arkëtime Total	"	**458,194,300**	**555,306,991**	**557,560,274**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

- Zëri "Arkëtime nga shërbime të tjera" përfshihen arkëtimet e tjera të faturuara si: lidhje të reja, akt kolaudim, prerje rilidhje, si edhe arkëtimi i shumës si agjent i mbledhjes së taksës së Bashkive, bazuar në normën e % së secilës njësi.

- Lidhjet e ujit për periudhen objekt audtimi 2023-2024-2025 nga viti në vit kanë ardhur duke u rritur sipër abonentët familjarë dhe abonentët "ente private" si në numër kontratash edhe në vlerë monetare.

- Komponenti i tarifes fikse është tarifa fikse për mirëmbajtjen e kontratës, aplikohet në rastet e basave apo enteve private që janë bosh. Ky tregues ka ardhur duke u ulur nga viti 2023 në vitin 2025.

✓ Përsa i përket arkëtimit të debive të prapambetura, shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Arkëtimi nga "U.K.Kamëz" sha për vitet 01.01.2023-31.12.2025 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Arkëtimet e detyrimeve të prapambetura 2023-2024-2025

(në lekë)

ARKETIM +KAMATE	2023			2024			2025		
	Parashikim (faturimi)	Fakt (Arkëtimi)	% e realiz	Parashikim (faturimi)	Fakt (Arkëtimi)	% e realiz	Parashikim (faturimi)	Fakt (Arkëtimi)	% e realiz
Total	528.977.196	458.194.300	86.6%	609.185.464	555.306.991	91%	542,605,944	557,560,274	107%
Koherent	458.194.300	426.083.731	92.9%	555.306.991	518.044.189	93.2%	542,605,944	518,450,217	95.5%
I prapambetur	70.782.896	32.110.569	45%	53.878.473	37.262.802	69 %	24,155,727	39,110,057	161%
% arketim koherent	86.6 %	92 %		91 %	93%		95.5%	93%	
% arketim i prapambetur	13.4 %	8 %		9 %	7%		4.5%	7%	

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Në **vitin 2023** arkëtimet totale janë në vlerën 458,194,300 lekë, ku arkëtimet të vitit ushtrimor (koherente) janë në vlerën 426,083,731 lekë ose 92 % dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 32,110,569 lekë ose 8%. Në **vitin 2024** arkëtimet totale janë në vlerën 555,306,991 lekë, ku arkëtimet të vitit ushtrimor (koherente) janë në vlerën 518,044,189 lekë ose 93% dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 37,262,802 lekë ose 7%. Në **vitin 2025** arkëtimet totale janë në vlerën 557,560,274 lekë, ku arkëtime të vitit ushtrimor janë në vlerën 518,450,217 lekë ose 93%, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 39,110,057 lekë ose 7%.

Për periudhën e auditimit niveli i faturimit dhe arkëtimit i vitit uashtrimor dhe në total është mbi normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU. Përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit krahasuar me vitin 2023 (fillimi i periudhës së auditimit). Megjithatë arkëtimi i vitit ushtrimor (koherent) është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse. Ndërsa arkëtimi i debive të prapambetura mbetet në nivele të ulëta. Mosarkëtimi i detyrimeve nga abonentët e të gjithë kategorive është në kundërshtim me:

-VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK", pjesa II pika 4;

-VKM nr. 236, datë 10.5.1993 "Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar", i ndryshuar, neni 1;

- Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm", i ndryshuar, pika 6, - Kontratën e Shërbimeve Ujësjellës Kanalizime, miratuar me vendim të KKRR Nr. 25, datë 08.07.2015 "Kontratë për shërbime Ujësjellës – Kanalizime e përditësuar" neni 7 dhe 10.

❖ *Mbi prodhimin, blerjen e ujit, shërbimi e furnizimit me ujë dhe faturimin e ujit dhe nivelin e matjes*

Shërbimi i furnizimit me ujë në Bashkinë Kamëz ofrohet për 74.14% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet 11,004,000 m^3 ujë prej së cilës, vetëm 98.2% rezulton i matur, pjesa tjetër vlerësohet. Numri i kontratave për 2024 është mbyllur me 30,026 lidhje rrjeti ujësjellës dhe 21,507 kontrata ujrave të ndenjura. Konsumi i faturuar për konsumatorët familjarë me matje dhe afrofe paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Konsumi i faturuar për konsumatorët familjarë me matje dhe afrofe 2023-2024-2025

Shoqëria UK Kamëz	Popullsia me shërbim	Konsumi Total në m3	Konsumi I matur në m3	Konsum I pamatur në m3	Nr.i lidhjeve me matës	Nr.i lidhjeve pa mates	Konsum I matur l/ditë,banor
Viti 2024	111,292	3,367,000	3,000,000	367,000	25,861	4,165	87.2

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Shoqëria Ujësjellës kanalizime Kamëz sha ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit por shoqëria furnizon me 4 orë në ditë qytetarët sipas raportit vjetor të performancës të UKK Sha. Të dhënat për numrin e popullsisë që i ofrohet shërbim dhe asaj të regjistruar në zonën e shërbimit sipas raportimit të shoqërisë pranë ERRU-së praqitet:

Tabela: Popullsia që i ofrohet shërbim dhe ajo e regjistruar në zonën e shërbimit

Shoqëria UK Kamëz	Popullsia me shërbim	Uji që futet në sistem (m3)	Konsumi total i matur dhe Afrofe	Popullsia e Regjistruar në zonën e shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i tij (në m3/vit)
Viti 2024	111,292	11,004,000	87.2	150,101	13,824,000

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a ka 2 burime nga të cilat furnizohet me ujë dhe një pjesë të ujit që faturon e blen nga U.K. Tiranë sha.

- Nga auditimi mbi prodhim-blerjen e ujit dhe faturimin e ujit, u konstatua se për **vitin 2023** janë prodhuar dhe blerë gjithsej **11.73 milion m^3** ujë dhe nga këto vetëm 3.35 milion m^3 ujë janë faturim ujë i pijshëm, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 71% e ujit të prodhuar. Për **vitin 2024** janë prodhuar dhe blerë gjithsej 11 milion m^3 ujë dhe nga këto vetëm 3.62 milion m^3 ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 68% e ujit të prodhuar. Për **vitin 2025** janë prodhuar dhe blerë gjithsej 10.229 milion m^3 ujë dhe nga këto vetëm 3.774 milion m^3 ujë janë faturuar, çka ka rezultuar në humbje teknike në masën 63 % e ujit të prodhuar. Uji pa të ardhura mbetet problem serioz, pasi norma është shumë e lartë.

✓ **Uji Pa të Ardhura (UPA)** është **s**asia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve.Uji pa të ardhura është një nga indikatorët kryesor të performancës së sektorit të ujit dhe një nga pengesat kryesore të performancës teknike që ndikon në situatën financiare.Vërehen përmirësime nga viti në vit por ende treguesi është në nivele jo të kënaqshme. **Në lidhje me prodhimin e ujit** pas instalimit të matësave të prodhimit në disa prej stacioneve kryesore rezulton se prodhimi i ujit është më i madh se ai që rezulton në përllogaritje. Të dhënat përmbledhëse për prodhimin, faturimin dhe ujin pa të ardhura përgjatë periudhës së auditimit paraqitet:

Tabela: *Uji pa të ardhura %*

000/m³

Emërtimi	Fakt 2023	Fakt 2024	Fakt 2025
Prodhim	11.738	11,004	10,229
Faturim	3.355	3.620	3.774
% uji pa të ardhura	**71%**	**67%**	**63%**

Burimi: UK Kamëz

Norma e lartë i referohet kryesisht rrjetit të amortizuar pra humbjeve teknike, por një peshë të rëndësishme në humbje zenë edhe lidhjet e paligjshme sidomos në zonat informale ku rrjeti nuk është i kontrollueshëm. Niveli i ujit pa të ardhura është në rënie, ku për vitin 2023 është në masën 71%, në vitin 2024 në masën 67% dhe në vitin 2025 në masën 63%, kur ky tregues nga ERRU është i pranueshëm në masën 30%. Ndërsa referuar "Strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030" ky tregues për vitin 2023 parashikohet në nivelin 60%.

✓ **Niveli i Matjes** është tregues që ka ardhur në përmirësim nga viti në vit. Të dhënat për numrin e abonentëve sipas kategorisë së tyre të pajisur me matësa, pa matësa dhe lidhjet e kontratave për peridhen objekt auditimi paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Abonentët sipas kategorisë së tyre të pajisur me matësa, pa matësa dhe lidhjet e kontratave 2023-2025

Nr	E m ë r t i m i	2023	2024	2025
1	**Numri i lidhjeve me matës**	**22,429**	**25,609**	**28,874**
a.	Familje	22,191	23,657	26,681
b.	Ente private	1,741	1,907	2,108
c.	Institucione	64	45	85
2	**Numri i lidhjeve afrofe**	**1,595**	**1,499**	**923**
a.	Familje	1,570	1,446	869
b.	Ente private	20	33	34
c.	Institucione	5	20	20
3	**Numri i lidhjeve Tarifë shërbimi**	**2,494**	**2,918**	**4,154**
a.	Familje	2,315	2,721	3,780
b.	Ente Private	179	197	374
c.	Institucione	0	0	
	Totali	**28,210**	**30,026**	**33,951**

Burimi: UKKamëz sha dhe Përllogaritje e grupit të auditimit të KLSH

- Humbjet nga faturimi afrofe kanë ardhur si rezultat se ekziston ende një numër subjektesh afrofe, pavarësisht se numri i lidhjeve me matës nga viti 2023 deri në 2025 ka qënë në rritje.

Për vitin 2023 nga 28,210 lidhje në total 1,595 subjekte janë faturuar afrofe me një një peshë specifike prej 5.6%. Për vitin 2024 nga 30,026 subjekte në total 1,499 subjekte janë faturuar afrofe me një një peshë specifike prej 4.99 %. Për vitin 2025 nga 29,647 subjekte në total, 923 subjekte janë faturuar afrofe me një peshë specifike prej 2.75%. Humbjet më të mëdha në lidhje me afrofet vijnë nga abonentët familjarë.

Gjatë periudhës objekt auditimi nga ana e shoqërisë janë programuar dhe kryer investime në drejtim të vendosjes së matësave të ujit, duke montuar në total për tre vite1976 matësa, ku **për vitin 2023** janë vendosur 635 matësa, **për vitin 2024** janë vendosur 945 matësa dhe për vitin 2025 janë vendosur 815 matësa.

Konsumatorët duhet të paguajnë për sasinë reale të ujit të konsumuar prej tyre, prandaj pajisja me ujëmatës të gjithë sistemit mbetet një nga sfidat e shoqërisë në mënyrë që të lehtësohen problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimit të tij nga mbikonsumi.

- Humbjet nga mos lidhja e kontratave (mos faturimi), bazuar në të dhënat e paraqitura u konstatua se, për vitin 2023 janë 28,210 kontrata të lidhura, për vitin 2024 janë 30,026 kontrata të lidhura dhe për vitin 2025 janë 33,951 kontrata të lidhura.
Nga Sektori i Shitjes nuk është marrë numri i familjeve në Zyrën e Gjendjes Civile në Bashkinë Kamëz. Nuk janë marrë të dhëna mbi numrin e familjeve që kanë lidhur kontratë me CEZ shpërndarje. Nuk janë marrë të dhëna mbi numrin e subjekteve private në Drejtorinë e Tatimeve Tiranë dhe Sektorin e Taksave e Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë. Këto të dhëna të krahasoheshin me numrin e familjeve dhe numrin e bizneseve që kanë lidhur kontratë me këtë shoqëri, për të bërë të mundur gjykimin sa më të drejtë në drejtim të humbjeve në rrjet si pasojë e konsumit të ujit nga familjarë e biznese pa kontratë dhe ligjërimin e tyre.
Për sa më sipër nuk është vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr. 236, datë 10.5.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë", i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2, si dhe Udhëzimit nr. 3, datë 28.7.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm", Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, pika II, vendosja e aparateve matës të ujit.

Si përfundim, për periudhën objekt auditimi konstatohet se: Nuk ka programe zhvillimi të hartuar, bazuar në treguesit historik, në iniciativat, perspektivat e investimeve, por kanë patur prioritet vetëm treguesit e prodhimit, faturimit dhe arkëtimit duke i planifikuar me rritje, por pa argumentuar nga ana sasiore apo cilësore, pa një analizë të hollsishme për aftësinë paguese të shoqërisë; Në relacionet dhe në raportet mbi realizimin e programit ekonomik nuk jepen shpjegime të sakta mbi arsyet dhe faktorët e realizimit ose mosrealizimit të treguesve të planifikuar; Nuk ka përllogaritje të sasisë së ujit që humbet nga lidhjet e paligjshme që janë në rrjetin aktual që administrohet nga shoqëria, pasi janë futur në humbje dhe shpërdorimet e ujit nga lidhjet e paligjshme dhe nga mosfaturimi i ujit, të cilat janë konsideruar si humbje tekniko-ekonomike në masën 60-70%; Megjithë punën e bërë nuk janë evituar humbjet e ujit që vijnë nga rrjedhjet në depot e ujit të dukshme dhe jo të dukshme, humbjet nga lidhjet e paligjshme, humbjet për shkak të rrjedhjeve në linjat e transmetimit, të cilat kanë humbje teknike (reale) por llogariten me vlerësim; Nuk janë shfrytëzuar të gjitha burimet në rritjen e faturimit të ujit për mungesë të instalimit të sistemit të matjes në gjithë rrjetin shpërndarjes, në përmirësimin e cilësisë së ujit te konsumatorët, si dhe në rritjen e kohës së furnizimit me ujë/24 orë, e cila sot është 4 orë/në 24 orë; Megjithëse arkëtimi koherent kundrejt faturimit është në nivele të larta rreth 98%, por edhe debitë janë në nivele të larta, ndërsa arkëtimet e detyrimeve të prapambetura janë në nivele të ulëta rreth 8%. Edhe pse norma e arkëtimit për mbulimin e kostove direkte të operimit&mirëmbajtjes dhe kostos totale është në nivel të pranueshëm të përcaktuar nga ERRU, duhet theksuar se kostot e punës, ku përfshihen shpenzimet për paga, shtesa e kontribute për punonjësit janë në nivele të larta nga rritja e numrit të punonjësve nga viti në vit. Këto shpenzime zënë rreth 56-69% të kostos direkte O/M dhe rreth 45-56% të kostos totale dhe me një koeficient të numrit të punonjësve në 1000 lidhje të UK prej 4,93-5.54 mbi nivelin prej 4.6 të përcaktuar nga ERRU. Këto shpenzime duheshin kontrolluar në drejtim të uljes së tyre dhe rritjes nga ana tjetër e shpenzimeve për investime e mirëmbajtje për përmirësimin e proceseve të punës për furnizimin me ujë të komunitetit dhe menaxhimin e sistemit të kanalizimeve, si dhe rritjen e faturim-arkëtimeve e uljen e humbjeve.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi strukturat drejtuese të shoqërisë, z. E. M. me detyrë ish-Administrator i Shoqërisë (për periudhen 01.01.2023- 12.07.2024), z. Sh. L. me detyrë Administrator i Shoqërisë (për periudhen 12.07.2024 e në vazhdim), znj.E. P. me detyrë Drejtore e Departamentit Ekonomik dhe z. B. A. me detyrë Drejtor i Departamentit Teknik.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.3. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:
-Struktura Organizative e UKK, Njësive dhe numri i punonjësve;
-Planet e nevojave për rekrutim,
-Databaza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna.
-Listë pagesat për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, etj.

1. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimet/emërimet dhe lirimet nga detyra/largimet nga puna të punonjësve.

Me vendimin nr. 11, datë 13.11.2017 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve të Shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" Sh.A, është miratuar Akti i Themelimit dhe statutit të shoqërive që krijohen rishtazi nga ndarja e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sh.A, miratuar me Vendimin nr. 8, datë 27.09.2017 të Asamblesë së Aksionarëve, i cili vendosi,
Miratimin e Statutit dhe aktit të themelimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Bashkia Kamëz Sh.a si një nga tre shoqëritë pritëse që krijohen rishtazi nga ndarja e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a, me miratimin e akteve të ndarjes me Vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të UKT sha. Nr. 8, datë 27.09.2017.
Me vendimin nr. 2, datë 01.10.2019, është vendosur ndryshimi i emrit të shoqërisë nga Ujësjellës Kanalizime Bashkia Kamëz Sh.a, në Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a (UKK Sh.a)

Me vendimin nr. 4, datë 02.12.20199 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.A", është vendosur miratimi i strukturës dhe miratimi i nivelit të pagave. Numri total i punonjësve sipas këtij vendimi është 191 punonjës.
Për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2025 janë bërë ndryshime në strukturë.
Me vendimin nr. 11, datë 01.12.2022 "Për disa shtesa dhe në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të ujësjellës kanalizime kamëz sh.a. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 280.
Me vendimin nr. 13, datë 18.12.2023 dhe nr. 9, datë 19.12.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 290.
Me vendimin nr. 11, datë 23.12.2024 dhe nr. 8, datë 27.12.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 299.
Me vendimin nr. 5 dhe 7, datë 18.08.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 309.
Vendimet e mësipërme janë miratuar nga Këshilli Administrativ si dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, e cila përbëhet nga ortaku i vetëm, Kryetari i Bashkisë Kamëz.

Organika përbëhet si më poshtë:
1.Asambleja e Përgjithshme;
2.Këshilli i Administrimit;
3.Administratori;
4.Departamenti Teknik me 8 Sektorë;
5.Departamenti Ekonomik me 6 Sektorë;
6.Njësia Kamëz me 2 Sektorë;
7.Njësia Bathore me 2 Sektorë;
8.Njësia Valias – Laknas me 2 Sektorë;
9.Njësia Paskuqan me 2 Sektorë;
10.Njësia Babrru me 2 Sektorë;

Për vitet objekt auditimi, UK Kamëz është drejtuar si vijon:
-Deri më 10.01.2023 Dr. i Përgjithshëm z. G. M;
-Z. E.S. për periudhën 10.01.2023 deri më 09.07.2024;
-Z. SH.L. për periudhën 09.07.2024 e në vijim;
Përgjatë viteve periudhë auditimi, lëvizjet e punonjësve të UKK rezultojnë, si më poshtë:
Tabela: Emërime, transferime, largime për periudhën 2023-2025

Viti	Emërime	Transferime	Largime
2023	46	22	29
2024	49	35	41
2025	42	18	23

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Emërimet
Lidhur me emërimet e bëra nga UKK Sh.a për vitet objekt auditimi, mungojnë proceset e hartuara për rekrutimet, veprim në kundërshtim me nenet 20 "Mjedisi i Kontrollit" dhe 22 "Veprimtaritë e Kontrollit" të Ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar dhe pikën 3.1 dhe 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
-Gjithashtu, lidhur me procedurat e punësimit drejtuar të interesuarve për tu punësuar pranë UKK, në nenin 7 Seksioni D të Rregullores mbi Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm të UKK, përcaktohet se *Me krijimin e vendit të lirë, UKK sh.a do të shpall në faqen e vet zyrtare në internet, pozicionet e vendeve të lira dhe kriteret përkatëse të punësimit si dhe specifikimin nëse aplikohet për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë. Në shpallje, do të përcaktohen afatet për secilën procedurë (afatet e dërgimit të dokumentacionit dhe afatet e shpalljeve të rezultateve)*
U verifikua faqja zyrtare e këtij institucioni, konkretisht https://ukk.al/vende-pune/, e cila kishte 1 hapësira ku mund të merrje informacion që lidhet me punësimet me përshkrimin *Vakant*. Në këtë hapësirë dedikuar procesit të punësimit, kishte vetëm 1 thirrje për pozicion pune të mbartur nga data 8 Shtator 2025, ndërkohë nuk kishte asnjë element tjetër të nevojshëm për të përcaktuar se çfarë procedurash janë ndjekur për rekrutimet për periudhën objekt auditimit nga UKK.

Sa më sipër, konstatohet se UKK, Drejtuesit e saj nuk ndjekin procedura transparente për rekrutimin e punonjësve të rinj, në kundërshtim me nenin 9 pika 5 germa (a) të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton se:

5. Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:
a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë;

dhe nenin 7 Seksioni D të Rregullores së Brendshme të UKK.

Arsimimi dhe dosjet e punonjësve

Lidhur me arsimimin e stafit të UKK, në nenin 7 "Rekrutimi i punonjësve" janë përcaktuar kriteret e veçanta të punësimit për 2 pozicione, Drejtor Departamenti Teknik dhe Drejtor Departamenti Ekonomik, dhe arsimin përkatës që nevojitet, ndërkohë u vu në dispozicion nga Burimet Njerëzore edhe një dokument i firmosur nga Administratori i Shoqërisë, z. Sh. L, i cili përcakton pozicionet e punës dhe niveli arsimor që duhet të kenë punonjësit në raport me pozicionin e punës. Në total ky dokument ka 70 pozicione pune, për të cilat kërkohet niveli bazë arsimor dhe dega përkatëse. Konstatohet se për shumë nga pozicionet e punës, krahas nivelit arsimor të nevojshëm, kërkohen edhe lloji i degës/profesionit, ku në mënyrë të përhapur përcaktohen 2 – 3 degë që kërkohet për këtë profil pune, duke shtuar në fund edhe (etj). Pikërisht, përcaktimi (etj), është përcaktim shumë evaziv, pasi mund të justifikohet në emërime të papërshtatshme të stafit.

Bazuar në informacionin e administruar nga Burimet Njerëzore, u verifikuan me zgjedhje rastësore dosjet e 20 punonjësve ekzistues si dhe punonjësit e emëruar për periudhën objekt auditimi, ku rezulton se 15 prej tyre, nuk kanë arsimin e duhur në raport me pozicionin e punës që ata kanë, dhe konkretisht:

-Punonjësja Dorjana Lika, e emëruar sipas Urdhrit nr. 1073 prot., datë 14.09.2020 në pozicionin e punës "Kimiste" në Sektorin Kimiko – Bakterologjik. Rezulton e diplomuar me bachelor për Biologji – Kimi. Mungojnë vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria.

-Punonjësi Gj. Gj, i emëruar në pozicionin "Përgjegjës i Zyrës së Shitjes" sipas urdhrit nr. 130 prot., datë 04.05.2020. Me urdhrin nr. 294 prot., datë 08.03.2021 është bërë transferimi i tij në pozicionin "Shef i Sektorit të Transportit dhe Makinerive të Rënda". Me urdhër nr. 504/1 prot., datë 02.03.2022 është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punës me motivacionin "Me dëshirë". Me urdhër nr. 606 prot., datë 18.03.2022 është bërë emërimi në detyrë në pozicionin e punës Inspektor në sektorin e Task – Forcës. Me urdhër nr. 690/1 prot., datë 24.05.2022 është bërë transferimi i tij në pozicionin e punës "Shef i Sektorit Operacional". Ky punonjës rezulton se ka paraqitur një vërtetim shkolla për ndjekjen e studimeve në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve (specialiteti tanke – komandues). Sipas vërtetimit ka nr. Diplome por në dosje mungon kopje e noterizuar e diplomës. Referuar pozicioneve të punës që ka ky punonjës në këtë shoqëri, rezulton se nuk janë në përputhje me arsimin e tij. Në dosje disponohet vetëm kontrata e dytë e lidhur pas ri-emërimit në detyrë, ndërkohë që nuk disponohet kontrata e parë. Gjithashtu, mungon kërkesa për ri-punësim, por disponohet vetëm kërkesa e parë e cila nuk është e protokolluar.

-Punonjësi A. B, i emëruar me urdhrin nr. 11 prot., datë 02.12.2019 në pozicionin "hidraulik" pranë UK Kamëz. Ky punonjës rezulton me arsim të mesëm me drejtim mekanika bujqësore. Arsimimi i tij nuk është në përputhje me pozicionin e punës së hidraulikut. Rezulton se kontrata e punës është nënshkruar vetëm nga Administratori i Shoqërisë, por jo nga punëmarrësi. Në aneksin e kontratës është përshkrimi i punës, edhe ky i firmosur vetëm nga Administratori por jo nga punëmarrësi. Mungojnë vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria.

-Punonjësi E. K, i emëruar në detyrë me urdhrin nr. 489 prot., datë 13.04.2021 në pozicionin "hidraulik". Me urdhër nr. 41 prot., datë 10.01.2022 është transferuar në pozicionin e punës "Punëtor Mirëmbajtje", dhe me urdhër nr. 758 prot., datë 06.04.2022 është transferuar sërish në pozicionin e "hidraulikut". Në dosje mungon kontrata e punës dhe përshkrimi i punës i firmosur nga punonjësi. Rezulton se ka mbaruar shkollën e mesme me drejtim hidrosanitar. Libreza e punës rezulton kopje e panoterizuar. Mungojnë vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria. Në dosje rezultojnë 7 procesverbale të mbajtur nga Shefi i Sektorit të Sigurisë në Depo dhe Kryeinxhinieri, ku evidentohet fakti se në datat 2, 4 7, 8, 9, 10, dhe 11 Korrik, punonjësi nuk është paraqitur në vendin e punës, pa njoftuar. Me shkresën nr. 1531 prot., datë 17.07.2025 është bërë njoftimi për bisedime lidhur me ecurinë e marrëdhënies së punës. Është mbajtur procesverbali me nr. 1531/1 prot., datë 21.07.2025 ku ky punonjës rezulton në pozicionin e punës "manovrator në depo", ndërkohë në dosje nuk ka asnjë urdhër që ky punonjës transferohet në këtë detyrë, pasi transferimi i fundit rezulton në pozicionin e hidraulikut. Në parashtrimet e tij, sqaron se arsyeja e mungesës është rikthimi në pozicionin e mëparshëm sipas kërkesës së bërë me datë 16.06.2025. Me urdhër nr. 1531/2 prot., datë 23.07.2025 është bërë ndërprerja e marrëdhënieve të punës me motivacionin *Mosparaqitje në punë prej më shumë se 7 ditë, pa arsye të justifikueshme.* Me urdhër nr. 1531/3 prot., datë 04.08.2025 është bërë kompensim financiar i lejes vjetore të pakryer me 51 ditë pune, për mos kryerje të lejes së zakonshme për vitet 2023, 2024 dhe 2025.
-Punonjësi A. K, i emëruar në detyrë me urdhrin nr. 16 prot., datë 07.01.2020 në pozicionin "Përgjegjës Sektori K.U.N". Ky punonjës rezulton me arsim të mesëm, në kundërshtim me dokumentin e politikave të punësimit i cili përcakton arsimim në nivel bachelor, shkencor/ profesional për këtë pozicion pune. Libreza e punës në dosje rezulton fotokopje e panoterizuar. Mungon kërkesa për punësim pranë UK Kamëz. Është nënshkruar kontrata mes palëve si dhe përshkrimi i punës së punëmarrësit.
-Punonjësja M. M, e cila rezulton sipas kontratës së punës së lidhur me datë 06.09.2023, në pozicionin e punës specialiste faturimi. Në dosje mungon urdhri i emërimit në detyrë, por disponohet Urdhri me nr. 1668 prot., datë 04.09.2023 "Për lëvizje në detyrë", ku nga pozicioni i punës "Operatore ZMK" transferohet në pozicionin "Specialiste faturimi". Rezulton se kjo punonjëse ka arsimin bachelor për infermieri, profesion i cili nuk përputhet me pozicionin e punës. Mungojnë vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria.
-Punonjësi M. B, i emëruar në pozicionin "Specialist i verifikimit në terren" sipas urdhrit nr. 68 prot., datë 14.01.2020. me urdhër nr. 525 prot., datë 04.03.2022 është bërë transferimi i tij në pozicionin "magazinier" në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse. Ky punonjës rezulton me shkollë të mesme për agronomi, arsim i cili është i papërshtatshëm për pozicionin e punës, pasi kërkohet Bachelor, MSC Shkencore/ Profesional. Mungojnë vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria.
-Punonjësi A. L. Në dosjen e këtij punonjësi mungon urdhri i emërimit dhe kontrata e punës. Ka një urdhër transferimi me nr. 1874 prot., datë 02.10.2023 nga pozicioni i punës "manovrator në depo" në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit Teknik" Ky punonjës rezulton me arsim të mesëm, arsim i cili nuk është i përshtatshëm me pozicionin e punës së transferuar. Libreza e punës dhe dëshmia e manovratorit rezultojnë fotokopje të panoterizuara. Mungojnë vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria.
-Punonjësi J. K, i emëruar me Urdhrin nr. 85 prot., datë 16.01.2020 në pozicionin "pompist". Ky punonjës rezulton se ka mbaruar arsimin e mesëm për agronomi, dhe nuk ka asnjë kualifikim apo dëshmi që lidhet me pozicionin e punës. Në dosje nuk disponohet kontrata e punës e punonjësit.
-Punonjësi M. K, i emëruar me urdhrin nr. 304 prot., datë 17.02.2023 në pozicionin "Specialist zyre" në Sektorin Operacional me afat 7 muaj. Me urdhër nr. 1719 prot., datë 11.09.2023 është

bërë emërimi i përkohshëm në detyrë në pozicionin "Laborant" pranë Sektorit Kimiko – Bakteriologjik". Me urdhër nr. 1446 prot., datë 10.06.2024 është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës me motivacion *Përfundim i afatit të kontratës.* Në dosje mungon kontrata ku të përcaktohet edhe termat e lidhur ndërmjet palëve. Ky punonjës rezulton me arsim të mesëm, ndërkohë që pozicioni i specialistit të zyrës dhe sidomos pozicioni i laborantit, kërkohet me bachelor, MSC Shkencor/ Profesional. Diploma e shkollës së mesme gjithashtu është fotokopje e panoterizuar. Mungon kërkesa për punësim.

-Punonjësi K. B, i emëruar në detyrë me urdhër nr. 576 prot., datë 23.03.2023 në pozicionin e punës "Laborant" në Sektorin Kimiko – Bakterologjik, për një periudhë 8 mujore Urdhri fotokopje). Në dosje, gjendet një kopje e panoterizuar diplome e shkollës së mesme pedagogjike, e cila nuk është në përputhje me pozicionin e punës së laborantit. Mungon dëshmia e penalitetit. Disponohet në dosje faqe e pare e librezës së punës e cila është e panoterizuar. Kërkesa për punësim është e pafirmosur. Vërtetimet nga prokuroria dhe gjykata janë fotokopje të panoterizuara. Mungon kontrata e punës dhe përshkrimi i punës.

-Punonjësi N. H. i emëruar në detyrë në pozicionin e punës "Hidraulik" një Njësinë Paskuqan. Ky punonjës rezulton me arsim të mesëm të përgjithshëm, dhe nuk disponohet në dosje asnjë dëshmi për kualifikimin e tij si "hidraulik".

-Punonjësi B. C, i emëruar në detyrë me urdhër nr. 1983 prot., datë 12.10.2023 në pozicionin "Mekanik Pompist" në Njësinë Zonale Valias. Ky punonjës rezulton me shkollë të mesme të përgjithshme, dhe nuk ka asnjë dëshmi/ kualifikim për pozicionin e punës së pompistit. Në dosjet e tij mungon kërkesa për punë, ndërkohë gjendet një kërkesë tjetër nga shtetasi Gjevalin Perleka.

-Punonjësi M. K, e emëruar në detyrë me urdhër nr. 1132 prot., datë 22.06.2023 në pozicionin "Ekonomiste" pranë Sektorit të Financës. Me urdhër nr. 1132 prot., datë 06.11.2023, është ndërprerë marrëdhënia e punës me motivacion "Përfundim i afatit të kontratës". Në dosje nuk disponohet kontratë, ku të përcaktohet afati, ndërkohë në urdhrin e emërimit përcaktohet afati 3 mujor, i cili lidhet me periudhën e provës. Rezulton se punonjësja ka punuar rreth 4 muaj e gjysëm, dhe motivacioni rezulton i pa saktë, por në mungesë të kontratës në dosje, nuk mund të evidentohet nëse marrëdhënia e punës ka qenë me afat të caktuar apo jo. Me urdhër nr. 359 prot., datë 06.02.2024, është bërë sërish emërimi i kësaj punonjëse si "Specialiste e Menaxhimit të Riskut" pranë Departamentit Ekonomik. Me urdhër nr. 755 prot., datë 18.03.2024 është bërë transferimi i saj në pozicionin e punës "Ekonomiste në Sektorit e Financës". Në dosje gjendet një diplomë e nivelit të parë për ciklin e ulët parashkollor, pra ka kryer studimet për mësuesi dhe nuk disponohet asnjë diplomë që të përcaktojë se kjo punonjëse ka mbaruar për ekonomi/ financë, profile të cilat kërkohet për këtë pozicion pune. Mungojnë vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria.

-Punonjësi J. Ç, i emëruar në detyrë me urdhrin nr. 362 prot., datë 06.02.202 në pozicionin ekonomist pran Sektorit të Financës. Me urdhër nr. 1475 prot., datë 11.06.2024 është bërë një emërim tjetër në detyrë si "Specialist IT" në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse. Gjithashtu, rezulton sipas dokumentacionit në dosje se ky punonjës ka mbaruar studimet për Financë – Kontabilitet (Bachelor), ndërkohë që pozicioni i punës kërkon specialist IT. Sa më sipër, arsimimi i tij nuk është në përputhje me pozicionin e punës. Mungon kërkesa për punësim, mungon dëshmia e penalitetit, mungojnë vërtetimet e lëshuara nga Gjykata dhe Prokuroria, Raporti Mjekoligjor dhe CV, Certifikata Familjare dhe Libreza e Punës.

-Punonjësi R. K, e emëruar në detyrë sipas Urdhrit nr. 2480 prot., datë 18.10.2024 në pozicionin e punës "Arkëtare". Kjo punonjëse rezulton me arsim të mesëm, arsim i cili nuk është në përputhje me pozicionin e punës së arkëtares, për të cilën kërkohet minimumi bachelor në ekonomi, menaxhim, administrim. Mungon vërtetimi nga prokuroria.

-Punonjësi Gj. K, i emëruar me urdhër nr. 844 prot., datë 17.07.2020 në pozicionin e punës "Teknik Linjash" pranë UK Kamëz. Me urdhër nr. 1193 prot., datë 30.09.2020 nga pozicioni i teknik linjash transferohet në pozicionin "Përgjegjës i Zyrës së Shitjes – Valias". Me urdhër nr. 977 prot., datë 28.06.2021 transferohet në pozicionin e punës "Përgjegjës i Sektorit të Shitjes" në Njësinë Zonale Valias. Në dosje nuk disponohet kontratë që lidhet me emërimin si dhe transferimin në detyrë të këtij punonjësi. Arsimimi i tij rezulton i mesëm, ndërkohë për të dy pozicionet e punës kërkohet arsimim tjetër, konkretisht për teknik linjash kërkohet Teknik i Mesëm, Hidraulik, Inxhinieri, Hidroteknik, ndërsa për "përgjegjës zyre të shitjeve, kërkohet arsimim i lartë. Sa më sipër, arsimi i këtij punonjësi për secilën nga pozicionet e punës nuk është në përputhje me arsimimin e tij. Ne dosje ndodhet edhe disa urdhra të tjerë, konkretisht urdhër për emërim në detyrë në Bashkinë Kamëz si shofer i datës 04.03.2024, dhe urdhri i lirimit nga detyra me datë 16.06.2025. Rezulton të jetë ripunësuar pranë UK Kamëz sipas urdhrit nr. 1227 prot., datë 16.06.2025 dhe kontratës së lidhur të datës 17.06.2025 në pozicionin Shef i Njësisë Zonale Bathore, pozicion i cili sërish nuk përputhet me arsimimin e tij. Në dosje, ka një urdhër me nr. 674 prot., datë 01.03.2024 "Për shpërblim", për lejen vjetore të vitit 2023.
-Punonjësi A. M, e emëruar në detyrë sipas urdhrit nr. 1740 prot., datë 06.08.2025 dhe kontratës së lidhur me datë 08.08.2025, rezulton e punësuar si "Specialiste Arkive". Kjo punonjëse rezulton e diplomuar për Mësuese bë Biologji, arsim i cili nuk përputhet me profilin e arsimit të kërkuar në dokumentin për politikat e punësimit në raport me arsimin e stafit.
-Punonjësi A. K, i emëruar në detyrë sipas urdhrit nr. 1799 prot., datë 15.08.2025 në pozicionin e punës "Inxhinier Mjedisi". Nuk disponohet në dosje kontratë e lidhur për këtë emërim. Me urdhër nr. 2206 prot., datë 03.10.2025 është transferuar në detyrën "Specialist Verifikimi" në Task – Forcë, për të cilën është lidhur edhe kontrata e datës 06.10.2025. Ky punonjës ka paraqitur në dosje dy fotokopje diplomash të panoterizuara për inxhinier ndërtimi dhe hidroteknik, profile të cilat të paktën me emërimin në detyrë si "inxhinier mjedisi" janë të pa përshtatshme.
-Punonjësi K. N, i emëruar në detyrë sipas urdhrit nr. 2517 prot., datë 05.11.2025 dhes kontratës së punës të lidhur me datë 06.11.2025 në detyrën e Inspektorit në Sektorin Task – Forcë pranë UK Kamëz. Punonjësi rezulton me arsim për "Pikturë Monumentale", arsim i cili nuk përputhet me pozicionin e punës. Mungon kërkesa për punësim, vërtetimet e lëshuara nga Gjykata dhe Prokuroria.

Mangësitë e mësipërme, janë në kundërshtim me dokumentin e politikave të punësimit, i cili ka përcaktuar pozicionet dhe arsimin përkatës për secilin pozicion pune. Punësimet e kryera me personel pa arsimin përkatës, janë risk i shtuar për kryerjen e aktivitetit të kësaj shoqërie. Titullari i institucionit, njëkohësisht ka vepruar në kundërshtim me nenin 20 "Mjedisi i kontrollit" të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, i cili përcakton përgjegjësitë e titullarit që lidhen me (i) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, (ii) aftësitë profesionale të punonjësve;

Largimet
Për periudhën objekt auditimi dhe nga informacioni i administruar nga Burimet Njerëzore, janë liruar nga detyra 93 punonjës, nga të cilët 29 për vitin 2023, 41 për vitin 2024 dhe 23 për vitin 2025. Arsyet e lirimit janë të ndryshme, ku përfshihen largimet me dëshire, për mosparaqitje në punë, për aftësi, për shkelje të etikës apo dalje në pension.
Sa i përket largimeve ndër vite, motivacionet kanë qenë, si më poshtë:
Tabela: Motivacionet e largimeve për periudhën 2023-2025

Viti	Me kërkesë	Dalje në pension	Mospërmbushje e detyrave	Të tjera	Total
2023	14	5	7	3 (2 përfundim kontrate, 1 paaftësi në punë)	**29**
2024	28	1	9	3 (2 mbarim kontrate dhe 1 ndërruar jetë)	**41**
2025	10	8	2	3 (2 ndërruar jetë, 1 mbarim kontrate)	**23**

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit ka kërkuar 11 procedura lirimi, bazuar në bazën e të dhënave me largimet përgjatë viteve periudhë auditimi, për punonjës që janë larguar me motivacion tjetër nga "me kërkesë të tij/ saj", ku janë vënë në dispozicion, si më poshtë:

-U verifikua dosja e punonjësit R. I i emëruar sipas urdhrit nr. 214 prot., datë 05.02.2020 "Mirëmbajtës i linjës së kanalizimeve". Në dosjen e këtij punonjësi mungonin dokumentet për arsimin e tij, si vërtetime nga gjykata, prokuroria, dëshmi penaliteti. Nuk disponohet urdhër lirimi nga detyra apo motivacion për lirimin e këtij punonjësi. Libreza e punës ndodhej në dosje, e plotësuar vetëm me datën e fillimit por jo të mbarimit të marrëdhënies së punës;

-U verifikua dosja e punonjësit M. P, i emëruar në detyrë me urdhër nr. 286 prot., datë 15.02.2023 në pozicionin "Manovrator ne depo". Në dosjen e këtij punonjësi, mungojnë pjesa me e madhe e dokumenteve të nevojshme si Kontrata e Punës, Dëshmi Penaliteti, Dëshmi/ Diplomë për arsimin e tij, Fotokopje e librezës së punës e noterizuar, si dhe nuk disponohet asnjë urdhër për lirimin e tij nga detyra.

-U verifikua dosja e punonjësit G. Gj, i emëruar në detyrë me urdhrin nr. 260 prot., datë 20.02.2020 në pozicionin Operator i Shpërndarjes dhe Manovrimit të Rrjetit". Është lidhur kontrata e datës 21.02.2020. Me urdhër nr. 1390 prot., datë 30.09.2021, është transferuar nga pozicioni "punëtor mirëmbajtje" në pozicionin "Manovrator në depo". Transferimi nuk shoqërohet me kontratë dhe përshkrimin e punës së pozicionit të ri sipas urdhrit. Ky punonjës rezulton nga informacioni i liruar nga detyra, sipas urdhrit nr. 898 prot., datë 19.05.2023 me motivacionin "Mosparaqitje në punë prej më shumë se 7 ditë, pa arsye të justifikueshme". Në urdhrin e lirimit, bashkëlidhur gjendet një grafik me nr. 838 prot., datë 05.05.2023 ku paraqitet grafiku sipas turneve i punonjësve në depon Skeja për muaji Maj 2023. Së pari, konstatohet se ndarja e punës me turne 24 orësh, vjen në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores së Përgjithshme", e cila përcakton se orari i punës është nga ora 8 deri në orën 16.30 (me një pushim 30 minuta), nga e hëna në të premten. Sipas grafikut, punonjësi G. Gj, rezulton se duhet të jetë në punë në datat 2, 6, 10, 14 dhe 18 Maj 2023, ndërkohë që procesverbali me nr. 838 prot., i mbajtur nga Shefi i Njësisë Zonale i datës 05.05.2023, përcakton se në orën 08.00, ky punonjës nuk u paraqit në punë. Nëse i referohemi grafikut të punës, ky punonjës nuk është në punë në datën e caktuar. Është mbajtur një procesverbal me nr. 838/1 prot., i datës 12.05.2023 sipas të cilit ky punonjës nuk është paraqitur në punë nga data 08.05.2023 deri më datë 12.05.2023. Referuar grafikut ky punonjës duhet të ishte në punë me data 10.05.2023, ndërkohë që edhe pasqyrimi i mungesës në punë për gjithë javën nuk është i saktë, pasi nëse do duhej të ishte në punë çdo ditë të javës, duhet mbajtur akti përkatës i mungesës në punë çdo ditë. Është mbajtur procesverbali nr. 838/2 prot., datë 14.05.2023 ku pasqyrohet se punonjësi ka munguar në punë për datat 13.05.2023 dhe 14.05.2023. Është mbajtur procesverbali nr. 838 prot., datë 18.05.2023, sipas të cilit ky punonjës nuk është paraqitur në punë për datat 17.05.2023 dhe 18.05.2023. Referuar këtyre datave, konkretisht 13 dhe 14 Maj 2023, rezulton se janë ditë fundjave, konkretisht e shtunë dhe e diel, pra janë ditë pushimi. Në dosje ndodhet një njoftim për bisedime me nr. 902/1 prot., datë 16.06.2021 me objekt përfundimin e marrëdhënies së punës, por ky njoftim dhe data e tij nuk përkon me situatën e urdhrit të lirimit të muajit Maj 2023. Nuk disponohet në dosje mbajtja apo njoftimi i këtij punonjësi për takim që lidhet me situatën e sipërcituar.

-U verifikua dosja e punonjëses M. S. Në dosje gjendet kopje e urdhrit të emërimit në detyrë me nr. 59, datë 12.06.2017 si "Verifikues matësash në terren dhe mbledhje debie" (periudhë prove 1 mujore). Në dosjen e kësaj punonjëse, Me urdhër nr. 25 prot., datë 10.01.2020 është emëruar në pozicionin e punës "Operator Z.M.K" (fotokopje e urdhrit). Mungojnë kontrata e punës e lidhur në vitin 2017 me këtë punonjëse, por gjendet kontrata e lidhur me datë 10.01.2020. Rezulton se dosja e kësaj punonjëse ka çdo dokument fotokopje të panoterizuar, si diploma, lista e notave, libreza e punës, ndërsa mungojnë dëshmia e penalitetit, apo vërtetimet nga gjykata dhe prokuroria. Nga të dhënat e përcjella nga Burimet Njerëzore kjo punonjëse është liruar nga detyra me urdhrin nr. 1113 prot., datë 21.06.2023 me motivacion "Mos paraqitje në punë prej më shumë se 7 ditë, pa arsye të justifikuar". Në dosje nuk disponohet asnjë procesverbal i mbajtur për mos prezencën në punë, apo njoftim i punonjësit për takim në vijim të respektimit të afateve ligjore të përcaktuara në Kodin e Punës.
-U verifikua dosja e punonjësit F. B. Në dosje gjendet 2 (dy) urdhra emërimesh, të 2 (dy) me nr. 18 prot., datë 07.01.2020, ku në njërin emërohej si "Specialist Verifikimi", dhe në urdhrin tjetër emërohej Inspektor Task Force, ndërkohë në kontratën e punës të lidhur me datë 08.01.2020, rezulton Inspektor Task Force. Me urdhër nr. 1309 prot., datë 10.09.2021, është transferuar nga pozicioni i punës "Specialist Verifikimi" në pozicionin "Inspektor Task Force. Siç evidentohet, pozicionet e punës janë të ndryshme nga ato të përcaktuara në kontratën e cituar më sipër, ku sipas saj dhe përshkrimit të punës të firmosur prej tij, ai rezulton në pozicionin e punës "Inspektor Task Force". Me urdhër nr. 1786 prot., datë 13.12.2021 transferohet në pozicionin e punës "Shef i Njësisë Zonale Bathore". Rezulton se ka 2 masa disiplinore të marrë sipas shkresës nr. 92 prot., datë 12.01.2022 "Vërejtje" për performancë të dobët, dhe shkresës me nr. 995 prot., datë 02.06.2023 "Qortim", për mos përmbushje të detyrave funksionale, por nuk disponohet praktikë e njoftimit të këtij punonjësi lidhur me masat disiplinore të dhëna. Me urdhër nr. 1745 prot., datë 12.07.2024 është komanduar në pozicionin e punës "Shef i Njësisë Zonale Paskuqan". Me urdhër nr. 2416 prot., datë 10.10.2024, është bërë transferim i përkohshëm i këtij punonjësi nga pozicioni i "Shefit të Njësisë Zonale Bathore", në pozicionin e punës "Specialist i Lartë në Sektorin e Statistikës". Nuk ka kontratë të lidhur apo dokument të firmosur prej tij për përshkrimin e punës së transferuar, ku të shprehet edhe dakordësia për këtë transferim. Në dosjen gjendet 5 procesverbale të mbajtura nga data 15.10.024 – 21.10.2024 ku evidentohet fakti se punonjësi nuk është paraqitur në punë. Është mbajtur një procesverbal ndërmjet përfaqësuesve të UK Kamëz dhe punonjësit F. B. me nr. 2517 prot., datë 24.10.2024, ku ky punonjës parashtron me shkrim se kam ankimuar shkaqet e transferimit të pozicionit të punës. Me urdhër nr. 2517/4 prot., datë 28.10.2024, është ndërprerë marrëdhënia e punës me motivacion për "braktisje të vendit të punës, mos paraqitje në punë prej më shumë se 7 ditë, pa arsye të justifikueshme". Lidhur me këtë shkak, evidentohet se me anë të procesverbaleve është pasqyruar mungesa në punë për 5 ditë pune, dhe jo 7 sa citohet në urdhër.
-Për punonjësin Sh. S, i emëruar në detyrë sipas urdhrit nr. 1038 prot., datë 11.05.2022 në pozicionin e punës "Specialist Verifikimi". Për këtë punonjës nuk disponohet asnjë dokument tjetër i nevojshëm si kontrata e punës, dëshmi penaliteti, dëshmi gjykate dhe prokurorie, kopje e noterizuar e librezës së punës etj. Rezulton se ky punonjës është liruar nga detyra sipas urdhrit nr. 837/3 prot., datë 16.05.2023 me motivacion "Mosparaqitje në punë prej më shumë se 7 ditë, pa arsye të justifikuara. Në dosje gjenden disa procesverbale të mbajtur me nr. 837 prot., datë 05.05.20232 sipas të cilit ky punonjës nuk u paraqit në punë në këtë ditë, procesverbali me nr. 837/1 prot., datë 12.05.2023 sipas të cilit ky punonjës nuk është paraqitur në punë nga data 08.05.2023 deri më datë 12.05.2023, dhe procesverbali nr. 837/2 prot., datë 16.05.2023 sipas të

cilit ky punonjës nuk është paraqitur në punë për datat 15.05.2023 dhe 16.05.2023, datë në të cilën ka dal dhe urdhri i lirimit. Nuk disponohet asnjë element në dosje për njoftimin e këtij punonjësi për mungesat në punë.
-U verifikua dosja e punonjësit A. D, e emëruar në detyrë sipas urdhrit nr. 682 prot., datë 01.03.2024 në pozicionin "Përgjegjëse e Sektorit të Shitjes në Njësinë Zonale Bathore. Është lidhur kontrata e punës. Rezulton se kjo punonjëse ka marrë masë disiplinore "Vërejtje" me nr. 2494 prot., datë 18.10.2024 për mosparaqitje në vendin e punës. Është mbajtur një procesverbal i datës 11.10.2024, sipas të cilit kjo punonjëse dhe disa punonjës të tjerë, nuk janë paraqitur në punë duke mos njoftuar. Me urdhrin nr. 2650/1 prot., datë 05.11.2024, është marrë masa "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", për moszbatim të detyrave funksionale. Konkretisht është mbajtur një procesverbal i datës 29.10.2024, protokolluar me nr. 2650 prot., datë 05.11.2024, sipas të cilit kjo punonjëse nuk i ka dhënë zgjidhje ankesës së një qytetareje. Është mbajtur një procesverbal me nr. 2741 prot., datë 12.11.2024, ku kjo punonjëse nuk pranon vërejtjen për rastin e qytetares pasi nuk ka administruar ajo ankesën, procesverbal i cili është firmosur nga 6 punonjës, përfshirë edhe këtë punonjëse. Në dosje rezulton se me urdhrin nr. 2828 prot., datë 25.11.2024, është bërë lirimi i saj nga detyra me motivacionin "Moszbatim në mënyrë të përsëritur të detyrave funksionale".
-U verifikua dosja e punonjësit N. K, emëruar me urdhër nr. 84 prot., datë 16.01.2020 në pozicionin "Operator manovrimi". Me urdhër nr. 228 prot., datë 22.02.2021 është bërë transferim në detyrën e "Mirëmbajtës i Linjës së Kanalizimeve". Rezulton se ky punonjës është liruar nga detyra sipas urdhrit nr. 1406/1 prot., datë 05.06.2024 me motivacionin "Moszbatim të urdhrit (verbal) të Administratorit për pastrimin e territorit në puset Valias, si dhe thyerje e kodit të etikës". Bashkëlidhur gjendet një procesverbal me nr. 1406 prot., datë 05.06.2024 mbajtur nga Shefi i Njësisë Zonale z. A. K, sipas të cilit punonjësi ka ofenduar eprorët dhe thyer etikën në punë.
-U verifikua dosja e punonjësit D. N, emëruar në detyrë sipas urdhrit nr. 1349 prot., datë 31.07.2023 në pozicionin e punës Inxhinier Hidroteknik pranë Sektorit Teknik. Rezulton se ky punonjës është liruar nga detyra me urdhër nr. 2668/3 prot., datë 13.11.2024 me motivacionin "Shkelje e rëndë e etikës në punë". Bashkëlidhur gjendet një kërkesë e protokolluar me nr. 2668 prot., datë 06.11.2024 nga Drejtori Teknik, i cili rendit disa arsye madhore të kryera nga ky punonjës që bien ndesh me pozicionin e punës. Në dosje administrohet edhe një shkresë me nr. 2668/2 prot., datë 12.11.2024 drejtuar këtij punonjësi, ku parashtrohen arsyeja e lirimit nga detyra. Nuk administrohet procesverbal për komunikimin me këtë punonjës, dëgjesë për pretendimet.
-U verifikua dosja e punonjësit Xh. B, i emëruar me urdhrin nr. 40 prot., datë 13.09.2020 në pozicionin "Operator i shpërndarjes dhe manovrimit të rrjetit". Në dosje nuk disponohet kontrata e punës, diploma ose dokument mbi nivelin arsimor, libreza e punës është fotokopje e panoterizuar. Në dosje rezultojnë se janë marrë dy masa disiplinore, konkretisht me urdhër nr. 2934/2 prot., datë 06.12.2024 masa "vërejtje" për mosparaqitje në vendin e punës, dhe me urdhër nr. 2934/3 prot., datë 10.12.2024, "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" me motivacionin "Mosparaqitje në vendin e punës". Rezulton se në dosje janë mbajtur dy procesverbale, konkretisht procesverbali nr. 2934 prot., datë 05.12.2024 sipas të cilit në orën 7.05 ky punonjës nuk ishte prezent në vendin e punës, dhe procesverbali i datës 2934/1 prot., datë 06.12.2024 sipas të cilit në orën 7.00 ky punonjës nuk ishte në vendin e punës. Referuar këtyre procesverbaleve, konstatohet se ora e mbajtur nuk është orar zyrtar, pasi referuar rregullores orari zyrtar është 8 me 16.30. Me urdhër nr. 2934/4 prot., datë 13.12.2024 është bërë ndërprerja e marrëdhënies së punës me motivacionin "Mosparaqitje në vendin e punës dhe shkelje të renda të Kodit të Etikës". Në dosje nuk disponohet

asnjë shkresë apo procesverbal ku ky punonjës të jetë njoftuar për masat disiplonore deri tek lirimi i tij nga detyra.

Konkluzione:

Nga verifikimi me zgjedhje i praktikave të emërimit dhe lirimit nga detyra për punonjësit e UK Kamëz për periudhën objekt auditimi, ka rezultuar në pjesën më të madhe mangësi që lidhen me procedurën e rekrutimit, të evidentuara më sipër tek trajtimi për rekrutimet. Rezulton se dosjet e punonjësve në mënyrë të përhapur nuk kanë të plotë dokumentacionin e punonjësve, ku mungojnë përgjithësisht kërkesat për punësim, të cilat edhe kur disponohen janë të paprotokolluara, mungojnë dëshmitë e lëshuara nga gjykata dhe prokuroria, dokumente të caktuara si kopjet e diplomave ose librezës së punës janë dokumente të pa noterizuara. Konstatohet gjithashtu, se shumë nga punonjësit e emëruar në detyrë, janë me arsim të papërshtashëm me pozicionin e punës, ku mund të evidentohen edhe punonjës të cilët kërkohen me arsim të lartë, por rezultojnë më arsim të mesëm etj. Në dosjet e punonjësve nuk gjendet asnjë vlerësim i punës së tyre. Mungon inventari i brendshëm i dosjeve. Rezulton se për shumë punonjës nuk janë hartuar kontratat e punës. Mungesa e kontratave të punës është në kundërshtim me nenin 21 "Forma e kontratës së punës" pikat 1, 2, 3, 4, dhe nenit 202 pika 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar *(Në vijim Kodi i Punës).*

Lidhur me lirimet nga detyra, janë evidentuar mangësi në procedurën e ndjekur, dhe dokumentimin e saj, duke mos ju përmbajtur detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Punës, Rregullore e Brendshme e Institucionit dhe Kontrata e Punës, në rastet kur disponohej.

Neni 141 i Kodit të Punës, përcakton se *Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit.*

-Sa më sipër, konstatohet se në praktikat e trajtuara më sipër, në thuajse gjitha rastet nuk janë respektuar afatet e njoftimit për punonjësit e liruar/shkarkuar nga puna. Kodi i Punës në nenin 143 pika 1 përcakton se *1. Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej dy javësh, kur marrëdhënia e punësimit ka zgjatur deri në gjashtë muaj, prej një muaji, për kohëzgjatjen mbi gjashtë muaj deri në dy vjet, prej dy muajsh, për kohëzgjatjen mbi dy vjet deri në pesë vjet, dhe prej tre muajsh, për kohëzgjatjen për më shumë se pesë vjet.*

Neni 144 i Kodit të Punës përcakton procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, nisur nga njoftimi të paktën 72 orë para takimit me punëmarrësin, parashtrimi i arsyeve të vendimit të parashikuar për t'u marrë, mundësia për t'u shprehur, njoftimi i zgjidhjes me shkrim, 48 orë deri në 1 javë nga takimi, ku të përcaktohet arsyeja e zgjidhjes së kontratës, të lidhura me shkaqe si aftësia, sjellja ose kërkesat operacionale të institucionit. Referuar pikës 5 të këtij neni, punëdhënësi që nuk respekton procedurën e përcaktuar në këtë nen detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim të barabartë me pagën e dy muajve, që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të mundshme.

Referuar nenit 145 të Kodit të Punës, punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet, e drejtë që punëmarrësi do ta humbiste, në rastet e pushimit të menjëhershëm për shkaqe të arsyeshme.

-Lidhur me dispozitat e mësipërme të Kodit të Punës dhe praktikave të audituara, ka rezultuar mos respektim nga Institucioni të kuadrit ligjor. Ndërprerja arbitrare e marrëdhënieve të punës nga ana e Drejtuesve përgjatë periudhës objekt auditimi, ka përbërë arsye për një numër procesesh

me objekt lirimin e padrejtë nga detyra, dhe konkretisht në mos respektim të neneve 141, 143, 144, 145 dhe 146 të Kodit të Punës e cila ka sjellë dhe rrezikon të sjellë kosto të tjera financiare për institucionin dhe buxhetin e shtetit (e detajuar më gjerësisht te çështjet gjyqësore më poshtë).

Çështjet gjyqësore

Nga auditimi rezulton se UKK, në cilësinë e punëdhënësit, është palë e paditur në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në **6** raste përgjatë periudhës së auditimit, ku rezulton se në 3 raste gjyqi është humbur nga UKK në shkallë të parë të gjyqësorit, vendimet të cilat janë ankimuar, ndërkohë që rezultojnë edhe 3 kërkesë padi të tjera të cilat janë në shkallë të parë ose në fazë deklarate mbrojtje nga institucioni.

E detajuar ndër vite,

- **Për vitin 2023**, janë 3 padi për largimet nga puna, të cilat janë pranuar nga gjykata. Vendimet nuk kanë marrë formë të prerë pasi është bërë ankimimi;

- **Për vitin 2024**, janë 2 padi për largimet nga puna, të cilat vijojnë nga informacioni në proces gjyqësor në shkallë të parë;

- **Për vitin 2025,** është 1 padi për largim nga puna, e cila është në fazë deklarate mbrojtje;

Duke përllogaritur të dhënat e pagës bruto momentin e lirimit nga detyra, rezulton se sipas vendimit të shkallës së parë për 3 gjyqet në të cilat Institucioni ka humbur çështjen objekt gjykimi, rezulton se,

Për punonjësin G. Gj. vlera që potencialisht parashikohet për tu likuiduar është 539,000 lekë dëmshpërblim + 123,445 lekë shpenzime gjyqësore = 662,445 lekë;

Për punonjësin M. S. vlera që potencialisht parashikohet për tu likuiduar është 566,640 lekë dëmshpërblim + 103,000 lekë shpenzime gjyqësore = 669,640 lekë;

Për punonjësin Sh. S. vlera që potencialisht parashikohet për tu likuiduar është 612,750 lekë dëmshpërblim + 103750 lekë shpenzime gjyqësore = 715,750 lekë;

Në total, vlera që potencialisht mund të likuidohet për shkak të vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna për periudhën objekt auditimi është 2,047,835 lekë, vlerë e cila nuk ka të përllogaritur shpenzimet përmbarimore të ardhshme.

Lidhur me lirimet nga detyra në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të padrejta sipas vendimit të gjykatës, duke mos respektuar njëkohësisht afatet dhe procedurat në kundërshtim me Kodin e Punës, pavarësisht se vendimet e cituara më sipër nuk kanë marrë formë të prerë, mos ndjekja e procedurës ligjore për lirimin nga detyra mund të përbëjë shkak për efekte financiare në dëm të Shoqërisë UK Kamëz Sh.a, e cila duke përllogaritur vendimet e shkallës së parë, janë në vlerën 2,047,835 lekë, pa përshirë detyrimet përmbarimore.

Gjithashtu, fakti se krahas 3 vendimeve humbura në shkallë të parë të gjyqësorit, janë edhe 3 kërkesë padi të tjera në pritje të gjykimit në shkallën e parë të gjykimit, e rrit edhe më shumë riskun dhe probabilitetin që të kemi detyrime të tjera në vijim, kjo duke parë dhe vlerësuar praktikat e ndjekura nga punëdhënësit të cilët nuk kanë respektuar detyrimet që lindin nga Kodi i Punës dhe kontrata me punëmarrësit, duke mos ndjekur procedurat e duhura në largimet e punonjësve nga puna.

- ***Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve.***

Për periudhën objekt auditimi, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për punonjësit e UKK sh.a, paraqitet si më poshtë:

Tabela: Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për periudhën 2023-2025

Nr	Artikulli	Viti 2023		%	Viti 2024		%	Viti 2025		%
		Plan	Fakt		Plan	Fakt		Plan	Fakt	
1.	Paga gjithsej	188,463	186,158	99%	220,440	204,008	93%	266,016	265,711	100%
2.	Sig. Shoqërore & shëndetësore	38,394	31,144	81%	36,813	33,705	92%	44,424	40,714	92%
3.	Shpërblim punonjës		5,300			5,740			6,100	
4.	Të tjera personeli	500	324	64%	1,000	735	74%	2,192	1,272	58%
5.	Nr. mesatar punonjës	280	278	99%	290	283	98%	309	298	96%
	Total	227,357	222,926	98%	258,253	244,190	92%	312,663	313,709	100%

Burimi: Drejtoria e Financës, dhe përpunoi Grupi i Auditimit

-Shpenzimet për "paga & sigurime shoqërore" për vitin 2023 janë realizuar në shumën 212,428 mijë lekë, nga 226,857 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 93.6% nga planifikimi.
-Shpenzimet për "paga & sigurime shoqërore" për vitin 2024 janë realizuar në shumën 243,453 mijë lekë, nga 257,253 mijë të planifikuara, ose realizuar në masën 94.6%.
Siç evidentohet, përgjithësisht fondi i pagave është realizuar në masën 99% dhe 100%, dhe vetëm viti 2024 ka realizim në masën 93%. Mos realizimi i plotë ka ardhur si shkak i vakancave në strukturë.
-Evidentohet se struktura organizative dhe fondi i pagave, çdo vit kanë progresion rritës.
Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën objekt auditimi, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamenti etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori të firmosura nga drejtuesi i njësisë dhe shefi i burimeve njerëzore. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto.
-Janë audituar me zgjedhje listë-pagesat e periudhës objekt auditimi 2023-2025 (janar – mars 2023, prill – qershor 2024, korrik – shtator 2025) nga të cilat rezulton se janë hartuar referuar përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe nuk ka probleme me llogaritjen e ndalesave të tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Vlera e listë pagesave me urdhër pagesat rakordon në vlerë.

-Nga auditimi, rezulton se përgjatë periudhës objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2025, Institucioni ka paguar 36 punonjës në vlerën 2,925,187 lekë ku për 34 prej tyre për vlerën 2,845,187 lekë, pagesa është kryer për shkak të lejeve të zakonshme të prapambetura, të cilat në disa raste janë të mbartura edhe deri në 2 vite e 6 muaj, dhe për 2 punonjës janë dhënë shpërblime për shkak sëmundshmërie.

Lidhur me pagesat për lejet e zakonshme të prapambetura nga vitet e mëparshme, rezulton se në të gjitha rastet ato janë dhënë për punonjës të larguar nga puna ose për punonjësit e dalë në pension.

Referuar praktikës dhe dokumentacionit që administron shoqëria UKK Sh.A, për asnjë nga vitet objekt auditimi, nuk disponohet një plan/grafik lejesh i miratuar nga titullari. Nuk disponohet arsyeja nëse këta punonjës kanë kërkuar leje dhe u është refuzuar.

Referuar nenit 93 pika 3 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (Kodi i Punës në vijim), përcaktohet se *Pushimet vjetore duhet të jepen gjatë vitit të punës ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës.*

Në pikën 4 të nenit të mësipërm, përcaktohet se *E drejta e pushimeve që nuk jepen nga punëdhënësi ose nuk merren nga punëmarrësi, parashkruhen brenda tre vjetëve nga dita në të cilën punëmarrësit i lind kjo e drejtë.*

Në pikën 8, Rubrika III (Pushimet), të VKM-së nr. 568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" përcaktohet se *8. Pushimet vjetore të paguara, përfshirë rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, nuk zëvendësohen me pagesë, me përjashtim të rasteve kur marrëdhënia e punës ka përfunduar për arsye të paparashikuara dhe kryerja e pushimeve vjetore është e pamundur. Në këtë rast, i punësuari, të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës, ka të drejtë të përfitojë një shpërblim të barabartë me pagën e këtyre pushimeve. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, është e pavlefshme.*

Edhe në rregulloren e brendshme të institucionet, përcaktohet në pikën 7 të nenit 9 të saj, se *Koha e kryerjes së pushimit vjetor të paguar përcaktohet nga titullari i institucionit, sipas kërkesës të të punësuarit, duke mos cenuar vijueshmërinë e punës.*

Në nenin 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit" të Ligjit nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", përcaktohet se *1. Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.*

Në nenin 22 pika 3 germa (f) "Veprimtaritë e kontrollit" të ligjit të mësipërm, përcaktohet se *Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë minimalisht f) Rregullat për menaxhimin e burimeve njerëzore;*

Referuar situatës së mësipërme, në mungesë të një plani/grafiku për menaxhimin e burimeve njerëzore në raport me lejet e zakonshme, rezulton se çdo vit jo të gjithë punonjësit kërkojnë kryerjen e lejes, e cila në rastet kur këta punonjës largohen nga detyra, u kompensohet me detyrim financiar. Pikërisht, titullari i institucionit, referuar përgjegjësive menaxheriale për përdorimin e fondeve publike me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë, nuk ka hartuar apo krijuar politika për menaxhimin e burimeve njerëzore lidhur me pushimet vjetore.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga Administratori i UK Sh.A z. Sh. L, është paraqitur observacioni i dërguar me shkresën nr. 1417 prot., datë 22.06.2026, të administruara në KLSH me nr. 1051/9 prot., datë 25.06.2026 si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me gjetjen 1 faqe 320 të projekt raportit të auditimit në të cilën përcaktohet se,
Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për rekrutimin e punonjësve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, rezultoi se Administratorët e UKK Sha për periudhën nën auditim nuk kanë hartuar dhe miratuar një procedurë për rekrutimin e punonjësve, sqarohet se,
UKK Sha, gjatë periudhës objekt auditimi ka të miratuar rregulloren (Rregullorja e fundit datës 18.08.2025) me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e pozicionit të punës që duhet të kryej i punësuari. Kjo rregullore përcakton kriteret, fazat dhe përgjegjësitë për procesin e rekrutimit (neni 7, faqja 8 e rregullores). Gjithashtu, nëpërmjet faqes së web-it është komunikuar mbi vendet e lira që shoqëria ka pasur rekrutim.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

Lidhur me observacionet e paraqitura nga Administratori i Shoqërisë, grupi i auditimit sqaron si më poshtë:
Pretendimi se procedura e rekrutimit është e rregulluar sipas nenit 7 faqe 8 të rregullores së miratuar të UKK Sh.a, sqarohet se siç është cituar edhe ne gjetje, në nenin 7 të rregullores "Rekrutimi i punonjësve, lëvizje paralele dhe ngritja në detyrë", ka përcaktuar kritere të veçanta për pozicionet e punës Drejtor Departamenti Teknik dhe Drejtor i Departamentit Ekonomik, ndërkohë për pozicionet e tjera mungojnë kriteret e kërkuara. Pavarësisht se në Rubrikën (D) të këtij neni përcaktohet se *Me krijimin e vendit të lirë UKK sh.a do të shpall në faqen e vet zyrtare në internet pozicionet e vendeve të lira dhe kriteret përkatëse të punësimit si dhe specifikimin nëse aplikohet për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë. Në shpallje do të përcaktohen afatet për secilën procedurë (afatet e dërgimit të dokumentacionit dhe afatet e shpalljeve të rezultateve),* siç është cituar edhe në gjetje, kanë munguar publikimet në faqen web të UKK Sha, ndërkohë që përgjatë kësaj kohe janë realizuar rekrutime punonjësish. Bashkëlidhur keni paraqitur disa procedura rekrutimi të vitit 2026, pra përtej periudhës së auditimit, dhe disa aplikime të vitit 2025, të cilat si në periudhën nën auditim dhe aktualisht, nuk janë të ngarkuara në faqen web të institucionit.

2.4. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi i pronës publike.

Për auditimin e pikës 4 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2024 të shoqëruara me anekset.
2. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, arkës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, libri i madh, bilanci verifikues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve, libri i aktiveve.
4. Dokumente të tjera të gjeneruara sipas nevojës nga programi "Financa 3" për mbështetjen e veprimeve kontabël të kryera në mënyrë analitike.
5. Dokumentacioni i mbajtur mbi përllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.
6. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, për shpenzimet të ardhurat etj.).

Baza ligjore: UKK SHA ka hartuar pasqyrat financiare duke zbatuar Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF), sipas nenit 2, pika 23, shkronja "ç", e Ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", për hartimin e pasqyrave financiare". Administrimi i aktiveve, qarkullimi dhe kontabilizimi i tyre është bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, në ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, në ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar.

Marrëveshja e ristrukturimit të UKK SHA, me përfshirjen e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit neto të Ndërmarjes Ujësjellës Kanalizime Kamëz (NUKK), entitet publik

Ndërmarja publike Ujësjellës Kanalizime Kamëz (NUKK) me NIPT K51716029U, është themeluar me 14.11.2001 dhe është regjistruar si entitet publik në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë dhe si e tillë, nuk rezulton e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
Gjate vitit 2019 duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz nr.18 date 19.09.2019 "Për miratimin e Marrëveshjes për ndarjen e shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" SHA dhe marrjen në dorëzim të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Kamëz" SHA u realizua marrja në dorëzim e të drejtave dhe detyrimeve në zbatim të akteve të ndarjes së shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Tiranë" SHA. Ky proces u miratua me vendim 03 date 01.10.2019 të aksionarit të vetëm Bashkia Kamëz.
NUKK ka raportuar pasqyrat financiare te vitit 2019 (me datë raportuese 31.12.2019) sipas standartit të entiteteve publike bazuar në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" dhe ka ushtruar veprimtarinë e saj si njësi e tillë, ku veprimet financiare janë kryer në degën e Thesarit. Këto pasqyra financiare, janë pasqyrat financiare të fundit, të deklaruara në Degën e Thesarit, Tiranë. Si rezultat vlerat e raportuara në PF e vitit 2019 të UKK SHA. kanë ndryshuar, si rezultat i këtij bashkimi aksionari i vetëm i UKK SHA. ka emëruar audituesin e pavarur për të audituar pasqyrat financiare të vitit 2019 të Ndërmarrjes UK-Bashkia Kamëz dhe për të reformuar pasqyrat financiare nga entitet publik në shoqëri aksionare, sipas formatit të përcaktuar në SKK 2 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare". Raporti i auditimit për këto pasqyra është lëshuar me datë 28 Shkurt 2023.
Pasqyrat financiare të konsoliduara të UKK SHA me datë 31.12.2019, me efektet e transferimit të aktivitetit të NUKK me datë 31.12.2019, janë paraqitur në PF e vitit 2019.

Afatet e hartimit të PF: Për vitet 2023 dhe 2024 janë hartuar pasqyrat financiare dhe miratuar nga organet drejtuese të Shoqërisë nga Këshilli i Administrimit me vendimet nr.4, datë 31.07.2024 dhe nr.4, datë 25.07.2025, të cilat janë certifikuar nga ekspertët kontabël të kontraktuar nga kjo Shoqëri në bazë të akt-marrëveshjes nr.prot.879, datë 12.05.2023 dhe nr.prot.302, datë 31.01.2024. Pasqyrat financiare janë deklaruar në sistemin e organeve tatimore në datat 31.03.2024 dh 01.04.2025, duke respektuar afatin ligjor në lidhje me depozitimin e pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës, të shoqëruara këto me deklaratën vjetore të tatimit mbi fitimin. Pasqyrat financiare e dorëzuara pranë organeve tatimore ishin pranuar dhe nuk ishin kontestuar prej tyre.

Parimet kontabile, që janë përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatin

financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara).
Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike dhe parimit të të drejtave të konstatuara dhe janë të paraqitura në monedhë vendase ”lekë”, paraqitja e tyre është në përputhje me formatin SKK-2.
Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve.
-Të ardhurat dhe shpenzimet janë njohur sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.
Të ardhurat nga shitja e ujit të pijshëm janë njohur, kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, të ardhurat janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtueshme.
- Shpenzimet janë njohur atëherë, kur ato janë siguruar nga të tretët në të njëjtin ushtrim kontabël të lidhur me realizimin e të ardhurave.
- Fluksi parasë është paraqitur me metodën indirekte.
-Tatimi mbi fitimin e pagueshëm për vitin ushtrimor bazohet mbi fitimin e tatueshëm, norma aktuale e tij është 15%, i cili ka lidhje me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
-Kërkesat për tu arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afat shkurtër dhe afatgjatë, në para janë regjistruar në PF sipas vlerës së faturës dhe shitjes dhe e përfaqësuar me inventarët e fundvitit.
-Huatë e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtër dhe afatgjatë, për tu shlyer në para, në përgjithësi janë mbajtur me koston e amortizuar në PF, pasivet financiare afatshkurtra janë mbajtur në vlerën e tyre neto të realizueshme, të vertetuar nga një faturë apo kontratë.
-Aktivet afatgjatë materiale janë bazuar me kosto neto janë paraqitur kosto minus amortizimin e akumuluar.
Mbajtja e kontabilitetit është realizuar me regjistrimet në librat kontabël, duke i kontabilizuar në llogaritë përkatëse të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike që i përkasin kësaj njësie shpenzuese në përmjet programit informatik “Alfa”.
Të gjitha transaksionet bankare janë të njohur në mënyrë të përshtatshme dhe në bazë të dokumenteve justifikues në këto pasqyra financiare.
Për çdo regjistrim kontabël janë shënuar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik dhe kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë përkatëse bazuar në planin kontabël.
Për vitet 2023 dhe 2024 na u vu në dispozicion dokumentacioni kontabël në të cilin ishin pasqyruar efektet e veprimeve ekonomike të klasifikuara sipas llogarive të prekura nga azhurnimi në ditarë nëpërmjet mbartjes së shumave nga ditarët në fund të periudhës ushtrimore.
Konkluzion: Pasqyrat financiare përsa përket pozicionimit të llogarive paraqiten në mënyrë të drejtë, ku përformanca e tyre dhe fluksi i parasë është në pajtim me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.
Pasqyra rrjedhëse e parasë është rakorduar me postet e paraqitura në aktiv dhe pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas viteve ushtrimore.
Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve të pasqyruar me dokumenta justifikues, ishin rregjistruar me shumat e paguara dhe të pritshme për t’u paguar.
Kostoja e punësimit është pasqyruar në mënyrë të saktë si shpenzime me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.
Shpenzimet janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit sipas destinacionit dhe natyrës.
Në zërin shpenzime të tjera janë përfshirë taksat lokale dhe taksa të tjera që kanë lidhje me aktivitetin si biznes.

Amortizimi është njohur si shpenzim sipas kërkesave të ligjit dhe gjendjet në këtë llogari janë nxjerrë nga pasqyrat e amortizimit e hartuara, ku janë bërë përllogaritjet për çdo lloj aktivi,duke zbatuar përqindjet përkatëse sipas aktiveve të përcaktuar në dispozitat ligjore për këtë qëllim.
Shpenzimet për paga janë kontabilizuar në mënëyrë të saktë dhe mbi bazë të dokumentacionit financiar dhe justifkues.

- **Mbi auditimin e informacionit kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare.**

Aktivi dhe pasivi në pasqyrën e pozicionit financiar është i kuadruar. Pasqyrat anekse rakordojnë me aktivin dhe pasivin në pasqyrën e pozicionit financiar për llogaritë analoge.
Analiza e posteve kryesore të aktivit dhe pasivit në pasqyrën e pozicionit financiar për vitet 2023-2024 paraqitet si më poshtë:
Tabela: Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Emërtimi I llogarive	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023 I rideklaruar	Korrigjimi I gabimeve	31 Dhjetor 2023 I deklaruar
	AKTIVE	**5,701,862,638**	**5,505,045,657**	**53,787,112**	**5,451,258,545**
	AKTIVET AFATSHKURTRA	**974,596,450**	**844,559,577**	**-168,167,882**	**1,012,727,459**
	Mjetet monetare në arkë dhe në bankë	65,957,220	15,544,898		15,544,898
	Llogari të arkëtueshme tregtare	878,586,985	804,651,692		804,651,692
	Të tjera të arkëtueshme	11,128,241	12,497,685	-168,167,882	180,665,567
	Inventarët	18,924,005	11,865,302		11,865,302
	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0		
	AKTIVET AFATGJATA	**4,727,266,188**	**4,660,486,080**	**221,954,994**	**4,438,531,086**
	Aktivet afatgjata materiale	4,727,266,188	4,660,486,080	221,954,994	4,438,531,086
	PASIVE	**5,701,862,638**	**5,505,045,657**	**53,787,112**	**5,451,258,545**
	DETYRIME	**4,122,103,386**	**3,883,701,820**	**101,775,672**	**3,781,926,148**
	DETYRIME AFATSHKURTRA	**1,526,210,243**	**1,407,103,229**	**-253,479,813**	**1,660,583,041**
	Detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve te kredise	59,623,009	60,369,614		60,369,614
	Llogari të pagueshme tregtare	1,389,321,090	1,276,780,734	-315,358,972	1,592,139,705
	Detyrime ndaj personelit	7,341,489	4,234,543		4,234,543
	Detyrime tatimore	68,664,655	64,119,339	61,879,159	2,240,180
	Detyrime të konstatuara	1,260,000	1,599,000		1,599,000
	DETYRIME AFATGJATA	**2,595,893,143**	**2,476,598,592**	**355,255,484**	**2,121,343,107**
	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	1,377,535,251	1,457,955,802		1,457,955,802
	Fonde buxhetore afatgjata /Grant per AAM	1,200,157,492	1,018,642,789	355,255,484	
	Provizione për shpenzime	18,200,400	0		0
	KAPITALI	**1,579,759,252**	**1,621,343,837**	**-47,988,560**	**1,669,332,397**
	Kapitali aksionar	1,928,337,500	1,928,337,500		1,928,337,500
	Rezerva të tjera (kapitali neto i transferuar nga NUKK-shtet)	0	0		0
	Rezerva nga rivleresimi AAM-transf.UKT SHA.	17,851,570	17,851,570		17,851,570
	Fitimi/Humbja e mbartur	-324,845,233	-326,214,057	-19,008,216	-307,205,840
	Fitimi i ushtrimit	-41,584,585	1,368,824	-28,980,343	30,349,167

Burimi: UK Kamëz

Bazuar në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) nr. 8 "Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet", paragrafi 42 dhe 43, duke konsideruar që gabimi i periudhës paraardhëse korrigjohet me rideklarim retrospektiv, "UKK SHA" ka rideklaruar të gjitha efektet në zërat e pasqyrës së pozicionit financiar dhe në rezultatin financiar (llogaria 108) efektet komulative të vitit 2022 dhe 2023 që lidhen me shpenzimet e amortizimit, rimarrjen e granteve dhe diferencat e kursit nga mbyllja e furnitorit. Ata kanë rideklaruar balancat krahasuese të vitit 2024 dhe 2023 ashtu sikurse duhet të jenë.

Aktivet monetare [Likujditete në arkë dhe në bankë]

Mjetet monetare përfshijnë arkën dhe llogaritë rrjedhëse në bankat e nivelit të dytë. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë paratë e gatshme dhe depozita me afat,

me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Shoqëria disponon mjete monetare në arkë, te cilat janë arkëtuar ne llogarite bankare ne date 05.01.2025**.**

Tabela: Mjete monetare në arkë dhe bankë

	Nr. Llogari	Emri i llogarise	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Mjetet monetare në arkë dhe në bankë	5121	Vlera monetare në bankë	14,403,658.79	762,067,432.47	711,850,525.27	64,620,565.99
	5311	Vlera monetare në arkë	1,141,239.00	1,336,654.00	1,141,239.00	1,336,654.00
	581	Xhirime te brendshme	0.00	16,477,893.00	16,477,893.00	0.00
			15,544,897.79	779,881,979.47	729,469,657.27	65,957,219.99

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Gjendja e llogarive te likujditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të barabarta me të dhënat kontabilitetit rrjedhës dhe janë të konfirmuara me nxjerrjen e llogarisë rrjedhëse të bankës në çdo vit si dhe llogaria e arkës është e barabartë me invetarin fizik të kryer në arka me 31 dhjetor të çdo viti.

Gjatë vitit, shoqëria arkëton faturat e klientëve në bankë, në arkat e njësive të saj vartëse si dhe në institucionet financiare jo banka (agjent tatimor) me të cilat ka lidhur marrëveshje. Paratë e grumbulluara në arkë derdhen në llogaritë bankare të shoqërisë e cila punon me 5 banka të nivelit të dytë, me llogari bankare vetëm në lekë. Pagesat nga shoqëria kryhen vetëm me veprime/transaksione bankare dhe jo cash.

Aktive të tjera financiare afatshkurtra.

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerën e faturuar. Në këtë zë janë përfshirë kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit, të cilat në njohjen fillestare janë vlerësuar me vlerën e paskontuar apo me koston e transaksionit. Pas njohjes fillestare, aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me kosto përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme dhe të drejta të ngjashme si nga tatimet, debitorët etj.

- Në pasqyrën e pozicionit financiar në llogarinë ***"Kërkesa të arkëtueshme"*** janë të pasqyruara faturat e pa arkëtuara për shitjet që shoqëria ka bërë për aktivitetin e saj deri në fund të çdo viti ushtrimor. Llogaritë e arkëtueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të çdo viti ushtrimor janë si më poshtë:

Tabela: Llogari të arkëtueshme

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Klientë per tu arketuar	941,493,879	867,558,586
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme transferuar nga UKT SHA.	-62,906,894	-62,906,894
Gjendja më 31 Dhjetor	**878,586,985**	**804,651,692**

Burimi: UK Kamëz

✓ ***Llogaritë e arkëtueshme tregtare*** në mënyrë analitike, në fillim dhe në fund të çdo viti ushtrimor dhe lëvizjet e tyre debi-kredi paraqiten si më poshtë:

Tabela: Llogari të arkëtueshme tregtare

	Nr. Llogari	Emri i llogarise	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Llogari të arkëtueshme tregtare	411	Kliente per mallra , produkte e shërbime	860,712,252.24	636,088,621.62	555,306,991.88	941,493,881.98
	491	Provizione per faturat e klientëve	-56,060,560.00	0.00	6,846,334.00	-62,906,894.00
	Shuma		804,651,692.2	636,068,621.62	562,153,325.88	878,586,987.98

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Një pjesë e këtyre detyrimeve janë si rezultat i ristrukturimit të Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve Kamëz me datë 31.12.2019, të cilat u transferuan te UKK SHA. në llogarinë

"Klientë" kërkesa për arkëtim në vlerën 238,181,559 lekë. Teprica e llogarisë "Klientë" në mbyllje të vitit 2019 ishte në vlerën 463,639,692 lekë.

Debitorët.

Llogaria 411 Gjendjet e debitorëve dhe arkëtimet e kryera nga debitorët sipas viteve dhe klasifikimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Gjendja e debitorëve

Nr	Lloji i Debitorëve	Gjendjet e debitorëve në 31 dhjetor sipas viteve					
		Viti 2023		Viti 2024		9-mujori 2025	
		Debitorë	Arkëtime	Debitorë	Arkëtime	Debitorë	Arkëtime
1	Familjarë	756,409,339	369,901,211	848,288,836	412,395,029	831,900,505	303,319,504
2	Shtet & Privat	88,150,680	51,074,612	90,973,796	67,970,631	144,469,014	44,099,510
3	Te tjera	22,998,586	37,218,477	2,231,247	74,941,331	15,606,876	75,976,453
	Shuma	**867,558,586**	**458,194,300**	**941,493,879**	**555,306,992**	**991,976,395**	**422,395,467**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezulton që kërkesat për arkëtim në vitin 2023 janë në vlerën 867,558,586 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 941,493,879 lekë. Pra kërkesat për arkëtim kanë pësuar rritje prej 73,935,293 lekë ose në masën 8.5 % nga viti 2023 në vitin 2024, ku familjarët 97 %, privatët dhe shtetërorët 3 %, nga të cilat peshën kryesore për mospagimin e detyruar ndaj Ujësjellës Kanalizimeve Kamëz SHA. e zënë familjarët.

Nga UKK SHA janë ndërmarrë dhe zbatuar këto masa:

Tabela: Masat e marra kundrejt debitorëve

Nr	Viti	Nr i njoftimeve	Akt-konstatime	Fletë-gjoba	Prerje furnizim me ujë
1	2023	67	29	13	16
2	2024	46	66	3	10
3	2025	559	178	0	94

Burimi: UK Kamëz

Nga debitorë gjithsej në vlerën 941,493,879 lekë deri në 31.12.2024 është trashëguar që para vitit 2020 vlera prej 556,887,070 lekë, ndërsa vlera prej 384,606,809 lekë është akumuluar gjate vitit 2020-dhjetor 2024. Nga debia totale vlera 732,277,140 lekë ka pritshmëri arkëtimi, ndërsa vlera prej 244,092,379 lekë nuk ka shpresë arkëtimi, pasi janë mbi 10 vjet. Këta shifra të detajuara sipas llojit të debitorëve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Të dhëna mbi debitorët

Nr	Lloji i Debitorëve	Me pritshmëri arkëtimi	Pa shpresë arkëtimi
1	Familjarë	623,925,379	207,975,126
2	Shtet & privat	108,351,761	36,117,253
3	Te tjera	0	0
	Shuma	**732,277,140**	**244,092,379**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Një pjesë e këtyre detyrimeve janë si rezultat i ristrukturimit të Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve Kamëz me datë 31.12.2019, të cilat u transferuan te UKK SHA. në llogarinë "Klientë" kërkesa për arkëtim në vlerën 238,181,559 lekë. Teprica e llogarisë "Klientë" në mbyllje të vitit 2019 ishte në vlerën 463,639,692 lekë. Me datë 31.12.2024 vlera e klientëve është 941,493,879 lekë, që i përkasin detyrimeve që kanë 63230 abonentë ndaj UKK SHA. Pra është rritur vlera e klientëve që nuk kanë paguar në afat të faturat e furnizimit me ujë, duke përfshirë dhe mosarkëtimet e abonentëve për taksa dhe tarifa vendore të cilat janë në vlerën 362,220,001 lekë në fund të vitit 2024 nga 279,645,251 lekë në fund të vitit 2023. Nga evidenca e marrë për klientët në datë 31.12.2024 konstatohet se vlera në total e klientëve është 814,029 lekë më shumë se sa në kontabilitet. Në ëtë evidencë u konstatuan se janë përfshirë dhe klientë me balancë kreditore, për të cilën nuk na u paraqit një analizë e tyre arsyeja e krijmit dhe efekti i përllogaritur.

Konkluzion: Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria sintetike "Kërkesa të arkëtueshme" bashkë me provizionet për zhvlerësimin e tyre paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 804,651,692 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 878,586,984 lekë. Llogaria analitike 411 "Klientë për mallra, produkte e shërbime" paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 867,558,586 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 941,493,879 lekë. Pra kërkesat për arkëtim në vitin 2024 kanë pësuar rritje prej 73,935,293 lekë ose në masën 8.5 % krahasuar me vitin 2023, ku peshën kryesore të debitorëve ndaj UKK SHA e zënë abonentët familjarë në masën 97 %, privatët dhe institucionet shtetërore në masën 3 %.
Vlera e klientëve prej 941,493,879 lekë i përket detyrimeve që kanë 63230 abonentë ndaj UKK SHA në datën 31.12.2024, ku vlera prej 556,887,070 lekë është trashëguar që para vitit 2020 në momentin e transferimit nga UKT SHA në UKK SHA, ndërsa vlera prej 384,606,809 lekë është akumuluar gjatë viteve 2020-dhjetor 2024, në të cilën është përfshirë edhe vlera prej 362,220,001 lekë e debitorëve nga mosarkëtimet e abonentëve për taksa dhe tarifa vendore ndaj Bashkisë Kamëz. Për llogaritë e arkëtueshme neto, nuk ka të dhëna për kohën kur këto debitorë janë krijuar dhe sa janë vonesat për secilin prej tyre, që përbën një risk të shtuar për sigurinë e nevojshme lidhur me saktësinë dhe plotësinë e shumës neto për llogaritë e arkëtueshme në datën 31.12.2024 si dhe për mbledhjen dhe zhvlerësimin e tyre.
Mosarkëtimi i detyrimeve është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenet 1 e 12.
Situata e mësipërme tregon për një punë jo të mirë nga administratës së Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA në drejtim të arkëtimit të të ardhurave nga uji i pijshëm në kundërshtim me VKM nr.236, datë 10.5.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë", i ndryshuar me VKM nr.96, datë 21.2.2007, me Udhëzimin e nr.3, datë 28.07.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm", pika 6 në të cilën përcakohet: "*6. Konsumatori në bazë të kontratës së lidhur me SHA. ujësjellës-kanalizime, shoqërinë menaxhuese të ujësjellës-kanalizimeve ose ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, duhet të paguajë për konsumin e ujit të pijshëm. Fatura tatimore e konsumit të ujit të pijshëm, sipas modelit të përcaktuar 3518 nga Ministria e Financave, në bazë të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, me ndryshimet përkatëse "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" është titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e saj*".

- ✓ Gjendje e llogarisë 491"Provizione për faturat e klientëve" paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 56,060,560 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 62,906,894 lekë.

Për pjesën e transferuar nga UKT SHA. zhvlerësimi është njohur bazuar në politikën kontabël të aplikuar nga shoqëria transferuese për shumën 56,060,560 lekë dhe vlerat janë paraqitur sipas proces-verbalit të marrjes në dorëzim në dhjetor 2019. Po kështu në vitin 2024 është rritur vlera e zhvlerësimit për faturat e klientëve me 6,846,334 lekë që lidhen me detyrimet e e transferuara nga UKT me vonesë një pjesë e kontratave të abonentëve që ndodhen nën administrim të UKT SHA, por që i përkasin UKK SHA. Vlera prej 6,846,334 lekë është korrigjuar për gjendjen e vitit 2023 dhe është rideklaruar, e cila përfaqëson zhvlerësimin e klientëve për 139 abonentë debitorë të transferuar me vonesë dhe përllogaritjes së provizionit për to deri në 31.03.2022 nga UKT SHA. Ky veprim kontabël është bërë në bazë të procesverbalit të marrjes në dorëzim me shkresën nr.prot. 251/3, datë 14.12.2022 të hartuar nga UKT SHA dhe firmosur nga komisionet e dy palëve përfaqësuese UKT SHA dhe UKK SHA. Të dhënat sipas procesverbalit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Të dhëna nga procesverbali lidhur me debitë dhe provigjonet

Përmbledhëse e debisë			Përmbledhëse e provigjoneve			
Kategoria/ mënyrë matje	**Debi + fatura Mars 2022**	**Nr. Kontratave**	**Kategoria**	**Debia Mars 2022**	**Provizioni deri Mars 2022**	**% e provizionit deri Mars 2022**
Institucione Buxhetore	**1,591,070**	**4**	**Institucione Buxhetore**	**1,591,070**	**1,591,070**	100%
Me matje	1,591,070	4				
Familjar pa kanal	**1,599,980**	**57**	**Familjar pa kanalizime**	**1,599,980**	**1,599,980**	100%
Me matje	1,200,659	55				
Mesatare (pa matje)	82,265	1				
Pa matje	317,056	1				
Familjarë	**3,646,322**	**77**	**Familjarë**	**3,646,322**	**3,646,322**	100%
Me matje	1,589,737	70				
Pa matje	2,056,585	7				
Privat	**8,962**	**1**	**Privat**	**8,962**	**8,962**	100%
Me matje	8,962	1				
Total	**6,846,334**	**139**	**Total**	**6,846,334**	**6,846,334**	100%

Burimi: UK Kamëz

Për klientët e transferuar nga NUKK me datë efektive 31.12.2019 te UKK SHA. nuk është njohur zhvlerësim, pavarësisht vonesave në pagesë. Po kështu për vitin 2024 nuk është kryer zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme, pavarësisht ekzistencës së vonesave në arketimin e klientëve.

✓ Balancat e llogarive "**Të tjera të arkëtueshme"** në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Llogari të arkëtueshme të tjera

	31 Dhjetor 2024	**31 Dhjetor 2023**
Tvsh e zbritshme	0	0
Tatim ne burim i mbipaguar	567,156	476,194
Paga punonjësish	1,205,458	1,541,840
Ndermjetes financiar për arkëtimin e faturave te klienteve	6,181,113	7,979,651
Debitorë për furnizime	2,500,000	2,500,000

Burimi: UK Kamëz

✓ Teprica e llogarisë së **TVSH së zbritshme** në mbyllje të vitit 2023 dhe 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë. TVSH e zbritshme është akumuluar që nga viti 2022 e në vazhdim, si rezultat i zbritjes së të drejtës për TVSH për projektet që paguhen më fonde të buxhetit të shtetit apo të tjera marrëdhënie. Fonde buxhetore janë marrë për ndërtimin e AAM të projektit të Bovillës së Vjetër, ndërtim i cili është marrë në dorëzim nga UKK SHA. me datë 20/06/2023 në vlerën total fonde te disbursuara janë 738,223,539.75 lekë, investim i cili ka filluar në vitin 2021 dhe është financuar deri vitin 2024. Me shkresën nr. 834/1 prot, datë 26.03.2024 Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, në përgjigje të kërkesës së UKK SHA. nr. 702 prot, datë 06.03.2024 ka konfirmuar që fondet e marra për financimin e këtij projekti janë grant. Për faturat ndaj furnitorit për këtë projekt TVSH-ja është likujduar në momentin e pagesës, por me mbylljen e vitit ushtrimor TVSH-ja e përllogaritur është korrigjuar në deklaratën e TVSH-ës së zbritshme pranë organeve tatimore, duke u korrigjuar vlera e kreditueshme e TVSH-ës në kontabilitet.

Tabela: Llogaritë e arkëtueshme të tjera dhe aktive të tjera financiare në mënyrë analitike

	Nr. Llogari	**Emri i llogarise**	**Gjendje me 31.12.2023**	**Debi**	**Kredi**	**Gjendje me 31.12.2024**
Të tjera të arkëtueshme	421	Paga e shperblime	745,688.00	175,890,847.00	176,138,806.00	497,729.00
	423	Paradhënie per punonjesit	707,729.00	0.00	0.00	707,729.00
	449	Tatimi ne burim	476,194.00	273,249.00	182,287.00	567,156.00
	4671	AK-INVEST SHA	1,490,801.24	124,301.04	1,490,801.24	124,301.04
	4672	UNIONI FINANCIAR TIRANE SHA	3,036,157.24	1,305,797.00	3,036,157.24	1,305,797.00
	4673	TARIFIMI I TAKSAVE BASHKIA KAMEZ	26,434.50	175,171,845.00	175,198,279.50	0.00

	4674	EASY PAY SHPK	3,452,693.00	3,884,645.18	3,452,693.00	3,884,645.18
	4675	RAEA FS SHPK	0.00	866,369.36	0.00	866,369.36
	4676	AKPA PAGA DHE SIG	0.00	4,888,578.00	4,214,064.00	674,514.00
	4677	Marërdhënie me 2 AF GROUP	2,500,000.00	0.00	0.00	2,500,000.00
			12,435,696.98	362,405,631.58	363,713,087.98	11,128,240.58

Burimi: UK Kamëz

✓ **Konkluzion: Teprica e llogarisë 421 *"Paga e shpërblime punonjësish"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 745,688 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 497,729 lekë. Këto gjendje përfaqëson kreditimin e punonjësve në formë paradhënie për paga dhe jo për udhëtime e dieta, të cilat nuk janë kthyer brenda afatit ligjor në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kreu "Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave më vlerë" pikat 64 dhe 66.

✓ **Konkluzion: Teprica e llogarisë 423 *"Paradhënie për punonjësit"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 707,729 lekë, vlerë e cila përfaqëson paradhënie për punonjësit e pa kthyer, e trashëguar që para viteve 2022, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kreu "Dokumentimi I vlerave monetare dhe letrave më vlerë" pikat 64 dhe 66.

✓ **Teprica e llogarisë 449 "*Tatim në burim"*** paraqitet në nbyllje të vitit 2023 në vlerën 476,194 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 567,514 lekë. Kjo gjendje përfaqëson tatimin e pa ndalur dhe e pa arkëtuar nga punonjësit.

✓ **Teprica e llogarisë 467/1-4 *"Ndërmjetës financiarë për arkëtimin e faturave të klientëve"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 7,979,651 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 6,181,113 lekë, që përaqësojnë gjendjet e arkëtuara nga abonentët (klientët), por të pa arkëtuara për llogari të UKK SHA nga institucionet financiare jo-bank që shoqëria UKK SHA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për shërbimin si agjent tatimor për arkëtimin e faturave të ujit për llogari të shoqërisë.

✓ **Teprica e llogarisë 467/6 *"AKPA të arkëtueshme paga dhe sigurime projekti i punësimit"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerë 674,514 lekë. Kjo gjendje përfaqëson detyrimin i AKPA për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetsore të muajit dhjetor 2024 që paguhen në janar 2025 është e drejtë që shoqëria UKK SHA ka për të marrë në vlerën 674,514 me datë 31.12.2024. AKPA është Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive një projekt i nxitjes së punësimit në të cilin ka marrë pjesë Shoqëria UKK SHA referuar kontratës datë 23.05.2024 me afat 1 vjecar, financuar me fonde buxhetore, të cilat nuk janë njohur në të ardhura dhe shpenzime të UKK SHA, por në llogaritë e marrëdhënies me AKPA.

✓ **Konkluzion:** Teprica e llogarisë **467/7 *"Debitorë për furnizime"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2024 në të njëjtën vlerë prej 2,500,000 lekë, e cila përfaqëson kryerjen e shpenzimeve me mbërritjen e faturës për blerje blloqe betoni për mbyllje të gropave të hapura që nga viti 2021 sipas kontratës përkatëse të këtij viti. Ky mall nuk është tërhequr nga UKK SHA nga furnitori "AF Group", pasi nuk është përdorur deri në fund të vitit 2025. Për këtë vlerë edhe pse kanë kaluar 4 vite nga UKK dhe shoqëria furnizuese nuk është ndërmarrë asnjë hap për mbylljen e këtij detyrimi, e drejtë për kthim UKK SHA. Kjo nënllogari vazhdon të rezultojë dhe pas 4 vitesh me tepricë debitore, gjë cila nuk ka llogjikë kontabël, duke mos u kryer asnjë veprim sistemimi, ndërkohë që edhe kontrata është tejkaluar për furnizimin me këtë mall. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK 1, pika 10, 25, 26, me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 5 dhe neni 11/1.

Inventari

Gjendja e inventarëve në fillim dhe në fund të ushtrimeve paraqitet:

Tabela: Inventarët

	Nr. Llog.	Emri i llogarise	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Inventarët	311	Materiale te para	8,396,062.02	0.00	6,650,868.00	1,745,194.02
	3123	Materiale ndihmese	22,500.00	0.00	22,500.00	0.00
	3124	Lende djegese	52,182.12	136,315.45	0.00	188,497.57
	3125	Pjese nderrimi	1,086,300.00	0.00	647,800.00	438,500.00
	327	Inventar i imet	2,308,258.00	14,243,555.00	0.00	16,551,813.00
	351	Mallra grupi I	-0.00	41,084,242.00	41,084,242.00	0.00
	Shuma		11,865,302.14	55,464,112.45	48,405,410.00	18,924,004.59

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Vlera e inventarëve të paraqitura më sipër përputhet me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në çdo vit ushtrimor. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrje-daljet nuk janë të tranzituar në llogarinë e rezultatit ekonomik, pasi ndryshimi i gjendjeve është me rritje nga viti paraardhës 2023 në vitin ushtrimor 2024 për shumën 10,366,045.48 lekë sipas kartelës kontabël. Për përcaktimin e kostove të inventarëve është përdorur metoda direkte.

Aktivet afatgjata materiale [AAGJM-te]

AAM e trashëguara nga ish-Ndërmarrja e Ujësjellës Kananalizime Kamëz- ent publik janë njohur në kontabilitet me kosto, ndërsa AAM e transferuara nga UKT SHA. pjesërisht janë vlerësuar me vlerë tregu për një pjesë jo të rëndësishme të tyre. Pavarësisht se efekti i vlerës së tregut në total është i ulët (vlera është jo materiale) shoqëria duhet të rregullojë efektin e vlerës së saj të AAM përkatëse, për të njehsuar metodën e njohjes së AAM në pasqyrat financiare. Për AAM e transferuara në vitin 2019, UKT SHA. ka transferuar krahas aktiveve edhe rezervën e rivlerësimit qe ka rezultuar nga ky proces me vlerën 17,851,570 leke.

Tabela: Aktivet afatgjata materiale

	Emertimi e Aktiveve Afatgjata Materiale	Gjendje 01.01.2024	shtesa /Riklasifikime	Pakesime	vlera e mbetur 31.12.2024
2116	Toka	9,350,000	0	0	9,350,000
2126	Ndertesa	109,050,276	22,458,059	3,783,522	127,724,813
2131	Rrjeti Ujesjelles	4,304,510,063	207,588,982	113,133,231	4,398,965,814
2134	Makineri,pajisje pune,Infor dhe mobilje	9,389,454	1,506,000	4,588,346	6,307,108
2151	Mjete Transporti	6,231,295	3,500,000	517,095	9,214,200
231	Aktive ne proces	0	175,714,255	-	175,714,255
	Shuma	**4,438,531,088**	**410,767,296**	**122,022,194**	**4,727,276,190**

Burimi: UK Kamëz

Vlera dhe klasifikimi në grupe i aktiveve afatgjata materiale të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe në tabelat shoqëruese të tyre janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimit fizik, që shoqëria ka kryer në fund të muajit dhjetor të çdo viti. Si politikë kontabël për kontabilizimin shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos [SNK-5].Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes si inventar është bërë me koston e blerjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amotizimin. Masa e llogaritjes së amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efekte fiskale, kjo sipas kërkesave të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, kapitulli i amortizimit.

Aktivet në proces gjate vitit 2024 janë financuar me fonde buxhetore. AAM e transferuara nga NUKK- ent publik, janë njohur në kontabilitet me Kosto, ndërsa AAM e transferuara nga UKT SHA pjesërisht janë vlerësuar me vlerë tregu për një pjesë jo të rëndësishme të tyre. Pavarësisht se

efekti i vlerës së tregut në total është i ulët (vlera është jo materiale) shoqëria duhet te rregulloje efektin e vlerës së saj te AAM përkatëse, për te njehsuar metodën e njohjes se AAM në pasqyrat financiare. Për AAM e transferuara ne vitin 2019, UKT SHA ka transferuar krahas aktiveve edhe rezervën e rivlerësimit qe ka rezultuar nga ky proces me vlere 17,851,570 Leke. Për shkak të evidencës së paplotë te aktiveve te rivlerësuara, rezerva është njohur në vlerën sikurse është transferuar në vitin 2019.

Amortizimi: Vlera e amortizueshme e një elementi të AAM-së njihet në pasqyrën e të performancës, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të aktivit. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime me metodën e vlerës së mbetur, për ndërtesat, pajisjet informatike, makineritë dhe pajisjet, rrjeti ujësjellës dhe kanalizime, mjetet e transportit etj. Toka nuk amortizohet.

Normat e amortizimit të përdorura për llogaritjen e amortizimit për periudhën janar-dhjetor 2024, janë normat e miratuara me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 05, datë 28.08.2023 si vijon: "Ndërtimet" me jetëgjatësi 50 vite dhe normë vjetore amortizimi 2%; "Rrjetet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet" me jetëgjatësi 40-50 vite dhe normë 2%-3%; "Makineri e pajisje pune" me jetëgjatësi 15 vite dhe normë 7%; "Automjetet" me jetëgjatësi 20 vite dhe normë 5%; "Pajisjet e zyrës, mobiljet, pajisjet dhe programet informatike, inventari i imët" me jetëgjatësi 5 vite dhe normë 20%. Data e zbatimit për herë të parë të këtyre normave është viti 2021, pasi pasqyrat financiare të këtij viti janë mbyllur në vitin 2024.

Gjendja neto e aktiveve afatgjata materiale në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë:

Tabela: Aktivet afatagjata materiale, gjendje neto

	Nr. Llog.	Emri i llogarise	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Aktivet afatgjata materiale	2116	Toka	9,350,000.00	0.00	0.00	9,350,000.00
	2126	vepra infrastrukture (Ndërtesa)	114,797,828.00	22,458,059.00	0.00	137,255,887.00
	2131	instalime teknike specifike	3,288,791,620.85	0.00	0.00	3,288,791,620.85
	21311	Investimi linje e re tubacion d=7000mm Bovilla e vjeter	743,450,002.53	0.00	0.00	743,450,002.53
	21312	Investime KFV(Rrjete & Kun) Projekti IV/Euro	1,033,344,786.40	230,047,041.00	22,458,059.00	1,240,933,768.40
	2134	Makineri dhe pajisje pune	20,844,359.00	726,000.00	0.00	21,570,359.00
	2151	MJETE TRANSPORTI	16,643,864.00	3,500,000.00	0.00	20,143,864.00
	2181	Mobilje dhe pajisje zyre	4,757,626.67	0.00	0.00	4,757,626.67
	2182	Pajisje informative	4,276,607.00	780,000.00	0.00	5,056,607.00
	231	AA materiale ne proces	-0.00	175,714,254.50	0.00	175,714,254.50
	2811	Amortizimi Aktive Afatgjata Materiale Jashteperdorimit	0.00	0.00	3,038,640.00	-3,038,640.00
	2812	Per ndertesat	-5,527,613.00	0.00	3,793,522.00	-9,321,135.00
	2813	Per instalime teknike, makinerite, pajisje, instrum e vegl	-763,950,782.89	0.00	113,133,231.00	-877,084,013.89
	2815	Per mjete transporti	-10,994,683.00	0.00	517,095.00	-11,511,778.00
	2818	Per te tjera AA materiale	-17,252,529.11	0.00	1,549,706.00	-18,802,235.11
	Shuma		4,438,531,086.45	433,225,354.50	144,490,253,.00	4,727,266,187.95

Burimi: UK Kamëz

Aktivet në proces gjate vitit 2024 janë financuar me fonde buxhetore. Gjatë vitit 2024 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve kanë programuar buxhetin për investime kapitale sipas programit "Furnizimi me ujë dhe kanalizime" për vitin 2024-2025 sipas projekteve të investimit:

- "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz" dhe supervizimin e saj në vlerën 163,046,302 lekë.

- “Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjellësit nga Impianti i Bovillës-Depo Maloku, Kamëz” dhe supervizimin e saj në vlerën 12,667,952 lekë.
Gjendja dhe lëvizjet sipas vite të aktiveve afatgjata në proces në mënyrë analitike paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Llogaria 231 “Investime në proces”

Nr i llog	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2023	Debi	kredi	Gjendja ne fund te vitit 2024
231	“Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe KUZ të zonës së Frutikulturës,Valias i Vjetër,Bashkia Kamëz”	0	161,535,990	-	161,535,990
231	Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjellësit nga Impianti i Bovillës-Depo Maloku,Kamëz.	0	12,602,952	-	12,602,952
231	Mbikqyrje “Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe KUZ të zonës së Frutikulturës,Valias i Vjetër,Bashkia Kamëz”	0	1,510,312	-	1,510,312
231	Mbikqyrje Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjellësit nga Impianti i Bovillës-Depo Maloku,Kamëz.	0	65,000	-	65,000
231	**Shuma investimeve ne proces**	-0.00	175,714,254.50	0.00	175,714,254.50

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

- **Detyrimet afatshkurtra.**

Ne kete grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitorëve, institucioneve financiare per huamarrjet, punonjësve, administratës tatimore, kreditorëve të tjerë etj.
Ne njohjen fillestare zerat e ketij grupi jane vleresuar me kosto.
Ne fund te vitit detyrimet vlerësohen me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anullohen ose skadojnë.
Detyrimet afatshkurtra përbëhen nga:

Tabela: Detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë

Përshkrimi	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
MFE-Kredia Infrastruktura bashkiake II-principal viti pasardhes	21 265 833	22 507 333
MFE-Kredia Infrastruktura bashkiake II-principal i papaguar ne afat	31 898 749	33 760 999
Interes i maturuar, i papaguar ne afat	6 458 427	4 101 282
Shuma	**59 623 009**	**60 369 614**

Burimi: UK Kamëz

Teprica e llogarisë ***“Detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë”*** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 60,369,614 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 59,623,009 lekë. Kjo gjendje përfaqëson pjesën e këstit vjetor të papaguar deri në datën 31.12.2024 (principalit dhe interesit) të kredisë afatgjatë “Kredia Infrastruktura Bashkiake II” për projektin e investimit “Furnizimi me uje dhe kanalizimet, me referencë Bashkia Kamëz O-12/04 KAMZA”, financuar nga KFẀ. Nga kjo shumë rezulton detyrim i papaguar në afat 541,666.7 EUR ekuivalent me 59,623,009 lekë. Gjendjet sipas viteve dhe lëvizjet në mënyrë analitike të detyrimeve afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Detyrimet afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë

	Nr. Llog.	Emri i llogarise	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve te kredise	46321	Kredi Afatgjata Ref O-12/04/Kame papaguar ne afat	0.00	0.00	53,164,581.70	-53,164,581.70
	484	Interesa pasive te llogaritura	-4,101,282.02	1,652,541.35	4,009,686.19	-6,458,426.86
		Shuma	-4,101,282.02	1,652,541.35	57,174,267.89	59,623,008.56

Burimi: UK Kamëz

Llogaria 401-404 "Të pagueshme tregtare" pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerje dhe shërbime pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor, e cila në mbyllje të vitit 2023 paraqitet me tepricë në vlerën 1,592,168,670.97 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet me tepricë në vlerën 1,389,321,090.46 lekë, me një diferencë në zbritje prej 202,847,580.51 lekë. Pavarësisht uljes së detyrimeve në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023, detyrimet ndaj të tretëve mbetet në shuma të konsiderueshme, gjë e cila përbën risk për aftësinë paguese të institucionit. Analiza më e detajuar detyrimeve ndaj furnitorëve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Detyrimet ndaj furnitorëve

Emri i Furnitorit	Pershkrimi i llojit të shpenzimit	Gjendje 31.12.2023	Likuiduar gjatë vitit 2024	Shtesa gjatë vitit 2024	Gjendje 31.12.2024
UKT	Detyrime për blerje uji nga UKT SHA	542,155,303	19,408,539	67,134,528	589,881,292
UKT	Të pagueshme ndaj UKT SHA sipas raportit të ndarjes në 2017	241,201,439	0	0	241,201,439
FSHU	Detyrime për blerje energjie elektrike	83,390,667	27,400,846	26,834,481	82,822,322
B.Kamëz	Detyrime ndaj palëve të lidhura (Bashkia Kamëz)	279,645,251	155,870,985	238,445,735	362,220,001
	Detyrime të pagueshme për investime MP/IV-Kamza-SCV-2019	315,358,972	315,358,972	0	0
	Të pagueshme furnitorit me fonde buxhetore	68,817,228	201,766,389	213,585,734	80,636,573
	Të pagueshme të tjera	61,570,846	93,376,123	64,364,761	32,559,484
		1,592,139,706	**813,181,854**	**610,365,239**	**1,389,321,111**

Referuar analizës së detyrimeve të pagueshme tregtare që përfaqësojnë faturat e palikujduara ndaj furnitorëve rezulton se peshën më të madhe e zënë:

a. Detyrimet për blerje uji nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA në shumën 831,082,731lekë ose në masën 60% ndaj totalit të detyrimeve të pagueshme, e cila përbëhet nga:

- shuma prej 241,201,439 lekë detyrim ndaj UKT SHA, e trashëguar nga pasqyrat financiare të transferuar nga bashkimi i UKK SHA me Ndërmarrjen Shtetërore NUK Kamëz në vitin 2019. Në lidhje me këtë detyrim është dakordësuar mes palëve në relacionin e vënies në zbatim të akteve të ndarjes, që ti propozohet Këshillave Bashkiake të Bashkive respektive që të vendosin, që të drejtat dhe detyrimet e krijuara midis dy shoqërive (UKT SHA dhe UKK SHA) si rezultat i veprimtarisë ekonomike nga data 01.01.2017 deri me 31.10.2019 të transferohen pa detyrime të ndersjellta. Deri në datën e nënshkrimit tët këtyre pasqyrave, një akt i tillë nuk është nënshkruar dhe balanca e detyrimit ka mbetur e njëjtë, si në datën e transferimit.

- shuma prej 589,881,292 lekë detyrim i Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA ndaj Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA, e cila është në vlerë të konsiderueshme, për shkak të mos likujdimit të këtyre faturave nga mos realizimi i të ardhurave nga shitja e ujit.

Për shlyerjen e detyrimeve UKK SHA ka lidhur me UKT është vepruar në mënyrë të tillë që për cdo muaj janë kryer pagesa sipas mundësive financiare që UKK SHA disponon.

b. Detyrime ndaj FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) për blerje energjie elektrike paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në shumën 83,390,667 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 82,822,302 lekë, të cilat janë akumuluar para viteve 2020 dhe përbëjnë 6% të detyrimeve të pagueshme tregtare. Për faturat e palikujduara të viteve të mëparshme me FSHU është bërë një akt-rakordim me nr.prot.28953, datë 18.12.2023.

c. Detyrime ndaj palëve të lidhura (Bashkia Kamëz) në shumën 362,220,001 lekë që përbën masën 26% ndaj totalit të detyrimeve të pagueshme. Kjo vlerë përfaqëson detyrimet e pagueshme për faturimin dhe arkëtimin e taksave familjare dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë që buron nga fakti se shoqëria UKK SHA ka një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Kamëz si agjent tatimor. Ky detyrim që shoqëria UKK SHA ka ndaj Bashkisë Kamëz përbëhet nga:

- vlera prej 99,307,118 lekë që është detyrim i transferuar nga NUKK në UKK SHA me Bashkinë Kamëz
- vlera prej 262,912,883 lekë që është akumuluar gjatë viteve 2021-2024 si rezultat i mosarkëtimit të taksave familjare dhe të ndikimit në infrastrukturë nga abonentët.

d. Detyrimet e pagueshme për investime (të financuar me hua nga KFW) janë në shumën 0 lekë. Lidhur me detyrimet e pagueshme për investimin në projektin MIP/IV-KAMZA-SCW-2019 në shumën 3,035,800.65 EUR konvertuar në 315,358,972 lekë UKK SHA në mbyllje të vitit 2022 dhe 2023 ka raportuar detyrimin ndaj Shoqërisë sipërmarrëse të punimeve "S.A.G". Gjatë vitit 2024 këto detyrime në vlerën 315,358,972 lekë janë likuiduar, gjë të cilën e ka konfirmuar edhe furnitori me njoftim të datës 19.06.2024, se të gjitha detyrimet ndaj tij janë paguar, pra balanca e të drejtës së tyre ndaj UKK SHA. me datë 31.12.2024 është 0 lekë.

e. **Të pagueshme për furnitorë** për detyrimet ndaj furnitorëve për investime financuar me fonde buxhetore janë:
- për projektin "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz" në vlerën 78,068,022 lekë me OE fitues "E"
- për supervizimin e projektit "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz" në vlerën 1,812,374 lekë me OE fitues "T" SHPK
- për projektin "Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjellësit nga Impianti i Bovillës-Depo Maloku, Kamëz" në letrën 756,177 lekë me OE fitues "N.G.S" SHPK.

Tabela: Llogaritë "Të pagueshme ndaj punonjësve" në fund të çdo viti

	Nr. Llog.	Emri i llogarise	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Detyrime ndaj personelit	4211	Paga te tjera personeli	88,423.00	428,561.00	625,568.00	-108,584.00
	4212	Paga AKPA	0.00	2,514,667.00	2,916,876.00	-402,209.00
	431	Sigurime shoqerore dhe shendetsore	-4,234,543.00	53,981,509.00	56,311,208.00	-6,564,242.00
	4311	sigurime AKPA	0.00	1,664,279.00	1,930,731.00	-266,452.00
			-4,146,120.00	**58,589,016.00**	**61,784,383.00**	**-7,341,487.00**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Referuar analizës së llogarive "detyrime të pagueshme ndaj personelit" peshë të madhe zënë detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shendetësore, që përfaqësojnë detyrimet e muajit dhjetor 2024 të paguara në vitin 2025. Detyrimet per paga të muajit dhjetor të vitit 2024 janë paguar në atë muaj. Paga të tjera personeli në shumën 108,584 lekë përfaësojnë honorare të Këshillit Aministrimit të muajit dhjetor të paguara në vitin 2025.Paga dhe sigurime AKPA (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive) perfaqësojnë detyrime lidhur me një projekt të nxitjes se punësimit në të cilin ka marrë pjesë Shoqëria referuar kontratës datë 23.05.2024 me afat 1-vjecar të financuar me fonde buxhetore, të cilat nuk janë njohur në të ardhura dhe shpenzime të UKK SHA, por në llogaritë e marrëdhënies me AKPA.

Detyrimet tatimore në fund të çdo viti paraqesin tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, të llogaritura dhe të paguara, tatimin mbi vlerën e shtuar që paraqet detyrimin nga tvsh e pagueshme, të pa likujduar sipas formularit të deklarimit të pasurive (FDP-ve), për vitet 2023 e 2024. Balanca e detyrime tatimore në mbyllje të vitit 2023 dhe të vitit 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:
Tabela: Balanca e detyrime tatimore në mbyllje të vitit 2023 dhe të vitit 2024

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Detyrime tatimore	442	Tatim mbi të ardhurat e personale	-1,633,509.00	11,092,892.00	11,004,404.00	-1,545,021.00
	4421	Tatim i mbajtur AKPA	0.00	35,118.00	40,971.00	-5,853.00
	444	Tatim mbi fitimin	-606,671.00	0.00	0.00	-606,671.00
	4454	Shteti-TVSH për tu marrë	168,167,881.89	176,618.40	234,851,609.83	-66,507,109.54
	4455	TVSH e zbritshme	2,553.31	61,616,154.79	61,618,708.10	-0.00
	4456	Shteti-TVSH e zbritshme	-0.00	296,470,317.93	296,470,317.93	0.00
			165,930,255.20	**369,391,101.12**	**603,986,010.86**	**-68,664,654.54**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Referuar analizës të llogarive të detyrimeve tatimore rezulton se në fund të vitit 2024 janë gjendje detyrimet ndaj shtetit (DPT) për tu paguar si: detyrimi mbi të ardhurat personale të punonjësve në vlerën 1,550,874 lekë që i takon pagave të muajit dhjetor 2024, tatim fitimi në shumën 606,671 lekë dhe TVSH nga faturat e shitjes në vlerën 66,507,109 lekë.

Detyrime të konstatuara (të llogaritura)
Teprica e llogarisë 481 "Shpenzime të llogaritura" paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,599,000 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,260,000 lekë që përfaqësojnë detyrimet e konstatuara për shpenzime të faturuara e të kryera për auditimin e pasqyrave financiare pas datës së pasqyrave finanaciare, që lidhen me vitin ushtrimor 2024.

Konkluzion: Në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria sintetike ***"Detyrimet afatshkurtra"*** paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,407,103,229 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,526,210,243 lekë, duke u rritur në vlerën prej 119,107,014 lekë ose në masën 7.8%. Në këto detyrime peshën kryesore e zënë:

a. ***"Detyrimet e pagueshme tregtare"*** të cilat paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,592,168,670.97 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,389,321,090.46 lekë, me një diferencë në zbritje prej 202,847,580.51 lekë. Pavarësisht uljes së detyrimeve në vitin 2024 në krahasim me vitin 2023, detyrimet ndaj të tretëve mbetet në shuma të konsiderueshme, gjë e cila përbën risk për aftësinë paguese të institucionit. Në këto detyrime peshën më të madhe e zënë:

- detyrimet ndaj UK Tiranë SHA në shumën 831,082,731lekë ose në masën 60% ndaj totalit të detyrimeve të pagueshme, ku 241,201,439 lekë janë trashëguar në momentin e transferimit viti 2019. UK Tiranë SHA ka raportuar të drejta për shumën 18,157,547 lekë më tepër se balanca sipas UK Kamëz SHA, duke cënuar kështu parimin e plotësisë dhe besueshmërisë se vlera e detyrimeve ndaj UKT SHA është e saktë dhe pasqyruar drejtë në kundërshtim me Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" nenet 3/7, 7, 11, 15 me SKK nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare" pikat 69-76.

- detyrimet ndaj FSHU (Furnizuesi i Shërbimit Universal) për blerje energjie elektrike përbëjnë 6% të detyrimeve të pagueshme tregtare në shumën 82,822,302 lekë.

- detyrimet ndaj palëve të lidhura (Bashkia Kamëz) në shumën 362,220,001 lekë që përbën masën 26% ndaj totalit të detyrimeve të pagueshme. Kjo vlerë përfaqëson detyrimet e pagueshme për faturimin dhe arkëtimin e taksave familjare dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi UKK SHA është në rolin e agjentit tatimor.

b. ***"Detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë"*** paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 60,369,614 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 59,623,009 lekë. Kjo gjendje përfaqëson pjesën e këstit vjetor të papaguar deri në datën 31.12.2024 (principalit dhe interesit) të kredisë afatgjatë "Kredia Infrastruktura Bashkiake II" për projektin e investimit "Furnizimi me ujë dhe kanalizimet, me reference Bashkia Kamëz O-12/04 KAMZA", financuar nga KFẂ.

c. *"**Detyrimet tatimore"*** paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 165,930,255.20 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 68,664,654.54 lekë, ku pjesën më të madhe e zënë detyrimet e TVSH-ës për faturat e shitjes të pa derdhur në strukturat tatimore, të cilat paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 168,167,881.89 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 66,507,109.54 lekë. Mos shlyerja nga UKK këtyre detyrimeve është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenet 1 e 12.
Pra "Aktivet afatshkurtra" nuk mbulojnë "Detyrimet afatshkurtra", sepse sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datë 31.12.2024 "Aktivet afatshkurtra" janë në shumën 955,672,446 lekë (mjetet monetare plus llogaritë e arkëtueshme duke zbritur vlerën e inventarit qarkullues) dhe "Detyrimet afatshkurtra" në shumën 1,445,573,669 lekë (pasi është zbritur vlera e detyrimeve të pagueshme me fonde të buxhetit të shtetit). Kjo situatë evidenton paaftësinë financiare të shoqërisë për mbulimin e detyrimeve afatshkurtra, e cila mund të sjellë pasiguri për vijimësinë e aktivitetit, si rezulat i pamundësisë së kryerjes së pagesave të detyrimeve që aktualisht i kanë tejkaluar afatet ligjore, por edhe përballjen me kosto shtesë si rezultat i çështjeve gjyqësore që mund të drejtojnë palët e treta ndaj saj. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK nr.1 pikat 46, 47 "Parimi i vijueshmërisë".

Detyrimet afatgjata

Tabela: Detyrimet afatgjata huamarrje dhe grante

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	408	Ministria e Finances -Hua KFẀ-kredia Infrastruktura bashkiake III/IV	-850,257,800.00	46,900,050.00	0.00	-803,357,750.00
	4632	Kredi Afatgjata Ref O-12/04/Kamez kredia Infrastruktura bashkiake II	-663,966,333.69	89,788,832.70	0.00	-574,177,500.99
			-1,514,224,133.69	**136,688,882.70**	**0**	**-1,377,535,250.99**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Të dyja kreditë janë në monedhën e huaj Euro, për këtë me datë 31.12.2024 ata janë rivlersuar me kursin e datës 31.12.2024, duke u debituar për shumën e rivlerësimit vjetor sipas kursit të këmbimit prej 136,688,882.7 lekë (është amortizuar për këstin vjetor të kredive**).**

Kredia Infrastruktura Bashkiake II, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, me referencë Bashkia Kamez O-12/04 KAMZA, është njohur referuar marrëveshjes së nënhuasë ndërmjet Ministrisë së Financave (MF) dhe Bashkisë Kamëz, datë 30.05.2012, me vlerë 6,500,000 EUR. Programi i Infrastrukturës Bashkiake II, Furnizimi me ujë dhe kanalizimet për bashkinë e Kamzës, me afat 40 vite, nga i cili 10 vite, periudhë e lirë. Sipas kontratës pagesa e huasë duhet të fillojë me datë 30 Qershor 2021 me afat 30 vite, deri me 30 Dhjetor 2051. Shoqëria nuk ka njohur shpenzime interesi për huanë e marrë deri me 31.12.2021. Në kontratë nuk është shënuar norma e interesit (neni 3). Sipas kontratës, interesi i periudhës së lirë nga data e kontratës e më pas, i pagueshëm në KFẀ-së, i njoftohet huamarrësit nga MFE (si interesi i paguar ashtu edhe interesi për tu paguar). Shoqëria nuk ka paguar në afat detyrimet e vitit 2024. Këto detyrime si dhe këstet e pagueshme në vitin 2024, janë raportuar te detyrimet afatshkurtra.
Balanca totale e kësaj kredie me 31.12.2024 është 5,850,000.02 EUR, nga e cila është zbritur shuma e principalit. Pagesat e principalit të kësaj kredie që duhet të paguhen gjatë vitit 2025 janë në shumën 541,666.65 EUR .

Kredia Infrastruktura Bashkiake IV, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, me referencë Bashkia Kamëz O-17/03 KAMZA, financuar nga KFẀ, me fond limit në shumën 8,185,000 EUR dhe balancë të detyrimit me 31.12.2023 të konfirmuar nga MFE në vlerën 8,185,000 EUR ose 850,257,800 lekë (31.12.2022: 8,185,000 EUR ekuivalent me 934,972,550 lekë).
Kjo hua me tepricë në vlerën 8,185,000 EUR përfaqëson disbursimet e kryera nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE), referuar marrëveshjes së nënhuasë ndërmjet saj dhe Bashkisë Kamëz, Ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime datë 29.12.2017 me vlerë 8,185,000 EUR, "Programi i Infrastrukturës Bashkiake IV, Furnizimi me ujë dhe kanalizimet në qytetin e Kamzës", me afat 40 vite, nga i cili 10 vitet periudhë e lirë. Pagesa e huasë fillon me datë 30 maj 2028 me afat 30 vite, deri me 30 nëntor 2057. Shoqëria nuk ka njohur shpenzime interesi për huanë e marrë. Në kontratë nuk është shënuar norma e interesit. Sipas kontratës interesi i periudhës së lirë nga data e kontratës deri më 31 maj 2028 e më pas i njoftohet huamarrësit nga MFE (si interesi i paguar ashtu edhe interesi per tu paguar). Shoqëria nuk ka marrë informacion lidhur me këtë pikë. Ajo ka paraqitur huanë në këto pasqyra financiare me vlerën e huasë së disbursuar (me kosto).

Fonde buxhetore afatgjata /Grant për AAM

Tabela: Fonde buxhetore AAGJ/ Grante për AAM

Nr i llog.	Emërtimi i llogarive	Gjendjet sipas viteve	
		Viti 31.12.2023	Viti 31.12.2024
	Financim buxhetor/Grant per AAM	663,387,305	851,405,300
	Grant AAM nga S & AKUK	355,255,484	348,752,192
	Shuma	**1,018,642,789**	**1,200,157,492**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Veprimet kontabël në këto llogari, lëvizjet dhe gjendjet sipas viteve në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme*:*

Tabela: Veprimet kontabël për fonde buxhetore AAGJ/ Grante për AAM

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Fonde buxhetore afatgjata /Grant per AAM	1311	Llogaria e Shpenzime Kapitale	-663,387,304.65	14,869,000.00	202,886,995.75	-851,405,300.40
	1312	Grant nga qeveria per MIP IV	0.00	19,455,249.00	368,207,441.00	-348,752,192.00
		Shuma	**-663,387,304.65**	**34,324,249.00**	**571,094,436.75**	**1,200,157,492.40**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Nga analiza e llogarive sipas raportit verifikues të llogarive fonde buxhetore afatgjata/grant për AAM rezulton se:
- Teprica e llogarisë 1311 "Shpenzime kapitale" paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 663,387,304 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 851,405,300 lekë

- Teprica e llogarisë 1312 "Grant nga qeveria (SECO&AKUK) për MIP IV" paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 348,752,192 lekë. Me deklarimin e PF të vitit 2024 është bërë korrigjimi i gjendjes së kësaj llogarie të vitit 2023 me vlerën prej 355,255,484 lekë, e cila përfaqëson shumën e Grandit të rimbursuar për AAM të dhënë nga SECO për ndërtimin e projektit MIP IV "Furnizimi me ujë dhe kanalizimet në qytetin e Kamzës". Kjo llogari është sistemuar me llogarinë e shpenzimeve kapitale.

Gjatë vitit 2024 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve kanë programuar buxhetin për investime kapitale sipas programit "Furnizimi me ujë dhe kanalizime" për vitin 2024-2025, për projektin "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz" dhe supervizimin e saj, si dhe për projektin "Rikonstruksion i rrjetit të linjës së furnizimit të Ujësjellësit nga Impianti i Bovillës-Depo Maloku, Kamëz". Fondet buxhetore të e alokuara nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë për vitin 2024 për këta dy projekte janë në shumën 129,942,744 lekë, të cilat janë përdorur për kryerjen e pagesave të kontraktorit të punimeve dhe të mbikëqyrësit të punimeve. Gjithashtu fonde buxhetore janë alokuar edhe për AAM të projektit të investimit "Për ndërtimin e Bovillës së vjetër", investim i cili është marrë në dorëzim nga UKK SHA me datë 20.06.2023 në vlerën 72,944,251.75 lekë, pra në total fonde të disbursuara janë 202,886,995.75 lekë. Punimet e kryera janë paraqitur në zërin "Aktive në proces", ku përfshihet vlera e situacioneve të ndërtimit dhe TVSh e pazbritshme (rregulluar), pra detyrimet e papaguara ndaj kontraktorëve të lidhur me këto projekte. Me shkresën nr. 834/1 prot, date 26.03.2024 Agjencia Kombëtare e Ujësjellës

Kanalizimeve, ne përgjigje të kërkesës se UKK SHA. nr. 702 prot, datë 06.03.2024 ka konfirmuar që fondet e marra për financimin e këtij projekti janë Grant, por nuk është përcjellë pranë UKK SHA. kontrata e grantit.

Provizione për shpenzime

Teprica e llogarisë 49211 ***"Zhvlerësim i të drejtave dhe detyrimeve gjyqësore"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 18,200,000 lekë, gjendje e cila përfaqëson shpenzimet për vendime gjyqësore të pritshme në periudhat e ardhshme të përllogaritura nga Drejtoria Juridike efektet financiare të proceseve gjyqësore që janë në proces. Këto procese gjyqësore janë finalizuar me vendime të gjykatës së shkallës së parë dhe nga UKT e UKK jnë apeluar në Gjykatën e Apelit, ku 24 çështje janë me objekt: "Për pavlefshmëri të titullit ekzekutiv" me efekt financiar të përllogaritur në vlerën 2,540,573 lekë dhe 29 çështje janë me objekt: "Shkëputje të marrëdhënieve të punës" me efekt financiar të përllogaritur në vlerën 15,659,827 lekë.
Gjatë vitit 2024-2025 nuk ka pagesa të kryera për shpenzime për vendime gjyqësore, por vetëm në vitin 2025 është paguar në shumën 1,152,899 lekë për detyrim për 1 rast të vendimit gjyqësor në favor z. A. Sh. për largim të padrejtë nga puna (trajtuar më hollësisht në pagesat nëpërmjet Bankës). Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i shoqërisë dhe nuk është kërkuar analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, për shmangien e praktikave të gabuara të në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi dhe shpenzimet me efekt negativ financiar në buxhet që sjellin ato. Analiza e këtyre shpenzimeve paraqitet në Aneks.

Kapitali
- Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i paraqitur më pasqyrën e pozicionit financiar, është i njëjtë me vendimet e depozituar në QKB në vlerën 289,024,000 lekë, me vlerë nominale 1000 lekë aksioni, ku Bashkia Kamëz zotëron 100% të aksioneve. Gjatë ushtrimeve kontabël të viteve nuk ka arritje ose pakësim të kapitalit.
- Fitimet e pa shpërndara nuk ka patur, pasi shoqëria ka rezultuar me humbje.

Palët e lidhura
Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike. Palë të lidhura konsiderohen drejtuesit dhe Këshilli i Administrimit (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër). Më poshtë paraqiten balancat ndaj palëve të lidhura:

Tabela: Balancat ndaj palëve të lidhura

	Aktive me 31.12.2024	Detyrime me 31.12.2024	Te ardhura viti 2024	Shpenzime viti 2024
Aksionari i vetëm, Bashkia Kamëz		362 220 001		
Administratori dhe Keshilli i Administrimit	108 586			-
Total	**108 586**	**362 220 001**	**-**	**-**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

-Vlera prej 362,220,001 lekë përfaqëson detyrimin që ka UKK SHA ndaj Bashkisë Kamëz për taksa dhe tarifa vendore si agjent tatimor të pa mbledhura nga abonentët.

- Vlera prej 108,586 lekë përfaqëson pagesën më tepër të shpërblimit anëtarëve të Këshillit të Administrimit në vitin 2024.

Rezerva nga rivlerësimi AAM

Konkluzion: Teprica e llogarisë 49211"Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale" paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 17,851,570 lekë. Kjo rezervë është transferuar nga shoqëria "UKT SHA" në procesin e ndarjes në vitin 2019, në mungesë të një evidence mbështetëse, për të cilën nuk ka një analizë, veprime këto në kundërshtim me SKK 1 dhe 6 "Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara" dhe Ligjin nr.25/2018 datë "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 3, pika 14, neni 5, neni 7. Shoqëria duhet të unifikojë politikën e njohjes së AAM me kosto historike dhe të mbyllë këtë llogari.

Tabela: Pasqyra e Performancës

Emërtimi i llogarive	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhës i rideklaruar	Korrigjimi i gabimeve	Ushtrimi paraardhës I deklaruar
	2024	2023		2023
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	354,837,748	303,783,090		303 783 090
Te ardhura te tjera	21,372,293	14,406,268	6,503,293	7,902,975
Total të ardhura	**376,210,041**	**318,189,358**	**6,503,293**	**311,686,065**
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	-118,168,411	-130,323,720		-130,323,720
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi AAM	-113,940,127	-103,015,322	4,063,099	-98,952,223
Shpenzime zhvlerësimi konsum i inventarit të imët	0	0		0
Shpenzime të tjera	-4,764,381	-7,752,119		-7,752,119
Shpenzime për provizione	-18,200,400	0		0
Shpenzime personeli	-243,889,753	-224,003,480		-224,003,480
Total shpenzime	**-498 963,072**	**-465,094,642**	**4,063,099**	**-465,094,642**
Te ardhura/shpenzime financiare				
Shpenzime financiare	-2,732,609	-2,822,951		-2,822,951
Fitimi/humbja nga kurset e kembimit	83,901,054	151,097,059	-31,420,537	182,517,595
Fitimi/humbja para tatimit	**-41,584,585**	**1,368,824**	**-28,980,343**	**30,349,167**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	0			
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	0	0		0
Fitimi/humbja e vitit	**-41,584,585**	**1,368,824**	**-28,980,343**	**30,349,167**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-			
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-			
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	**-41,584,585**	**1,368,824**	**-28,980,343**	**30,349,167**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

a. Të Ardhurat

Tabela: Të ardhurat e realizuara gjatë viteve ushtrimore, sipas llojit

Emërtimi i llogarive	Gjendjet sipas viteve	
	Viti 31.12.2024	Viti 31.12.2023
Të ardhura nga shitja e ujit	300,360,672	280,437,628
Të ardhura nga shitja e sherbimeve dytesore	30,787,620	23,195,878
Të ardhura të tjera	23,689,457	149,584
Shuma e të ardhurave të veta	**354,837,749**	**303,783,090**
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (Grant per AAM)	21,372,293	14,406,268
Totali i të ardhurave	**376,210,042**	**318,189,358**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Të ardhurat për shitjen e ujit janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtueshme, shumë e cila është zhveshur nga TVSH-ja. Të ardhurat janë paraqitur neto, pa efektin e faturuar për taksat vendore që faturohen dhe mblidhen për llogari te Bashkisë Kamëz. Të ardhurat në mënyrë analitike

sipas llogarive, veprimet kontabël dhe gjendjet në vitet 2023-2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Të ardhurat në mënyrë analitike 2023-2024

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	7002	TE ARDHURA NGA UJI DHE KUN	4	-	300,360,676	-300,360,671.50
	70401	Pike lidhje uji	-	-	8,915,001	-8,915,001.35
	70402	Pike lidhje KUN	(0)	-	5,825,836	-5,825,835.93
	70403	Gen Plan	-	-	2,947,500	-2,947,500.00
	70404	Kontrata Familjare	-	-	4,192,500	-4,192,500.00
	70405	Kontrata Biznesi	-	-	2,260,000	-2,260,000.00
	70406	Kontrata Biznesi	-	-	380,000	-380,000.00
	70411	MATES	-	-	3,665,000	-3,665,000.00
	70412	KASETE	0	-	1,624,764	-1,624,764.27
	70413	SPOSTIM MATESI	-	-	18,748	-18,748.49
	70414	LIBREZA UJI	-	-	244,600	-244,600.00
	70415	NDRYSHIM EMRI	(0)	-	325,702	-325,702.48
	70416	TARIFE SHERBIMI AKT-KOLAUDIMI	-	-	156,667	-156,667.02
	70417	NGA FAMILJE NE BIZNES	-	-	37,500	-37,500.00
	70418	Aktivizim kontrate	-	-	4,700	-4,700.00
	70419	Nderhyrje ne Infrastrukturen Rrrugore per pike lidhje	-	-	100,000	-100,000.00
	70421	Vertetime	-	-	14,100	-14,100.00
	70422	Pages firmat e shtrirj linja internet telef qe pajis me leje ndert	-	-	-	0.00
	70423	Nderhy ne Infrastrukturen Rrrugore per zhbllokim tubacioni	-	-	75,000	-75,000.00
	7082	Komisione	-	-	15,224,616	-15,224,616.00
	757	Penalitete dhe gjoba te arketuara	-	-	145,000	-144,999.84
	7571	Kamatvonesa ne pagesa te faturave	-	-	8,122,014	-8,122,014.00
	758	Te ndryshme	-	-	193,835	-193,835.29
	768	Te ardhura te tjera financiare	0	-	3,992	-3,991.85
		Totali i të ardhurave të veta	**4**		**354,837,751**	**-354,837,748.02**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

b. Shpenzimet e veprimtarisë kryesore.

- ✓ **Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme**

Tabela: Balanca e lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme në mbyllje të 2023 dhe 2024

Emërtimi i llogarive	Gjendjet sipas viteve	
	Viti 31.12.2024	Viti 31.12.2023
Shpenzime per blerje uji per shitje	-55 086 917	-76 355 168
Shpenzime per blerje energjie elektrike	-23 255 373	-21 448 219
Shpenzime per blerjen e materialeve te tjera	-39 377 041	-32 441 316
Agjensia e Menaxhimit te Burimeve Ujore	-423 080	-79 017
Shuma e shpenzimeve	**-118 168 411**	**-130 323 720**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Shpenzimet për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme në mënyrë analitike sipas llogarive, veprimet kontabël dhe gjendjet në vitet 2023-2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Shpenzimet për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme në mënyrë analitike

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Lendë të parë dhe materiale te konsumueshme	6035	Ndrysh.gjend.mallra	0	30,718,197	41,084,242	-10,366,045.34
	604	Bl.energji,avull,uje	(1)	23,247,640	-	23,247,639.27
	605	Blerje /shpenzime mallra, sherbimesh	0	48,482,310	41,574	48,440,736.13
	60501	Shpenzime fiskalizimi,	-	26,000	-	26,000.00

	6051	Blerje Uji	-	55,086,917	-	55,086,917.35
	608	Blerje /shpenzime te tjera	0	80,350	-	80,350.00
	6081	BLERJE KLORI	-	1,222,000	-	1,222,000.00
	6341	Tarife perdorimi për ujë të pijshëm	0	423,080	-	423,080.00
				159,286,494	**41,125,816**	**118,160,677.41**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

✓ Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi

Shpenzimet për amortizimi dhe zhvlerësimi në mënyrë analitike sipas llogarive, veprimet kontabël dhe gjendjet në viet 2023-2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi AAM	6811	amortizim i AQ afatgjatë, Inventar Ekonomik	0.00	1,549,706.00	0.00	1,549,706.00
	6812	Amortizim i AQ afatgjatë, Ndërtesa	0.00	5,809,551.00	0.00	5,809,551.00
	6813	Amortizim i AQ afatgjata Rrjete, vepra ujore	-2.00	106,063,777.00	0.00	106,063,775.00
	6815	Amortizim i AQ afatgjataMjete transporti	0.00	517,095.00	0.00	517,095.00
		Shuma	**-2**	**113,940,129.00**	**0**	**113,940,127.00**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

✓ Shpenzime personeli

Tabela: Balanca e shpenzimeve të personelit në mbyllje të vitit 2023 dhe 2024

Emërtimi i llogarive	Gjendjet sipas viteve	
	Për vitin 2024	Për vitin 2023
Shpenzime për paga	-209 748 718	-191 458 246
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	-33 705 700	-31 144 334
Kompensim per shkeputjen e mardhenieve te punes	-435 335	-1 081 520
Ndihma dhe shperblim per personelin	0	-319 380
Gjendja më 31 Dhjetor	**-243 889 753**	**-224 003 480**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Tabela: Shpenzimet për personelin në mënyrë analitike sipas llogarive, veprimet kontabël dhe gjendjet në vitet 2023-2024

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Shpenzime personeli	641	Pagat dhe shpërblimet e personelit	6.00	209,748,718.00	6.00	209,748,718.00
	644	Sigurimet shoqërore dhe shendetësore	0.00	33,705,700.00	0.00	33,705,700.00
	6571	shpenzime gjyqësore dhe përmbarimore	0.00	440,713.00	0.00	440,713.00
		Shuma	**6**	**243,895,131.00**	**6**	**243,895,131.00**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Nga analiza e shpenzimeve për personelin rezulton se janë bërë pagesa për shërbime përmbarimore, ku për vitin 2024 në shumën 440,713 lekë dhe në vitin 2023 në shumën 134,228 lekë.

✓ Shpenzime të tjera

Tabela: Balanca e shpenzimeve të tjera në mbyllje të vitit 2023 dhe 2024

Emërtimi i llogarive	Gjendjet sipas viteve	
	Për vitin 2024	Për vitin 2023
Shpenzime për qira	-480 000	-480 000
Mirembajtje dhe riparime	-1 310 600	-3 243 005
Sherbim auditimi	-1 380 000	-2 514 000
Shpenzime per sigurime	-39 454	-39 454
Honorare per Anetaret e Keshilli Administrimit	-735 855	-324 000

Shpz.postare e telekom.	-566 013	-726 127
Sherbime bankare	-155 879	-118 570
Penalitete e gjoba e te ngjashme	-96 376	-146 978
Shoqata e Ujesjelles Kanalizime e Shqiperise	0	0
Gjendja më 31 Dhjetor	**-4 764 381**	**-7 752 119**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Shpenzimet e tjera në mënyrë analitike sipas llogarive, veprimet kontabël dhe gjendjet në vitet 2023-2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela: Shpenzimet e tjera në mënyrë analitike

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Shpenzime të tjera	61121	sherbime auditimi	-	2,979,000	1,599,000	1,380,000.00
	613	Qira	-	480,000	-	480,000.00
	615	Mirembajtje dhe riparime	0	1,211,200	-	1,211,200.11
	616	Sigurime	-	39,454	-	39,454.00
	621	Personel nga jashtë ndërmarrjes	-	735,855	-	735,855.00
	625	Transferime, udhëtim, dieta	-	-	-	0.00
	626	Shpz.postare e telekom.	(0)	566,013	-	566,013.32
	628	Shërbime bankare	0	155,884	5	155,878.73
	657	Gjoba dhe dëmshpërblime	-	90,998	-	90,998.37
	658	Shpenzime te tjera	-	107,133	-	107,133.43
	666	Zbritje akorduar klienteve	-	205	1	203.56
		Shuma		**6,365,742**	**1,599,006**	**4,766,736.52**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

- ✓ **Shpenzime financiare**

Tabela: Balanca e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare për vitin 2024 dhe 2023

Emërtimi	Për vitin 2024	Për vitin 2023
Shpenzime interesi per huamarrjet	-2 732 609	-2 824 205
Te ardhura nga interesi	0	1 253
Gjendja më 31 Dhjetor	**-2 732 609**	**-2 822 951**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Tabela: Shpenzimet financiare në mënyrë analitike sipas llogarive, veprimet kontabël dhe gjendjet në vitet 2023-2024

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Shpenzime financiare	667	Shpenzime per interesa	-0.08	2,732,608.84	0.00	2,732,608.76
	668	Shpenzime financiare te tjera (komisione bankare)	-	399,000	399,000	0.00
				3,131,608.84	399,000	2,732,608.76

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Referuar analizës së kësaj llogarie shuma prej 2,732,608.84 lekë, përfaqëson shpenzimet për interesin vjetor të kredisë, e cila paguhet në çdo 6 muaj në kuotën prej 1,366,304.42 lekë.

- ✓ **Fitimi/humbja nga kurset e këmbimit**

Balanca e të ardhurave dhe shpenzimeve financiare për vitin e mbyllur 2023 dhe për vitin 2024 me efektin nga vlerësimi i detyrimeve financiare me kursin e këmbimit Eur/lekë prej 103.88 dhe 114.23 lek/eur në datat raportuese paraqitet si më poshtë:

Tabela: Fitim/humbje nga veprimet në valutë

Emërtimi	Për vitin 2024	Për vitin 2023
Humbje nga veprimet ne valute	0	0
Fitim nga veprimet ne valute	83 901 054	151 097 059

Gjendja më 31 Dhjetor	**83 901 054**	**151 097 059**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Tabela: Veprimet kontabël dhe gjendjet në vitet 2023-2024 në llogaritë e fitim/humbje nga kurset e këmbimit

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Fitimi/humbja nga kurset e kembimit	669	Humbje nga këmbimet valutore	-	52,848,469	52,848,469	0.00
	769	Fitim nga këmbimet valutore	4.56	0.00	83,901,058.81	-83,901,054.25

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

- ✓ **Fitim/Humbja e viteve financiare**.

Tabela: Fitim/humbja e viteve 2023-2024

	Nr. Llog.	Emri i llogarisë	Gjendje me 31.12.2023	Debi	Kredi	Gjendje me 31.12.2024
Fitimi/Humbja e mbartur	108	Fitim / humbja e pashpërndarë	307,205,840.00	60,940,536.48	43,301,171.96	324,845,204.52
	109	Rezultati i ushtrimit	(30,349,190)	30,349,190	-	0.00

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Në vitin 2024 janë kryer veprimet e njohjes së kontratës së Grantit për TVSH për shumën 230,047,041 lekë për "Projektin MIP IV" -TVSH e paguar nga AKUK për shoqërinë zbatuese të projektit, furnitorin "S.A.G" marrëveshjes SECO datë 29.12.2017, për shumën 1,330,000 Eur. Meqenëse këto grante lidhen me investimet e përfunduara në vitin 2021 dhe 2022 dhe meqenëse vlerat e tyre janë të rëndësishme, "UKK SHA" ka llogaritur efektet e ketyre kontratave nga data më e hershme, që është data e njohjes së investimeve, tvsh dhe detyrimeve ndaj furnitorit në kontabilitet, duke kryer rregullimet kontabël në bazë të tyre. Referuar analizës së llogarisë fitim e humbje rezolton se:

Llogaria **108 "Fitim / humbja e pashpërndarë"**

është **kreditua**r:

- për shumën 30,349,190 lekë që përfaqëson rezultatin e deklaruar për vitin 2023,
- për shumën 8,092,067 lekë që përfaqëson rimarrjen e grandeve për AAM "Projekti MIP IV-AKUK" për vitin 2021-2023 (njohjen e detyrimit për Tvsh-ën e zbritur gabimisht deri në konfirmimin me shkresë se financimi është me grand).
- për shumën 4,859,889 lekë rimarrje e granteve SECO për AAM "Projekti MIP IV" për diferencat nga kursi këmbimi si rezultat i rivlerësimit me kursin e datës 31.12.2024.

është debituar:

- për shumën 8,092,067 lekë shpenzime amortizimi për AAM "Projekti MIP IV-AKUK"
- për shumën 52,848,469 lekë përfaqësojnë diferencat e kursit të këmbimit për pagesat e furnitorit "Strabag" nga rivlerësimi me kursin e datës 31.12.2024

Shpenzimet e tatim mbi fitimin.

Tabela: Shpenzimet e tatimit mbi fitimin për ushtrimet kontabël 2023 dhe 2024 pas auditimit

Emërtimi i llogarive	Gjendjet sipas viteve	
	Viti 31.12.2024	Viti 31.12.2023
Humbja/Fitimi para tatimit	(41,584,585)	1,368,824
Shpenzime te pazbritshme (Total)	21,770,751	1,228,498
Gjoba tatimore	96,376	146,978
Amortizimi I AAM te rivleresuara		-
Kompensim per shkeputjen e mardhenieve te punes	435,335	1,081,520

Provizione per rreziqe dhe shpenzime	18,200,400	-
Zhvleresimi I AAM	3,038,640	-
Te ardhura te patatueshme	-	-
Humbje te mbartura	-	(2,597,322)
Humbja/Fitimi i tatueshem i ushtrimit	(19,813,834)	(0)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	-
Fitimi/Humbja e vitit	**(41,584,585)**	**1,368,824**

Burimi: Drejtoria Ekonomike UKK, përpunuar nga grupi i KLSH

Konkluzion: Referuar analizës së shpenzimeve të tatim mbi fitimin rezulton se janë përfshirë në shpenzimet e zbritshme shuma prej 3,038,640 lekë shpenzime amortizimi për AAM të vlerësuara jashtë përdorimi të pa nxjerra jashtë përdorimi, kur në fakt kjo vlerë është përshirë edhe në shpenzimet totale të amortizimit, duke ndikuar në tatim fitimin.

Shoqëria nuk rezulton me fitim të tatueshëm si rezultat i mbartjes se humbjeve dhe humbjes vjetore me vlerë 41,584,585 lekë, ndaj shpenzimi për tatim fitimin për vitin 2024 është zero lekë (viti 2023 zero lekë).

- *Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe qarkulluese rezultoi se:*

Në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik" është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për vitet 2023 dhe 2024. Procesi i inventarizimit ka filluar në bazë të urdhrave përkatës të Administratorit për secilin vit "Për ngritjen e grupit të punës përinventarizimin e aktiveve" përkatësisht me me shkresat nr.prot.2431, datë 04.12.2023 dhe me nr.prot.2913, datë 04.12.2024, ku është përcaktuar komisioni i inventarizimit prej 4 anëtarësh dhe 1 kryetar. Inventarizimi është kryer në zyrat e godinës së UKK, pikat e shitjes dhe njësitë për aktivet e llogarisë 218 "Inventar ekonomik", llogarië 214 "Iinstalime teknike, makineri e paisje", llogarisë 215 "Mjete transporti", llogarisë 327 "Inventar i imët" dhe aktivet në 2 magazinat e materialeve. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisioni i inventarizimit ka hartuar fletë inventaret me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive dhe është konfirmuar nga ky komision. Janë hartuar proces-verbalet e rezultateve të inventarizimit në të cilët nuk janë konstatuar diferenca. Gjithashtu janë kryer inventarët në magazinën e institucionit, nga komisioni i inventarizimit dhe është hartuar lista e artikujve gjendje në magazine, e cila rezulton të jetë e barabartë me gjendjen në kontabilitet. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se janë kryer veprimet për inventarin fizik të gjithë artikujve dhe janë krahasuar me gjendjen kontabël dhe nuk kanë rezultuar diferenca. Fletët e inventarizimit janë firmosur nga komisioni i inventarizimit dhe punonjësi përgjegjës material. Nuk ka relacion për zhvillimin e procesit dhe daljen e rezultatit të inventarizimit. Nga dokumentacioni inventarizimit vërehet se janë përcaktuar aktive pa vlerë përdorimi për nxjerrje jashtë përdorimi në vlerën 10,691,556 lekë, por nuk janë kryer procedurat e vlerësimit jashtë përdorimi me argumente përkatës si dhe tjetërsimi apo asgjesimi i tyre. Referuar pasqyrave financiare për këto aktive është llogaritur vlerë amortizimi prej 3,038,640 lekë. Pra për dy vite nuk ka nxjerrje të aktiveve jashtë përdorimi.
Për mangësitë e konstatuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi zj.E. P. me detyrë Drejtore e Departamentitit Ekonomik në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe hartuese e pasqyrave financiare, z. H.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.5. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Për auditimin e pikës 5 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Dokumente kontabël si: ditaret e bankës dhe të arkës, libri i arkës në lekë dhe valutë.
3. Dokumentacioni i kryerjes së pagesave dhe arkëtimeve shoqëruar me dokumentet mbështetës.
4. Dokumente të tjera të gjeneruara sipas nevojës nga programi "Financa 3"për mbështetjen e veprimeve kontabël të kryera në mënyrë analitike.
5. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme për shpenzimet të ardhurat etj.).

- *Rregullariteti i veprimeve me arkë.*

Veprimet me arkë kryhen për arkëtimet nga klientët abonentë familjarë për shitjen e ujit dhe shërbimin e kanalizimeve të ujrave të ndotura (KUN) nga UKK SHA sipas faturave tatimore, ku përveç tarifës së ujit dhe KUN përfshihen dhe vlerat e taksave vendore. Procesi i arkëtimeve realizohet nga 7 arka: Babrru, Bathore 1, Bathore 2, Frutikulturë, Paskuqan, Valias dhe Qendër Kamëz. Nga secila arkë të gjitha veprimet nëpërmjet arkës janë evidentuar me mandat-arkëtime në librat e arkës sipas datave kalendarike për arkëtimet dhe mandat-pagesat për derdhjet tek Koordinatori i Arkës pranë Aparatit të UKK ShA. Për shumat e arkëtuara tek Koordinatori i Arkës janë mbajtur procesvebalet e datës përkatëse me arkëtarët. Derdhjet në Bankat e nivelit të dytë nga Koordinatori i Arkës nuk janë bërë ditore, por dy a tre herë në muaj në varësi të shumave të mbledhura. Nga auditimi i dokumentacionit të arkës për periudhat korrik-gusht-shtator të vitit 2023, janar-shkurt-mars të vitit 2024 dhe tetor-nëntor-dhjetor të vitit 2025 nuk u konstatuan pagesa me lekë në dorë dhe dokumentet e arkës ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*.
Tabela: Gjendjet e arkave në fund të muajve për periudhën objekt auditimi

Nr	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Muajt	**Gjendja në lekë**	**Muajt**	**Gjendja në lekë**	**Muajt**	**Gjendja në lekë**
1	Janar	1,564,956	Janar	2,284,713	Janar	1,625,406
2	Shkurt	3,027,651	Shkurt	1,452,139	Shkurt	2,282,660
3	Mars	1,163,608	Mars	1,542,567	Mars	1,319,727
4	Prill	1,192,667	Prill	2,273,895	Prill	2,591,275
5	Maj	1,667,896	Maj	1,251,650	Maj	1,817,709
6	Qershor	1,440,815	Qershor	2,787,563	Qershor	2,506,627
7	Korrik	2,286,350	Korrik	2,634,406	Korrik	4,243,772
8	Gusht	2,883,993	Gusht	1,211,738	Gusht	2,174,328
9	Shtator	2,411,664	Shtator	2,323,163	Shtator	2,640,777
10	Tetor	3,018,810	Tetor	1,045,517	Tetor	2,611,582
11	Nëntor	3,762,188	Nëntor	2,269,417	Nëntor	2,578,106
12	Dhjetor	783,801	Dhjetor	1,336,654	Dhjetor	1,563,255
	Xhiro vjetore	494,217,693	Xhiro vjetore	460,111,106	Xhiro vjetore	444,944,361
	Limiti i arkës	24,710,884	Limiti i arkës	23,005,555	Limiti i arkës	22,247,218

Burimi: UK Kamëz
Referuar të dhënave për gjendjet ditore dhe në fund të muajve të arkave të nxjerra nga librat e arkës rezulton se, këto gjendje nuk e tejkalojnë limitin e arkës të përlllogaritur sipas xhirove vjetore përkatëse në bazë të Ligjit nr. 83/2022, datë 24.11.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin

nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, i cili në nenin 59/2 përakton se: *"2. Kriteri për përcaktimin e shumës maksimale të arkës së tatimpaguesit, që lëshon faturë, është niveli i qarkullimit vjetor të tatimpaguesit që lëshon faturë. Shuma maksimale e lejuar e parave cash në arkë për tatimpaguesit skedulohet si më poshtë:*
a) për tatimpaguesit me qarkullim vjetor, gjatë vitit të mëparshëm tatimor, deri në 2 milionë lekë, shuma maksimale e lejuar e parave cash në arkë është deri në 150 000 lekë;
b) për tatimpaguesit me qarkullim vjetor, gjatë vitit të mëparshëm tatimor, mbi 2 milionë lekë deri në 10 milionë lekë, shuma maksimale e lejuar e parave cash në arkë është deri në 500 000 lekë;
c) për tatimpaguesit me qarkullim vjetor, gjatë vitit të mëparshëm tatimor, mbi 10 milionë lekë, shuma maksimale e lejuar e parave cash në arkë është deri në 500 000 lekë ose 5% të qarkullimit vjetor të vitit të kaluar, cilado qoftë vlera më e lartë.
Në rastet kur një tatimpagues fillon veprimtarinë gjatë vitit kalendarik, limiti maksimal i lejuar i parave cash në arkë përcaktohet në përputhje me shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj pike, referuar shumës së qarkullimit të parashikuar deri në fund të vitit."
Pjesa tjetër e arkëtimeve nga klientët realizohet nëpërmjet institucioneve të tjera financiare jo-bankare si: "Ŵ. U" sh.a, "A. I" sh.a, "E.P" SHPK dhe "R"SHPK, të cilat bëjnë arkëtimet periodike në bankat e nivelit të dytë në favor të UK Kamëz SH.A për shumat e mbledhura nga klientët për ujin dhe KUN. Këto arkëtime sillen zyrtarisht nga institucionet financiare jo-banka pranë UKK SHA në formë listash mujore të klintëve me shumat e arkëtuara, të cilat rakordohen me shumat e depozituara në bankat e nivelit të dytë në llogaritë likujduese të UKK-ës.
Për pjesën e taksave dhe tarifave vendore të mbledhura nëpërmjet faturave të shitjes së ujit dhe shumave të derdhura Bashkisë Kamëz nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë mbahet akt-rakordimi ndërmjet Titullarit i UKK SH.A dhe Drejtorit të Tatim-Taksave të Bashkisë Kamëz.

- *Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës*

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të konfermave bankare, të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga Bankat e nivelit të dytë dhe të vulosura nga të dy palët. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Totali i shpenzimeve dhe të ardhurave mujore dhe progresive kuadronin me statement-et bankare mujore, si dhe çdo lidhje e bankës mujore shoqërohej nga kartela bankare. Nga verifikimi i shumave të konfermave bankare për periudhën 12-mujore të tre viteve objekt auditimi nga ku rezultoi se, totali është i barabartë me shumën e balancës sipas statementit të veprimeve të kryera të lëshuar nga bankat për llogaritë e UKK sha në fund të vitit. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që debitohen dhe kreditohen.
Nga auditimi i dokumentacionit të bankës me zgjedhje rezultoi se përpilimi i konfermave bankare ishte i bazuar në dokumentet autorizues dhe vërtetues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, aktmarrje në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi të ardhurat, akkt-rakordimet per taksat dhe tarifat vendore, etj. Vlerat e shënuara në konfermën bankare përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimet dhe të ardhurat. Përveç shpenzimeve për blerje mallrash, shërbimesh dhe investime të lidhura koston direkte dhe operacionale nuk janë kryer shpenzime udhëtim e dieta apo shpenzime të tjera.

Vlen për tu theksuar se mbajtja e dokumentacionit bankar në UKK SHA nuk është i plotë, pasi për çdo transanksion finannciar nuk është bashkëlidhur dokumentacioni i plotë që justifikon shpenzimet dhe të ardhurat. Dokumente të ndryshme që duhej të ishin pjesë e praktikës mbaheshin në dosje të ndryshme sipas hallkave apo fazave nëpërmjet të cilit kishte kaluar veprimi ekonomik. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011, i ndryshuar, pikat 35, 36.

- Me urdhër-pagesën e Bankës K. T. të datës 03.04.2023 (vetëm me firmën e NA) bazuar në urdhrin e brendshëm të Titullarit nr.prot.608/1, datë 03.04.2023 është kryer pagesa në vshumën 1,152,899 lekë në favor të përmbaruesit privat E. O. në bazë të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të datës 28.03.2023 për likujdimin e detyrimit z.A. Sh, sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.918 datë 02.03.2023 si dëmshpërblim me 17 paga mujore për largim të padrejtë nga puna. Nga këto 48,600 lekë janë shpenzime gjyqësore, 71,379 lekë janë shpenzime përmbarimore dhe 1,031,920 lekë detyrimi i përllogaritur sipas vendimit. Kjo pagesë përbën një mbishpenzim me efekt negativ financiar për buxhetin e UKK SHA në shumën 1,152,899 lekë, pasi largimi nga puna është bërë në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 141,143/4,144,153,155.
- Shpenzimet për përdorim të telefonisë celulare nga punonjësit e administratës janë përcaktuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.5, datë 15.01.2021 "Për pagesat e shërbimit telefonik", ku është miratuar pagesa për shërbim telefonik për Drejtorin e Përgjithshëm, Zv/Drejtorin e Përgjithshëm dhe 3 Drejtorat e Departamenteve: Teknik, Ekonomik dhe Administrativ me një limit mujor prej jo më shumë se 10,000 lekë, që në fakt sipas dokumentacionit bankar nuk i kalon 6,000 lekë.
- Të gjitha shpenzimet e kryera dhe të ardhurat e realizuara janë rregjistruar në ditarët përkatës dhe në librat e blerjeve për blerjet dhe librat e shitjeve për shitjet e faturuara për ujin e pijshëm çdo muaj, si dhe është bërë deklarimi pranë organeve tatimore sipas afatit të përcaktuar në ligj.

Tabela: Shitjet dhe blerjet me TVSH dhe detyrimet për TVSH sipas viteve 2023-2024-2025

Në lekë

Vitet	Blerje të përjashtuara	Blerje të tatueshme	TVSH në blerje	Shitje të përjashtuara	Shitje të tatueshme	TVSH në shitje	Tvsh per tu paguar	TVSH e paguar	TVSH e pa deklaruar
Viti 2023	166,874,372	323,783,799	64,756,759	64,478,287	280,103,373	56,020,674	(8,736,085)	(8,736,085)	-
Viti 2024	203,786,638	308,080,778	61,616,156	75,171,845	301,193,693	60,238,739	(1,377,417)	(1,377,417)	-
Viti 2025	169,071,390	531,001,900	106,200,380	32,937,933	345,021,636	69,004,327	(37,196,053)	(37,196,053)	-
T O T A L I	**539,732,400**	**1,162,866,477**	**232,573,295**	**172,588,065**	**926,318,702**	**185,263,740**	**(47,309,555)**	**(47,309,555)**	**-**

Burimi: Sektori i Financës, përllogaritur nga grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi i pagesave rezulton se janë deklaruar pranë organeve tatimore detyrimet për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale të punonjësve si dhe tatimi në burim.

Konkluzion: Nga auditimi në organet tatimore për deklarimet e detyrimeve në organet tatimore u konstatua se shoqëria UKK sha është penalizuar për vonesë deklarimi me gjoba, të cilat janë likujduar në vlerën 170,000 lekë, duke sjellë efekt negativ në shpenzime. Kështu:

- nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane për periudhën 01 Janar 2023 - 31.12.2024 me 5 (pese) gjoba në vlerën 50,000 lekë për muajt janar, mars, gusht 2023, qershor dhe shtator 2024 për mos deklarim ne afat te tatimit te mbajtur ne burim.
- nga QKB me gjobë në vlerën 60,000 lekë për deklarim të vonuar në kohë të pasqyrave financiare 2022 paguar në vitin 2024 dhe me gjobë në vleren 60,000 lekë për deklarim të vonuar në kohë në QKB, me datë 28.10.2025 të pasqyrave financiare 2024, paguar në vitin 2025.

Gjatë periudhës kohore 2023-2025, për arsye të mos pagesës së detyrimeve të ndaj UKT SHA për furnizimin me ujë përmbaruesi privat ka vendosur 3 herë masën sekuestro konservative për llogaritë bankare të këtij institucioni për llogari të UKT SHA. Ndërmjet Ujësjellës Kanalizime Kmëz SHA dhe Zyrës së Përmbarimit Privat "A" nuk është është bërë akt-marrëveshje, por është dakortësuar që për shlyerje të detyrimit nga UKK SHA kalimin e një shume deri në 3,000,000 lekë cdo muaj nëpërmjet "urdhrave të transferimit të shumës së sekuestruar". Referuar akt - rakordimit midis UKK SHA dhe UKT SHA në fund të vitit 2025 rezulton se ka një detyrim total për blerjen e ujit në vlerën 397,283,373.56 lekë, ku vlera e principalit është 361,551,268.20 lekë dhe vlera e kamatëvonesës është 35,732,105.36 lekë. Vlera e shërbimit përmbarimor të angazhuar nga UKT SHA është 502,434 lekë (shuma 246,402 lekë në vitin 2024 dhe shuma 256,032 lekë në vitin 2025), konsiderohet efekt financiar negativ në buxhetin e shoqërisë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin 10296 date 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar neni 8 pika 1, neni 12 pika 3 germa "e".

Për gjithë periudhën objekt auditimi likuidimi i karburantit dhe hyrja e këtij malli është bërë në bazë të faturës tatimore elektronike të lëshuar nga firma furnizuese me tollona për sasinë e blerë, ku mungojnë sasia e tollonave dhe numrat serial të tyre. Faturat e lëshuara nga operatori ekonomik janë lëshuar periodikisht sipas furnizimeve me këtë mall të UK Kamëz SHA, ku për vitin 2023 në 9 raste likujdimesh në vlerën 7,467,516 lekë, për vitin 2024 në 4 raste likujdimesh në vlerën 3,848,616 lekë dhe për vitin 2025 në 3 raste likujdimesh në vlerën 8,603,207 lekë, të cilat janë të shoqëruara me: dokumentin e informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për çmimet e karburanteve në datën e faturës së lëshuar, dokumenti i kursit zyrtar të valutës të Bankës së Shqipërisë në datën e faturës së lëshuar nga furnizuesi, dokumenti i kuotimit të çmimit të karburantit me analizat e saj mbi bazën e të cilës është llogaritur çmimi për litër dhe raportin e testimit të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial për cilësinë e mallit e plotësimin e parametrave teknik të kërkuar.

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për përdorimin e karburantit për periudhën objekt auditimi rezultoi se, për çdo vit me urdhrat e titullarit nr.prot.27, datë 05.01.2024,nr.prot..637, datë 23.02.2024, nr.prot.1340, datë 01.07.2025 dhe nr.prot.1341, datë 01.07.2025 është caktuar komisioni i verifikimit të të normativës së harxhimit të karburantit, i cili ka hartuar procesverbalin e verifikimit në terren të harxhimit të karburantit litër/100km dhe litër/ore pune për çdo mjet. Për vitin 2023 nuk është ngritur komision e për pasojë normativat e harxhimit të karburantit në 100km për automjetet për këtë vit nuk janë testuar me komision. Për çdo vit është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit "Për miratimin e sasisë së karburantit që do të vihet në dispozicion të administratës së UKK SHA", respektivisht VKA nr.1, datë 25.01.2023, VKA nr.01, datë 10.01.2024 dhe VKA nr.02, datë 06.01.2025, ku është përcaktuar një limit mujor nga 50-100 litra për tërheqje karburant nga 16 punonjës në pozicionet e shefave të Sektorëve krysorë dhe 5 shefat e njësive zonale për përdorimin e makinave private për nevoja të punës. Çdo ditë shqyrtohen kërkesat për furnizim me ujë me mjetin "bot" si dhe ankesat e abonentëve për riparime apo defekte të ndodhura në terren. Në bazë të tyre përcaktohet përdorimi i mjeteve të rënda për riparime dhe investime të vogla për eleminimin e difekteve. Mbi bazën e këtyre Drejtori i Departamentit Teknik nxjerr urdhër pune. Në urdhrin e punës përshkruhet vendi ku do punohet dhe sasia që duhet të furnizohet mjeti. Ky urdhër pune kalon në Sektorin e Financës, i cili përgatit urdhrin e daljes nga magazina të karburantit. Magazinieri bën daljen e karburantit duke plotësuar fletë-daljen përkatëse. Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të mbajtur në muajt: mars të vitit 2023, shtator të vitit 2024 dhe tetor të vitit 2025 rezultoi se për çdo muaj janë mbajtur fletë-udhëtime në të cilat janë

plotësuar të gjitha lëvizjet me destinacionet përkatëse, duke përshkuar distancat në kilometra të tyre si dhe orët e punës të firmosur nga shoferi, Shefi i sektorit të transportit, Shef i Burimeve Njerëzore dhe janë të shoqëruara me autorizimet nga titullari për lëvizjet dhe në rast punimesh me procesverbale të punimeve. Në fund të muajit fletë udhëtimi është shoqëruar me procesverbalin e përcaktimit të harxhimit të karburantit sipas natyrës së punës. Për rastet e punimeve që kryhen nga automjetet e rënda daljet e karburantit nga magazina bashkëlidhur urdhër-dorëzimit dhe autorizimit, janë edhe procesverbalet e evidentimit të punës gjatë datave të ndryshme të muajit me orët e punës apo km e lëvizjeve, vendi i punës dhe përshkrimi i punës së kryer.

Fletë-dalja për daljen e karburantit plotësohet në bazë të urdhrit për furnizim të Drejtorisë Ekonomike e cila është firmosur nga drejtuesi i automjetit dhe nga magazinieri. Në rastet e verifikuara rezulton se sasia e karburantit e shënuar në fletë-daljet përkatëse të muajit rakordon me urdhër-dorëzimet, autorizimet dhe me fletë-udhëtimet përkatëse për çdo shofer.

Ndërsa makinat private të punonjësve të përcaktuar me VKA, dokumentacioni justifikues përmban: faturën tatimore të blerjes së karburantit, fletë-udhëtimin mujor të plotësuar shumën mujore të furnizuar referuar limitit mujor, me destinacionet gjatë datave të muajit, pa përcaktuar km e përshkruara për çdo destinacion, të firmosur nga drejtuesi mjetit, Shefi i Sektorit të Transportit, Shef i Burimeve Njerëzore. Furnizimi dhe harxhimi i karburantit sipas muajve dhe automjeteve në tre vitet 2023-2024 dhe 2025 paraqitet në tabelat mëposhtme:

Gjendja naftës me dt 01.01.2023 = 310 litra

tabela e shpërndarje se Karburantit 2023 daljet 2023													
nr.	emërtimi i makinave (targa)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
		litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra
1	Fadrome Targe ADMT02	1400	1400	1470	1190	1040	1470	1570	1670	1430	1670	1390	1330
2	Furostrade Volsvagen Amarok	140	140	210	140	140	70	210	140	210	140	140	210
3	Mjete Pune me Qera	420	420	0	3180	3440	6800	850	0	0	0	0	0
4	Shefat e njesive	0	1050	1050	0	1000	1150	1150	1150	1150	800	820	70
5	Mjete Eskavator	0	1560	1180	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Totali harxhuar 2023	**1960**	**4570**	**3910**	**4510**	**5620**	**9490**	**3780**	**2960**	**2790**	**2610**	**2350**	**1610**

Hyrje për vitin 2023 = 49,810 litra

Sasia e naftës se harxhuar për vitin 2023 është = 46,160 litra

Gjendja naftës me dt 01.01.2024 = 3,960 litra

tabela e shpërndarje se Karburantit 2024 daljet 2024													
nr.	emërtimi i makinave (targa)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
		litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra
1	Fadrome Targe ADMT02	1600	1520	1260	1400	1260	1800	1850	1910	1640	1850	1560	1640
2	Furostrade Volsvagen Amarok	140	70	140	140	140	210	140	210	140	140	140	140
3	Kamioncine Iveco	0	80	80	140	210	140	140	210	210	210	210	140
4	Kamioncine Ford	0	110	0	0	140	140	210	210	140	140	210	140
5	Shefat e Njesive	200	180	1530	1040	1070	1140	1240	1090	1090	1080	1090	1150
	Totali harxhuar 2024	**1940**	**1960**	**3010**	**2720**	**2820**	**3430**	**3580**	**3630**	**3220**	**3420**	**3210**	**3210**

Hyrje për vitin 2024 = 33,550 litra

Sasia e naftës se harxhuar për vitin 2024 është = 36,150 litra

Gjendja naftës me dt 01.01.2025 = 1,360 litra

tabela e shpërndarje se Karburantit 2025 daljet 2025													
nr.	emërtimi i makinave (targa)	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
		litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra	litra
1	Fadrome Targe APMT-72	1580	1660	1380	1580	970	1390	1590	1590	1650	1470	1370	1620
2	Fadrome Targe ADMT-02	0	0	630	1650	1180	1120	1250	1390	1250	1180	970	1280
3	Foristrada Amarok	140	140	70	70	70	140	140	140	70	70	70	140
4	Kamioncine Iveco	140	210	140	140	210	140	140	210	140	210	210	210
5	Kamioncine Ford	140	140	140	210	140	140	70	140	210	140	140	210
6	Autobot Pastrimi de zhbllokimi	0	0	0	0	0	0	400	280	160	120	280	320
7	Autobot Uji	0	0	0	0	0	0	1000	360	770	0	200	80
8	Shefat e njesive	1450	1450	1470	1460	1460	1490	1670	1590	1440	1390	1430	1470
	Totali harxhuar 2025	**3450**	**3600**	**3830**	**5110**	**4030**	**4420**	**6260**	**5700**	**5690**	**4580**	**4670**	**5330**

Hyrje për vitin 2025 = 58,390 litra
Sasia e naftës se harxhuar për vitin 2025 është = 56,670 litra
Gjendja ne magazinë me 31.12.2025 është = 3,080 litra

Në fletë-udhëtimet apo procesverbalet ditore të punës si për automjetet e UKK SHA dhe ato private të vëna në dispozicion janë përcaktuar destinacionet dhe sasia e karburantit të tërhequr, por nuk janë përcaktuar kilometrat e përshkruara dhe në fund të muajit është shënuar një shumë kilometrash të përshkruara sipas karburantit të tërhequr dhe normativës së harxhimit për 100/km.

Për mangësitë e konstatuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi zj. E. P. me detyrë Drejtore e Departamentit Ekonomik në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Për sa trajtuar më sipër, Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kamëz sha ka paraqitur observacionin me shkresën nr.prot.1417,datë 22.06.2026, protokolluar në KLSH me nr.prot.1051/9, datë 25.06.2026..

Pretendimet e Subjektit të audituar.

1. Në lidhje me konstatimin e bërë me gjetjen 11 faqe 327 të projekt raport auditit rubrika A.MASA ORGANIZATIVE nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sqarojmë si vijon: Sa herë që shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sha" ka kryer furnizime me karburant bashkëlidhur ka pasur dhe dokumentacionin si dokumentin e informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Për çmimin e karburantit në datën e faturës së lëshuar, dokumenti i kursit zyrtar të valutës të Bankës së Shqipërisë, dokumenti i kuotimit ti çmimit të karburantit me analizat e saj mbi bazën e së cilës është Ilogaritur çmimi për litër dhe raportin e testimit të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për cilësinë e mallit. Gjithashtu përsa i përket numrave serial mbas çdo tolloni ka numrin serial të identifikuar. Bashkëlidhur dokumentacioni sipas vitit.

2. Në lidhje me konstatimin e bërë në lidhje me gjetjen 12 faqe 327 të projekt raport auditit rubrika A.MASA ORGANIZATIVE nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sqarojmë si vijon: Mjetet që shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sha" disponon janë të pajisur me aparat matës kilometrash. Kilometrat evidentohen periodikisht dhe shërbejnë për evidentimin e konsumimit të karburantit. Bashkëlidhur dokumentacioni për aparatin matës të km në mjet.

Qëndrimi i Grupit të KLSH

Në bazë të dokumentacionit shoqërues të bashkëlidhur observacionit të sjellë nga Shoqëria UKK SHA sqarojmë se argumentohen shpjegimet e bëra në observacion nga subjekti i audituar lidhur me konstatimet e grupit të Auditimit të bëra më lart, për këtë arsye merren në konsideratë, duke u reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit

2.6. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

2.6.1. PROKURIMET

*1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve***.**

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi. Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës.
Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga UK Kamëz, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

PËRMBLEDHËSE 2023-2024-2025	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHSEJ	**74**	**811,608,865**	**769,207,254**
E hapur int	1	27,000,000	26,995,575
Të hapura	9	694,215,911	662,164,020
E hapur e thjeshtuar	23	67,982,441	60,836,478
Blerje me vlerë të vogël	32	21,572,329	18,411,108.27
Blerje nën 100 mijë lekë	9	838,184.00	800,072.33

Viti 2023

Procedura 01/01/2023- 31/12/2023	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHSEJ	**30**	**77,516,962**	**70,560,357,33**
Të hapura	2	37,285,437	35,321,083
E hapur e thjeshtuar	11	31,353,782	27,668,637
Blerje me vlerë të vogël	12	8,439,559	7,166,665
Blerje nën 100 mijë lekë	5	438,184	403,972.33

Viti 2024

Procedura 01.01.2024 – 31.12.2024	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHSEJ	**24**	**644,332,187**	**614,931,058**
Të hapura	4	613,780,474	586,713,486
E hapur e thjeshtuar	8	24,928,659	23,270,846.33
Blerje me vlerë të vogël	8	5,223,054	4,550,625.23
Blerje nën 100 mijë lekë	4	400,000.00	396,100.00

Viti 2025

Procedura 01.01.2025 – 01.10.2025	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHSEJ	**20**	**89,759,716**	**83,715,839**
E hapur INT	1	27,000,000	26,995,575
Të hapura	3	43,150,000	40,129,451
E hapur e thjeshtuar	4	11,700,000	9,896,995
Blerje me vlerë të vogël	12	7,909,716	6,693,818.04

Për vitin 2023: UK Kamëz ka zhvilluar gjithsej **2** procedura prokurimi "E hapur", me vlerë të fondit limit total 37,285,437 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 35,321,083 lekë pa TVSH, duke kursyer shumën prej **1,964,354** lekë pa TVSH.

- "E Hapur e thjeshtuar", **11** procedura, me fondin limit në total 31,353,782 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total 27,668,637 lekë TVSH, duke kursyer shumën prej **3,685,145** lekë pa TVSH.
- "Blerje me vlerë të vogël", **12** procedura, me fondin limit në total 8,439,559 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura në total 7,166,665 lekë pa TVSH, duke kursyer shumën **1,272,894** lekë pa TVSH.

Për vitin 2024: UK Kamëz ka zhvilluar gjithsej **4** procedura prokurimi "E hapur", me vlerë të fondit limit total 613,780,474 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 586,713,486 lekë pa TVSH, duke kursyer shumën prej **27,066,988** lekë pa TVSH.

- “E Hapur e thjeshtuar”, **8** procedura, me fondin limit në total 24,928,659 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total 23,270,846 lekë TVSH, duke kursyer shumën prej **1,657,813** lekë pa TVSH.
- “Blerje me vlerë të vogël”, **8** procedura, me fondin limit në total 5,223,054 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura në total 4,550,625 lekë pa TVSH, duke kursyer shumën **672,429** lekë pa TVSH.

Për vitin 2025: UK Kamëz ka zhvilluar gjithsej **3** procedura prokurimi “E hapur”, me vlerë të fondit limit total 43,150,000 lekë pa TVSH, vlerë të kontratës 40,129,451 lekë pa TVSH, duke kursyer shumën prej **3,020,549** lekë pa TVSH.
- “E Hapur INT”, **1** procedurë, me fondin limit në total 27,000,000 lekë pa TVSH, kontrata e lidhur pa TVSH në total 26,995,575 lekë TVSH, duke kursyer shumën prej **4,435** lekë pa TVSH.
- “E Hapur e thjeshtuar”, **4** procedura, me fondin limit në total 11,700,000 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total 9,896,995 lekë TVSH, duke kursyer shumën prej **1,803,005** lekë pa TVSH.
- “Blerje me vlerë të vogël”, **12** procedura, me fondin limit në total 7,909,716 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura në total 6,693,818 lekë pa TVSH, duke kursyer shumën **1,215,898**lekë pa TVSH.

PËRMBLEDHËSE 2023-2025
Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën **01.01.2023 – 01.10.2025**, janë realizuar gjithsej **74** procedura me fond limit **811,608,865** lek pa TVSH dhe vlerë kontrate **769,207,254** lek pa TVSH, me një diferencë për vlerën **42,401,611** lek pa TVSH.

Në zbatim të pikës 6 të Programit të Auditimit nr. 1051/2 , datë 12.11.2025, i ndryshuar, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave”, është bërë auditimi i 17 procedurave të prokurimit, me vlerë totale të fondit limit **754,391,731 lekë pa TVSH, ose rreth 98.5 %** e vlerës totale të procedurave të hapura, që në arsyetimin tonë, kanë edhe riskun më të lartë, paraqitur në Aneksin 2.6. “Prokurimet publike”:

1. “Blerje mjete transporti të përdorura (viti 2023) ”

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje mjete transporti të përdorura”, Nr. REF-90133, datë 12-07-2023.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 2474 prot, datë 07.12.2023</td><td rowspan="2">1. Urdhër Prokurimi
Nr. 2474 prot, datë 07.12.2023
Njësia e Prokurimit
- A. Xh., Personi përgjegjës, jurist
- R. Z., Anëtar
- E. N, Anëtar
2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 1547/1, datë 22.08.2023
- A. C
- D. N.
- L. M.</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 1566/1 prot, datë 24.08.2023
1. S. P, Kryetar
2. A. P, anëtar
3. E. Ç, anëtar</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
“E hapur e thjeshtuar, mallra”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
4,340,000 lekë pa TVSH,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE “T.R” SHPK me ofertë 3,500,000 lekë pa TVSH
sipas kontratës nr. 2474/6/7, datë 17.01.2024, me afat 30 ditë.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 840,000 lekë pa TVSH, ose 19.35 %</td></tr>
</table>

8. Data e hapjes së tenderit Datë 14.09.2023	9. Burimi Financimit Nga Buxheti i UK Kamëz (vetëfinancim)	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur e thjeshtuar, mallra", me vlerë 4,351,916 lekë pa TVSH dhe do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 1547 prot., datë 22.08.2023 për prokurimin e blerjes së automjeteve për UK Kamëz SHA. Relacioni teknik për këtë objekt prokurimi, me nr. 1547/2 prot., datë 25.08.2023, i hartuar nga A. C, kryetar, D. N. dhe L. M, citon nevojën për dy kamioncina, disponimi i të cilave do të sjellë kryerjen e punëve që deri në këtë kohë bëhen nga mjete të marra me qera, si: transport materialesh nga magazina në linjën me difekt dhe transportin e punonjësve për në destinacionin e punës.
Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit pa nr prot., datë 01.09.2023, i mbajtur nga grupi i punës me përbërje A. C, kryetar, D. N. dhe L. M, anëtarë.
Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimeve të mjeteve me studim tregu, janë kërkuar tre oferta dhe është bërë mesatarja e tyre, duke nxjerrë një vlerë prej 4,340,000 lekë. Nga verifikimi i studimit të tregut konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë "S & C. C" SHPK, "S." SHPK dhe "P. I." SHPK. Nga verifikimi në website-n e QKB, rezulton se këto shoqëri kanë si objekt të veprimtarisë edhe shitjen e mjeteve motorike.
Nga auditimi konstatohet se në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë krahasim apo kërkim për çmimet e tregut në website-t e përcaktuara për shitblerje mjetesh motorike.
Sa sipër, testimi i tregut nuk është bërë i studiuar, duke mbartur riskun që fondi limit të mos jetë real.
Rezulton gjithashtu se fondi limit i përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit është vendosur në mënyrë të paargumentuar 11,916 lekë më shumë se fondi limit i përcaktuar nga grupi i punës. Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi z. A. Xh, si përgjegjës i prokurimit të kësaj procedure.
Specifikimet teknike nuk janë të mirëpërcaktuara dhe disa prej tyre, si viti i prodhimit, lloji i karburantit, madhësia e gomave, madhësia e kabinës, tipi i tapicerisë, etj., janë në kufijtë e subjektivitetit.
Përsa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës me përbërje znj. A. C, kryetar, D. N. dhe L. M.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet një procesverbali, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës*

fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit...
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".
- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se janë vendosur konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE/BOE, nga të cilët dy të skualifikuar dhe një i kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi
1	**"A" SHPK**	**3,980,000**	**Kualifikuar**
2	"S" SHPK	4,190,000	kualifikuar
3	"B S" SHPK	4,280,000	skualifikuar
4	"T.R" SHPK	4,300,000	kualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

1. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se është skualifikuar një OE "B. S" SHPK dhe janë kualifikuar tre OE pjesëmarrës. Është shpallur fitues OE "A" SHPK, me vlerë më të ulët.
2. Pas verifikimit në SPE të dokumentacionit të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "A" SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte konform kritereve të përcaktuar në DT.
Sa sipër, është lidhur kontrata me nr. 1566/7, data 12.10.2023.
Me shkresën nr. 1566/12, datë 10.11.20223, TAK ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të mjeteve. Ky komision, me përbërje A. C, E. K. dhe H. B, ka hartuar procesverbalin e marrrjes në dorëzim të mallit me shkresën nr. 2303 prot., datë 14.11.2023, sipas të cilës pesha ngritëse dhe numri i gomës nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në DT. Pas këtij procesverbali, nga ky komision është hartuar procesverbali përfundimtar ku citohet se pesha ngritëse e vinçit sërish nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara, duke refuzuar marrjen në dorëzim të automjetit.
Me shkresën nr. 2303/3 prot., datë 01.12.2023, AK ka njoftuar OE "A" SHPK për zgjidhjen e kontratës dhe konfiskimin e garancisë së kontratës dhe vënien në dijeni të APP-së për zgjidhjen e kësaj kontrate. Me shkresën nr 2454 prot., datë 05.12.2023, AK ka njoftuar APP-në për zgjidhjen e kontratës dhe me shkresën nr 2454/2 prot., datë 27.12.2023, AK i ka kërkuar APP-së përjashtimin e kontraktorit "A" SHPK nga e drejta për të fituar kontrata publike.
Me shkresën nr. 2474, datë 07.12.2023 është hartuar Urdhri i Prokurimit për përsëritje të procedurës së prokurimit me të njëjtën Njësi Prokurimi.
Nga verifikimi në SPE dhe Raporti Përmbledhës i prokurimit, grupi i auditimit konstaton se në këtë procedurë prokurimi, përveç OE "A" SHPK janë kualifikuar edhe dy OE pjesëmarrës. Sa sipër, Komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, në bashkëpunim me KVO-në, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, duhet të bënte propozimin tek TAK për lidhjen e kontratës me OE të rradhës, duke mos lejuar fillimin e një procedure të re prokurimi.

Për procedurën e re të prokurimit (me Ref. 90133-12-07.2023) nuk ka urdhër tjetër për ngritjen e KVO-së, por nga auditimi i dosjes së prokurimit, rezulton se është e njëjta KVO me atë të procedurës së parë. Gjithashtu, janë hedhur në SPE dokumentet e tenderit si në procedurën e parë, pa ndryshime.
Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit me nr. 2474/4 prot., datë 19.01.2024 dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 3 OE, si më poshtë:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi
1	**"T.R" SHPK**	**3,500,000**	**kualifikuar**
2	"A.K" SHPK	3,990,000	kualifikuar
3	"S" SHPK	4,190,000	kualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

1. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se janë kualifikuar të tre OE pjesëmarrës. Është shpallur fitues OE "T.R" SHPK, me vlerë më të ulët.
2. Pas verifikimit në SPE të dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "T.R" SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte konform kritereve të përcaktuar në DT.

Sa sipër, kualifikimi i OE të shpallur fitues "T.R" SHPK është i drejtë, në zbatim të nenit 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
KVO-ja ka bërë propozimin tek TAK për lidhjen e kontratës me këtë OE, me vlerë 4,200,000 lekë me TVSH.

U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit z. A. Xh.

2. Blerje automjetesh për UK Kamëz SHA, viti 2025

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje automjetesh për UK Kamëz SHA", Nr. REF-39956, datë 03-05-2025.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 283/5 prot, datë 17.02.2025</td><td rowspan="2">1. Urdhër Prokurimi
Nr. 283/5, datë 17.02.2025
Njësia e Prokurimit
- E. D, Personi përgjegjës,
- E. P, Anëtar
- B. A, Anëtar
2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 283/1, datë 06.02.2025
- D. C.
- E. N.
- L. B</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 283/6, datë 17.02.2025
1. F. Xh, Kryetar
2. A. D, anëtar
3. H. B, anëtar</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
"E hapur, mallra"</td></tr>
</table>

5. Fondi Limit (pa TVSh) 13,150,000 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "S" SHPK me ofertë 12,980,000 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 283/13, datë 28.04.2025, me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit 170,000 lekë pa TVSH, ose 1.29 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 19.03.2025	9. Burimi Financimit Nga Buxheti i UK Kamëz (vetëfinancim)	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur, mallra", me vlerë 13,150,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 283 prot., datë 06.02.2025 për prokurimin e blerjes së automjeteve për UK Kamëz SHA. Relacioni teknik për këtë objekt prokurimi, me nr. 283/2 prot., datë 12.02.2025, i hartuar nga ing. D.C, E. N dhe L. B, citon nevojën për autobot për furnizimin me ujë, autobot pastrimi dhe zhbllokimi dhe një kovë e pasme gërmimi për fadromën, disponimi i të cilave do të sjellë rritjen e cilësisë, sigurisë dhe performancës së UK Kamëz.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit pa nr prot., datë 12.02.2025, i mbajtur nga grupi i punës me përbërje z D. C. kryetar, E. N dhe L. B, anëtarë.
Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimeve të mjeteve me studim tregu, janë kërkuar tre oferta dhe është bërë mesatarja e tyre, duke nxjerrë një vlerë prej 13,150,000 lekë. Nga verifikimi i studimit të tregut konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë "S & C. C" SHPK, "T.R" SHPK dhe "P. I" SHPK. Nga verifikimi në website-n e QKB, rezulton se këto shoqëri kanë si objekt të veprimtarisë edhe shitjen e mjeteve motorike.
Nga auditimi konstatohet se:
- Autoboti i pastrimit dhe zhbllokimit nga të tre subjektet është ofertuar si "Blerje sonde zhbllokimi" (në të njëjten datë 10.12.2024), edhe pse nga ana e UK Kamëz, me shkresën nr 2827 prot, datë 25.11.2024, dërguar këtyre subjekteve, është kërkuar "Autobot pastrimi dhe zhbllokimi";
- Nuk është bërë testimi i tregut për kovën e pasme të gërmimit të fadromës.
Gjithashtu, në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë krahasim apo kërkim për çmimet e tregut në website-t e përcaktuara për shitblerje mjetesh motorike.
Sa sipër, testimi i tregut është bërë fiktiv, duke mbartur riskun që fondi limit të mos jetë real.
Specifikimet teknike nuk janë të mirëpërcaktuara dhe disa prej tyre, si viti i prodhimit, kontinenti i prodhimit, lloji i karburantit, madhësia e gomave, pesha e mjetit (jo kapaciteti mbajtës), gjatësia, gjerësia, lartësia, etj., janë në kufijtë e subjektivitetit.

Përsa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi grupi i punës me përbërje z D. C. kryetar, E. N. dhe L. B, anëtarë

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet një procesverbali, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 2.2.2 të KPK është vendosur kriteri që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022,2023**.** Ky kriter nuk është kërkuar sipas DST të miratuara nga APP.

2. Në pikën 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri që operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, ndërkohë që specifikimet teknike e përjashtojnë alternativën e dytë.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e Njësisë së Prokurimit E. D, E. P dhe B. A.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE/BOE, nga të cilët dy të skualifikuar dhe një i kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi
1	"S&C. C" SHPK	12,200,000	Kualifikuar
2	**"S" SHPK**	**12,980,000**	**Kualifikuar**

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

1. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se janë kualifikuar të dy OE pjesëmarrës, pasi kanë paraqitur dokumente të mjaftueshme në SPE.

- Nga verifikimi në SPE, konstatohet se për OE "S&C. C" SHPK ka mospërputhje në lidhje me vlerësimin në sistem dhe procesverbalin e shqyrtimit të ofertave. Në SPE del se nga vlerësimi në datën 07.04.2025, ky OE nuk plotëson kriterin teknik dhe citon që "*Operatori ekonomik i pari skualifikohet per arsyen se nuk permbush fazen e vleresimit te dokumenteve fizikë, saktësisht kriterin "2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklaroje që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent, i cili përbën kusht për kualifikim.*

Për këtë arsye anëtarët e komisionit të vlerësimit vendosën kalimin te operatori i radhës". Ndërkohë në Procesverbalin e shqyrtimit të ofertave me datë 14.04.2025, citohet që ky OE kualifikohet i pari dhe "*Ky klasifikim iu bë me dije në mënyrë elektronike në datën 27.03.2025 OE pjesëmarrës në tender*". Nga verifikimi i dokumentacionit të hedhur në SPE, ky OE është kualifikuar me të drejtë. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet dosja fizike e këtij OE, por në Formularin e Njoftimit të Fituesit (jo procesverbal për shqyrtimin e dokumentacionit fizik) dhe Raportin përmbledhës të prokurimit, nuk citohet që ky OE nuk ka paraqitur dokumentacionin fizik, siç pretendohet nga kryetari i KVO-së gjatë ballafaqimit në zyrat e UKK-së. Sa sipër, për mosparaqitje të dokumentacionit fizik nga OE i shpallur i pari, të cilit i është bërë kërkesa nga

KVO në datën 27.03.2025 në SPE, skualifikimi është i drejtë, por nga KVO-ja, ky skualifikim duhej bërë nëpërmjet një procesverbali, në të cilin të citohej arsyeja e skualifikimit.
2. Pas verifikimit në SPE të dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "S" SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur nuk ishte konform kritereve të përcaktuar në DT, pasi nga certifikata e konformitetit e paraqitur nga ky OE, nuk del që për mjetin "Autobot pastrimi dhe zhbllokimi" prodhimi të jetë bërë në BE, ose i destinuar për BE.
Sa sipër, kualifikimi i OE të shpallur fitues "S" SHPK është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...*".

Me skualifikimin e OE "S" SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, pika 1/b, sipas të cilit "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...*
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO-ja duhet të bënte propozimin tek TAK për anulimin e procedurës së prokurimit. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës, me vlerë 15,576,000 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së F. Xh, A. D, H. B.

U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit zn. E. D.

3. **"Blerje karburanti, viti 2023", UK Kamëz**

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti (gazoil)", Nr. REF-65805, datë 04-12-2023.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 20, datë 20.03.2023</td><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 20, datë 20.03.2023
Njësia e Prokurimit
1. A. Xh, Personi përgjegjës,
2. E. K, Inxhinier
3. E. N, Ekonomist

2. Urdhër nr. 519/1, datë 16.03.2023 për fondin limit dhe specifikimet teknike
- A. D, Kryetar
- N. M, anëtar,</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 21, datë 20.03.2023
1. E. P, Kryetar
2. B. A.
3. E. Ç</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
"E hapur, e thjeshtuar, mallra"</td><td></td><td></td></tr>
</table>

	- V. P, anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 5,681,848 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "E. D" SHA me marzh fitimi 15 lekë/litër, ose 5,228,800 lekë, sipas kontratës nr. 677/2, datë 16.05.2023 me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 453,048 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Datë 24.04.2023	9. Burimi Financimit Nga Buxheti i UK Kamëz vetëfinancim)	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur e thjeshtuar, mallra", me vlerë 5,681,848 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 519 prot., datë 16.03.2023.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Në dosje administrohet procesverrbali për argumentimin e fondit limit me datë 20.03.2023, i mbajtur nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 519/1, datë 16.03.2023, me përbërje z. A. D, kryetar dhe N.M. e V. P, anëtarë.
Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimit të karburantit sipas çmimit të publikuar në buletinin e APP-së të datës 20.03.2023, me vlerën e USD në lekë, të marrë nga banka e Shqipërisë, duke i shtuar edhe taksat dhe akcizën (gjithsej 165.17 lekë/litër). Për përllogaritjen e sasisë së karburantit, është dhënë një informacion në formë tabelare për periudhën e marrjes me qera për 5 mjete (2 ekskavatorë nga 44 ditë me konsum 20 l/ditë, një kamion me konsum 40 l/100km dhe 2 kamionçina me konsum 10 l/100km), ku është llogaritur sasia prej 20000 litra gjithsej. Gjithashtu është llogaritur edhe sasia e karburantit në dispozicion të mjeteve personale të administratës 1200 litra /muaj, ose 14400 litra në vit, e vendosur me vendimin e Këshillit Administrativ nr.1, datë 24.01.2023 "Për miratimin e vënies në dispozicion të automjeteve nga punëmarrësit, miratimin e marrëveshjes tip dhe sasisë së karburantit për vitin 2023". Gjithsej është llogaritur sasia prej 34400 litra në vit, me vlerë 5,681,848 lekë.
Konsumi i karburantit për mjetet që do të merren me qera është marrë apriori, pasi nuk dihet se cilat do të jenë mjetet që do të merren me qera dhe sa do të jetë konsumi për secilin mjet. Po kështu edhe për mjetet private të punëmarrësve.
Sa sipër, përcaktimi i nevojave për gazoil, nuk është i mirëargumentuar dhe mbart riskun për të mos qenë i saktë.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 20.03.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se ato janë konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE/BOE, nga të cilët një i kualifikuar dhe një i skualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit	Vlerësimi
1	"E. D" SHA	15 lekë/litër	Kualifikuar
2	"I" SHPK & "B.O" SHA	14.5 lekë/litër	Skualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se është skualifikuar OE i mëposhtëm:
1. BOE "O" SHPK & "B.O" SHA skualifikohet nga ky tender për arsyen e poshtëshënuar:

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçencë për tregtim karburantesh të llojit III.1.A ose autorizim për leje tregtimi karburantesh të lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore.

- Bazuar në kontratën e bashkëpunimit me Nr.542 Rep Nr 146.Kol date 19.04.2023 ndërmjet OE "B.O." SHA dhe "O." SHPK, ky kriter nuk përmbushet nga subjekti "O." SHPK, i cili bazuar në kontratën e bashkëpunimit ka marrë përsipër 60% të kërkesave dhe detyrimeve të këtij bashkëpunimi dhe nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuar në pikën 2.1.1.

- Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të BOE "O" SHPK & "B.O" SHA, me vlerë të ofertës 5,163,784 lekë (marzh fitimi 14.5 lekë/litër), rezulton se ky BOE nuk ka paraqitur faturat tatimore, të kërkuara në DT, si dokumente që vërtetojnë eksperiencën e ngjashme dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.3, në lidhje me disponimin e stacionit të autorizuar të tregëtimit të karburantit me pakicë për automjete në territorin e Bashkisë Kamëz. Mangësia e cituar nga KVO-ja në lidhje me mungesën e licencës të llojit III.1.A nga subjekti "O." SHPK, nuk qëndron, pasi ky kriter është i plotësuar nga pjesa tjetër e BOE, siç përcaktohet edhe në pikën 3 të nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Për pasojë, skualifikimi i këtij OE është i drejtë, por jo për arsyen e cituar nga KVO-ja.

2. Pas verifikimit në SPE të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "E. D" SHA, u konstatua se dokumentacioni është konform kritereve të vendosura në DT dhe kualifikimi i tij nga KVO-ja është i drejtë.

U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit z. A. Xh.

4. **<u>"Blerje karburanti, viti 2024", UK Kamëz</u>**

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburanti (gazoil dhe benzinë), viti 2024", Nr. REF-93016, datë 01-11-2024.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 77, datë 11.01.2024</td><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 77, datë 11.01.2024</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 77/1, datë 11.01.2024
1. E. P, Kryetar
2. A. C.
3. E. Ç</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
"E hapur, e thjeshtuar, mallra"</td><td>Njësia e Prokurimit
1. A. Xh, Personi përgjegjës,
2. E. K, Inxhinier
3. E. N, Ekonomist

2. Urdhër nr. 74/1, datë 10.01.2024 për fondin limit dhe specifikimet teknike
- B. A, Kryetar
- N.M, anëtar,
- S. Ç, anëtar</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
7,397,840 lekë pa TVSH,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE "E D" SHPK me marzh fitimi 10.93 lekë/litër, ose 7,321,086 lekë,
sipas kontratës nr. 77/9, datë 19.02.2024 me afat 12 muaj.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 76,754 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 29.01.2024</td><td>9. Burimi Financimit
Nga Buxheti i UK Kamëz vetëfinancim)</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 2 OE
b) S'kualifikuar 0 OE,
c) Kualifikuar 2 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës
nuk ka</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E Hapur e thjeshtuar, mallra", me vlerë 7,397,840 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

<u>Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi</u>

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 74 prot., datë 10.01.2024.

<u>Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike</u>

Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit me nr. 74/2 prot., datë 11.01.2024, një procesverbal mbajtur nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 74/1, datë 10.01.2024, me përbërje z. B. A, kryetar dhe N.M e S. Ç, anëtarë, si dhe një preventiv me sasitë 48640 litra gazoil me çmimin 150.34 lekë/lt dhe 600 litra benzinë me çmimin 142.17 lekë/lt, ose 7,397,840 lekë pa TVSH gjithsej.

Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimit të karburantit sipas çmimit të publikuar në buletinin e APP-së të datës 08.01.2024, me vlerën e USD në lekë, të marrë nga Banka e Shqipërisë, duke i shtuar edhe taksat dhe akcizën (gjithsej 150.34 lekë/litër për gazoil dhe 142.17 lekë/litër për benzinën). Për përllogaritjen e sasisë së karburantit, është dhënë një informacion në formë tabelare për harxhimin e karburantit nga mjetet e marra me qera apo në pronësi të UKK për vitin 2023. Është llogaritur sasia e karburantit për një vit, për 3 mjete që do të blihen nga UKK (1 kamioçinë me vinç me 160 lit/muaj, 1 kamioçine pa vinç me 150 lit/muaj dhe fadromë me goma 1400 lit/muaj), gjithsej 20520 litra/vit, 14080 litra karburant për 2 mjetet e marra me qera në vitin 2023,

si dhe 1160 lit/muaj sasia e karburantit në dispozicion të mjeteve personale të administratës, ose 10040 litra në vit, e vendosur me vendimin e Këshillit Administrativ nr.1, datë 10.01.2024 "Për miratimin e sasisë së karrburantit që do të vihet në dispozicion të administratës së UKK për vitin 2024". Gjithsej është llogaritur sasia prej 48640 litra gazoil dhe 600 litra benzinë në vit, me vlerë totale 7,397,840 lekë pa TVSH.
Konsumi i karburantit për mjetet që do të blihen është marrë apriori, pasi nuk dihet se cilat do të jenë mjetet dhe sa do të jetë norma e konsumit të karburantit për secilin mjet. Po kështu edhe për mjetet private të punëmarrësve.
Sa sipër, përcaktimi i nevojave për gazoil, nuk është i mirëargumentuar dhe mbart riskun për të mos qenë i saktë dhe ngarkon me përgjegjësi grupin e punës për përllogaritjen e fondit limit.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit pa datë, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.
- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se ato janë konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE/BOE, të dy të kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit	Vlerësimi
1	**"E.D." SHA**	**10.93 lekë/litër**	**Kualifikuar**
2	"O." SHPK & "B.-OIL" SHA	11.5 lekë/litër	Kualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Pas verifikimit në SPE dhe dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE i kualifikuar dhe shpallur fitues "E.D." SHA, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte i plotë dhe konform DT të hedhura ne SPE.

U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit z. A.XH..

5. “**Blerje karburanti, viti 2025”, UK Kamëz**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti (gazoil dhe benzinë), viti 2024”, Nr. REF-37545, datë 02-10-2024.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 298/7, datë 10.02.2025 2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra”	1. Urdhër Prokurimi Nr. 298/7, datë 10.02.2025 Njësia e Prokurimit 1. E.D., Personi përgjegjës, 2. I.D., Juriste 3. B.N, Ekonomist 2. Urdhër nr. 298/1, datë 07.02.2025 për fondin limit dhe specifikimet teknike - B.H, Kryetar - N.M., anëtar, - L.B., anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 298/8, datë 10.02.2025 1. D.C., Kryetar 2. A.D. 3. H.B.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 12,000,000 lekë pa TVSH,	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE “E.D.” SHPK me ofertë ekonomike 11,553,638 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 596, datë 25.03.2025 me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit 446,362 lekë, ose 3.72%.
8. Data e hapjes së tenderit Datë 26.02.2025	9. Burimi Financimit Nga Buxheti i UK Kamëz (vetëfinancim)	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur, mallra”, me vlerë 12,000,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij prokurimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 298 prot., datë 07.02.2024 për kryerjen e këtij prokurimi.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit me nr. 298/2 prot., datë 10.02.2025, një procesverbal mbajtur nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr. 298/1, datë 07.02.2025, me përbërje z. B.H, kryetar dhe N.M. e L.B., anëtarë, si dhe një preventiv me sasitë 78540 litra gazoil me çmimin 145.9 lekë/lt dhe 3720 litra benzinë me çmimin 141.63 lekë/lt, ose 11,985,850 lekë pa TVSH gjithsej.

Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimit të karburantit sipas çmimit të publikuar në buletinin e APP-së të datës 10.02.2025, me vlerën e USD në lekë (95.87 lekë/USD), të marrë nga Banka e Shqipërisë datë 10.02.2025, duke i shtuar edhe taksat, akcizën dhe marzhin e fitimit (gjithsej 145.9 lekë/litër për gazoil dhe 141.63 lekë/litër për benzinën). Për përllogaritjen e sasisë së karburantit, është dhënë një informacion në formë tabelare për harxhimin e karburantit nga mjetet e marra me qera apo në pronësi të UKK për vitin 2024. Është llogaritur sasia e karburantit për një vit, për 4 mjete në pronësi të UKK (sipas harxhimit në vitin 2024) + për fadromën e re HIDROMEK (në pronësi të Bashkisë Kamëz (kontrata nuk administrohet në dosje) 1450 lit/muaj + boti i ujit> 8 ton 900 lit/muaj, + boti i pastrimit> 8 ton 900 lit/muaj dhe emergjenca avari 600 lit/muaj, si dhe 1180 lit/muaj gazoil dhe 250 lit/muaj benzinë, sasia e karburantit në dispozicion të mjeteve personale të administratës, ose 14,160 litra/vit gazoil dhe 3000 lit/vit benzinë, e vendosur

me vendimin e Këshillit Administrativ nr.2, datë 06.01.2025 "Për miratimin e sasisë së karrburantit që do të vihet në dispozicion të administratës së UKK për vitin 2025". Gjithsej është llogaritur sasia prej 78540 litra gazoil dhe 3000 litra benzinë në vit, me vlerë totale 11,985,850 lekë pa TVSH.
Në dosje nuk administrohen procesverbalet që përcaktojnë normën e konsumit të karburantit për secilin mjet në pronësi të UKK-së. Po kështu edhe për mjetet private të punëmarrësve.
Sa sipër, përcaktimi i nevojave për gazoil, nuk është i mirëargumentuar dhe mbart riskun për të mos qenë i saktë dhe ngarkon me përgjegjësi grupin e punës për përllogaritjen e fondit limit.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit pa datë, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.
- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se ato janë konform natyrës dhe volumit të objektit që prokurohet.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur, mallra". Nga ana e KVO-së, është mbajtur procesverbali për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit, i mbajtur në datë 10.03.2025 dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE/BOE, të dy të kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	oferta	Vlerësimi
1	**"E. D" SHA**	**11,553,638**	**Kualifikuar**
2	"G. C. G.P.G" SHA	12,039,158	Skualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi i formularit të Njoftimit të fituesit, rezulton se është skualifikuar OE "G. C. G.P.G" SHA, pasi ka dhënë ofertë më të lartë se fondi limit. Sipas Raportit Përmbledhës të prokurimit oferta ekonomike e këtij OE është 12,039,158 lekë, por nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, referuar sipas DT dhe çmimeve të ofertuara (78540 lit gazoil x 152.16 lekë/litër + 3720 litra benzinë x 146.08 lekë/litër) oferta totale e këtij OE është 12,494,064 lekë, pa TVSH. Sa sipër skualifikimi i këtij OE është i drejtë, por oferta e llogaritur nga KVO-ja është më e vogël se ajo në fakt.

- Pas verifikimit në SPE dhe dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE i kualifikuar dhe shpallur fitues "E. D" SHA, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur nuk ishte i plotë dhe konform DT të hedhura ne SPE, pasi dokumentacioni i paraqitur si eksperiencë e ngjashme, ishte për furnizim me karburant me Bashkinë Kamëz, sipas kontratës Nr. 997 Prot., datë 02.02.2023 me objekt: "Blerje karburant", me vlerë 4,672,132.40 (katër milion e gjashteqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë e dy pike dyzet) lekë pa TVSH, ose më e vogël se vlera e kërkuar në DT 4,800,000 lekë pa TVSH.
Gjithashtu, nga llogaritja e bërë nga grupi i auditimit, referuar sasisë së furnizimit sipas DT dhe çmimeve të ofertuara (78540 lit gazoil x 146.21 lekë/litër + 3720 litra benzinë x 140.18 lekë/litër), oferta totale e këtij OE është 12,004,803 lekë pa TVSH, ose 4,803 lekë pa TVSH më e madhe se fondi limit.
Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar*

vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme".
Me skualifikimin e OE "E. D" SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, pika 1/b, sipas të cilit "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...*
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO-ja duhet të bënte propozimin tek TAK për anulimin e procedurës së prokurimit. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 11,553,638 lekë pa TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së D. C, A. D. e H. B.
Në kontratën e furnizimit me nr. 596 prot., datë 25.03.2025 është përcaktuar gjithashtu marzhi i fitimit e shprehur në vlerë absolute 10.93 lekë/litër, kur në ofertën e OE fitues është 15 lekë/litër.
U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 298, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit znj. E.D..

6. **"Blerje materiale për KUN dhe materiale ujësjellësi, tuba korregato, tuba dhe rakorderi uji të pijshëm", UK Kamëz**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale ër KUN dhe materiale ujësjellësi, tuba korregato, tuba dhe rakorderi uji të pijshëm", UK Kamëz", Nr. REF-56975, datë 01-25-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 04, datë 25.01.2023	1. Urdhër Prokurimi Nr. 04, datë 25.01.2023	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 05, datë 25.01.2023
2. Lloji i Procedurës – "E hapur, mallra" Marrëveshje kuadër	Njësia e Prokurimit - A. Xh, Personi përgjegjës, - K. B. , Anëtar - S. P., Anëtar 2. Grupi i hartimit te fondit limit Urdhër nr. 124/1, datë 23.01.2023 - B. A. - E. K. - B. N.	1. E. Ç., Kryetar 2. A. P., anëtar 3. H. B., anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSh) 14,865,000 lekë pa TVSH, shumatore të çmimeve njësi 1,117,945 lekë pa TVSH	6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "2.A.F A. G" SHPK me shumatore të çmimeve njësi 976,730 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 135/5, datë 08.03.2023, me afat 12 muaj.	7. Diferenca me shumatoren e çmimeve njësi sipas DT, 141,215 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit	9. Burimi Financimit	10. Operatoret Ekonomike

Datë 13.02.2023	Nga Buxheti i UK Kamëz vetëfinancim)	a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 3 OE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E Hapur, mallra", me vlerë 14,865,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 124 prot., datë 23.01.2023. Relacioni teknik për këtë objekt prokurimi, i hartuar nga ing. B. A. dhe E. K., citon nevojën për materiale hidraulike që do të nevojiten për përdorim njëvjeçar nga UK Kamëz, duke theksuar nevojat që paraqiten nga administratorët e njësive (që nuk janë bashkëlidhur relacionit), por nuk ka një analizë të hollësishme për të nxjerrë sasitë e nevojshme për prokurim, e cila do të llogaritej si diferencë e nevojave për materiale, me gjendjen e këtyre materialeve në magazinë. Sa sipër, sasitë e preventivit të fondit limit për materiale hidraulike, janë të paargumentuara teknikisht, duke mbartur riskun për një preventiv joreal.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje administrohet procesverrbali për argumentimin e fondit limit pa nr prot., datë 25.01.2023, i mbajtur nga Njësia e Prokurimit me përbërje z. A. X., Personi përgjegjës, K. B. dhe S. P., anëtarë. Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimeve të materialeve me studim tregu dhe bazuar në manualin në fuqi të çmimeve për disa nga materialet që do të prokurohen. Për materialet që janë në manualin e çmimeve, është nxjerrë vlera prej 9,613,163 lekë pa TVSH. Për materialet që nuk janë në manualin e çmimeve në fuqi, janë kërkuar tre oferta dhe është bërë mesatarja e tyre, duke nxjerrë një clerë prej 5,251,837 lekë. Fondi limit i kësaj procedure është shuma e dy vlerave të mësipërme prej 14,865,000 lekë.

Nga verifikimi i studimit të tregut konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë "E." SHPK, "2. A. G." SHPK dhe "R. C." SHPK. Nga verifikimi në website-n e QKB, rezulton se këto shoqëri kanë si objekt të veprimtarisë edhe shitjen ne materiaeve të ndërtimit.

Mbi përcaktimin e dokumenteve të tenderit dhe kritereve të kualifikimit:

1. Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se në Dokumentet e Tenderit (DT), në faqen e parë, është vendosur fondi limit/vlera e pritshme e kontratës 14,865,000 lekë pa TVSH dhe shumatore e çmimeve për njësi 1,117,945 lekë pa TVSH dhe në pikën 4.4 "Njoftimit paraprak të informacionit" citohet "4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar)". Ky kriter i vendosur nga NJP është bazuar në DST të publikuara nga APP "Dokumentet standarde të tenderit të miratuara me ndryshimet e fundit në datë 05.10.2022 për procedurën e hapur, mallra".

Nisur nga sa citohet më sipër, vendosja e shumatores së çmimeve për njësi është e paargumentuar ligjërisht, pasi sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore dhe janë bashkëlidhur dokumenteve të

tenderit. Gjithashtu, edhe në Udhëzimin e APP-së nr. 6, datë 16.01.2018 "Për përdorimin e Marrëveshjes Kuadër (MK) dhe përdorimin e saj me mjete elektronike" në pikën 5.3 citohet "5.3 *Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi. Vlerësimi i ofertës/ofertave fituese duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi, bëhet në ato raste kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur objektivisht, të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, si psh. në rastin e medikamenteve, artikujve ushqimor, pjesëve të këmbimit etj*."
Kjo mënyrë e përcaktuar për përzgjedhjen e fituesit, është e paargumentuar edhe teknikisht, qoftë për vlerën e publikuar të shumatores së çmimeve njësi (1,117,945 lekë pa TVSH), e cila nga llogaritja del 883,789 lekë pa TVSH, qoftë edhe për vlerësimin në grup, për sasi të ndryshme të materialeve të kërkuara.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, me përbërje A. Xh., K. B. dhe S. P.

2. Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 25.01.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri që Prodhuesi i tubave duhet të paraqese Çertifikaten ISO 4427-1|:2019 ose ekuivalent "Per sistemimin e tubacioneve plastike per furnizimin me uje, kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore nen presion". Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i fondit limit (mallra), nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.
2- Është kërkuar që OE duhet të ketë 2 kamionë me vinç. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga DT, nuk është në përpjestim me volumin e objektit që prokurohet..
Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e Njësisë së Prokurimit A. Xh., K. B. dhe S. P..

Mbi vlerësimin e ofertave
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 4 OE/BOE, nga të cilët një i skualifikuar dhe tre të kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Shumatorja e çmimeve njësi	Vlerësimi
1	**"2. A. G." SHPK**	**976,730**	**Kualifikuar**
2	"A ." SHPK	14,237,650	Skualifikuar
3	"A.-C." SHPK	1,002,075	Kualifikuar
4	"E. " SHPK	1,112,830	Kualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se është skualifikuar OE "A ." SHPK, për arsyen e poshtëshënuar:
Në pikën 4.4 te DST "Kriteret e vlerësimit: është përcaktuar:
B) ***oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x (vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi).***
Ne zbatim te Udhëzimit të APP nr. 6, date 16.01.2018 "Per perdorimin e marreveshjes kuader dhe zvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar pika 7.3, paragrafi 5 përcakton:
"Në rastin kur, autoriteti kontraktor vendos të vlerësojë me "çmim për njësi", atëherë përveç vlerës së pritshme të kontratave do të përllogarisë edhe shumatoren e çmimeve për njësi, e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) në njoftimin e kontratës.
Në këtë rast, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim, nga autoriteti kontraktor.
OE A. SHPK ka ofertuar me vlere totale dhe jo me shumatore të cmimeve për njësi në kundërshtim me përcaktimet e mësipërme. Oferta e OE konsiderohet e parregullt.

- Nga verifikimi i dokumenteve të tenderit, ku në pikën 4.4 "Njoftimit paraprak i informacionit" citohet "4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:
B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim
Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar)". Ky OE ka ofertuar me preventiv me vlerë totale, ku është e përfshirë edhe kolona e çmimeve njësi, me anë të së cilës KVO-ja mund të kishte llogaritur shumatoren e këtyre çmimeve, për ta krahasuar me ofertën e shpallur fituese. Ky devijim i ofertuesit, mund te cilësohej si devijim i vogël, pasi nuk ndryshon thelbësisht ofertën, në përputhje me neni 92 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Për pasojë, skualifikimi i këtij OE është subjektiv.

2. Pas verifikimit në SPE të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "2 . A. G." SHPK, u konstatua se dokumentacini i paraqitur nga ky OE është konform DT dhe kualifikim nga KVO është i drejtë. Nga analiza e bërë nga grupi i auditimit të ofertës ekonomike të dhënë nga OE "2 . A. G." SHPK, rezultoi se me çmimet njësi të paraqitura nga ky ofertues, vlera e pritshme e kontratës është 31,173,540 lekë pa TVSH, ose 16,308,508 lekë pa TVSH më shumë se fondi limit/vlera e pritshme e kontratës, të cituar në dokumentet e tenderit të hedhura në SPE. Ky fakt tregon se, nëse AK do të kërkonte të merrte të gjitha materialet e përcaktuara në fondin limit të kësaj procedure, do të paguante 16,308,508 lekë pa TVSH lekë më shumë se fondi limit i përcaktuar. KVO-ja duhet të

kishte bërë një analizë të ofertave ekonomike te paraqitura, si nga OE i skualifikuar, ashtu edhe nga OE të kualifikuar, duke mos lejuar që ofertat e paraqitura të tejkalonin fondin limit.

U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet personi përgjegjës i prokurimit z. A. Xh.

7. "Blerje materiale për ujësjellësin (saracineska, rakorderi, fasheta, bashkues, etj.) dhe blerje materiale për KUN (tuba korregato, puseta, etj.)", UK Kamëz

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale për ujësjellësin (saracineska, rakorderi, fasheta, bashkues, etj.) dhe blerje materiale për KUN (tuba korregato, puseta, etj.)", UK Kamëz", Nr. REF-94128, datë 01-30-2024.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 07, datë 30.01.2024</td><td rowspan="2">1. Urdhër Prokurimi
Nr. 07, datë 30.01.2024
Njësia e Prokurimit
- E. Ç., Personi përgjegjës,
- E. K., Anëtar
- S. P., Anëtar

2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 246/1, datë 26.01.2024
- B.H
- D. N.
- H. B.</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 08, datë 30.01.2024
1. E. P., Kryetar
2. A. Xh., anëtar
3. R. Z., anëtar</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
"E hapur, mallra"
Marrëveshje kuadër</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
24,999,500 lekë pa TVSH, shumatore të çmimeve njësi 4,887,836 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE "A." SHPK me shumatore të çmimeve njësi 3,467,844 lekë pa TVSH,
sipas kontratës nr. 274/6, datë 28.02.2024, Marrëveshje kuadër me afat 12 muaj.</td><td>7. Diferenca me shumatoren e çmimeve njësi sipas DT, 1,419,992 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 15.02.2024</td><td>9. Burimi Financimit
Nga Buxheti i UK Kamëz vetëfinancim)</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 2 OE
b) S'kualifikuar 1 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës
nuk ka</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur, mallra", me vlerë 24,999,500 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).
Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 246 prot., datë 26.01.2024. Relacioni teknik për këtë objekt prokurimi, i hartuar nga ing. B. A., D. N. dhe H. B., citon nevojën për materiale hidraulike që do të nevojiten për përdorim njëvjeçar nga UK Kamëz, duke theksuar nevojat që paraqiten nga administratorët e njësive (që nuk janë bashkëlidhur relacionit), por nuk ka një analizë të hollësishme për të nxjerrë sasitë e nevojshme për prokurim, e cila do të llogaritej si diferencë e nevojave për materiale, me gjendjen e këtyre materialeve në magazinë. Sa sipër, sasitë e preventivit të fondit limit për materiale hidraulike, janë të paargumentuara teknikisht, duke mbartur riskun për një preventiv joreal.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit me nr 246/2 prot., datë 29.01.2024, i mbajtur nga grupi i punës me përbërje z. B. A., Kryetar, D. N. dhe H. B., anëtarë.
Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimeve të materialeve me studim tregu, janë kërkuar tre oferta dhe është bërë mesatarja e tyre, duke nxjerrë një vlerë prej 24,999,500 lekë. Nga verifikimi i studimit të tregut konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë "F." SHPK, "Sh.-A." SHPK dhe "K." SHPK. Nga verifikimi në website-n e QKB, rezulton se këto shoqëri kanë si objekt të veprimtarisë edhe shitjen ne materiaeve të ndërtimit.

Mbi përcaktimin e dokumenteve të tenderit dhe kritereve të kualifikimit:

1. Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se në Dokumentet e Tenderit (DT), në faqen e parë, është vendosur fondi limit/vlera e pritshme e kontratës 24,999,500 lekë pa TVSH dhe shumatore e çmimeve për njësi 4,887,836 lekë pa TVSH dhe në pikën 4.4 "Njoftimit paraprak të informacionit" citohet "**4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**
B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.
Në rastin e marrëveshjes kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar)". Ky kriter i vendosur nga NJP është bazuar në DST të publikuara nga APP "Dokumentet standarde te tenderit te miratuara me ndryshimet e fundit ne date 05.10.2022 për procedurën e hapur, mallra".
Nisur nga sa citohet më sipër, vendosja e shumatores së çmimeve për njësi është e paargumentuar ligjërisht, pasi sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore dhe janë bashkëlidhur dokumenteve të tenderit. Gjithashtu, edhe në Udhëzimin e APP-së nr. 6, datë 16.01.2018 "Për përdorimin e Marrëveshjes Kuadër (MK) dhe përdorimin e saj me mjete elektronike" në pikën 5.3 citohet "5.3 *Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi. Vlerësimi i ofertës/ofertave fituese duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi, bëhet në ato raste kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur objektivisht, të përcaktojë sasinë që do të prokurohet, si psh. në rastin e medikamenteve, artikujve ushqimor, pjesëve të këmbimit etj*."
Kjo mënyrë e përcaktuar për përzgjedhjen e fituesit, është e paargumentuar edhe teknikisht, qoftë për vlerën e publikuar të shumatores së çmimeve njësi (4,887,836 lekë pa TVSH), qoftë edhe për vlerësimin në grup, për sasi të ndryshme të materialeve të kërkuara.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, me përbërje E. Ç., E. K. dhe S. P..

2. Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet procesverbalit datë 25.01.2024, veprim

në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri që operatoret ekonomikë, kur nuk janë prodhues duhet të paraqesin ***Vetëdeklarim për prodhuesin*** për çertifikatat e mëposhtme:

- **Çertifikaten ISO 4427-1|:2019 ose ekuivalent. "Per sistemimin e tubacioneve plastike per furnizimin me uje, kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore nen presion".**

Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i fondit limit (mallra), nuk është në përpjestim me natyrën e objektit që prokurohet.
2- Është kërkuar që OE duhet të ketë 2 kamionë me vinç. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga DT, nuk është në përpjestim me volumin e objektit që prokurohet..

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e Njësisë së Prokurimit E. Ç., E. K. dhe S. P..

Mbi vlerësimin e ofertave
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE/BOE, nga të cilët një i kualifikuar dhe një i skualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Marzhi I fitimit	Vlerësimi
2	"A ." SHPK	3,467,844	Kualifikuar
3	"A. S." SHPK		Skualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se është skualifikuar OE "A. S." SHPK, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument në SPE:
- Nga verifikimi në SPE, konstatohet se ky OE ka ngarkuar vetëm Ekstraktin historik, për pasojë, skualifikimi i këtij OE është i drejtë.

2. Pas verifikimit në SPE dhe i dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "A R ." SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte konform kritereve të përcaktuar në DT.
Nga analiza e bërë nga grupi i auditimit të ofertës ekonomike të dhënë nga OE "A ." SHPK, rezultoi se me çmimet njësi të paraqitura nga ky ofertues, vlera e pritshme e kontratës është 26,000,078 lekë pa TVSH, ose 1,005,078 lekë pa TVSH më shumë se fondi limit/ vlera e pritshme e kontratës, të cituar në dokumentet e tenderit të hedhura në SPE. Ky fakt tregon se, nëse AK do të kërkonte të merrte të gjitha materialet e përcaktuara në fondin limit të kësaj procedure, do të paguante 1,005,078 lekë pa TVSH lekë më shumë se fondi limit i përcaktuar. KVO-ja duhet të kishte bërë një analizë të ofertës ekonomike të paraqitur nga OE i kualifikuar, duke mos lejuar që oferta të tejkalonte fondin limit.

Me kualifikimin e “A .” SHPK, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Neni 22, pika 5, KVO-ja ka bërë propozimin tek TAK për lidhjen e kontratës me këtë OE. Ky veprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me shumatore të çmimeve njësi me vlerë 4,161,413 lekë me TVSH (e cila po të konvertohet në vlerë të pritshme të kontratës arrin vlerën 26,000,078 lekë pa TVSH, ose 1,005,078 lekë pa TVSH më shumë se fondi limit/ vlera e pritshme e kontratës së hedhur në dokumentet e tenderit), me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP, duke sjellë përdorim të pritshëm pa ekonomicitet të fondeve të UK Kamëz, në vlerën 1,005,078 lekë pa TVSH. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së E. P., A. X. e R. Z., si dhe referuar nenit 21, pika 5 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, edhe z. E. M., në cilësinë e Titullarit të AK. U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH”, neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të PP”, i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit z. E. Ç..

8. “Blerje materiale për ujësjellësin dhe KUZ”, UK Kamëz

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për ujësjellësin dhe KUZ”, UK Kamëz”, Nr. REF-53021, datë 07-01-2025.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi (ripërsëritje)
Nr. 1342, datë 01.07.2025
2. Lloji i Procedurës –
“E hapur, mallra”
Marrëveshje kuadër</td><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 1342, datë 01.07.2025
Njësia e Prokurimit
- E. D., Personi përgjegjës,
- R. Z., Anëtar
- E. N., Anëtar
2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 291/1, datë 06.02.2025
- B. A.
- K. D.
- L. B.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 291/8 prot, datë 02.04.2025
1. D. C., Kryetar
2. E. P., anëtar
3. I. D., anëtar</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
27,000,000 lekë pa TVSH, shumatore të çmimeve njësi 5,643,431 lekë pa TVSH</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE “A.” SHPK me shumatore të çmimeve njësi 3,677,430 lekë pa TVSH,
sipas kontratës nr. 1342/6, datë 04.09.2025, Marrëveshje kuadër me afat 12 muaj.</td><td>7. Diferenca me shumatoren e çmimeve njësi sipas DT, 1,966,001 lekë pa TVSH</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 01.08.2025</td><td>9. Burimi Financimit
Nga Buxheti i UK Kamëz vetëfinancim)</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 3 OE
b) S’kualifikuar 2 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
</table>

11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është "E Hapur, mallra", me vlerë 27,000,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim). Kjo procedurë është përsëritur pasi në procedurën e parë me Ref. 44679-04-10-2025, nga 2 OE pjesëmarrës në tender, vetëm njëri ka plotësuar kriteret pas kontrollit në SPE, i cili është skualifikuar nga KVO-ja, pasi ka patur mungesa në dokumentacionin fizik të paraqitur. Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Raporti Përmbledhës i Prokurimit, në të cilin duhej propozuar nga KVO-ja anulimi i procedurës. Sa sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO-së D. C., E. P. dhe I. D. dhe Titullari i AK (TAK) z. Sh. L..

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 291 prot., datë 06.02.2025 për prokurimin e materialeve për ujësjellësin dhe KUZ. Relacioni teknik për këtë objekt prokurimi, me nr. 291/2 prot., datë 06.02.2025, i hartuar nga ing. B. A., K. D. dhe L. B., citon nevojën për materiale hidraulike që do të nevojiten për përdorim njëvjeçar nga UK Kamëz, duke theksuar nevojat që paraqiten nga administratorët e njësive (që nuk janë bashkëlidhur relacionit), por nuk ka një analizë të hollësishme për të nxjerrë sasitë e nevojshme për prokurim, e cila do të llogaritej si diferencë e nevojave për materiale, me gjendjen e këtyre materialeve në magazinë. Sa sipër, sasitë e preventivit të fondit limit për materiale hidraulike, janë të paargumentuara teknikisht, duke mbartur riskun për një preventiv joreal.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit me nr 291/3 prot., datë 06.02.2025, i mbajtur nga grupi i punës me përbërje z. B. A., Kryetar, K. D. dhe L. B., anëtarë.

Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimeve të materialeve me studim tregu, janë kërkuar tre oferta dhe është bërë mesatarja e tyre, duke nxjerrë një vlerë prej 27,000,000 lekë. Nga verifikimi i studimit të tregut konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë "N. K." SHPK, "A." SHPK dhe "E." SHPK. Nga verifikimi në website-n e QKB, rezulton se këto shoqëri kanë si objekt të veprimtarisë edhe shitjen e materialeve të ndërtimit.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet një procesverbali, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.5 të KVK është vendosur kriteri që operatorët ekonomikë, të kenë një punësim mesatar prej të paktën 3 (tre) persona, të cilët të jenë **shoferë.** Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga pika 2.6 e KVK-ve, është kërkuar vetëm një mjet dhe ky kriter nuk është në përpjestim me volumin e objektit që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e Njësisë së Prokurimit E. D., R. Z., dhe E. N..

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE/BOE, nga të cilët dy të skualifikuar dhe një i kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Shumatorja e çmimeve njësi	Vlerësimi
1	OE A. B. PF	26,919,679	3,668,230	Skualifikuar
2	"A ." SHPK	26,995,575	3,677,430	Kualifikuar
3	"M. G." SHPK	-	-	Skualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

1. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se është skualifikuar OE "M. G." SHPK, pasi nuk ka paraqitur dokumente të mjaftueshme në SPE.
- Nga verifikimi në SPE, konstatohet se ky OE ka ngarkuar vetëm certifikatën ISO, licencën dhe një eksperiencë të ngjashme, për pasojë, skualifikimi i këtij OE është i drejtë.
2. Pas verifikimit në SPE, OE A.B. PF rezulton të jetë skualifikuar nga KVO-ja, për shkak se Sigurimi i ofertes i ngarkuar ne SPE nga operatori ekonomik nuk është i saktë, rezulton ne emer te nje operatori ekonomik tjeter, qe nuk ka lidhje me kete procedure prokurimi dhe nuk eshte i njejte me operatorin ekonomik pjesemarres.
- Nga verifikimi në SPE, rezulton se konstatimi i KVO-së është i saktë, për pasojë, skualifikimi i këtij OE është i drejtë.

3. Pas verifikimit në SPE dhe i dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "A R ." SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur nuk ishte konform kritereve të përcaktuar në DT, pasi ky OE ka paraqitur formularin e ofertës, jo sipas preventivit të hedhur në sistem, me sasitë përkatëse për çdo mall, por vetëm me çmimet njësi.

Sa sipër, kualifikimi i OE të shpallur fitues "A ." SHPK është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...*".
Me skualifikimin e OE "A ." SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, pika 1/b, sipas të cilit "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...*
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO-ja duhet të bënte propozimin tek TAK për anulimin e procedurës së prokurimit. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës Marrëveshje Kuadër, me vlerë të pritshme të kontratës 26,995,575 lekë pa TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së D. C., E. P. e I. D..

U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me

dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit znj. E. D..

9. <u>"Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a", Bashkia Kamëz</u>

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a", Bashkia Kamëz, Nr. REF-38603, datë 02-19-2025.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 273/7 prot., datë 12.02.2025

2. Lloji i Procedurës –
"E hapur - Punë"</td><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 273/7 prot., datë 12.02.2025
Njësia e Prokurimit
E. D., Personi përgjegjës, Jurist,
D. C., inxhinier mekanik,
V. P., financier

2. Hartuesit e specifikimeve teknike dhe fondit limit
Me Urdhrin nr. 273/7, datë 05.02.2025, NJP:
B. A., Kryetar
R. Z.
D. C.
M. H.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 273/8 prot., datë 12.02.2025
1. L. B., Kryetar
2. O. A.
3. H. B., zëvendësuar me z. F. Xh., me urdhrin nr. 444/1, datë 17.03.2025</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)
18,000,000 lekë</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)
BOE "B." SHPK & "C." SHPK me ofertë 15,595,813 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 1326/14 prot, dt. 30.09.2025 me afat 3 muaj nga data e fillimit të punimeve.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
2,404,187 lekë, ose 13.35 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 17.03.2025</td><td>9. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE
b) S'kualifikuar 1 BOE,
c) Kualifikuar 1 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; Nuk ka</td><td>12. Përgjigje Ankesës</td><td>13. Përgjigje Ankesës</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E hapur", me vlerë 18,000,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i UK Kamëz, sipas Vendimit nr. 7, datë 18.12.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve "Për planin ekonomik-financiar të vitit 2025 për UK Kamëz".
<u>Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi</u>
Në dosje administrohet gjithashtu shkresa me nr. 273/6, datë 05.02.2025, nënshkruar nga drejtori i Departamentit teknik z. B. A. "Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a", sipas të cilës ky prokurim duhet të kryhet, bazuar në shkresën nr. Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve me nr. 7, datë 18.12.2024 "Për miratimin e planit ekonomiko-financiar të vitit 2025".
<u>Mbi projektpreventivin e zbatimit:</u>

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar grupi i punës i ngritur me urdhrin e TAK me nr. 273/7 prot, datë 05.02.2025, me përbërje B. A., Kryetar, R. Z., D. C. dhe M. H.. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 90 ditë.
Në dosjen teknike të zbatimit të objektit nuk administrohet leje ndërtimi/infrastrukturore, në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor, z. Sh. L. dhe personi përgjegjës i prokurimit z. E. D..
Për këtë objekt administrohet Oponenca Teknike me nr. 1485/2 prot., datë 17.10.2023, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, ngritur me Urdhër Prokurimi Nr. 237/7 prot., datë 12.02.2025, është mbajtur procesverbal, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".
- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Është kërkuar që OE të ketë pikën e licencës NP-12/A "Punime te inxhinierise se mjedisit" dhe NS-18/A "Punime topogjeodezike". Ky kriter, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
2. Në pikën 2.3.4 është kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane". Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
3. Në pikën 2.3.5 është kërkuar që OE pjesëmarrës të disponojnë **60 punonjës** në 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Në dosjen e prokurimit dhe procesverbalin e argumentimit të fondit limit, nuk disponohet një analizë e detajuar, e bazuar në orët e punës (sipas zërave të punimeve) dhe grafikut të punimeve sipas DT. Për pasojë, ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht.

4. Në pikën 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje (ndërmjet të tjerëve: **2 (dy)** inxhinierë hidroteknikë, **1 ing. mjedisi, 3 teknikë ndërtimi**, **1** ***(një) specialist ekspert zjarrëfikës***. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, për punonjësit e cituar (bolduar) nuk është në përpjestim me natyrën/volumin e objektit që prokurohet.
5. Në pikën 2.3.7. është kërkuar që "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë **Rimorkiator për transport mjetesh të rënda min 20 ton + Koke Terheqese, Autobetoniere kantieri 2.5-3.5 m^3 (mjet teknologjik) 3 copë**, **MiniDumper kantieri deri ne 5 m^3, vinç eskavator mbi 6 ton, Makineri per shkulje pemesh pa i demtuar, Nofull hidraulike per prishje strukturash b/a, Tranxhe per prerje hekuri, Bango per kthim hekuri, GPS, Kokore, Komplet i ndihmës së shpejtë, Fikëse zjarri, jelekë fosforeshent.** Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 dhe nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit (Njësia e Prokurimit) E.D., D. C. dhe V. P..

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit dhe preventivi, janë hartuar nga grupi i punës, ngritur me urdhrin nr. 273/7, datë 05.02.2025 të TAK, me përbërje B. A., Kryetar, R. Z., D. C. dhe M. H..
Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 216, dt. 13.04.2023 "Sistemi i integruar i manualit të çmimeve në ndërtim".

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur, punë". Nga auditimi rezulton se në dosje administrohet Raporti Përmbledhës i Prokurimit me nr. 444/4 prot, datë 17.04.2025, miratuar nga TAK me shkresën nr. 444/5 prot., datë 17.04.2025. Nga KVO është mbajtur procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa nr protokolli, me datë 27.03.2025. Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 444/3, datë 16.04.2025.
Nisur nga procesverbal i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave dhe Raporti Përmbledhës i Prokurimit, si dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE "S. C." SHPK & "M." SHPK	14,216,128
2	**BOE "B." SHPK & "C." SHPK**	**15,595,813**

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar ofertuesi BOE "S.C." SHPK & "M." SHPK.
I. Nga verifikimi i procesverbalit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe verifikimi në SPE, u konstatua se ky OE është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:
- Operatori Ekonomik "S. C.SHPK" nuk ploteson kriterin për bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të cilët nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit sic është kërkuar në kriteret e vecanta te kualifikimit.
Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit në SPE, rezulton se konstatimi i KVO-së nuk është i saktë, pasi ky OE është i regjistruar në vitin 2022 dhe ka vetëm dy bilance (2022, 2023) nga të cilët njërin e ka me raport pozitiv ndërmjet aktivit dhe pasivit.
- BOE S. C. SHPK & M. SHPK, nuk përmbush kriterin e vecantë kualifikues. OE "S. C." SHPK nuk disponon kategorinë NP-7 *(Ujësjellësa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje)* në lidhje

me zërat e punimeve në preventiv *(F.V. Tuba e rakorderi ujësjellësi..., F.V. Tuba çeliku...)* Kategoria NP-12 *(Punime te inxhinierise se mjedisit)* duke qënë se kjo vepër po zhvillohet në terren të pyllëzuar, ka të bëjë me *ruajtjen dhe eleminimin e prishjes së ekuilibrave ekologjike në terrenin ku do të kryhen punimet objekt prokurimi* si nga proçesi i kryerjes së punimeve ashtu dhe mbetjeve inerte; sikurse është bërë ndarja e zërave të punimeve të preventivit nga aktmarreveshja e BOE.
Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit në SPE, rezulton se konstatimi i KVO-së për mungesën e kategorive NP-7 (Ujësjellësa, gazsjellsa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje) dhe NP-12 (Punime te inxhinierise se mjedisit) në licencën e OE "S. C." SHPK, është i saktë. Këto kategori i disponon OE-ja tjetër, pjesë e BOE-së.
- BOE S. C. SHPK & M. SHPK, nuk përmbush kriterin e vecantë kualifikues. Betonues – jo më pak se 3 (tre) punonjës.
Nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit në SPE, rezulton se konstatimi i KVO-së është i saktë.
Sa sipër, ky BOE është skualifikuar me të drejtë, por jo për arsyet që ka cituar KVO-ja.

II. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE fitues "B." SHPK & "C." SHPK në SPE, rezultoi se OE "B." SHPK nuk disponon kategorinë NP-12 të licencës.
Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".
Me skualifikimin e BOE fitues "B." SHPK & "C." SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, pika 1/b, sipas të cilit "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...*
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO-ja duhet të bënte propozimin tek TAK për anulimin e procedurës së prokurimit. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 24,547,746 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së L. B., O. A. dhe F. Xh..

Nga auditimi i dosjes të prokurimit, si dhe dosjes fizike të OE fitues "N. S." SHPK, rezultoi se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të PP"*, i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"*, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit znj. E. D..

10. <u>“Projektim i objektit “Ndërtim linje ujësjellësi transmetimi dhe shpërndarje dhe rrjet kanalizimesh në Laknas dhe Valias”</u>

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Projektim i objektit “Ndërtim linje ujësjellësi transmetimi dhe shpërndarje dhe rrjet kanalizimesh në Laknas dhe Valias”, Nr. REF-39956, datë 03-05-2025.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 1973/2, datë 11.09.2025</td><td rowspan="2">1. Urdhër Prokurimi
Nr. 1973/2, datë 11.09.2025
Njësia e Prokurimit
- E.D., Personi përgjegjës,
- V. P., Anëtar
- B. A., Anëtar
2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 1973/1, datë 09.09.2025
- D. C.,
- L. B.,
- A. K.,
- A. M.
- M. V.</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 1973/3, datë 11.09.2025
1. R. Z., Kryetar
2. I. D., anëtar
3. E. N., anëtar, ndryshuar me Urdhër nr. 1973/6, datë 06.10.2025, me z. S. B..</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
“E hapur e thjeshtuar, shërbim”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
5,557,330 lekë pa TVSH,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE “E..” SHPK me ofertë 5,220,000 lekë pa TVSH,
sipas kontratës nr. 1973/14, datë 11.11.2025, me afat 45 ditë.</td><td>7. Diferenca me fondin limit 337,330 lekë pa TVSH, ose 6.07 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 07.10.2025</td><td>9. Burimi Financimit
Nga Buxheti i UK Kamëz (vetëfinancim)</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 3 OE
b) S’kualifikuar 2 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; datë 24.10.2025</td><td>12. Përgjigje Ankesës AK me shkresë 2427 prot, datë 28.10.2025</td><td>13. Përgjigje Ankesës
KPP me vendimin nr. 1611/5, datë 07.11.2025</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur e thjeshtuar, shërbim”, me vlerë 5,557,330 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

<u>Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi</u>

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 1973 prot., datë 09.09.2025 për prokurimin e Projektim i objektit “Ndërtim linje ujësjellësi transmetimi dhe shpërndarje dhe rrjet kanalizimesh në Laknas dhe Valias”.

<u>Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike</u>

Në dosje administrohet Detyra e Projektimit për këtë objekt prokurimi, me nr. 1973/4 prot., datë 11.09.2025, i hartuar nga komisioni i për vendosjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit, ngritur me Urdhrin nr. 1973/1, datë 09.09.2025, me përbërje ing. D. C., L. B., A. K., A. M. dhe M. V., citon qëllimin, vendndodhjen, kërkesat që duhet të zgjidhë projekti, etj.

Në dosje administrohet një preventiv paraprak i zbatimit të këtij objekti dhe një procesverbal mbi përcaktimin dhe miratimin e fondit limit, nga grupi i punës i përbërë nga D. C., L. B. dhe M. V., në të cilin citohet baza ligjore, përshkrimi i objektit, arsyet që ka vlerësuar komisioni në përcaktimin e fondit limit dhe fondi limit i rekomanduar.

Në dosje administrohet procedura jo e plotë e përllogaritjes së fondit limit (përllogaritja sipas formulave në excel u administrua nëpërmjet e-mail-it), bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016

"Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" dhe udhëzimet teknike e metodologjinë për përllogaritjen e fondit limit. Pas hartimit të preventivit paraprak, grupi i punës ka bërë përllogaritjen e fondit limit të projektimit të objektit, sipas grupit III tarifor të veprave inxhinierike. Nga verifikimi i koeficientëve të marra për përllogaritjen e fondit limit, rezulton se ata janë marrë të saktë.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet një procesverbali, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1. Në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri që operatorët ekonomikë duhet të disponojnë 7 inxhinierë të ndryshëm në licencë dhe 3 inxhinierë si staf mbështetës. Nisur nga detyra e projektimit dhe nga volumi i shërbimit që projektohet, kriteri për arkitekt në licencën profesionale, si dhe 2 inxhinierë hidroteknikë si staf mbështetës, nuk janë sipas natyrës (arkitekti) dhe volumit (inxhinierët hidroteknikë) të objektit që prokurohet.
2. Në pikën 2.3.5 është kërkuar që OE të disponojnë 15 punonjës, ndërkohë që kërkesa për staf është 10 punonjës. Ky kriter nuk është në përputhje me volumin e objektit që prokurohet.
3. Në pikën 2.3.7 është kërkuar Certifikatë BS PAS 99-2012 (e vlefshme): Per sistemin e menxhimit te integruar. Ky kriter nuk është në përputhje me natyrën e objektit që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e Njësisë së Prokurimit E. D., V. P. dhe B. A..

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur, mallra". Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Në dosjen e prokurimit administrohet Raporti Përmbledhës i Prokurimit, nr. 1973/11 prot, datë 18.04.2025. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE/BOE, nga të cilët dy të skualifikuar dhe një i kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi
1	"A. E." SHPK	4,959,593.42	Skualifikuar

2	"N.-G." SHPK	5,000,000	Skualifikuar
3	**"E.." SHPK**	**5,220,000**	**Kualifikuar**

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se janë skualifikuar dy OE pjesëmarrës, për arsyet e mëposhtme:

1. OE "**A . E." SHPK** skualifikohet për arsye se dëshmitë që ka paraqitur OE nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit që po kryen AK duke mos përmbushur piken 2.3 të kritereve të vecanta. Nga verifikimi i bërë në SPE konstatohet se ky OE për punë të ngjashme në folderin "Punë 2" ka paraqitur edhe objektin "Studim Projektim Bypass Elbasan" me vlerë 81,460,000 lekë pa TVSH, me afat 22 muaj, në të cilin janë përfshirë edhe Studimi gjeologjik, testime, shpime, Studimi hidrogjeologjik, Studimi topografik dhe Studimi i ndikimit në mjedis, në vlerë të pjesshme 11,500,000 lekë pa TVSH, të cilat janë paguar me faturën elektronike me vlerë 32,584,000 lekë pa TVSH. Sa sipër, ky OE është skualifikuar padrejtësisht nga KVO-ja

2. OE "**N.-G." SHPK** skualifikohet për arsye se dëshmitë qe ka paraqitur OE nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit që po kryen AK duke mos përmbushur piken 2.3 të kritereve të vecanta.
Nga verifikimi i bërë në SPE konstatohet se ky OE për punë të ngjashme, të cilat nuk dëshmojnë eksperiencën e kërkuar në DT. Sa sipër, ky OE është skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.

3. Pas verifikimit në SPE të dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues **"E.."** SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte konform kritereve të përcaktuar në DT dhe ky OE është kualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.

Sa sipër, skualifikimi i OE "A . E." SHPK është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme...*".
Me kualifikimin e "A. E." SHPK, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", Neni 22, pika 5 sipas të cilit "*Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave merr vendim për shpalljen e fituesit, i cili publikohet në sistemin e prokurimit elektronik menjëherë, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit*", KVO-ja duhet të bënte propozimin tek TAK për lidhjen e kontratës me këtë OE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 6,264,000 lekë me TVSH ose 260,406 lekë pa TVSH më të lartë, duke sjellë përdorim pa ekonomicitet të fondeve të UK Kamëz, **në vlerën 260,406 lekë pa TVSH**. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së R. Z., I. D., S. B..

U konstatua gjithashtu, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të

PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit zn. E. D..

I. Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 1417 Prot., date 22.06.2026 të UKK, e protokolluar në KLSH me nr. 1051/9 Prot., date 25.06.2026, është observuar nga Administratori i UKK-së z. Sh. L., si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Grupi I auditit ka vlerësuar se skualifikimi I Operatorit ekonomik "A. E. " SHPK është I padrejtë, në kundërshtim me nenin 82 te VKM nr 285 datë 19.05.2021'Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ", I ndryshuar ,sipas të cilit "Komisioni I vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara ,duke I kualifikuar vetëm ato oferta ,që përmbushin kërkesat për kualifikim ,të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe janë të përgjegjshme

Në lidhje me vlerësimin e bërë nga grupi i auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në projekt raport sqarojmë sa vijon:

KVO ka vlerësuar shërbimet e ngjashme të paraqitura nga OE konkretisht "Punime 2.pdf" duke analizuar kontratën e projektimit me objekt "Ndërtimi i infrastrukturës së aksesimit dhe ankorimit për operimin e asetit gjenerues termik, në portin e peshkimit Triport-Vlorë sipas kontratës së tenderit me Nr.3502/16 date 04.10.2022 lidhur midis shoqërisë S. sh.p.k dhe KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe Akt marrveshjes noteriale Nr. 2050 Rep dhe Nr. 549 Kol datë 13.09.2022 lidhur midis shoqërisë S. sh.p.k dhe A. E. Sh.p.k.

Në ofertën e paraqitur nga OE "A. E." SHPK është e vërtetë se është përcaktuar preventive pjesor

3.1 Shpenzime per Studimet Gjeologjik, Hidrologjik

Nr	*Shpenzime per Studimet Gjeologjik, Hidrologjik*	*Njësi*	*Sasia*	*Çmimi/Njësi*	*Cmimi total*
A	*Studim Gjeologjik, Testime, Shpime*	*lek*	*1*	*3,000,000.00*	*3,000,000.00*
B	*Studim Hidrologjik*	*Lek*	*1*	*2,500,000.00*	*2,500,000.00*
C	*Studim Topografik*	*Lek*	*1*	*4,500,000.00*	*4,500,000.00*
D	*Studim i Ndikimit ne Mjedis*	*Lek*	*1*	*1,500,000.00*	*1,500,000.00*
	Shuma A+B+C+D				*11,500,000.00*

Por ky preventiv nuk është detajuar lidhur me punën që do të kryhet nga OE për realizimin e tyre. Për të qenë sa më korrekt me vlerësimin e OE , KVO ka marrë në shqyrtim termat e references së projektimit të hartuar nga AK "Autoriteti Rrugor Shqiptar" për ti krahasuar me ato të përcaktuara nga UKK sh.a në DST nga e cila rezulton:

A.Zeri Studim Gjeologjik, Testime, Shpime faqe (105-106)

3.2.2.Raporti përfundimtar i studimit gjeologjik dhe gjeoteknik

"Investigimet duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që të dhënat e marra nga studimi tyre, të shërbejnë për vlerësimin e stabilitetit të përgjithshëm të zonave problematike, të vlerësojnë pozicionimin e përshtatshme të strukturës së veprave të artit etj.

*Këto investigime do të japin të dhënat e formacioneve **gjeologjike** në lidhje me:*

- ***Tipin e dheut ose të shkëmbit;***
- ***Nivelin e ujërave nëntokësor;***
- ***Fortësinë paraprake dhe veçoritë e deformimet të dherave dhe shkëmbit."***

*Dokumentacionin për investigimet në terren (**sondë, gropa studimi**) ku të jepet vendi, data, metodat, standartet dhe rezultatet;*

<u>Përshkrimet e hollësishme të të gjitha shtresave duke dhënë vetitë e tyre fiziko-mekanike; Identifikimi i zonave të dobëta (dallimi në parametra gjeoteknik, vendndodhja) si dhe rekomandimet përkatëse; foto etj)</u>

Analiza e stabilitetit të argjinarurave dhe gërmimeve; Për çdo strukturë duhet të jepet i ndarë studimi gjeoteknik (llogaritje, standarti, testet, foto etj)

B Zeri Studim Hidrologjik dhe hidroteknik (faqe 106)

3.2.3. Raporti përfundimtar i studimit hidrologjik dhe hidroteknik

Në këtë studim do të vlerësohen kushtet hidrologjike të zonës ku shtrihet objekti duke përfshirë çështjet që lidhen me <u>drenazhimin e ujrave sipërfaqësor e nëntokësor</u>.

<u>Temperatura e ajrit, Mjegulla, Rreshjet atmosferike, Bora, Lagështia e ajrit, Era, Stuhitë</u>

<u>Studimi i kushteve hidrologjike ka rëndësi të vecantë në projektimin e sistemit të drenazhimit.</u>

Kërkesat e detyrës së projektimit se UKK sh.a

- ***REKOMANDIME PËR PROJEKTUESIN (faqe 8)***

- *Percaktimin në koordinim me Bashkine Kamez te nje prone ku do te ndertohen 2- Pus-shpimet dhe Stacioni i pompimit dhe Depo Kulle per Depozitim e shperndarje uji*
- *Kryerjen e nje Studimi hidrogjeologjik per sasine e ujit qe do te kene 2-puset ,ne menyre qe te jete e garantuar sasia min 40l/sec. per periudhen me te thate te vitit*
- *Studimi hidrogjeologjik per permiresimin e furnizimit me uje te pijshem te Bashkise Kamez.*

  ¬ Verifikimi ne terren veprave te ujesjellesit te zones ,kordinim me linjen e Puseve te Valiasit si edhe linjen e Stacionit qendror te puseve ne Laknas

  ¬ Linja kryesore e transmetimit qe do te vi nga puset e reja qe ndertohen ne Valias duhet te lidhet me linjen PE 160mm e parashikuar ne Projektin qe furnizon qendren e Laknasit e Univers City ,aty ne pjesen e bashkimit duhet te kete nje pusete me saraçineske qe kombinon ujerat sipas nevojave.
- *Projektin per te gjithe rrjetin shperndares te ujesjellesit te zones*
- *¬ Projektin per te gjithe rrjetin e kanalizimeve bashke me ndertimin e Kolektoreve kryesore te zones si eshe shkarkimi te jete i planifikuar per ne Impiant pastrami*

- ***OBJEKTIVAT (faqe 9)***

  Objektivat per furnizimin me uje, jane permbledhur me poshte:

  - *Ndertim i dy puseve te reja ne Valias*
  - *Pus-shpimet ne Valias do te jene sipas studimit Hidrogjeologjik e mund te jene minimalisht ne kuote jo me pak se 60m nen nivelin e tokes,por kjo do te udhezohet ne baze te studimeve hidrogjeologjike.*

- *Burimi ujore do te jene 2 cope Pus shpime te reja Marrja e ujit nga puset e reja Valias . Lidhja me Tubacionin e vjeter D=400mm te Valiasit do te shoqerohet me puset manovrimi bashke me mates elektromagnetik dhe nje dalje tubi per furnizimin e zones se Valiasit poshte pallateve deri ne breg te Lumit.*
- *Ndertim depo e re uji e tipi Kulle per te rritur kapacitet e depozimit te ujit ≥ 500m³ afer Stacionit te pompimit e puseve 1,2,…etj*

Nga sa më lart, rezulton se projekti i paraqitur nga OE për "Studim Projektim By Pass Elbasan" nuk është shërbim i ngjashëm më atë të kërkuar nga AK për faktin pasi dy projektimet kane natyra të ndryshme dhe se zërat e përcaktuara në të nuk kanë ngjshmëri me ato të kërkuara nga AK, konkretisht: shpimet e përcaktuara në këtë projekt i përkasin studimit gjeologjik për përcaktimin e tipit të dheut, ujrave nëntokesore dhe projekti hidrogjeologjik ka për detyrë përcaktimin e dranazhimit te ujrave te lumit dhe shiut ndërkohë që natyra e shërbimit që kërkohet nga AK ka të bëjë me rrjet ujësjellësi I cili do të bazohet ndertimin e 2- Pus-shpimeve, Stacionit te pompimit dhe Depo Kulle per Depozitim e shperndarje uji.

Pra nga dokumentacioni I paraqitur OE nuk vërteton të ketë projektuar studime gjeologjike dhe hidrogjeologjike të natyrës së kërkuar nga AK .

Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se:
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës
KVO gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme.
KVO gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për të bindur AK se ai ka aftësinë e nevojshme për të garantuar përmbushjen me me sukses te kontratës.
OE "A&E E" SHPK me dokumentacionin e paraqitur nuk përmbush kërkesat për kualifikim të përcaktuar nga AK dhe nuk garanton AK për realizimin me sukses të kontratës për rrjedhim KVO ka vlerësuar se oferta e OE duhet të skualifikohet.
Për sa më sipër, kërkojmë rishikimin e vlerësimit të bërë në projekt-raport dhe reflektimin argumenteve e dokumentacionit të paraqitur në raportin përfundimtar të auditimit.

Opinioni i grupit të auditimit:

Përsa është observuar në lidhje me skualifikimin nga KVO-ja të OE "A. E." SHPK, grupi i auditimit sqaron si më poshtë:
- Grupi i auditimit, si eksperiencë e ngjashme, i është referuar dokumentacionit të paraqitur nga OE "A. E." SHPK për objektin "Studim Projektim Bypass Elbasan" me vlerë 81,460,000 lekë pa TVSH dhe jo për objektin "Ndërtimi i infrastrukturës së aksesimit dhe ankorimit për operimin e asetit gjenerues termik, në portin e peshkimit Triport-Vlorë";
- Eksperienca e kërkuar në DT, nuk citohet "e njëjtë", por "e ngjashme" dhe studimi gjeologjik, hidrologjik dhe i ndikimit në mjedis, i paraqitur nga OE i skualifikuar është një eksperiencë e ngjashme në natyrë me eksperiencën e vendosur nga AK.

Sa sipër, ky pretendim **nuk merret në konsideratë**.

11. "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, Lagjja Zallmner", Bashkia Kamëz

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, Lagjja Zallmner", Bashkia Kamëz, Nr. REF-67278, datë 04-26-2023.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 529/2 prot., datë 25.04.2023	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 529/2 prot., datë 25.04.2023 E. Ç., Jurist B. A., Inxhinier, Specialist i fushës H. B., anëtar 1. Urdhër Prokurimi Nr. 529/2 prot., datë 25.04.2023 Njësia e Prokurimit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 529/1, datë 16.03.2023, 1. J. D., Kryetar 2. E. P. 3. E. K.
2. Lloji i Procedurës – "E hapur - Punë"		

	E. Ç., Personi përgjegjës, Jurist B. A., Inxhinier, Specialist i fushës H. B., anëtar	
5. Fondi Limit (pa TVSH) 22,420,437 lekë,	6. Oferta fituese (pa TVSH) BOE "B." SHPK, "N." SHPK & N." SHPK me ofertë 20,456,455 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 529/5 prot, dt. 16.06.2023 me afat 60 ditë nga data e fillimit të punimeve.	7. Diferenca me fondin limit 1,963,982 lekë, ose 8.8 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 12.05.2023	9. Burimi Financimit Buxheti i UK Kamëz	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE b) S'kualifikuar 1 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE
11. Ankimime; nuk ka ankesë.	12. Përgjigje Ankesës nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E hapur", me vlerë 22,420,437 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i i UK Kamëz, sipas Vendimit nr. 8, datë 01.12.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve "Për planin ekonomik-financiar të vitit 2023 për UK Kamëz".

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosjen e prokurimit administrohet një shkresë e nënshkruar nga drejtori i Departamentit teknik z. B. A. "Kërkesë për prokurimin e objektit "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, Lagjja Zallmner", Bashkia Kamëz, sipas të cilës ky prokurim duhet të kryhet, duke parë nevojën për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit, me qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë të komunitetit.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga studio e projektimit "R. S." SHPK në vitin 2023. Projekti nuk është i administruar në dosjen fizike të prokurimit. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 60 ditë.
- Për këtë objekt, nuk administrohet në dosje leje ndërtimi/infrastrukturore. Ky veprim është në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit", sipas të cilit ky objekt duhet të ishte pajisur me leje ndërtimi infrastrukturore.

Në dosjen e prokurimit nuk administrohet Oponenca Teknike, në mospërputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor, z. E. M. dhe personi përgjegjës i prokurimit z. E. Ç..

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se kjo procedurë është e përsëritur, por nuk ndodhen në dosje materialet e procedurës së anuluar. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit z. E. Ç..

Me Urdhër nr. 529/2 prot., datë 25.04.2023 të TAK është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, kritereve të kualifikimit, si dhe për përllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 529/2 prot., datë 25.04.2023, është mbajtur procesverbal pa nr prot, pa datë 16.03.2023, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje (ndërmjet të tjerëve) 2 teknikë ndërtimi, 3 hekurkthyes, 1 punonjës për konstruksione metalike, 2 muratorë, 2 punonjës saldimi. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën (teknikët e ndërtimit dhe punonjësi për konstruksionet metalike, muratorët) dhe volumin e punimeve (hekurkthyesët) në objektin që prokurohet.
2- Në pikën 2.3.11. është kërkuar që "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë Kamion me vinc me kapacitet vinci mbi 5 ton, Motogjenerator/Gjeneratore, Vibrator, Saldatrice, Pajisje per hekurthyes, Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve (kokore, prozhektorë, etj.). Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
3. Në pikën 2.3.7 është kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane", sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndyshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
5. Në pikën 2.3.1 është kërkuar që për të vërtetuar eksperiencën e ngjashme, në rast se punimet jane kryer me ente publike, Autoritetiti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
i. Kontratën e Sipërmarrjes,
ii. Situacionin përfundimtar të objektit
iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor
iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
v. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

Ky kriter është i paargumentuar teknikisht pasi edhe nga APP (Koordinimi.app.gov.al) është rekomanduar që këto dokumente të jenë vetëm për punimet e kryera me sektorin privat, ndërsa për ato me sektorin publik, do të mjaftonin Kontrata e Sipërmarrjes, Situacioni përfundimtar i objektit dhe Formulari i Vlerësimit nga Investitori.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën**.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit E. Ç., B. A., dhe H. B..

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit dhe preventivi, janë hartuar nga projektuesi.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur përgjithësisht sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje nuk administrohet procesverbali për hapjen e ofertave dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	**BOE "B." SHPK, "N." SHPK & N." SHPK**	**20,456,455**
2	OE "A. & T.-2." SHPK	21,750,435

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. extra prot, datë 09.06.2023, i cili nuk rezulton të jetë miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (TAK) z. E. M.. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi TAK dhe përgjegjësi i prokurimeve.

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 529/4, datë 01.06.2023.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se është skualifikuar OE "A. & T.-2." SHPK dhe është kualifikuar BOE "B." SHPK, "N." SHPK & N." SHPK.

- Nga verifikimi i Raportit Përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe verifikimit në SPE, u konstatua se OE "A. & T.-2." SHPK kishte mangësi në dokumentacionin e paraqitur dhe është skualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.
- Nga verifikimi në SPE dhe të dokumentacionit fizik të paraqitur nga BOE fitues "B." SHPK & "N." SHPK & N." SHPK, rezultoi se ky OE është kualifikuar padrejtësisht, pasi ka mangësitë si më poshtë:
- Në kontratën e bashkëpunimit, ndarja e punimeve është pa vlera dhe nuk mund të përcaktohet saktë përqindja e cituar në kontratë për secilin OE pjesëmarrës në bashkimin e përkohshëm, përkatësisht 40 %, 11% dhe 49%;

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga BOE fitues "B." SHPK & "N." SHPK & N." SHPK, rezultoi se:

- Dokumentet e paraqitura fizikisht nga OE "B." për taksat vendore, tatimet, FSHU dhe sigurimet shoqërore, janë marrë pas afatit përfundimtar të hapjes së tenderit;
- Vërtetimi i taksave vendore nga bashkia Kamëz është kopje e panoterizuar;

- Për manovratorin S. C. dhe muratorin Y. L., të paraqitur nga OE "B." SHPK, mungojnë diploma/certifikata e arsimit profesional si dhe certifikata e sigurimit teknik, të lëshuara nga shoqëri te akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë;
- Vërtetimi i paraqitur fizikisht nga OE "N." për detyrimet e energjisë, është marrë pas afatit përfundimtar të hapjes së tenderit;
- Objekti i vetëm i paraqitur si eksperiencë e ngjashme nga OE "N." SHPK "Ndërtim/rikonstruksion i sistemit të furnizimit me ujë në zonat rurale në Shqipëri, Loti II", ku punëdhënës është FSHZH, nuk është shoqëruar me dokumente të sakta, pasi i gjithë dokumentacioni i paraqitur është ndërmjet kontraktorit dhe nënkontraktorit (OE "Ndregjoni" SHPK). Akti i kolaudimit i paraqitur është urdhëruar nga kontraktori (A. G.) dhe jo nga punëdhënësi/investitori (Fondi Shqiptar i Zhvillimit), sikur të jetë investim i kontraktorit. Duke qenë se këto dokumente janë dhënë nga një shoqëri private, mungojnë faturat tatimore, që ky objekt të konsiderohej si "investim me ente private".

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Me skualifikimin e BOE "B." SHPK & "N." SHPK & N." SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, pika 1/b, sipas të cilit "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...*

b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO-ja duhet të bënte propozimin tek TAK për anulimin e procedurës së prokurimit. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 24,547,746 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së J. D., E. P. dhe E. K..

U konstatua gjithashtu, se :

- nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit;
- Sigurimi i ofertës është bërë në emër të OE "B." SHPK, si përfaqësuese e BOE, në kundërshtim me nenin 88, pika 2 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit duhet specifikuar pjesëmarrja në BOE;
- Kontrata është lidhur vetëm me OE "B." SHPK, në kundërshtim me nenin 88, pika 5 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit duhet të lidhet me të gjithë pjesëmarrësit në BOE;

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit z. E.Ç..

12. “Rehabilitimi i KUN, Rruga “Argjinatura” – Azili i pleqve (Rruga “Teuta”)”, Bashkia Kamëz

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i KUN, Rruga “Argjinatura” – Azili i pleqve (Rruga “Teuta”)”, Bashkia Kamëz, Nr. REF-17188, datë 08-27-2024.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 1377/9 prot., datë 13.06.2024</td><td rowspan="2">1. Urdhër Prokurimi
Nr. 1377/9 prot., datë 13.06.2024
Njësia e Prokurimit
A. Xh., Personi përgjegjës, Jurist,
S. P., ekonomist,
Ad. P., Inxhinier, Specialist i fushës

Me Urdhrin nr. 1377/11, datë 26.08.2024, NJP bëhet:
E. D., person përgjegjës, juriste
H. B., ekonomist
A. Pe., ing mjedisi, specialist i fushës</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 1377/10, datë 13.06.2024,
1. E. P., Kryetar
2. R. Z.
3. E. Ç., zëvendësuar me znj. I. D., me urdhrin nr. 1377/12, datë 26.08.2024</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
“E hapur - Punë”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)
17,429,918 lekë</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)
OE " U.” SHPK
me ofertë 14,979,450 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 1377/16 prot, dt. 04.11.2024 me afat 2 muaj nga data e fillimit të punimeve.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
2,450,468 lekë, ose 14.06 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 23.09.2024</td><td>9. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 3 OE/BOE
b) S’kualifikuar 2 BOE,
c) Kualifikuar 1 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime nuk ka</td><td>12. Përgjigje Ankesës</td><td>13. Përgjigje Ankesës</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është “E hapur”, me vlerë 17,429,918 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i UK Kamëz, sipas Vendimit nr. 8, datë 01.12.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve “Për planin ekonomik-financiar të vitit 2024 për UK Kamëz”.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi
Në dosje administrohet shkresa me nr. 1377, datë 04.06.2024, nënshkruar nga drejtori i Departamentit teknik z. B. A. “Kërkesë për prokurimin e objektit “Rehabilitimi i KUN, Rruga “Argjinatura” – Azili i pleqve (Rruga “Teuta”)”, Bashkia Kamëz, sipas të cilës ky prokurim duhet të kryhet, bazuar në Vendimin nr. 8, datë 01.12.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve “Për planin ekonomik-financiar të vitit 2024 për UK Kamëz”.
Mbi projektpreventivin e zbatimit:
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga dega teknike e UKK me përbërje ing/ B.H, ing. E.S., ing. D. N. dhe ing. M. H. (vetëm tek projekti) në vitin 2023-2024. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 60 ditë.
- Për këtë objekt, administrohet një kërkesë nga UK Kamëz, drejtuar Njësive Administrative Kamëz dhe Bathore, me nr. 2966 prot, datë 11.12.2024 (ose më shumë se një muaj nga lidhja e kontratës së zbatimit) “Kërkesë për leje infrastrukturore”, për të të cilën janë marrë dy përgjigje të njëjta nga Njësitë Administrative, ku vetëm citohet VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” për ndërhyrjet që nuk kërkojnë leje ndërtimi. Në këto

shkresa, nuk shprehet për miratimin ose jo të lejes së infrastrukturës. Sa sipër, ky objekt është pa leje ndërtimi/ infrastrukturore. Ky mosveprim ngarkon me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor, z. SH.L.dhe personin përgjegjës të prokurimit znj. E. D..
Për këtë objekt administrohet Oponenca Teknike me nr. 1485/2 prot., datë 17.10.2023, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, ngritur me Urdhër Prokurimi Nr. 1377/11, datë 26.08.2024, është mbajtur procesverbal pa nr prot, datë 26.08.2024 dhe Njoftimi për ndryshimin e dokumenteve të tenderit me nr. 1377/13 prot., datë 09.09.2024, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Është kërkuar që OE të ketë pikën e licencës NP-12/A "Punime te inxhinierise se mjedisit" dhe NS-18/A "Punime topogjeodezike". Ky kriter, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
2. Në pikën 2.10 është kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane". Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
3. Në pikën 2.3.5 është kërkuar që OE pjesëmarrës të disponojnë 40 punonjës në periudhën Qershor – Korrik 2024. Në dosjen e prokurimit dhe procesverbalin e argumentimit të fondit limit, nuk disponohet një analizë e detajuar, e bazuar në orët e punës së punëtorisë (sipas zërave të punimeve) dhe grafikut të punimeve sipas DT. Për pasojë, ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht.
4. Në pikën 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje (ndërmjet të tjerëve: **1 ing. mjedisi, 1 teknik ndërtimi**, **4 (katër)** karpentierë, **1 Saldator, 1(një) punonjes i pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**. Ky kriter

është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, për punonjësit e cituar (bolduar) nuk është në përpjestim me natyrën/volumin e objektit që prokurohet.
5. Në pikën 2.3.7. është kërkuar që "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë **Rimorkiator për transport mjetesh të rënda min 20 ton + Koke Terheqese, Dumper kantieri deri ne 5 m^3, Makineri per shkulje pemesh pa i demtuar, Rul ngjeshes gomë-hekur kapaciteti mbi 18 ton, Nofull hidraulike per prishje strukturash b/a, Tranxhe per prerje hekuri, Bango per kthim hekuri, Saldatrice, Kokore, Komplet i ndihmës së shpejtë, Fikëse zjarri.** Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 dhe nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi specialistin e fushën në Njësinë e Prokurimit, z. A.P..

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Argumentimi i fondit limit dhe preventivi, janë hartuar nga Dega Teknike e UKK, me përbërje ing. B. A., ing. E. K. dhe ing. D. N., me shkresën nr. 1377/2, datë 10.06.2023.
Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 216, dt. 13.04.2023 "Sistemi i integruar i manualit të çmimeve në ndërtim".

Mbi vlerësimin e ofertave
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave, pa nr protokolli me datë 08.10.2024. Nisur nga Raporti Përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 10 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE "B." SHPK & "P. G." SHPK	10,910,480
2	OE "Al – S .C. 01" SHPK	12,952,580
3	**OE "U." SHPK**	**14,979,450**

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga KVO është mbajtur procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa nr protokolli, me datë 03.10.2024. Nga auditimi rezulton se në dosje administrohet Raporti Përmbledhës i Prokurimit me nr. 1377/18 prot., datë 05.11.2024, i miratuar nga TAK me shkresën nr. 1377/19 prot., datë 05.11.2024.
Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 1377/14, datë 21.10.2024.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	BOE "B." SHPK & "P. G." SHPK	10,910,480
2	OE "A. – S. C.01" SHPK	12,952,580

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

I. Nga verifikimi i procesverbalit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe verifikimi në SPE, u konstatua se këta OE janë skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

1. **OE "A. – S. C. .1" SHPK**

2.5 - OE "A. – S. C. 1" SHPK ka deklaruar se numri mesatar I punonjesve per peridhën Qeshor _Korrik është mesatarisht 33 punonjes, nga 40 që është kërkuar në DT.
2.3 OE "A. – S. C. 1" SHPK, si eksperiencë të ngjashme ka paraqitur kontrata vetëm me vetem situacionin perfundimtar dhe faturen tatimore dhe jo sipas DT.
2.3.2. OE "A. – S. C. 1" SHPK i mungojnë pikat e licencës NP-12 (Punime te inxjinerise se mjedisit) dhe NS-18 (Punime topogjeodezike).
2.10 OE "A. – S. C. 1" SHPK i mungon liçenca profesionale nga Qëndra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane".
2.6-2.7 OE "A. – S. 1" SHPK i mungon inxhinieri hidroteknik, inxhinieri i mjedisit, 1 punonjës hekurkthyes, 4 punonjës karpentierë, 2 punonjës hidraulikë, 3 punonjës betonues ,1 punonjës automakinist, 2 manovratorë buldozeristë, 3 punonjës manovratorë eskavatoristë si dhe 5 drejtues mjeti.
2.11 OE "A.- S. C. 1" SHPK i mungon Kamion vetshkarkues me kapicitet mbajtes mbi 20 ton, kamion me vinc, Rimorkiator per transport mjetesh te renda min 20 ton + Koke terheqese, Autobetoniere kantieri 2.5-3.5 m3, dumper kantieri deri ne 5 m3 ,1 eskavator me zinxhire,minieskavator , Autobot uji, makineri per shkulje pemesh pa demtuar , rrul gome cilinder asfalti min 7 ton ,rrul cilinder min 5 ton, Nofull hidraulike per prishje srukturash b/a, afaltoshtruese,Autobitumatrice,Makineri teknologjike thithese per pastrimin e mbetjeve kapacitetit 7-9 m3, betoniere, vibrator betoni, tokmak ngjeshes, tranxhe per prerje hekuri, matrapik ,gps ,saldatrice , kokore pune jo ne sasine qe kemi kerkuar ,fikse zjari dhe komplet I ndihmes se shpejt jo ne sasine e kerkuar
2.14. OE "A. – S.C.1" SHPK nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi/distributori për tombino/betoni.
Nga verifikimi I bërë nga grupi I auditimit në SPE, rezulton se konstatimet e KVO-së, janë të sakta.
Sa sipër, ky BOE është skualifikuar me të drejtë.

2. BOE "B." SHPK & "P. G." SHPK skualifikohet nga ky tender, pasi nga përllogaritja rezultoi se oferta është anomalisht të ulët dhe bazuar ne VKM nr. Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, i cili përcakton "*Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve*".
Sa sipër, ky BOE është skualifikuar me të drejtë.

II. Nga pjesëmarrësit është kualifikuar ofertuesi OE "U." SHPK, me vlerë të ofertës 14,979,450 lekë pa TVSH.

Nga verifikimi në SPE të ofertës ekonomike të këtij OE, konstatohet se në kapitullin "Ndërtimi i Veprave të Artit+Kanalizime" janë shtuar 4 zëra pune që nuk janë në preventivin e hedhur në sistem, si dhe është ndryshuar volumi i 2 zërave punimesh. Sa sipër, OE fitues nuk i është përmbajtur dokumenteve të tenderit të hedhur në SPE dhe kualifikimi nga KV-ja është i padrejtë.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit fizik të paraqitur nga OE fitues "U." SHPK në SPE, rezultoi se:
- Asfaltoshtruesja e marrë me qera me kontratën nr. 1551 rep, nr. 648 kol, datë 20.09.2024 nuk ka asnjë dokument;
- Autobitumatriçja e marrë me qera me kontratën nr. 1551 rep, nr. 648 kol, datë 20.09.2024; nuk ka sigurimin dhe kontrollin teknik të mjetit, siç kërkohet në DT
- Autoboti i paraqitur (në pronësi) është autobot për transportin e mallrave të rrezikshme nga të tretë;
- Ruli gomë cilindër asfalti min 7 ton, i paraqitur fizikisht, nuk e tregon peshën.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".
Me skualifikimin e OE "U." SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, pika 1/b, sipas të cilit "*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...*
b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme", KVO-ja duhet të bënte propozimin tek TAK për anulimin e procedurës së prokurimit. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 17,975,340 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së E., P., R. Z. dhe I. D..
Nga auditimi i dosjes të prokurimit, si dhe dosjes fizike të OE fitues "U." SHPK, rezultoi se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të PP"*, i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"*, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit znj. E. D..

13. "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku", Bashkia Kamëz

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku", Bashkia Kamëz, Nr. REF-07666, datë 05.31-2024.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 1326 prot., datë 30.05.2024	1. Urdhër Prokurimi Nr. 1326 prot., datë 30.05.2024 Njësia e Prokurimit A. X., P. përgjegjës, Jurist,	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1326/1, datë 30.05.2024, 1. B. A., Kryetar 2. E. P.
2. Lloji i Procedurës –		

"E hapur - Punë"	S. P., ekonomist, E. K., Inxhinier, Specialist i fushës Me Urdhrin nr. 1326/8, datë 02.08.2024, NJP bëhet: I. D., person përgjegjës, juriste H. B., ekonomist A. P., ing mjedisi, specialist i fushës	3. E. Ç., zëvendësuar me z. D. C., me urdhrin nr. 1326/9, datë 02.08.2024
5. Fondi Limit (pa TVSH) 63,014,765.5 lekë	6. Oferta fituese (pa TVSH) OE "N. S." SHPK me ofertë 50,819,479 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 1326/14 prot, dt. 30.09.2024 me afat 4 muaj nga data e fillimit të punimeve.	7. Diferenca me fondin limit 12,195,286 lekë, ose 19.35 %
8. Data e hapjes së tenderit Datë 18.06.2024	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 10 OE/BOE b) S'kualifikuar 7 BOE, c) Kualifikuar 3 OE/BOE
11. Ankimime; dt. 15.07.2024 nga "A. K." SHPK	12. Përgjigje Ankesës - AK nr. 1326/6, datë 19.07.2024	13. Përgjigje Ankesës - KPP mr. 1919/8 prot, datë 28.08.2024

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E hapur", me vlerë 63,014,765.5 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i UK Kamëz, sipas Vendimit nr. 8, datë 01.12.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve "Për planin ekonomik-financiar të vitit 2024 për UK Kamëz".

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një shkresë e AKUK me nr. 1244, datë 24.04.2024 "Detajimi i buxhetit për shpenzime kapitale 2024-2026" në të cilën përcaktohet fondi për realizimin e këtij objekti. Në dosje administrohet gjithashtu shkresa me nr. 1233, datë 16.05.2024, nënshkruar nga drejtori i Departamentit teknik z. B.H "Kërkesë për prokurimin e objektit "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga imbianti i Bovillës –D. M.", Bashkia Kamëz, sipas të cilës ky prokurim duhet të kryhet, bazuar në shkresën nr. 1244 prot., datë 24.04.2024 "Dërgohet buxheti për shpenzimet kapitale 2024-2026" të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga studio e projektimit "A. 2." SHPK në vitin 2023. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 120 ditë.
- Për këtë objekt, administrohet një shkresë nga sipërmarrësi i punimeve me nr. 21 prot., datë 16.09.2024, ku kërkohet pajisja me leje ndërtimi të objektit. Në dosjen teknike të zbatimit të objektit ndodhet një shkresë e Njësisë Administrative Bathore, ku citohen objektet që nuk kërkojnë leje ndërtimi/infrastrukturore. Në dosje administrohet deklaratë për kryerje punimesh me nr. 7598/1 prot., datë 23.12.2024 (pas afatit të fillimit të punimeve) dhe jo leje ndërtimi/infrastrukturore e këtij objekti, në mospërputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor, z. E.S. dhe personi përgjegjës i prokurimit z. A.XH..

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, ngritur me Urdhër Prokurimi Nr. 1326 prot., datë 06.06.2024, është mbajtur procesverbal pa nr prot, pa datë dhe Njoftimi për ndryshimin e dokumenteve të tenderit me nr. 1326/4 prot., datë 27.06.2024, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*
Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.
Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Është kërkuar që OE të ketë pikën e licencës NS-18 A "Punime topogjeodezike". Ky kriter, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
2. Në pikën 2.3.1 është kërkuar që për të vërtetuar eksperiencën e ngjashme, në rast se punimet jane kryer me ente publike, Autoritetiti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- *Situacionin përfundimtar të objektit*
- *Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- *Aktin e Kolaudimit të objektit*
- *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- *Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

Ky kriter është i paargumentuar teknikisht pasi edhe nga APP (Koordinimi.app.gov.al) është rekomanduar që këto dokumente të jenë vetëm për punimet e kryera me sektorin privat, ndërsa për ato me sektorin publik, do të mjaftonin Kontrata e Sipërmarrjes, Situacioni përfundimtar i objektit dhe Formulari i Vlerësimit nga Investitori.
3- Është kërkuar që OE të ketë pikat e licencës Kategoria NS-1 (Punime për prishjen e ndërtimeve) – Klasifikimi A dhe Kategoria NS-18 (Punime topogjeodezike) – Klasifikimi A. Ky kriter, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
4. Në pikën 2.3.3 është kërkuar që Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane", sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009

"Për disa ndyshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
5. Në pikën 2.3.5 është kërkuar që OE pjesëmarrës të disponojnë 45 punonjës në tre muajt e fundit. Në dosjen e prokurimit dhe procesverbalin e argumentimit të fondit limit, nuk disponohet një analizë e detajuar, e bazuar në orët e punës së punëtorisë (sipas zërave të punimeve) dhe grafikut të punimeve. Për pasojë, ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht.
Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën**.**
6. Në pikën 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje (ndërmjet të tjerëve **2 teknikë ndërtimi**, **1 specialist elektrik**, **2** Saldatorë, **2** hekurkthyes, **2** karpentierë, **2 hidroizolues**, **2 muratorë/suvatues, 2** betonues, **1 (një) specialist ekspert të pajisur me "Çertifikatë për Vlerësimin e ndikimit në mjedis** dhe **1 (një) specialist ekspert zjarrfikës**. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, për punonjësit e cituar (bolduar) nuk është në përpjestim me natyrën/volumin e objektit që prokurohet.
7. Në pikën 2.3.7. është kërkuar që "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë **Rrul me kompresor, Paisje per hekurthyes Motogjenerator, Kokore, Komplet i ndihmës së shpejtë, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, Fikëse zjarri të lëvizshme.** Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
8. Në shënimet në fund të KVK-ve është cituar që "...Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze" Ky shënim, i cili është edhe kriter kualifikimi/skualifikimi, është i paargumentuar teknikisht dhe në kundërshtim me Dokumentet e Tenderit, të cilat në pikën 4.7, përcaktojnë vetëm gjuhën shqipe si gjuhë të ofertës.

Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 dhe nenin 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit (Njësia e Prokurimit) A.XH., S.P. dhe E.S..

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Argumentimi i fondit limit dhe preventivi, janë hartuar nga projektuesi në datën 12.12.2023.
Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 216, dt. 13.04.2023 "Sistemi i integruar i manualit të çmimeve në ndërtim".
Në preventiv ka 24 zëra jashtë listës së manualeve të ndërtimit me analizë çmimi, hartuar nga projektuesi, të cilat administrohen në dosjen teknike të zbatimit. Këto analiza nuk janë të shoqëruar plotësisht me testimin e tregut për secilin material të përdorur për hartimin e çmimeve.
Nga verifikimi i këtyre analizave, u konstatua se në disa zëra pune nuk janë respektuar sasitë e nënzërave të analizës së kostos dhe njësitë e matjes.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi projektuesi "A.2E" SHPK.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje nuk administrohet procesverbali për hapjen e ofertave dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 10 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE "A. K." SHPK	45,347,759
2	OE "B-I" SHPK	55,269,440
3	BOE "B" SHPK & "Sh-Al" SHPK	53,472,747
4	BOE "D. C." SHPK & "A. Ko." SHPK	40,561,837
5	**OE "N.S." SHPK**	**50,819,479**
6	OE "K." SHPK	52,319,674
7	OE "L. VII" SHPK	57,787,863
8	OE "L. Ko." SHPK	56,087,596
9	OE "N." SHPK	49,696,512
10	OE "Sh." SHPK	63,009,117

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet Raporti Përmbledhës i Prokurimit. Nga KVO është mbajtur procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa nr protokolli, me datë 03.07.2024. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi TAK dhe përgjegjësi i prokurimeve.
Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 1326/2, datë 20.09.2024.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE "A. K." SHPK	45,347,759
2	BOE "B" SHPK & "Sh-Al" SHPK	53,472,747
3	BOE "D. C." SHPK & "A. Ko." SHPK	40,561,837
4	OE "K." SHPK	52,319,674
5	OE "L. K." SHPK	56,087,596
6	OE "N." SHPK	49,696,512
7	OE "Sh." SHPK	63,009,117

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

I. Nga verifikimi i procesverbalit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe verifikimi në SPE, u konstatua se këta OE janë skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

2. **BOE "D. C." SHPK & "A. Ko." SHPK**

- Operatori ekonomik A.K. SHPK nuk e permbush kriterin 2.2.3 te kritereve te vecanta per kualifikim pas ne formularin e vetedeklarimit shtojca 8 ka deklaruar qe ka shlyer detyrimet per taksat vendore per vitin 2022, ne kriteret e vecanta pika 2.2.3 jane kerkuar taksat vendore te vitit 2023.
- Operatori ekonomik D.C. nuk ka deklaruar ne formularin e vetedeklarimit qe ka shlyer taksat vendore per vitin 2023 si dhe nuk ka paraqitur asnje dokument per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri.

Nga verifikimi I bërë nga grupi i auditimit në SPE, rezulton se konstatimet e KVO-së, janë të sakta.
- Kriteri 2.3.5 i kapacitetit teknik i kritereve te veçanta për kualifikim nuk përmbushet pasi per mallin Tuba e Rakorderi Ujesjellesi PE-100 RC d=500 mm, t=45.4, PN 16 mungon Çertifikata ISO 9001 *(Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)*/ ekuivalente dhe e vlefshme e prodhuesit FERPLAST.
- Kriteri 2.3.5 i kapacitetit teknik i kritereve te veçanta për kualifikim nuk përmbushet pasi per mallin Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400 Çertifikata ISO 9001*(Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)*/ ekuivalente dhe e vlefshme e prodhuesit ITAP S.P.A i ka mbaruar vlefshmeria me datë 04-06-2024 datë përpara hapjes së ofertave në procedurën e prokurimit.
Nga verifikimi I bërë nga grupi I auditimit në SPE, rezulton se Çertifikata ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme e prodhuesit FERPLAST është paraqitur ndërsa Çertifikatës ISO 9001 e prodhuesit ITAP SPA i ka mbaruar vlefshmëria në datë 04-06-2024 ose 14 ditë para hapjes së ofertës.

2.3 Kapaciteti teknik:

- Kriteri 2.3.1 i kapacitetit teknik i kritereve te vecanta per kualifikim nuk permbushet nga operatori ekonomik "D.C." SHPK, pasi per permbushjen e ketij kriteri eshte paraqitur kontrate e ngjashme lidhur nga bashkim operatoresh por nuk eshte paraqitur kontrata e bashkepunimit midis operatoreve. *(Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre).*

Nga verifikimi I bërë nga grupi I auditimit në SPE, rezulton se objekti I paraqitur si eksperiencë e ngjashme nga OE "D.C." SHPK është "Ndërtim Ujësjëllësi Dritaj-Fanje-Karkavec", Bashkia Prrenjas. Marrëveshjen e bërë me OE tjetër të BOE, shoqërinë "A." SHPK, e ka të përfshirë në kontratën e firmosur me A.K., Bashkia Prrenjas, në të cilën citohet që marrëveshja e bashkëpunimit të përkohshëm për krijimin e BOE-s është bërë para noterit me nr. 670 kol, datë 22.04.2017. Pra në kontratën e punëve publike për këtë objekt, dalin qartë të dhënat që kërkohen në DT (eksperienca e ngjashme) dhe ky devijim mund të quhej si devijim i vogël, në zbatim të nenit 92, pika 3 të LPP-së, sipas të cilës "*...Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit*."

Sa sipër, ky BOE është skualifikuar me të drejtë, por jo për arsyet që ka cituar KVO-ja.

2. OE "A. K." SHPK skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshtëshënuara:

Kriteri 2.3.5 kapaciteti teknik I kritereve te veçanta per kualifikim per mallin Saraçineska Gize me fllanxha, Pn deri 16 bar, Ø400 nuk plotesohet nga operatori ekonomik A. K. SHPK per arsyet e poshteshenuara:
- Mungon autorizimi/marreveshja qe tregon lidhjen midis distributorit dhe prodhuesit.
- Mungon katalogu/fragmente te katalogut qe te tregoje dhe te specifikoje mallin e mesiperm.
- Çertifikata ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ ekuivalente dhe e vlefshme e prodhuesit eshte ne gjuhe te huaj. (*Referuar kritereve per kualifikim të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do*

të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.)

- Shenim: Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë ***të detyrueshme për t'u përmbushur*** nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet ***të refuzohen*** si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

Nga auditimi të dosjes seë prokurimit, konstatohet se ky OE ka bërë ankesë pranë AK–së dhe KPP-së në datën 15.07.2024, në të cilën ka kundërshtua vendimin e KVO-së për skualifikimin e tij. Titullari i AK z. SH.L. ka nxjerrë Urdhrin për pezullimin e procedurës së prokurimit me nr. 1326/4 prot., datë 16.07.2024, duke ngritur Komisionin e Shqyrtimit të Ankesës me përbërje H.B., A.C. dhe E.N..

- Me shkresën nr. 1326/6 prot., datë 19.07.2024, KSHA ka marrë në shqyrtim ankesën dhe ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE "A. K." SHPK.
- Gjithashtu, me shkresën nr. 1919/8, datë 27.08.2024, KPP-ja ka përcjellë pranë AK UK Kamëz, vendimin e saj me Nr. 1126/2024, datë 28.08.2024, sipas të cilit ka vendosur të mos pranojë ankesën e OE "A. K." SHPK dhe të lejojë AK për të vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. **OE "N" SHPK skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshteshenuara:**

Kriteri 2.3.9 I kapacitetit teknik per kriteret e vecanta te kualifikimit nuk permbushet nga ana e Operatorit ekonomik "N" SHPK pas nuk ka deklaruar ne Formularin e vetedeklarimit disponimin e paisjes *"Paisje elektronike per matjen e presionit te uji"*.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar 1 *(një)* s**pecialist ekspert** zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, i cili nëse nuk figuron në listëpagesa të shoqërisë mund të jetë ***i kontraktuar***, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë të vlefshme pune dhe çertifikatë përkatëse të lëshuar nga Drejtoria MZSH/ekuivalente.

- Kriteri 2.3.7 pika e) i kapacitetit teknik per kriteret e vecanta te kualifikimit nuk permbushet nga ana e Operatorit ekonomik "N" SHPK pasi nuk eshte deklaruar ne formularin e vetedeklarimit dhe

nuk ka paraqitur asnje dokumet tjeter per permbushjen e ketij kriteri. 1 *(një)* s**pecialist ekspert** zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin
- Kriteri 2.3.1 i kapacitetit teknik i kritereve te vecanta per kualifikim nuk permbushet nga operatori ekonomik "N" SHPK pasi asnje nga kontratat e ngjashme te paraqitura nuk konsiderohen te tilla (mungon elementi natyre e ngjashme).
Shenim: Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.
Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.
Nga verifikimi I bërë nga grupi I auditimit në SPE, rezulton se ky OE është skualifikuar me të drejtë, për arsyet që ka cituar KVO-ja.

II. Nga pjesëmarrësit janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	**OE "N.S." SHPK**	**50,819,479**
2	OE "B-I" SHPK	55,269,440
7	OE "L. VII" SHPK	57,787,863

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues "N.S." SHPK në SPE, rezultoi se:
- Pajisja e paraqitur nga OE mbështetës "G.C." SHPK "Aparaturë për bashkimin tubacionesh "kokë më kokë"", me faturë doganore dt 09.03.2003, nuk del të jetë siç është kërkuar në DT ("kokë më kokë").
- Nuk ka deklaruar në formularin nr. 8 që nuk ka detyrime për taksat vendore 2023, siç është kërkuar në pikën 2.2.3 të KVK.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".
Me skualifikimin e OE "N.S." SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, KVO nuk duhet ta kishte shpallur fitues këtë OE dhe të bënte propozimin tek TAK

për OE të rradhës. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 60,983,374.8 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, B.H, Kryetar, E.P. dhe D.C..

Nga auditimi i dosjes të prokurimit, si dhe dosjes fizike të OE fitues "N.S." SHPK, rezultoi se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të PP"*, i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"*, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit z. A.XH..

14. "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës Frutikulturës, Valias i Vjetër", Bashkia Kamëz

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës Frutikulturës, Valias i Vjetër", Bashkia Kamëz, Nr. REF-09519, datë 06-14-2024.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 1408 prot., datë 06.06.2024
2. Lloji i Procedurës –
"E hapur - Punë"</td><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 1408 prot., datë 06.06.2024
Njësia e Prokurimit
E. Ç., Personi përgjegjës, Jurist, ndryshuar me Urdhrin mr nr. 1889 prot., datë 02.08.2024 me znj O.A.
B.H, Inxhinier, Specialist i fushës
E.P., ekonomist</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 1408/1, datë 06.06.2024,
1. E.S., Kryetar
2. S.P.
3. A.XH.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSH)
508,336,290 lekë</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSH)
BOE "E." SHPK & "2." SHPK
me ofertë 495,914,580 lekë pa TVSH, sipas kontratës nr. 1408/1 prot, dt. 08.08.2024 me afat 12 muaj nga data e fillimit të punimeve.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
12,421,710 lekë, ose 2.44 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 11.07.2024</td><td>9. Burimi Financimit
Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE
b) S'kualifikuar 4 BOE,
c) Kualifikuar 3 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës
nuk ka</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E hapur", me vlerë 508,336,290 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i UK Kamëz, sipas Vendimit nr. 8, datë 01.12.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve "Për planin ekonomik-financiar të vitit 2024 për UK Kamëz".

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një shkresë e nënshkruar nga drejtori i Departamentit teknik z. B.H. "Kërkesë për prokurimin e objektit "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës Frutikulturës, Valias i Vjetër", Bashkia Kamëz, sipas të cilës ky prokurim duhet të kryhet, bazuar në shkresën nr. 1492 prot., datë 20.05.2024 "Dërgohet buxheti për shpenzimet kapitale 2024-2026" të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve.

Mbi projektpreventivin e zbatimit:

- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga studio e projektimit "E." SHPK në Qershor 2020. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 365 ditë.
- Për këtë objekt, administrohet në dosje leje ndërtimi/infrastrukturore, me nr. 7084, dt. 30.08.2024. Ky veprim është në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11/1, "Punime që duhet t'u kërkohet leja e ndërtimit".

Për këtë objekt administrohet Oponenca Teknike me nr. 1591/2 prot., datë 15.11.2023, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit, ngritur me Urdhër Prokurimi Nr. 1408 prot., datë 06.06.2024, është mbajtur procesverbal pa nr prot, pa datë dhe Njoftimi për ndryshimin e dokumenteve të tenderit me nr. 1408/4 prot., datë 27.06.2024, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 2.3.4 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje (ndërmjet të tjerëve) 1 inxhinier elektrik, 1 inxhinier elektronik, një inxhinier mjedisi, 2 teknikë ndërtimi, 2 Saldatorë, 1 pllakashtrues, 1 (një) mjek dhe 1 (një) specialist ekspert zjarrfikës. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, për punonjësit e cituar nuk është në përpjestim me natyrën e objektin që prokurohet.

2- Është kërkuar që OE të ketë pikën e licencës Kategoria NP-12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit) – Klasifikimi A. Ky kriter, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
3- Është kërkuar që OE të ketë pikën e licencës NP-7 (Ujësjellësa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje) – Klasifikimi E. Ky kriter, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me volumin e punimeve në objektin që prokurohet, pasi vlera e objektit është më e madhe se 400 mln lekë dhe duhet të ishte kërkuar klasifikimi F.
4- Në pikën 2.3.7. është kërkuar që "Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë Kamiona vetshkarkues me kapaciteti mbajtës mbi **20 ton** per secilin kamion, Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës minimumi **7 ton,** jo më pak se **2 copë,** Autobetoniere jo më pak se **2 copë, Rimorkiator për transportin e makinerive, Matës largësie / Instrument për Topogjeodezim, Motogjenerator, Kokore, Prozhektorë ndriçimi natën, Komplet i ndihmës së shpejtë, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra.** Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve në objektin që prokurohet.
5. Në shënimet në fund të KVK-ve është cituar që "...Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze" Ky shënim, i cili është edhe kriter kualifikimi/skualifikimi, është i paargumentuar teknikisht dhe në kundërshtim me Dokumentet e Tenderit, të cilat në pikën 4.7, përcaktojnë vetëm gjuhën shqipe si gjuhë të ofertës.
6. Në pikën 2.3.4 është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencë të vlefshme - Kodi III.2.B - Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ndryshme inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme (mbetjet që dalin nga punimet), të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Ky kriter, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.
7. Në pikën 2.3.6 është kërkuar që OE pjesëmarrës të disponojnë 90 punonjës në tre muajt e fundit.
Në dosjen e prokurimit dhe procesverbalin e argumentimit të fondit limit, nuk disponohet një analizë e detajuar, e bazuar në orët e punës së punëtorisë (sipas zërave të punimeve) dhe grafikut të punimeve. Për pasojë, ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht.
Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet dhe nuk kanë nxitur konkurrencën**.**
Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit E.Ç., B.H dhe E.P..

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike
Argumentimi i fondit limit dhe preventivi, janë hartuar nga projektuesi në datën 17.01.2024.
Nga verifikimi me zgjedhje sipas vlerave më të larta, i disa prej zërave të preventivit të ofertës (vetëm ato me nr analize sipas manualeve), rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 216, dt. 13.04.2023 "Sistemi i integruar i manualit të çmimeve në ndërtim".
Në preventiv ka 76 zëra jashtë listës së manualeve të ndërtimit me analizë çmimi, të cilat nuk administrohen në dosjen e prokurimit. Pas kërkesës së grupit të auditimit, u dorëzuan analizat e

çmimeve të hartuara nga projektuesi. Këto analiza nuk janë të shoqëruar me testimin e tregut për secilin material të përdorur për hartimin e çmimeve.
Nga verifikimi i këtyre analizave, u konstatua:
- Analiza An 37 e çmimit të zërit "Tub HDPE SN8 d=250 mm" ka nxjerrë çmimin e këtij zëri 2473 lekë/ml (200 lekë/ml më shumë se zëri "FV tub i brinjëzuar HDPE SN8 me d=315mm"). Nga verifikimi i nënzërit material të kostos, rezultoi se çmimi i tubit me d=250 mm është marrë 1710 lekë/ml, ndërkohë që në manualin në fuqi, çmimi i tubit me d=315 mm është 1100 lekë/ml. Nëse do të marrim këtë çmim materiali dhe të bëjmë rillogaritjen e çmimit të zërit të punës "Tub HDPE SN8 d=250 mm", ky zë pune do të kishte çmimin 1738 lekë/ml, ose 735 lekë/ml më pak se ai i marrë në preventivin e fondit limit. Nga rillogaritja, vlera e këtij zëri pune është rritur me 8,587,574 lekë/ml.
- Analiza An 38 e çmimit të zërit "Puseta polipropileni (me kapak gize D=10) thellësia 1.5 m – 2 m", i cili në preventivin e fondit limit ka vlerën 82,864,610 lekë pa TVSH, ose 16.3% të vlerës totale të preventivit, nuk është i shoqëruar me testim tregu të materialit, por gjithashtu nuk ka as detaje në projektin e hedhur në SPE. Sasia e orëve të punës për realizimin e këtij zëri (sipas analizës, puseta është e përgatitur), është marrë në mënyrë të paargumentuar 8 op/copë, kur për ndërtimin e një pusete prej betoni me h 2.5-3 m, duhen 8 op/copë.
- Analiza An 42 e çmimit të zërit "Tub PE d=400 mm, Pn16" ka nxjerrë çmimin e këtij zëri 16593 lekë/ml, duke e marrë çmimin e tubit 13442 lekë/ml, ndërkohë që në manualin në fuqi çmimi i tubit me d=400 mm dhe Pn20 është 11,950 lekë/ml. Nëse do të marrim këtë çmim materiali dhe të bëjmë rillogaritjen e çmimit të zërit të punës "Tub PE d=400 mm, Pn16", ky zë pune do të kishte çmimin 1738 lekë/ml, ose 735 lekë/ml më pak se ai i marrë në preventivin e fondit limit. Nga rillogaritja, vlera e këtij zëri pune është rritur me 1,321,709 lekë/ml.

Sa sipër, pa marrë në konsideratë zërat e punës për të cilat nuk ka referenca krahasimi në manualet në fuqi, rezulton të jetë rritur fondi limit në vlerën **9,909,283 lekë pa TVSH**, duke ngarkuar me përgjegjësi projektuesin "E." SHPK.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje nuk administrohet procesverbali për hapjen e ofertave dhe procesverbali për vlerësimin e ofertave. Nisur nga Raporti Përmbledhës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, si dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 7 OE, me ofertat e mëposhtme:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE "A. Kon." SHPK	426,562,584
2	BOE "L. K." SHPK & V.Ko." SHPK	431,086,304
3	**BOE "E" SHPK &"2." SHPK**	**495,914,580**
4	OE "A. K." SHPK	505,627,600
5	OE "K.Ko." SHPK	501,529,905
6	OE "S." SHPK	499,799,549
7	OE "Sh.I." SHPK	507,666,222

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se në dosje nuk administrohet Raporti Përmbledhës i Prokurimit. Nga KVO është mbajtur procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave pa nr protokolli, me datë 23.07.2024. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi TAK dhe përgjegjësi i prokurimeve.

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 1408/9, datë 26.07.2024.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	OE “A. Kon.” SHPK	426,562,584
2	BOE "L. K." SHPK & V.Ko.” SHPK	431,086,304
3	4OE “A. K.” SHPK	505,627,600
4	OE “K.Ko.” SHPK	501,529,905

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

I. Nga verifikimi i procesverbalit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe verifikimi në SPE, u konstatua se janë skualifikuar OE për arsyet e mëposhtme:

1. OE A. KON. SHPK skualifikohet nga ky tender për arsyet e poshtëshënuara:

1. Për kapacitetin teknik:

2.3.1 **Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- **Tuba HDPE/ PN 10** ***sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike***
- **Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8** ***sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike***

- Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE shifet që nuk keni paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare pasi certifikata e konformitetit e paraqitur ka përfunduar afatin e saj me datë 19 Nëntor te vitit 2023, si dhe ky dokumentacion për plotësimin e kësaj pike është në gjuhë të huaj në kundërshtim me kriterin pikën 2.7 të dokumentave standarte të tenderit ku parashikohet si me poshtë vijon :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip **X** **Anglisht** □

Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.

Paraqitja e dokumetacionit në gjuhë të huaj e ben te pamundur identifikimin e plotësimit të kriterit mbi dëshmi të testeve zyrtare sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.
-Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE, grupi I auditimit konstaton se ky dokumentacion është I rregullt, pasi vlefshmëria e certifikatës së akreditimit të “NPT Ferplast” është deri në datën 11.04.2027 dhe data 05.10.2023 (dhe jo data 19 Nëntor 2023) është afati për konsultime. Gjithashtu, katalogët janë në gjuhë të huaj, por është e përcaktuar edhe në KVK që katalogët mund të pranohen në gjuhë të huaj.

2.3.8 **Makineri, Pajisje)**

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet dhe pajisjet **(sipas tabelës)** të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ mjetit/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamiona vetshkarkues me kapaciteti mbajtës mbi 20 ton per secilin kamion	*jo më pak se* **2 copë**
2.	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 -20 ton	*jo më pak se* **3 copë**
3.	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5 -10 ton	*jo më pak se* **3 copë**
4.	Kamion/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton	*jo më pak se* **3 copë**
5.	Kamion me Vinç me kapacitet mbajtës minimumi 7 ton	*jo më pak se* **2 copë**

- Ky kusht nuk permbushet nga operatori ekonomik "A. KON." pasi nga 3(tre) kamion vetshkarkues 10-20 ton ka paraqitur vetëm 2(dy). Operatori ka deklaruar 4(katër) kamiona vetshkarkues me kapacitet 5-10 ton nga 3(tre) te kerkuar po kjo nuk ploteson tonazhin e kerkuar nga AK.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", , si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vendosi te refuzoje oferten e OE "A. KON." SHPK, për mospërmbushje të kritereve të veçanta kualifikuese.

- Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE, grupi i auditimit konstaton se mangësia e gjetur nga KVO-ja qëndron, pasi OE ka deklaruar që ka vetëm dy mjete me tonazh 10-20 ton, nga tre të kërkuara, duke deklaruar 4 mjete me tonazh 5-10 ton, nga tre të kërkuara. Këtë devijim, KVO-ja nuk e ka konsideruar devijim të vogël, edhe pse diferenca e ofertave ekonomike, ndërmjet OE fitues dhe këtij OE është 69,351,996 lekë pa TVSH.

2. BOE "L. K." SHPK & "V.Ko." SHPK skualifikohet nga ky tender per arsyet e poshteshenuara:

2.3.5 **Për Listën e mallrave/ materialeve të përcaktuara në Preventivin objekt prokurimi, listën si më poshtë:**

- **Tuba HDPE/ PN 10** ***sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt – preventivin dhe Specifikimeve teknike***
- **Tuba të brinjëzuar HDPE SN 8** ***sipas dimensioneve të kërkuara në Projekt - preventivin dhe Specifikimeve teknike***

<u>Operatori ekonomik duhet të paraqesë:</u>

1. **Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (*ose ekuivalenti i tij/saj*) të zyrtarizuar**, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të proçedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
2. **Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

<u>Shënim</u>: *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **dëshmi të testimeve zyrtare të kryera**, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara

Ky kusht nuk përmbushet nga operatori ekonomik BOE L. K. SHPK & V.KO. SHPK pasi mungojnë:
- Operatori ekonomik V.KO. SHPK nuk ka paraqitur autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues per tubat:

40 An40 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=l40mm Pn 10 ml 1615
An41 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=225mm Pn 10 ml 3610

të cilat do te realizohen nga ky operator sipas marreveshjes se bashkepunimit.
- Mungon katalogu ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/vet të tubave të mësipërm.
- Mungojnë dëshmitë e testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (tubat e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.
- Operatori ekonomik L. K. nuk ka paraqitur katalog ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/vet të tubave

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogel se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogel se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.
Nuk përmbush kriteret për kapacitetin teknik, për përvojën në realizimin e punëve të ngjashme, për objektin "Rrjeti shperndares I furnizimit me uje dhe te KUZ te zones se Fruti Kultures, Valias I Vjetër, Bashkia Kamëz", pasi referuar kritereve të vendosura në DST, për të konsideruar një ofertë të kualifikueshme, duhen përmbushur një nga dy kushtet e mëposhtme: a) Punë të Ngjashme për Një Objekt të Vetëm: Vlera e kontratës së realizuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet). b) Punë të Ngjashme me Shumë Kontrata: Vlera monetare totale e punëve të kryera nga operatori ekonomik gjatë pesë viteve të fundit duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Konkretisht Mosplotësimi i Kushteve të Sipërpërmendura per operatorin ekonomik "L. K." SHPK pasi kontratat e paraqitura nga ky opertor **nuk arrijnë vlerën e kërkuar.** Referuar përcaktimeve te Legjislacionit për Prokurimin Publik dhe dokumenteve të tenderit, si dhe konceptit të përgjithshëm të prokurimeve, objektet/kontratat e ngjashme, operatoret ekonomikë duhet te përmbushin këto elemente:
• Elementi Kohë: Kontratat duhet të jenë përfunduar brenda pesë viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.
• Elementi Vlerë: Madhësia e kontratave duhet të përmbushë kërkesën e autoritetit kontraktor, qoftë 50% apo 200% të vlerës së kontratës që prokurohet.

• Elementi Natyrë e Ngjashme: Kontratat duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet. Përmbushja e këtyre kritereve është e domosdoshme për të konsideruar përvojën e një operatori ekonomik si të vlefshme.
Mungesa e përmbushjes së një prej këtyre elementëve (kohë, vlerë, natyrë e ngjashme) e bën të pavlefshme përvojën e paraqitur nga kandidatët ofertues. Sa me siper, Operatori Ekonomik: "**L. K." SHPK, skualifikohet nga ky tender**. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme."

- Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE, grupi i auditimit konstaton se mangësitë e gjetura nga KVO-ja përgjithësisht qëndrojnë dhe skualifikimi i këtij BOE është i drejtë, por jo për të gjitha arsyet e cituara nga KVO-ja.

II. Nga pjesëmarrësit janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Nr.	OE pjesëmarrës	Vlera e Ofertës
1	**OE "E" SHPK & "2T" SHPK**	**495,914,580**
2	OE "S." SHPK	499,799,549
3	OE "Sh.I." SHPK	507,666,222

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE fitues "E" SHPK & "2." SHPK në SPE, rezultoi se:
- Testimet e kryera nga prodhuesi i tubave "IGS Resources" nuk janë në gjuhën e kontratës të përcaktuar në DT;
- Marrëveshja e bashkëpunimit e OE "E" SHPK me shoqërinë "R.Al." SPA, për kryerjen e punëve në objektin "Rehabilitimi i rrugës Elbasan – Banjë, Loti 3" dhe Marrëveshja e bashkëpunimit e OE "E" SHPK me shoqërinë "F." SHPK, për kryerjen e punëve në objektin "Rivitalizimi i sheshit para Portit Durrës", nuk janë shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE (kërkesë në DT, pika.2.3.1).
Për shkak të kësaj mangësie, KVO nuk mund të gjykojë nëse këto objekte mund të konsiderohen si eksperiencë e ngjashme, pasi edhe emërtimi i tyre nuk është i ngjashëm me objektin që prokurohet. Objektet e tjerat të paraqitura, nuk e plotësojnë vlerën prej 114,884,001 lekë në një objekt të vetëm, ose 457,502,661 lekë në të gjitha objektet, që duhet të plotësojë ky OE, si eksperiencë e ngjashme.
- OE " E." SHPK ka paraqitur dy manovratorë (L.D. dhe Q.B.), nga 7 manovratorë të kërkuar gjithsej. Nisur nga përqindja e punëve të marra përsipër, ky OE duhet të kishte paraqitur 45.2 % të manovratorëve, ose 3 manovratorë.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Me skualifikimin e BOE "E" SHPK & "2." SHPK, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", Neni 92 dhe 97, KVO nuk duhet ta kishte shpallur fitues këtë BOE dhe të

bënte propozimin tek TAK për OE të rradhës. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 595,097,496 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së, E.S., S.P. e A.XH..

Nga auditimi i dosjes të prokurimit, si dhe dosjes fizike të BOE fitues BOE "E" SHPK & "2T" SHPK, rezultoi se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të PP"*, i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *"Për arkivat"*, Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit O.A.

15 "Blerje matësa uji dhe kaseta", UK Kamëz

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje matësa uji dhe kaseta", UK Kamëz", Nr. REF-53021, datë 07-01-2025.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi Nr. 418/5, datë 28.02.2025</td><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 418/5, datë 28.02.2025
Njësia e Prokurimit
- E.D., Personi përgjegjës,
- E.P.j, Anëtar
- B.Hj, Anëtar
2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 418/1, datë 26.02.2025
- D.C.
- K.D.
- L.B.</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 418/6 prot, datë 28.02.2025
1. I.D., Kryetar
2. S.B., anëtar
3. A.P., anëtar</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
"E hapur e thjeshtuar, mallra"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
5,000,000 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE "Al-C" SHPK me ofertë 4,396,295 lekë pa TVSH,sipas kontratës nr. 418/13, datë 05.05.2025, me afat 20 ditë.</td><td>7. Diferenca me fondin limit, 603,705 lekë pa TVSH, ose 12.07%</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 17.03.2025</td><td>9. Burimi Financimit
Nga Buxheti i UK Kamëz vetëfinancim)</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 2 OE
b) S'kualifikuar 0 OE,
c) Kualifikuar 2 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës
nuk ka</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur e thjeshtuar, mallra", me vlerë 5,000,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 418 prot., datë 26.02.2025 për prokurimin e blerjes së matësave të ujit dhe kasetave. Relacioni teknik për këtë objekt prokurimi, me nr. 418/3 prot., datë 27.02.2025, i hartuar nga ing. D.C., K.D. dhe L.B., citon nevojën për matësa dhe kaseta UK Kamëz, duke theksuar nevojat e përditshme për kryerjen e punimeve, sidhe përmirësimin e kapaciteteve për matjen dhe kontrollin e sasisë së ujit të konsumuar nga qytetarët dhe subjektet që përdorin ujin e administruar nga UK Kamëz.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit me nr 418/1 prot., datë 06.02.2025, i mbajtur nga grupi i punës me përbërje z. D.C., Kryetar, K.D. dhe L.B., anëtarë.

Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimeve të materialeve me studim tregu, janë kërkuar tre oferta dhe është bërë mesatarja e tyre, duke nxjerrë një vlerë prej 5,000,000 lekë. Nga verifikimi i studimit të tregut konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë "Ë.10." SHPK, "A.Ka" PF dhe "E." SHPK. Nga verifikimi në website-n e QKB, rezulton se këto shoqëri kanë si objekt të veprimtarisë edhe shitjen e materialeve hidraulike.

Nga verifikimi i regjistrave të realizim të prokurimeve, konstatohet se ky objekt prokurimi është bërë edhe në vitet paraardhëse. Në dosje nuk ka një analizë të hollësishme për të nxjerrë sasitë e nevojshme për prokurim, e cila do të llogaritej si diferencë e nevojave për matësa, me gjendjen e këtyre materialeve në magazinë. Sa sipër, sasitë e preventivit të fondit limit për matësa, janë të paargumentuara teknikisht, duke mbartur riskun për hartimin e një preventivi joreal.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet një procesverbali, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se janë vendosur konform legjislacinit të prokurimit publik.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së, janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave me datat respektive 28.03.2025 dhe 01.04.2025 (dokumentacioni fizik), ose 14 ditë pas hapjes së ofertave sipas DT, në kundërshtim me nenin 55, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, sipas të cilit për procedurën e hapur, e

thjeshtuar "...*Shqyrtimi i ofertave duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dorëzimi i ofertave*". Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi KVO-ja me përbërje I.D., S.B. dhe A.P..
Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit me nr. 418/11 prot., datë 17.04.2025 dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE/BOE, nga të cilët të dy të kualifikuar.

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta ekonomike	Vlerësimi
2	"Al-C" SHPK	4,396,295	Kualifikuar
3	"H." SHPK	4,545,800	Kualifikuar

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

1. Pas verifikimit në SPE dhe i dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "Al-C" SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte konform kritereve të përcaktuar në DT. Sa sipër, kualifikimi i OE të shpallur fitues "Al-C" SHPK është i drejtë, në përputhje me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

U konstatua, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit znj. E.D..

16 "Marrje mjete me qera, ekskavator, kamion, pick-up"

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Marrje mjete me qera, ekskavator, kamion, pick-up", Nr. REF-62846, datë 03-17-2023.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 313/ datë 20.02.2023</td><td rowspan="2">1. Urdhër Prokurimi
Nr. 313/ datë 20.02.2023
Njësia e Prokurimit
- E.Ç., Personi përgjegjës,
- A.P., Anëtar
- H.B., Anëtar
2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 281/1, datë 14.02.2023
- B.H,
- A.Do.,
- A.M</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 313/1 datë 20.02.2023
1. K.Ç., Kryetar ndryshuar me Urdhër nr. 313/3, datë 01.03.2023, me z. J.D.
2. Xh.M., anëtar, ndryshuar me Urdhër nr. 313/6, datë 30.03.2023, me znj. E.P.
3. B.N, anëtar</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –
"E hapur e thjeshtuar, shërbim"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
3,000,000 lekë pa TVSH,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE "K.K." SHPK me ofertë 2,980,000 lekë pa TVSH,</td><td>7. Diferenca me fondin limit 20,000 lekë pa TVSH, ose 0.67 %</td></tr>
</table>

	sipas kontratës nr. 313/11, datë 12.04.2023, me afat 90 ditë për kamionçinat dhe 44 ditë për ekskavatorët dhe kamionët.	
8. Data e hapjes së tenderit Datë 30.03.2023	9. Burimi Financimit Nga Buxheti i UK Kamëz (vetëfinancim)	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime; Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës Nuk ka	13. Përgjigje Ankesës Nuk ka

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është "E Hapur e thjeshtuar, shërbim", me vlerë 3,000,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 281 prot., datë 14.02.2023 për prokurimin me objekt "Marrje mjete me qera, ekskavator, kamion, pick-up", pasi mjetet që disponon UKK (një fadromë dhe një makinë tip Amarok Ëolksvagen), nuk i plotësojnë nevojat për shërbime për këtë institucion.

Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Në dosje administrohet një Relacion teknik dhe specifikimet teknike për këtë objekt prokurimi, me nr. 281/3 prot., datë 17.02.2023, i hartuar nga komisioni i për vendosjen e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit, ngritur me Urdhrin nr. 281/2 prot., datë 17.02.2023, me përbërje ing. B.H, A.Do. dhe A.M, i cili citon qëllimin, llojin e mjeteve që do të merren me qera (2 ekskavatorë, një kamion dhe 2 kamionçina), afatin kohor (respektivisht ekskavatorët dhe kamioni 44 ditë pune, ndërsa kamionçina 90 ditë kalendarike), si dhe specifikimet teknike për të gjitha mjetet. Nga auditimi konstatohet se specifikimet për dy ekskavatorët janë të ndryshme, pa e argumentuar teknikisht arsyen. Janë vendosur gjithashtu, disa specifikime teknike të paargumenturara teknikisht, si lënda djegëse, viti i prodhimit, numri i cilindrave, etj.
Në dosje administrohet një procesverbal mbi përcaktimin dhe miratimin e fondit limit, nga grupi i punës i përbërë nga B.H, A.D. dhe A.M, në të cilin citohet studimi i tregut, ku janë kërkuar tre oferta dhe është bërë mesatarja e tyre, duke nxjerrë një vlerë prej 2,999,852 lekë. Nga verifikimi i studimit të tregut për çmimin e orëve të punës së mjeteve të cituara në relacionin e specifimimeve teknike, konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë "D.1" SHPK, "E. & P." SHPK dhe "U." SHPK.
Nga auditimi konstatohet se në dosjen e prokurimit nuk gjendet asnjë krahasim me çmimet që përcaktojnë manualet e çmimeve në fuqi (në rastin konkret, Manuali Nr.1) dhe as kërkesat që u janë bërë shoqërive të mësipërme për dhënie oferte. Për pasojë, nga ana e grupit të auditimit nuk mund të gjykohet nëse ofertat e dhëna, e përfshijnë karburantin dhe shoferët/manovratorët, për të cilat në specifikimet teknike është përcaktuar që janë në ngarkim të UKK (nafta dhe shoferët e kamionçinave).
Sa sipër, testimi i tregut nuk është bërë i studiuar, duke mbartur riskun që fondi limit të mos jetë real.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit janë argumentuar nëpërmjet një procesverbali datë 20.02.2023, veprim në

përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2.
- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2..2.1 të KVK është vendosur kriteri që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2019, 2020 dhe 2021) ku vlera mesatare e tyre të jetë jo më e vogël së vlera e fondit limit, si dhe vetëm bilancet e viteve 2020, 2021. Vitet e kërkuara nuk përkojnë me afatin e zhvillimit të procedurës, sipas të cilit duhet të ishte kërkuar xhiro vjetore për vitet 2020, 2021 dhe 2022 dhe bilancet për vitet 2019, 2020, 2021.
Përsa sipër, ky kriter nuk është në përputhje me DST, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e Njësisë së Prokurimit E.Ç., A.P. dhe H.B..

Mbi vlerësimin e ofertave
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, shërbime". Konstatohet se për mospjesëmarrje të asnjë oferte të përshtatshme në procedurën me REF 59714-02-20-2023, kjo procedurë është e përsëritur. Në SPE nuk ka gjurmë të procedurës së anuluar, ndërsa në dosjen e prokurimit administrohet vetëm Formulari i Njoftimit të Anulimit, si dhe Urdhri për përsëritjen e procedurës së prokurimit me nr. 313/6, datë 17.03.2023.
Nga ana e KVO-së, nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Në dosjen e prokurimit administrohet vetëm Raporti Përmbledhës i Prokurimit, nr. 313/9 prot, datë 11.04.2023. Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë vetëm OE "K.K.", i kualifikuar dhe me ofertë 2,980,000 lekë pa TVSH.

- Pas verifikimit në SPE të dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "K.K." SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte konform kritereve të përcaktuar në DT dhe për pasojë ky OE është kualifikuar me të drejtë nga KVO-ja.

U konstatua, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi personi përgjegjës i prokurimit zn. E.Ç..

17. <u>“Blerje matësa uji dhe kaseta”, UK Kamëz</u>

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje matësa uji dhe kaseta”, UK Kamëz”, Nr. REF-53021, datë 07-01-2023.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi Nr. 240, datë 08.02.2023
2. Lloji i Procedurës –
“E hapur e thjeshtuar, mallra”</td><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 240, datë 20.02.2023
Njësia e Prokurimit
- E.Ç., Personi përgjegjës,
- Xh.M., Anëtar
- E.N., Anëtar
2. Grupi i hartimit te fondit limit
Urdhër nr. 223/1, datë 06.02.2023
- E.S.
- A.P.
- A.G.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Urdhër nr. 240/1 prot, datë 08.02.2023
1. B.H, Kryetar
2. E.P., anëtar
3. A.XH., anëtar</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
2,198,802 lekë,</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh)
OE “H.” SHPK me ofertë 2,105,380 lekë pa TVSH,sipas kontratës nr. 240/6, datë 27.02.2023, me afat 20 ditë.</td><td>7. Diferenca me fondin limit, 93,422 lekë pa TVSH, ose 4.24%</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit
Datë 20.02.2023</td><td>9. Burimi Financimit
Nga Buxheti i UK Kamëz vetëfinancim)</td><td>10. Operatoret Ekonomike
a) Pjesëmarrës në tender 1 OE
b) S’kualifikuar 0 OE,
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës
nuk ka</td></tr>
</table>

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:
Kjo procedurë është “E Hapur e thjeshtuar, mallra”, me vlerë 2,198,802 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga UK Kamëz (vetëfinancim).

<u>Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi</u>
Në dosjen e prokurimit administrohet një kërkesë e bërë nga Departamenti teknik dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 223 prot., datë 06.02.2023 për prokurimin e blerjes së matësave të ujit dhe kasetave. Relacioni teknik për këtë objekt prokurimi, me nr. 223/3 prot., datë 07.02.2023, i hartuar nga ing. E.S., A.P. dhe A.G., citon nevojën për matësa dhe kaseta UK Kamëz, duke theksuar nevojat e përditshme për kryerjen e punimeve, sidhe përmirësimin e kapaciteteve për matjen dhe kontrollin e sasisë së ujit të konsumuar nga qytetarët dhe subjektet që përdorin ujin e administruar nga UK Kamëz.
<u>Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike</u>
Në dosje administrohet procesverbali për argumentimin e fondit limit me nr 223/2 prot., datë 06.02.2023, i mbajtur nga grupi i punës me përbërje z. E.S., Kryetar, A.P. dhe A.G., anëtarë.
Në këtë procesverbal është bërë llogaritja e çmimeve të materialeve sipas çmimeve të manualeve në fuqi dhe për zërat e materialeve që nuk gjenden në manual, është bërë me studim tregu, duke kërkuar tre oferta. Është bërë mesatarja e këtyre, duke nxjerrë një vlerë të fondit limit prej 2,198,802 lekë. Nga verifikimi i studimit të tregut konstatohet se ofertat janë sjellë nga shoqëritë “H.” SHPK, “M. LTD” PF dhe “Ë. & E. S.” SHPK. Nga verifikimi në website-n e QKB, rezulton se këto shoqëri kanë si objekt të veprimtarisë edhe shitjen e materialeve hidraulike.
Nga verifikimi i realizimit të prokurimeve, konstatohet se ky objekt prokurimi është bërë edhe në vitet paraardhëse. Në dosje nuk ka një analizë të hollësishme për të nxjerrë sasitë e nevojshme për prokurim, e cila do të llogaritej si diferencë e nevojave për matësa, me gjendjen e këtyre

materialeve në magazinë. Sa sipër, sasitë e preventivit të fondit limit për matësa, janë të paargumentuara teknikisht, duke mbartur riskun për hartimin e një preventivi joreal.

Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit rezulton janë argumentuar nëpërmjet një procesverbali, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se janë vendosur konform legjislacionit të prokurimit publik.

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar, mallra". Nga ana e KVO-së nuk janë mbajtur procesverbale për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi KVO-ja me përbërje B.H. , E.P. dhe A.XH..

Nisur nga Raporti Përmbledhës i prokurimit me nr. 240/4 prot., datë 24.02.2023 dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në procedurë OE "H." SHPK, i kualifikuar, me ofertë 2,105,380 lekë.

- Pas verifikimit në SPE dhe i dokumentacionit fizik të OE të kualifikuar dhe shpallur fitues "Hi." SHPK, u konstatua se dokumentacioni i paraqitur ishte konform kritereve të përcaktuar në DT.

Sa sipër, kualifikimi i OE të shpallur fitues "H." SHPK është i drejtë, në përputhje me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

U konstatua, se nuk është bërë numerizimi përkatës i dokumentacionit, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8, shkronja g). Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara dhe pa numerizuara, mbartin riskun e cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.;

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. E.S. dhe personi përgjegjës i prokurimit znj. E.Ç..

2.6.1/1 Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave. (Procedurat e prokurimit blerje të vogla)
Viti 2023

Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

-Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2023 janë zhvilluar 16 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit pa tvsh për vlerën prej 7,686 mijë lekë, dhe vlerën e kontratës prej 6,401 mijë lekë (83% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 1,285 mijë lekë, nga të cilat 4 janë procedura me vlerë nën 100,000 lekë.

- Për vitin 2023, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. E.S. me nr. 2 dhe nr. 103 Prot., datë 19.01.2023, me përbërje si vijon:

1. E.P. – Kryetar
2. E.Ç. – Anëtar
3. A.XH. – Anëtar

I ndryshuar me Urdhrin nr. 33 dhe 1143 prot., datë 26.06.2023 ku zëvendësohet Kryetari E.P. me S.P. si anëtare dhe kryetar i KBV.

U krye testimi i disa prej procedurave të ndjekura si vijon:
1-Me urdhër prokurimi nr. 15, datë 23.02.2023 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Pjesë këmbimi goma, bateri, vaj, filtra".***
Administrohet kërkesa nga Sektori i Transporteve dhe Makinerive të Rënda me nr. 317/2 prot., datë 20.02.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm E.M..
Me urdhër nr. 317/1 prot., datë 20.02.2023 është ngritur komisioni për përcaktimin e nevojave për pjesë këmbimi dhe përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga A.D., K.D. dhe N.B..
Komisioni ka mbajtur një procesverbal të datës 21.02.2023 ku sqaron se automjetet janë dërguar në një servis i cili nga kontrolli i bërë ka përcaktuar nevojat për 2 mjetet, Fadroma me targa ADMT02 dhe Volsëagen Amarok.
Komisioni ka mbajtur procesverbalin për përcaktimin dhe përllogaritjen e fondit limit të datës 22.04.2023, sipas të cilit janë administruar 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, të evidentuara në këtë procesverbal, duke përcaktuar fondin limit në vlerën 985,503 lekë.
Është hartuar një procesverbal pa nr., datë 23.04.2022 (vendos gabim data pasi procedura zhvillohet në vitin 2023) për argumentimin dhe miratimin e e specifikimeve teknike nga ana e anëtarëve të KBV, procesverbal i cili nuk rezulton të jetë ngarkuar në SPE, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është hartuar ftesa për ofertë, me nr. 317/4 prot., datë 23.02.2023 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 24.02.2023.
Përgjithësisht kriteret janë minimale, por në pikën 5 kërkohet që nga OE të disponohet kategoria

e licencës VII.3.B.3, e cila nuk rezulton të ekzistojë si licencë nga QKL.
Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave, është pasqyruar në të nëse OE kanë objektin e aktivitetit të pasqyruar në QKB, në përputhje me pikën 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5 të APP.
Sipas procesverbalit të datës 27.02.2023, evidentohet se kanë marrë pjesë 22 OE, nga të cilët 19 OE janë kualifikuar, ndërsa 3 OE janë s'kualifikuar, konkretisht 2 OE për oferta mbi fondin limit dhe 1 ofertë e cila rezulton nën 50% të fondit limit.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	S.	500,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	A.K.	565,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	B.M.	647,800	***Kualifikuar / Fitues***

Të renditurit në vend të parë dhe të dytë, nuk janë paraqitur pranë AK duke mos njoftuar arsyet. Në secilin rast janë mbajtur procesverbalet për kalimin tek OE i radhës, sipas përcaktimit të paragrafit të dytë te pikës 18 të Udhëzimit nr. 5 të APP.
I renditurit në vend të tretë dhe i shpallur fitues, subjekti B.M., ka dorëzuar dokumentacionit i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit.
Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Është ngritur urdhri i brendshëm i Titullarit me nr. 575 prot., datë 23.03.2023 për marrjen në dorëzim të mallrave/ shërbimit i përbërë nga A.K., N.H. dhe B.D., marrë në dorëzim me procesverbalin me nr. 575/1 prot., datë 23.03.2023, në të cilin specifikohet se malli ishte i rregullt dhe plotëson specifikimet e kërkuara. Është lëshuar fatura tatimore me nr. 43/2023, datë 21.03.2023, likuiduar me urdhër xhirimi të datës 31.03.2023.

2- Me urdhër prokurimi nr. 31, datë 06.06.2023 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Mbikëqyrje punimesh në objektin "Rikonstruksion Rrjeti Ujësjellësi lagjja Zallmner, Kamëz".***
Është administruar kërkesa me nr. 999 prot., datë 02.06.2023 nga Departamenti Teknik drejtuar Sektorit të Prokurimeve për kryerjen e procedurës me objekt "Mbikëqyrje punimesh në objektin "Rikonstruksion Rrjeti Ujësjellësi lagjja Zallmner, Kamëz", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
Është mbajtur procesverbali për përcaktimin dhe miratimin e fondit limit me nr. 999/2 prot., datë 02.06.2023 nga komisioni i përbërë nga Ing. B.H, E.S. dhe A.C., në të cilin përcaktohet se përllogaritja është bërë sipas nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" dhe Rekomandimit të APP nr. 5585 prot., datë 25.07.2017. Nga përllogaritja ka rezultuar vlera

maksimale **582,931 lekë** vlerë e cila është edhe fondi limit i procedurës.
Në dosje nuk disponohet procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili kërkohet të jetë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe të firmoset nga secili nga anëtarët sipas përcaktimit të pikës 2 paragrafi i fundit i nenit 78 të VKM-së nr. 285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, por rezulton se në SPE ishte ngarkuar ky dokument.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 1014/1 prot., datë 06.06.2023 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 07.06.2023.
Përgjithësisht kriteret janë minimale, por kërkesat e pikës 6 e cila kërkon kategoritë e licencës dhe kërkesa e pikës 6.1 e cila kërkon stafin e inxhinierëve të nevojshëm për zbatimin e kontratës, rezulton se nuk është bërë argumentimi teknik në raport me punimet, por janë mjaftuar vetëm me argumentim ligjor, ndërkohë që paragrafi i dytë i nenit 78 të VKM-së nr. 285, krahas argumentimit ligjor, përcakton qartë edhe argumentimin teknik të kritereve.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, është mbajtur procesverbali i datës 07.06.2023 për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 20 OE, nga të cilët 9 OE janë kualifikuar dhe 9 OE janë skualifikuar, ku në 8 raste oferta është me vogël se analiza e çmimit mbi tarifën profesionale të ofertuar dhe në 1 rastë është më e lartë se sa ananliza e çmimit. Është pasqyruar nëse OE kanë objektin e aktivitetit sipas ekstraktit të QKB, sipas pikës 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	Dh.S.	538,090.49	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	M.C.	538,090.49	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	N.S.	538,090.49	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	R.S.	538,090.49	***Kualifikuar / Skualifikuar***
5	2.&. H. S.	538,090.49	***Kualifikuar/ Skualifikuar***
6	R.95.	538,090.49	***Kualifikuar/ Skualifikuar***
7	B.Y.M.Ch. SHPK	538,090.49	***Kualifikuar/ Fitues***
8	K.Co.	538,090.49	***Kualifikuar/ Skualifikuar***
9	M. St.	538,090.49	***Kualifikuar/ Skualifikuar***

Të renditurit nga vendi i parë në vendin e nëntë, rezulton se kanë paraqitur oferta të njëjta.
Është bërë njoftimi i OE për hedhjen e shortit me datë 08.06.2023, ora 12.00.
Pavarësisht se është përcaktuar hedhja e shortit me datë 08.06.2023, rezulton se është mbajtur një procesverbal i datës 12.06.2023 mbi hedhjen e shortit ku ka rezultuar i renditur i pari subjekti B.Y..
OE fitues, ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:
BOE ka paraqitur një kontratë bashkëpunimi të përkohshme për realizimin e objektit të procedurës me nr. 2635 Rep, 1980 Kol, datë 13.06.2023. Sipas nenit 3 pika 1, B.Y.p.f merr përsipër të kryejë detyrat e nënshkrimit të kontratës, të nënshkruaj preventiv, grafik punimesh, listën e çmimeve, të përfaqësojë shoqërinë për procedurat e prokurimit dhe ndjekjen e procedurave online dhe fizikisht, të dorëzojë, tërheqë, përpilojë, firmos, anulojë, ankimojë etj çdo lloj dokumentacioni të nevojshëm. Pagesat do kryhen në llogarinë e subjektit B.Y.p.f.
Në pikën 2 të kontratës, përcaktohet ndarja e punimeve e përcaktuar 80% për OE M.Ch dhe 20% për subjektin B.Y.p.f.
Sa më sipër, rezulton se pavarësisht ndarjes së punimeve dhe përcaktimit se cilat janë angazhimet e subjektit B.Y., kapaciteti teknik përfshirë kategoritë e licencës si dhe 3 inxhinierët e kërkuar drejtues teknik janë kapacitete që plotësohen nga OE M.Ch, ndërsa angazhimi i subjektit B.Y., rezulton vetëm angazhim administrativ, dhe nuk plotëson asnjë kriter teknik për të cilin janë përcaktuar edhe kriteret kualifikuese, përfshirë licencën e shoqërisë me kategoritë e saj dhe inxhinierët pjesë e licencës.
Sa më sipër, oferta e këtij BOE nuk duhej kualifikuar dhe shpallur fitues.
Kualifikimi i tyre është bërë në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të LPP dhe nenin 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është lëshuar fatura nr. 17/2023, datë 30.09.2023, likuiduar me urdhër xhirimi të datës 09.08.2024.

3-Me urdhër prokurimi nr. 44, datë 07.09.2023 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Shpenzim mirëmbajtje për kondicionim".***
Me urdhrin e brendshëm me nr. 722/1 prot., datë 19.04.2023 për ngritjen e komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, është ngritur grupi i punës i përbërë nga B.D., R.L. dhe S.P..
Me procesverbalin me nr. 722/2 prot., datë 06.09.2023, komisioni ka pasqyruar testimin e tregut duke bashkëlidhur 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, duke përcaktuar fondin limit në vlerën **983,620 lekë.**
Në dosje nuk disponohet procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili kërkohet të jetë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe të firmoset nga secili nga anëtarët sipas përcaktimit të pikës 2 paragrafi i fundit i nenit 78 të VKM-së nr. 285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe nuk ishte ngarkuar në SPE.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 1699/1 prot., datë 07.09.2023 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 08.09.2024.
Përgjithësisht kriteret janë minimale, por rezulton se nuk është bërë argumentimi teknik për stafin e kërkuar dhe certifikatën ISO, por janë mjaftuar vetëm me argumentim ligjor, ndërkohë që paragrafi i dytë i nenit 78 të VKM-së nr. 285, krahas argumentimit ligjor, përcakton qartë edhe argumentimin teknik të kritereve.
Kanë marrë pjesë 10 OE nga të cilët janë kualifikuar 7 OE dhe 3 OE janë skualifikuar.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	K. T. T.	682,500	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	G. Xh.	769,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	E. T.	789,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	B. U.	799,000	***Kualifikuar/ Anuluar***

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje, rezulton se kjo procedurë është anuluar sipas nenit 98

pika 1 (duke evidentuar se arsye e anulimit është gabimi gjatë procesit të kalimit tek OE fitues i radhës. Referuar nenit 98 pika 1 të ligjit në asnjë rast nuk përcaktohet si arsye s'kualifikimi gabimi në proces, ndërkohë rezulton sipas SPE se është realizuar njoftim i OE të radhës, konkretisht "B.U." me datë 21.09.2023. Rezulton që pikërisht me urdhrin nr. 1699/3 prot., datë 21.09.2023 të jetë urdhëruar ripërsëritja e kësaj procedure prokurimi, ndërkohë nuk është pritur afati 2 ditor sipas përcaktimit të nenit 19 të Udhëzimit nr. 5 të APP. Sa më sipër anulimi i procedurës është bërë në kundërshtim me legjislacionin dhe rregullat e prokurimit publik.

Në procedurën e rishpallur, rezulton se në dosje mungojnë dokumentet e nevojshme të tenderit si Ftesa për ofertë dhe procesverbali për argumentimin e kritereve kualifikuese, të cilat rezultojnë në SPE por nuk janë fizikisht dhe të firmosura në dosje. Nga verifikimi në SPE ka modifikime të kritereve të cilat teknikisht si në procedurën e parë nuk janë argumentuar.
Referuar të dhënave në SPE, rezulton se janë kualifikuar 7 OE

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	K. T. T.	682,500	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	S. – Klima	788,200	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	J.	900,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	O. M. M.	920,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
5	A.	927,700	***Kualifikuar / Skualifikuar***
6	K.. shpk	945,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
7	B.-T. A. 2.	965,350	***Kualifikuar / Skualifikuar***

I rendituri në vend të parë nuk është paraqitur duke njoftuar tërheqjen;
I rendituri në vend të dytë, S. – Klima është paraqitur duke dorëzuar dokumentacionin e administruar me nr. 1839 prot., datë 27.09.2023. i cili është skualifikuar për mos përmbushje të kritereve sipas ftesës për ofertë pasi mungojnë diploma/certifikatat për inxhinierin mekanik, dhe 2 teknikët e kondicionerëve;
I rendituri në vend të tretë është tërhequr duke dërguar njoftimin;
I rendituri në vend të katërt, ka paraqitur gjithashtu njoftim për tërheqje;
I rendituri në vend të pestë, A., nuk është paraqitur duke mos njoftuar arsyet e tërheqjes;
I rendituri në vend të gjashtë ka njoftuar tërheqjen;
I rendituri në vend të shtatë, nuk është paraqitur duke njoftuar tërheqjen.
Në këto kushte, është mbajtur formulari i radhës për anulimin e procedurës me nr. 1699/5 prot., datë 06.10.2023, anulim i kryer bazuar në pikën 1 germa (b) të nenit 92 të LPP.

Me urdhër nr. 2016 prot., datë 16.10..2023 është urdhëruar ripërsëritja e procedurës.
Administrohet në dosje procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve të veçanta të kualifikimit i firmosur nga anëtarët e KBV, por rezulton si në rastet e procedurave të anuluara, mungon argumentimi teknik i kritereve.
Është bërë ftesa për ofertë me nr. 2016/1 prot., datë 18.10.2023 me datë zhvillimi të procedurës 19.10.2023.
Nga verifikimi, rezulton se kërkesa e pikës 6 e Ftesës për ofertë, e cila kërkon stafin e nevojshëm për zbatimin e kontratës, ka kërkuar ndër të tjera që ky staf të figurojë në listëpagesa 3 muajt e fundit. Kjo kërkesë nuk është përputhje me nenin 41 pika 4 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën për të kërkuar fuqinë punëtore të nevojshme, pa përcaktuar detyrimin që të jenë në listëpagesa për periudha të caktuara. KBV duhet të mjaftohet me listëpagesën e fundit e cila duhet

të shërbejë si kriter kualifikues.
Kriteri i mësipërm, është në kundërshtim me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41 pika 2 të VKM-së nr. 285 cituar më sipër.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, është mbajtur procesverbali i datës 20.10.2023 për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 11 OE, nga të cilët 6 OE janë kualifikuar dhe 5 OE janë skualifikuar, ku në 3 raste skualifikimi është bërë bazuar në pikën 15 të Udhëzimit të APP për shkak se OE nuk kanë dhënë arsye për tërheqjen në procedura tjera të realizuara, në 1 rast për ulje nën 50% të fondit limit dhe 1 rast për mungesë objekti aktiviteti në ekstraktin e QKB.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	C.	597,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	A. Shpk	622,000	***Kualifikuar / Fitues***

I renditur në vend të parë, OE C., ka paraqitur dokumentacionin e administruar pranë AK pa nr. prot., pa datë. Është mbajtur procesverbal për kalimin tek OE i radhës ku pasqyrohet ndër të tjera se OE C. ka mangësi të pikës 6 të ftesës për ofertë për 1 ing.mekanik, 3 teknik kondicionerësh dhe 1 teknik elektricist, pasi në vend të diplomës ka paraqitur certifikata trajnimi për 3 teknik dhe 1 elektricist të cilat nuk vërtetojnë profesionalizimin e këtyre punonjësve.
I renditur në vend të dytë, A. shpk, i cili është shpallur edhe fitues, rezulton se ka dorëzuar dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se OE nuk përmbush kriterin e pikës 6 të Ftesës për ofertë për 1 inxhinier mekanik. Rezulton se është paraqitur dokumentacion për punonjësin Xh.S., i cili rezulton sipas diplomës i diplomuar inxhinier për metalurgji e materiale, drejtimi materiale. Sa më sipër, pavarësisht se ka studiuar në fakultetin e inxhinierisë mekanike, dega për të cilën është diplomuar nuk është mekanika për degë tjetër e cituar më sipër.
Në këto kushte, dhe duke ndjekur të njëjtin standard edhe në 2 procedurat e anuluara, ku KBV ka skualifikuar OE për mangësi dokumentesh, do duhej të skualifikohej edhe OE A. shpk e të vijohej me OE të radhës.
Kualifikimi i këtij OE është bërë në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të LPP dhe nenin 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 cituar më sipër.
Shërbimi është marrë në dorëzim sipas procesverbaleve përkatës. Janë lëshuar 3 fatura, konkretisht me nr. 109/2023, 13/2024 dhe 62/2024, likuiduar secili sipas urdhër xhirimeve përkatëse në datat 20.12.2023, 05.04.2024 dhe 11.10.2024.

4- Me urdhër prokurimi nr. 35, datë 11.07.2023 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Mirëmbajtje Printera dhe Fotokopje".***

Është administruar kërkesa me nr. 1159 prot., datë 30.06.2023 nga Departamenti Administrativ për kryerjen e procedurës me objekt "Mirëmbajtje printera dhe kompjutera", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Me urdhër nr. 1159/1 prot., datë 30.06.2023 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike i përbërë nga N.M., R.L. dhe E.Gj. Me procesverbalin e datës 10.07.2023 janë përcaktuar specifikimet teknike si dhe përllogaritur fondi limit ku bazuar në testimin e tregut janë marrë 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, duke përcaktuar fondin limit në vlerën 800,000 lekë.

Është hartuar procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i datës 11.07.2023 dhe firmosur nga secili nga anëtarët sipas përcaktimit të pikës 2 paragrafi i fundit i nenit 78 të VKM-së nr. 285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili është ngarkuar edhe në SPE.

Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 1249/1 prot., datë 11.07.2023 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 12.07.2023.

Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se kriteri i pikës 5 i ftesës për ofertë, kërkon nga OE 1 inxhinier elektronik dhe 2 teknik kompjuterësh të cilët të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit.

Lidhur me kërkesën që të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit, sqarohet se kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenin 41 pika 4 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë nëpër listëpagesa. Për AK do ishte më e arsyeshme të kërkohej stafi i mësipërm i cili të figurojë minimalisht në listëpagesën e fundit të shoqërisë. Kriteri i hartuar sipas formës së mësipërme mund të kufizojë pjesëmarrjen e OE që kanë kapacitetet e nevojshme, por stafi i tyre nuk është 3 muajt e fundit në listëpagesa, por gjendet të paktën muajin e fundit në listëpagesë.

Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, është mbajtur procesverbali i datës 13.07.2023 për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 11 OE, nga të cilët 7 OE janë kualifikuar dhe 4 OE janë skualifikuar nga të cilët 2 OE për mungesë objekti të aktivitetit në QKB, 1 OE për ofertët nën 50% të FL dhe 1 OE për ofertë mbi FL. Është pasqyruar nëse OE kanë objektin e aktivitetit sipas ekstraktit të QKB, sipas pikës 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	A.D	666,667	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	C.	723,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	E.C.	748,000	***Kualifikuar / Fitues***

I rendituri në vend të parë, A.D, nuk është paraqitur por njoftuar AK për tërheqjen nëpërmjet SPE, ndërsa i rendituri në vend të dytë, C., nuk është paraqitur dhe sipas procesverbalit të mbajtur nuk ka njoftuar tërheqjen.

OE fitues, E.C., ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në*

sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)”, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *“Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6.”*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:

OE nuk përmbush kriterin e pikës 5 të Ftesës për Ofertë e cila kërkon 1 inxhinier elektronik dhe 2 teknik kompjuterësh. Konkretisht, për 2 teknik kompjuterësh, OE ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 Teknik kompjuteri, punonjësin M.Ç., për të cilin ka paraqitur si dëshmi një certifikatë përfundimi të një kursi, certifikatë e cila nuk i jep titullin Teknik Kompjuteri, ndërkohë që kjo certifikatë, e lëshuar nga Cisco Netëorking Academy nuk është e lëshuar nga subjekte të akredituara nga DA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues.

Sa më sipër, oferta e këtij BOE nuk duhej kualifikuar dhe shpallur fitues.

Mangësitë e mësipërme, janë në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të LPP dhe nenin 41 pika 2 dhe nenin 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Është lidhur kontrata me nr. 1249/2 prot., datë 25.07.2023

Është mbajtur procesverbal për marrjen në dorëzim me nr. 12266/1 prot., datë 21.05.2024. Janë lëshuar faturat tatimore me nr. 233/2023, 270/2023 dhe 343/2023, likuiduar me urdhër xhirimet të datave 02.08.2023, 29.08.2023, 28.12.2023 dhe 11.03.2024.

5- Me urdhër prokurimi nr. 23, datë 25.04.2023 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***“Shërbim Zhbllokim Kanalizimesh me Bot Sonde”.***

Është administruar kërkesa me nr. 754 prot., datë 24.04.2023 nga Departamenti Teknik për kryerjen e procedurës me objekt “Pastrim kolektorësh dhe zhbllokim kanalesh me bot sonde”, e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Me urdhër nr. 754/1 prot., datë 24.04.2023 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike i përbërë nga B.H, A.P. dhe R.Z.. Me procesverbalin nr. 754/2 prot., datë 24.04.2023 është hartuar relacioni teknik dhe specifikimet teknike.

Është hartuar një preventiv nga grupi i punës duke përcaktuar FL në vlerën 600,000 lekë. Preventivi është bazuar në Analizë ku emërtimi i punës është Pastrim Kolektorësh në 7 Rrugë, me çmim për njësi 800 lekë. Lidhur me përcaktimin e këtij çmimi është hartuar procesverbali nr. 754/5 prot., datë 24.04.2023 ku janë bazuar në testimin e tregut duke marrë 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit.

Është hartuar procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili është ngarkuar edhe në SPE.

Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 766/1 prot., datë 25.04.2023 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 26.04.2023.

Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se kriteri i pikës 6 i ftesës për ofertë, kërkon nga OE 1 shofer të pajisur me leje drejtime të posaçme dhe 2 punëtorë me kontratë pune për dy muajt e fundit, të cilët të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit. Përveçse konfuz si kriter për 2 punëtoret me kontratë dy muajt e fundit të cilat të figurojnë në listëpagesë 3 muajt e fundit, kërkesa që të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit, nuk është në përputhje me nenin 41 pika 4 germa (c) të

VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë nëpër listëpagesa. Për AK do ishte më e arsyeshme të kërkohej stafi i mësipërm i cili të figurojë minimalisht në listëpagesën e fundit të shoqërisë. Kriteri i hartuar sipas formës së mësipërme mund të kufizojë pjesëmarrjen e OE që kanë kapacitetet e nevojshme, por stafi i tyre nuk është 3 muajt e fundit në listëpagesa, por gjendet të paktën muajin e fundit në listëpagesë.
Njëkohësisht, kërkesa për shoferin për të cilin kërkohet të disponojë leje drejtimi të posaçme, është kërkesë e pa plotë, pasi duhet specifikuar konkretisht se çfarë dokumenti të posaçëm duhet të disponojë ky punonjës.
Gjithashtu, kërkesa e pikës 7 e cila kërkon nga OE të disponojnë Licencën profesionale Kodi III.2.B (Transportim i ujërave të zeza), është e hartuar gabim, pasi kjo licencë është për shërbime ekspertize dhe/ ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, ndërkohë që objekti i procedurës është zhbllokimi i kanalizimeve dhe jo shërbim ekspertize.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, në dosje nuk disponohet procesverbali i për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës. Në dosje dhe nga verifikimi në SPE rezulton se kanë marrë pjesë 7 OE, nga të cilët 4 OE janë kualifikuar dhe 3 OE janë skualifikuar nga të cilët 2 OE për mungesë objekti të aktivitetit në QKB dhe 1 OE për ofertë mbi FL.

OE Pjesëmarrës me oferta të kualifikuara.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	J.	542,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	O.M.M.	564,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	T.T	570,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	K. Shpk	589,900	***Kualifikuar / Skualifikuar***

Të renditurit nga vendi i parë në të tretin, nuk janë paraqitur, ku i renditurit në vend të parë dhe të dytë kanë njoftuar nëpërmjet SPE tërheqjen, ndërsa i i renditurit në vend të tretë nuk ka dërguar njoftim. Është njoftuar i renditurit në vend të katërt, K. Shpk, por nuk disponohet në dosje as në SPE procesverbal i gjeneruar nëse ky OE është tërhequr apo nuk plotëson kriteret kualifikuese.
Me formularin nr. 766/2 prot., datë 10.05.2023 është njoftuar anulimi i procedurës së prokurimit, bazuar në nenin 98 pika 1 germa (b), pasi në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme.

Me urdhër nr. 857 prot., datë 10.05.2023 është Ripërsëritur procedura me të njëjtin objekt. Është hartuar Ftesa për ofertë me datë 10.05.2023 me datë zhvillimi 11.05.2023.
Si në rastin e procedurës së anuluar, rezulton se kriteri i pikës 6 i ftesës për ofertë, i cili kërkon nga OE 1 shofer të pajisur me leje drejtime të posaçme dhe 2 punëtorë me kontratë pune për dy muajt e fundit, të cilët të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit. Përveçse konfuz si kriter për 2 punëtoret me kontratë dy muajt e fundit të cilat të figurojnë në listëpagesë 3 muajt e fundit, kërkesa që të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit, nuk është në përputhje me nenin 41 pika 4 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë nëpër listëpagesa. Për AK do ishte më e arsyeshme të kërkohej stafi i mësipërm i cili të figurojë minimalisht në listëpagesën e fundit të shoqërisë. Kriteri i hartuar sipas formës së mësipërme mund të kufizojë pjesëmarrjen e OE që kanë kapacitetet e nevojshme, por stafi i tyre nuk është 3 muajt e fundit në listëpagesa, por gjendet të paktën muajin e fundit në listëpagesë.
Njëkohësisht, kërkesa për shoferin për të cilin kërkohet të disponojë leje drejtimi të posaçme, është

kërkesë e pa plotë, pasi duhet specifikuar konkretisht se çfarë dokumenti të posaçëm duhet të disponojë ky punonjës.
Gjithashtu, kërkesa e pikës 7 e cila kërkon nga OE të disponojnë Licencën profesionale Kodi III.2.B (Transportim i ujërave të zeza), është e hartuar gabim, pasi kjo licencë është për shërbime ekspertize dhe/ ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, ndërkohë që objekti i procedurës është zhbllokimi i kanalizimeve dhe jo shërbim ekspertize.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, është mbajtur procesverbali i datës 16.05.2023 për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 5 OE, nga të cilët 4 OE janë kualifikuar dhe 1 OE është skualifikuar për mungesë objekti të aktivitetit në QKB. Është pasqyruar nëse OE kanë objektin e aktivitetit sipas ekstraktit të QKB, sipas pikës 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	Pastrime S.	565,000	***Kualifikuar / Fitues***

I renditur në vend të parë dhe OE fitues, Pastrime S., ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:
OE nuk përmbush kriterin e pikës 5 për mjetin autobot për pastrimin e kolektorëve, për të cilin kërkon 2 pompa, një me presion 170 – 275 bar dhe një me presion 100 – 150 bar si dhe gjatësi sonde 80 ml. Sa më sipër, në skedën e specifikimeve teknike mungojnë të dhënat për gjatësinë 80 ml sipas ftesës për ofertë.
Sa më sipër, oferta e këtij BOE nuk duhej kualifikuar dhe shpallur fitues.
Kualifikimi i tyre është bërë në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të LPP dhe nenin 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është lidhur kontrata me nr. 857/2 prot., datë 30.05.2023, me afat realizimi për 6 javë.
Me urdhër nr. 857/3 prot., datë 30.05.2023 të Titullarit, është caktuar personi përgjegjës për ecurinë e zbatimit të kontratës, A.K..
Në dosje nuk disponohet procesverbal për realizimin e kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimit.
Është lëshuar fatura tatimore nr. 990/2023, datë 31.07.2023, likuiduar me Urdhër Transfertën datë 01.08.2023 në një bankë të nivelit të dytë.

6- Me urdhër prokurimi nr. 22, datë 23.03.2023 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt Kolaudim Punimesh për objektin* ***"Ndërtim linje e re në tubacionin d=700mm të***

Bovillës së vjetër, l=6.0 km (zëvendësim i tubacionit ekzistues – hekuri nga liqeni i Zall – Herr derei tek "Kafja e Rremës".

Është administruar kërkesa me nr. 568 prot., datë 23.03.2023 nga Departamenti Teknik drejtuar Sektorit të Prokurimeve për kryerjen e procedurës me objekt "kolaudim punimesh në objektin "Ndërtim linje e re në tubacionin d=700mm të Bovillës së vjetër, l=6.0 km (zëvendësim i tubacionit ekzistues – hekuri nga liqeni i Zall – Herr derei tek "Kafja e Rremës", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Fondet janë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimi dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, dërguar UK Kamëz me shkresën nr. 211/1 prot., datë 28.01.2021 ku vlera për kolaudimin e punimeve është 895,694 lekë.

Me procesverbalin e datës 23.03.2023 është bërë përllogaritja e vlerës kolaudim, vlerë e cila është bazuar në shkresën e AKUM cituar më sipër ku përcaktohet fondi limit në vlerën 746,636.9 lekë pa TVSH ose 895,964.3 lekë me TVSH.

Në dosje disponohet procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili kërkohet të jetë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe të firmoset nga secili nga anëtarët sipas përcaktimit të pikës 2 paragrafi i fundit i nenit 78 të VKM-së nr. 285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, i cili është ngarkuar në SPE.

Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 568/2 prot., datë 23.03.2023 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 24.03.2023.

Referuar kritereve të vendosura në Ftesën për ofertë, rezulton se kriteri i pikës 11 kërkon ndër të tjera për OE të disponojnë certifikatat ISO 45001:2018 "Sistemi i menaxhimit për shëndetin dhe sigurinë në punë", ISO 14001:2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit" dhe PASS 99 "Sistemi i menaxhimit të integruar". Referuar tipologjisë së procedurës, e cila është për kolaudimin e punimeve, kërkesa për këto certifikata nuk përputhet me objektin e prokurimit. Për certifikatën 14001:2015, shërbimi i kolaudimit nuk ka lidhje direkte me mjedisin, për ISO 45001:2018, kompania nuk kryen punime dhe nuk ka ekspozim operacional ndaj rreziqeve krahasuar me një kompani ndërtimi. PASS 99, janë sisteme të integruara të disa certifikatave dhe nuk justifikon teknikisht nevojën për një shërbim kolaudimi.

Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, është mbajtur procesverbali i datës 03.03.2023 (data në PV është gabim pasi data e zhvillimit të saj është 24.03.2023) për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 12 OE, nga të cilët 7 OE janë kualifikuar dhe 5 OE janë skualifikuar, pasi oferta e tyre është me vogël se analiza e çmimit mbi tarifën profesionale të ofertuar.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	L. Consulting	653,307.31	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	R.95.	653,307.32	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	A. 2E	653,307.32	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	M.C.	653,307.32	***Kualifikuar / Skualifikuar***
5	M. St.	653,307.32	***Kualifikuar/ Skualifikuar***
6	V. Eng.	653,307.32	***Kualifikuar/ Skualifikuar***
7	S.S.D.S	703,705	***Kualifikuar/ Skualifikuar***

Në dosje gjendet një Formular Nr. 5 Për Njoftimin e Anulimit të Procedurës me nr. 568/3 prot., datë 05.04.2023, ku sipas komisionit jemi para shkaqeve të nenit 98 pika 1, arsye të tjera, pasi gjatë procesit të vlerësimit të procedurës, është bërë lapsus nga komisioni, duke klikuar gabimisht konfirmimin e fituesit, në vend që të bënte kalimin te OE i radhës, pasi OE i klasifikuar i pari nuk paraqiti dokumentet për finalizimin e procedurës. Në kushtet kur sistemi nuk ka opsion për tu

rikthyer mbrapa, është anuluar procedura.

Është mbajtur njëkohësisht procesverbali i datës 05.04.2023, ku ndër të tjera përcaktohet se procedura do të vijojë pa asnjë ndryshim me dokumentacionin e parë.
Është nxjerr urdhër nr. 568/4 prot., datë 05.04.2023 për Ripërsëritjen e procedurës më të njëjtin objekt.
Janë ngarkuar në SPE dokumentet e tenderit, ftesa për ofertë me datë zhvillimi të procedurës 06.04.2023 dhe procesverbali për argumentimin e kritereve kualifikuese, ku si në procedurën e parë të anuluar, janë ripërsëritur edhe kërkesat për certifikatat ISO 45001:2018 "Sistemi i menaxhimit për shëndetin dhe sigurinë në punë", ISO 14001:2015 "Sistemi i menaxhimit të mjedisit" dhe PASS 99 "Sistemi i menaxhimit të integruar". Refuruar tipologjisë së procedurës, e cila është për kolaudimin e punimeve, kërkesa për këto certifikata nuk përputhet me objektin e prokurimit. Për certifikatën 14001:2015, shërbimi i kolaudimit nuk ka lidhje direkte me mjedisin, për ISO 45001:2018, kompania nuk kryen punime dhe nuk ka ekspozim operacional ndaj rreziqeve krahasuar me një kompani ndërtimi. PASS 99, janë sisteme të integruara të disa certifikatave dhe nuk justifikon teknikisht nevojën për një shërbim kolaudimi.
Është mbajtur procesverbali për hapjen e ofertave, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 16 OE, nga të cilët 8 OE janë kualifikuar dhe 8 OE janë skualifikuar, nga të cilët 7 OE për oferta më të vogla se analiza e çmimit mbi tarifën profesionale të ofertuar dhe 1 OE më të madhe se tarifa profesionale e ofertuar.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	H. Company	653,307.3	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	G. Co.	653,307.3	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	H.&S. .	653,307.3	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	X.&M.	653,307.3	***Kualifikuar / Skualifikuar***
5	A. Mk.	653,307.3	***Kualifikuar/ Fitues***

Të renditurit nga vendi i parë në vendin e pestë, rezulton se kanë paraqitur oferta të njëjta. Është bërë në SPE njoftimi për hedhje shorti me datë zhvillimi 11.04.2023, ora 14.00.
Është mbajtur procesverbali për hedhjen e shortitku rezulton i renditur në vend të parë OE Arena MK.
OE fitues, ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor*.
Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:
1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 11 të Ftesës për Ofertë për certifikatën PASS 99. Certifikata

e paraqitur BS PAS 99:2012, rezulton e lëshuar nga subjekti "CeR.", subjekt i cili nuk ka akreditimin përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për lëshimin e kësaj certifikate si dhe nuk ka akredimin nga Institucione Ndërkombëtare Akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
2.OE ka mangësi me pikën 10 të Ftesës për Ofertë lidhur me kërkesën për një punonjës të certifikuar "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë". Është paraqitur certifikatë trajnimi lëshuar në emër të punonjësit E.M. nga subjekti "A.Cert.", certifikatë e cila është lëshuar nga subjekte pa akreditimin përkatës për këto certifikime, e cila rezulton gjithashtu jashtë vlefshmërie nga data 27.12.2022. Është paraqitur gjithashtu një certifikatë e lëshuar nga subjekti "CeR". në emër të të njëjtin punonjës për "shëndetin dhe sigurinë në punë", e cila rezulton gjithashtu pa akreditimin përkatës.
Janë paraqitur edhe dy certifikata të tjera në emër të punonjëses N. M., njëra për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në punë" dhe tjetra për "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", të dyja të lëshuara nga subjekti "A.Cert", i cili nuk ka akreditimin përkatës për këto certifikime.
Sa më sipër, oferta e këtij BOE nuk duhej kualifikuar dhe shpallur fitues.
Kualifikimi i tyre është bërë në kundërshtim me nenin 92 pika 3 të LPP dhe nenin 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është lidhur kontrata nr. 568/5 prot., datë 18.04.2023, me afat 30 ditë kalendarike nga momenti i lidhjes së saj.
Është lëshuar fatura tatimore nr. 26/2023, datë 02.05.2023, likuiduar me urdhër xhirimi nr. 4, datë 06.11.2023.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Blerjeve të Vogla, E.P., E.Ç., A.XH. dhe S.P..

Viti 2024

-Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2024 janë zhvilluar 12 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit pa tvsh për vlerën prej 5,623 mijë lekë, dhe vlerën e kontratës prej 4,946 mijë lekë (88% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 671 mijë lekë, nga të cilat 3 procedura janë blerje nën 100,000 lekë.

- Për vitin 2024, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. E.S. me nr. 01 dhe nr. 44 Prot., datë 09.01.2024, me përbërje si vijon:

4. E.P. – Kryetar
5. E.Ç. – Anëtar
6. A.XH. – Anëtar

I ndryshuar me Urdhrin nr. 30 dhe 44/1 prot., datë 23.08.2024 ku zëvendësohet anëtari E.Ç. me I.D. dhe anëtari A.XH. me E.D..

U krye testimi i disa prej procedurave të ndjekura si vijon:
1-Me urdhër prokurimi nr. 26, datë 11.06.2024 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Riparim depo uji/ sistem pompimi dhe pastrim depo".***
Administrohet kërkesa nga Departamenti Teknik me nr. 1384 prot., datë 05.06.2024 me objekt "Riparim depo uji/ sistem pompimi dhe pastrim depo", miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm E.M., kërkesa të mbështetura në Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të UKK Sh.A me nr. 8, datë

19.12.2023 “Për miratimin e planit ekonomiko – financiar të vitit 2024”.
Me urdhër nr. 317/1 prot., datë 20.02.2023 është ngritur komisioni për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga E.S., F.XH dhe F.K.
Është hartuar një procesverbal pa nr., datë 11.06.2024 për argumentimin dhe miratimin e e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim nga ana e anëtarëve të KBV, i cili është ngarkuar gjithashtu në SPE.
Është hartuar ftesa për ofertë, me nr. 1468/1 prot., datë 11.06.2024 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 12.06.2024.
Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se kriteri i pikës 7 paraqet mangësi. Është kërkuar nga OE të disponojnë 1 Inxhinier Elektrik i cili të figurojë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit.
Lidhur me këtë kriter, së pari argumentimi i dhënë në procesverbal nuk është i plotë dhe i detajuar se përse kërkohet pikërisht inxhinier elektrik, ndërkohë që në procesverbal nuk i referohen inxhinierit elektrik, por në dy momente përcaktohet inxhinier elektronik. Gjithashtu, kërkesa që të jetë detyrimisht 3 muajt e fundit në listëpagesa është kërkesë në kundërshtim me nenin 41 pika 4 germa (b) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën që kanë AK për të kërkuar një listë të personelit kryesor të nevojshëm për zbatimin e kontratës, pa përcaktuar detyrimin e periudhës për të cilën duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.
Sipas procesverbalit të datës 14.06.2024, evidentohet se kanë marrë pjesë 14 OE, nga të cilët 10 OE janë kualifikuar, ndërsa 4 OE janë s’kualifikuar, konkretisht 3 OE për oferta mbi fondin limit dhe 1 OE për mungesë të objektit të aktivitetit në QKB.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	J.	456,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	E.B.	459,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	F.	464,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	A.	466,600	***Kualifikuar / Skualifikuar***
5	A. Pro	470,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
6	E. G. Co.	485,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
7	K. Shpk	489,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
8	O.H.	492,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
9	E.Ko.&T.	494,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
10	O.M.M.	494,000	***Kualifikuar / Fitues***

Të renditurit nga vendi i parë deri në vend të nëntë, rezulton se nuk janë paraqitur por kanë dërguar nëpërmjet SPE njoftimin e tërheqjes. Në secilin rast janë mbajtur procesverbalet për kalimin tek OE i radhës, sipas përcaktimit të paragrafit të dytë te pikës 18 të Udhëzimit nr. 5 të APP.
Është mbajtur procesverbali i Fituesit Përfundimtar, ku data e vendosur në procesverbal është 14.06.2024, datë e cila është vendosur gabim pasi referuar hapave të ndjekur, njoftimi i fituesit për këtë OE sipas SPE është bërë me datë 03.07.2024.
I renditur në vend të dhjetë dhe i shpallur fitues, subjekti O.M.M., ka dorëzuar dokumentacionit i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit.
Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *“Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”*, neni 17 i cili përcakton se *“Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)”*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se:

"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6.", si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Është lidhur kontrata me nr. 1468/2 prot., datë 12.07.2024 me afat 30 ditë pune nga momenti i lidhjes së saj.
Me urdhër nr. 1468/3 prot., datë 26.07.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të punimeve i përbërë nga F.Xh, A.C. dhe F.K. Punimet janë marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 1468/4 prot., datë 26.07.2024, sipas të cilit punimet janë kryer në përputhje me projektin dhe specifikimet e kërkuara.
Është mbajtur procesverbali nr. 1468/4 prot., datë 26.07.2024 për marrjen në dorëzim të punimeve.
Është lëshuara fatura me nr. 40/2024, datë 29.07.2024, likuiduar me Urdhër Transfertën e datës 14.08.2024 nga një bankë e nivelit të dytë.

2- Me urdhër prokurimi nr. 1045 prot., datë 22.04.2024 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Blerje materiale Higjeno - sanitare".***
Është administruar kërkesa me nr. 939 prot., datë 09.04.2024 nga Departamenti Administrativ drejtuar Sektorit Ligjor dhe Prokurimeve për kryerjen e procedurës me objekt "Blerje materiale higjieno – sanitare për nevojat e Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.A", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
Me urdhër nr. 939/1 prot., datë 09.04.2024 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga N.M., E.Gj dhe R.L..
Specifikimet teknike dhe sasitë janë përcaktuar me procesverbalin nr. 939 prot., datë 19.04.2024.
Është mbajtur procesverbali për përllogaritjen e fondit limit i datës 19.04.2024, sipas të cilit komisioni i është referuar çmimeve të tregut bë faqet online të 3 subjekteve, duke përcaktuar mesataren e tyre në vlerën e fondit limit 499,717 lekë.
Është hartuar procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili është publikuar në SPE.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 1045/1 prot., datë 22.04.2024 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 23.04.2024.
Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se kriteri i pikës 6 i cili kërkon nga OE të paraqesin vërtetim që nuk kanë detyrime të pashlyera kundrejt Ujësjellës Kanalizime Kamëz, është kriter i pakuptimtë pasi UK Kamëz mund të verifikojë nëpërmjet sistemit të debitorëve nëse kanë apo jo detyrime subjektet.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, është mbajtur procesverbali i datës 24.04.2024 për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 19 OE, nga të cilët 17 OE janë kualifikuar dhe 2 OE janë skualifikuar, ku në 1 rast oferta është më e lartë se fondi limit dhe në 1 rast oferta është nën 50% të fondit limit. Është pasqyruar nëse OE kanë objektin e aktivitetit sipas ekstraktit të QKB, sipas pikës 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	E.&E.	250,000	***Kualifikuar / Fitues***

I rendituri në vend të parë dhe OE fitues, E.&E. ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është

administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:
OE nuk ka paraqitur vërtetimin se nuk ka detyrime të pa shlyera ndaj Ujësjellës Kanalizime Kamëz, në kundërshtim me pikën 6 të Ftesës për ofertë.
Me urdhrin e brendshëm me nr. 1122 prot., datë 30.04.2024 është ngritur komisioni i përbërë nga M. B., M. D. dhe E.Gj.
Është lëshuar fatura tatimore me nr. 20/2024, datë 03.05.2024, likuiduar me Urdhër Transfertën datë 23.05.2024 pranë një banke të nivelit të dytë.
Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me FH nr. 13, datë 03.05.2024.

3-Me urdhër prokurimi nr. 16, datë 26.04.2024 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Blerje vaj, filtra, goma dhe të tjera pjesë këmbimi".***
Është administruar kërkesa nga Departamenti Teknik me nr. 940 prot., datë 09.04.2024 "Për blerje vaj+filtra, goma dhe të tjera pjesë këmbimi, miratuar nga Titullari i AK.
Me urdhrin e brendshëm me nr. 940/1 prot., datë 09.04.2024 për ngritjen e komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, është ngritur grupi i punës i përbërë nga A.C., S. Ç.dhe N.B..
Me procesverbalin me nr. 940/2 prot., datë 16.04.2024, komisioni ka pasqyruar testimin e tregut duke bashkëlidhur 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, duke përcaktuar fondin limit në vlerën **1,000,000 lekë.**
Në dosje nuk disponohet procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili kërkohet të jetë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe të firmoset nga secili nga anëtarët sipas përcaktimit të pikës 2 paragrafi i fundit i nenit 78 të VKM-së nr. 285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, por ky PV rezulton i ngarkuar në SPE.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 1080/1 prot., datë 26.04.2024 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 29.04.2024.
Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se kriteri i pikës 6 i cili kërkon nga OE kategorinë e licencës VII.3.B.1.a është jo në përputhje me objektin e prokurimit i cili është për blerje mallrash, ndërkohë kjo licencë është për "Riparim dhe mirëmbajtje të pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove". Referuar preventivimit dhe vetë objektit të procedurës, bëhet fjalë për blerje mallrash dhe jo shërbim. Gjithashtu, kërkesa edhe për kategorinë e licencës VII.3.B.3 nuk figuron si licencë me këto të dhëna në regjistrin e licencave.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, është mbajtur procesverbali i datës 02.05.2025 për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 19 OE,

nga të cilët 2 OE janë kualifikuar dhe 17 OE janë skualifikuar. S'kualifikimi i OE është bërë për arsye se nuk kanë licencë aktive në kateogoritë VII.3.B.1.a dhe VII.3.B.3.
sipas pikës 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	S.	500,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	B.M.	845,800	***Kualifikuar / Fitues***

Në dosje rezulton i mbajtur një procesverbal me nr. 1080/2 prot., datë 02.05.2024 "Formular për njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit", për të cilin sqarohet se anulimi bëhet bazuar në nenin 98 pika 1 germa (c) të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, pasi janë konstatuar se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme. Sipas KBV është konstatuar se nuk është hedhur në SPE procesverbali i argumentimit të kritereve por është hedhur procesverbali i argumentimit të fondit limit.
Referuar këtij konstatimi, nga verifikimi rezulton se është hedhur procesverbali i duhur, pra ai për argumentimin e kritereve pra nuk qëndron të jetë bërë gabim në dokumentet e tenderit, të paktën për shkakun e cituar më sipër.
Në vijim, pavarësisht se është mbajtur procesverbali i anulimit, rezulton se procedura ka vijuar, duke u njoftuar i rendituri në vend të parë, OE S., i cili rezulton se është tërhequr duke paraqitur njoftimin përkatës në sistem. Është bërë nëpërmjet sistemit njoftimi i OE të radhës me datë 03.05.2024, konkretisht subjektit B.M., i cili ka paraqitur dokumentacionin pranë AK, dokumentacion i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit.
Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se OE nuk përmbush kriterin e pikës 6 për kategorinë e licencës me Kod VII.3.B.3. OE ka paraqitur dy licenca, konkretisht atë me Kod VII.3.B.1 dhe licencën me Kod III.1.B. Vlen të theksohet se pikërisht me argumentin e mangësive që lidhen me kategoritë e licencës, janë s'kualifikuar 17 OE të tjerë, pasi sipas KBV, nga verifikimet e kryera në QKB, nuk kanë licenca aktive që lidhen me kodet e mësipërme.
OE ka mangësi që lidhen me pikën 4 të Ftesën për Ofertë për faturën e energjisë elektrike. OE rezulton se ka paraqitur vërtetimin me nr. OSHEE-2024-1968094-YM, datë 11.04.2024, sipas të cilit ky subjekt nuk ka detyrime deri me këtë datë, **pa përfshirë faturën koherente të muajit Mars 2024.** Duke qenë se kjo procedurë, hapja dhe vlerësimi i ofertave dhe dokumentacionit është bërë në Maj 2025, kërkohet që OE të disponojnë faturat e maturuara të energjisë elektrike, që në rastin konkret do duhej që fatura e muajit Mars të ishte e likuiduar, ndërkohë nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton debitor për muajin Mars 2024.
Me urdhër nr. 940/5 prot., datë 13.05.2024 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të

mallrave i përbërë nga N.H., S.N.dhe F.Z..
Sa më sipër, oferta e këtij OE nuk duhej kualifikuar dhe shpallur fitues.
Mangësitë e mësipërme që lidhen me hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, janë në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të LPP dhe nenin 40 pika 3 dhe 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim me nr. 940/6 prot., datë 21.05.2024 në të cilin specifikohet se janë kryer shërbimet sipas kushteve.
Është lëshuar fatura tatimore me nr. 113/2024, datë 24.05.2024, likuiduar Urdhër Transfertën e datës 09.07.2024 në një bankë të nivelit të dytë.

4- Me urdhër prokurimi nr. 34, datë 14.11.2024 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Mirëmbajtje chiller kondicionimi".***
Është administruar kërkesa me nr. 2728 prot., datë 11.11.2024 nga Departamenti Teknik për kryerjen e procedurës me objekt "Shpenzim mirëmbajtje për kondicionim për nevoja të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
Me urdhër nr. 2728/1 prot., datë 14.11.2024 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike i përbërë nga F.XH, P.L dhe F.K.. Me procesverbalin me nr. 2728 prot., datë 02.12.2024 është përllogaritur fondi limit ku bazuar në testimin e tregut janë marrë 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, duke përcaktuar fondin limit në vlerën 699,650 lekë.
Është hartuar procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit dhe firmosur nga secili nga anëtarët.
Mbajtja e procesverbalit është sipas përcaktimit të pikës 2 paragrafi i fundit i nenit 78 të VKM-së nr. 285 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ndërkohë rezulton se procesverbali nuk është ngarkuar në SPE, në kundërshtim me pikën 5 nenit 78 të VKM-së nr. 285 cituar më sipër.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 2728/5 prot., datë 03.12.2024 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 06.12.2024.
Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se kriteri i pikës 6 i ftesës për ofertë, kërkon nga OE 1 inxhinier elektronik, 1 inxhinier mekanik, 2 teknik kondicionerësh dhe 1 teknik elektricist të cilët të figurojnë në listëpagesa **3 muajt e fundit**. Lidhur me kërkesën që të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit, sqarohet se kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenin 41 pika 4 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë nëpër listëpagesa. Për AK do ishte më e arsyeshme të kërkohej stafi i mësipërm i cili të figurojë minimalisht në listëpagesën e fundit të shoqërisë. Kriteri i hartuar sipas formës së mësipërme mund të kufizojë pjesëmarrjen e OE që kanë kapacitetet e nevojshme, por stafi i tyre nuk është 3 muajt e fundit në listëpagesa, por gjendet të paktën muajin e fundit në listëpagesë.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, nuk është mbajtur procesverbali por gjendet kopje e klasifikimit përfundimtar e printuar nga sistemi, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 7 OE, nga të cilët 5 OE janë kualifikuar dhe 2 OE janë skualifikuar nga të cilët 1 OE për mungesë objekti të aktivitetit në QKB, 1 OE për ofertët mbi FL. Është pasqyruar nëse OE kanë objektin e aktivitetit sipas ekstraktit të QKB, sipas pikës 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***

1	R. K. shpk	565,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	C.	597,000	***Kualifikuar / Fitues***

I rendituri në vend të parë, R. K. shpk, nuk është paraqitur por njoftuar AK për tërheqjen nëpërmjet SPE.

OE fitues, C. shpk, ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:

OE nuk përmbush kriterin e pikës 6 të Ftesës për Ofertë e cila kërkon 1 inxhinier elektronik, 1 inxhinier mekanik, 2 teknik kondicionerësh dhe 1 teknik elektricist.

Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për 1 inxhinier elektronik. Për njërin nga teknikët e kondicionerëve, ka paraqitur një certifikatë trajnimi të lëshuar nga subjekti A.Cert në emër të Y.T, ndërkohë që subjekti certifikues nuk ka akreditimin përkatës për certifikime të tilla.

Sa më sipër, oferta e këtij OE nuk duhej kualifikuar dhe shpallur fitues.

Mangësitë e mësipërme që lidhen me hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, janë në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të LPP dhe nenin 41 pika 2 dhe 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Është lidhur kontrata me nr. 3041 prot., datë 23.12.2024.

Me urdhër nr. 75 prot., datë 13.01.2025 është ngritur komisioni për zbatimin e kontratës i përbërë nga F.XH, M.Vdhe K.T..

Rezulton se lëshuar fatura me nr. 41/2025, datë 31.03.2025, likuiduar me Urdhër Transfertën e datës 04.07.2025 në një bankë të nivelit të dytë për vlerën 507,000 me TVSH, dhe fatura me nr. 225/2025 e cila nuk është likuiduar.

Është mbajtur procesverbali me nr. 75/1 prot., datë 27.11.2025 për marrjen në dorëzim të shërbimit.

5- Me urdhër prokurimi nr. 37, datë 05.12.2024 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Rehabilitim dhe ndërtim burimi nr. 3".***

Është administruar kërkesa me nr. 2932 prot., datë 05.12.2024 nga Departamenti Teknik për kryerjen e procedurës me objekt "Rehabilitim dhe Ndërtim Burimi Nr. 3", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Është hartuar një preventiv pa çmime me nr. 1835 prot., datë 29.07.2024 nga inxhinierët B.H, E.S., A.C.dhe M.H., të cilët kanë hartuar edhe projektin dhe specifikimet teknike, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Sh.L.

Përllogaritja e fondit limit është bërë bazuar në testimin e tregut, ku janë administruar 3 oferta nga

subjekte ndërtimi, mesatare e të cilave rezulton 686,109 lekë, si dhe një analizë çmimi nga inxhinier B.H për njërin zë të preventivit në vlerën 7,675 lekë.
Në sistem, rezulton se FL është ngarkuar në vlerën 999,198 lekë, vlerë e cila nuk argumentohet me procesverbalet e mbajtura për këtë qëllim.
Është hartuar procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili nuk është ngarkuar edhe në SPE, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 78 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 2932/3 prot., datë 24.12.2024 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 27.12.2024.
1.Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se kriteri i pikës 6 i ftesës për ofertë, kërkon nga OE 1 inxhinier hidro, 1 inxhinier ndërtimi dhe 1 inxhinier elektrik, të cilët duhet të jenë në listëpagesa 3 muajt e fundit. Kërkesa që të figurojnë në listëpagesa 3 muajt e fundit, nuk është në përputhje me nenin 39 pika 6 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë nëpër listëpagesa. Për AK do ishte më e arsyeshme të kërkohej stafi i mësipërm i cili të figurojë minimalisht në listëpagesën e fundit të shoqërisë. Kriteri i hartuar sipas formës së mësipërme mund të kufizojë pjesëmarrjen e OE që kanë kapacitetet e nevojshme, por stafi i tyre nuk është 3 muajt e fundit në listëpagesa, por gjendet të paktën muajin e fundit në listëpagesë.
2.Gjithashtu, rezulton se kriteri i pikës 9 e cila kërkon nga OE disa kategori të licencës së ndërtimi, kërkohet që të disponojnë kategorinë NP1-B dhe NP-9B. Kërkesa që të disponojnë kategoritë B të licencës nuk është në përputhje me vlerën e investimit e cila është nën 1,000,000 lekë, ndërkohë që kategoria B është për punimet ndërmjet 20 milion deri në 50 milion lekë.
Kërkesa e pikës 10 e cila kërkon nga OE të zotërojnë aparat elektrufuziv, miniekskavator ose fadromë dhe saldatriçe, është e pa plotë, pasi nuk përcakton se çfarë dokumentesh duhet të paraqesin OE për të provuar disponimin e këtyre mjete/pajisje të nevojshme për zbatimin e kontratës.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, në dosje nuk disponohet procesverbali i për hapjen e tyre dhe pasqyrimin e OE pjesëmarrës, por është mbajtur një kopje e klasifikimit përfundimtar sipas SPE, nga ku rezulton se kanë marrë pjesë 7 OE, nga të cilët 3 OE janë kualifikuar dhe 4 OE janë skualifikuar për arsye se nuk kanë objektin e aktivitetit në QKB.

OE Pjesëmarrës me oferta të kualifikuara.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	B.Sh.C	909,008	***Kualifikuar / Fitues***

I rendituri në vend të parë dhe OE fitues, B.Sh.C shpk, ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të*

kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.
Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:
1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 3 për faturën e energjisë elektrike dhe kriterin e pikës 8, 9 dhe 10 për certifikatat ISO 90012015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018. Dokumentet e paraqitura rezultojnë fotokopje me ngjyra të panoterizuara, në kundërshtim me paragrafin e fundit të ftesës për ofertë i cili përcakton se të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.
2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 6 të Ftesës për ofertë për 3 inxhinier, konkretisht 1 ndërtim, 1 hidro dhe 1 elektrik. OE ka paraqitur të cilët të figurojnë 3 muajt e fundit në listëpagesa. OE ka paraqitur dokumente për 3 inxhinierë, konkretish Q.K. inxhinier ndërtimi (kontratë + kopje diplome), E.D. inxhinier elektrik (kontratë + kopje diplome) dhe E. N. inxhinier hidro (kopje kontrate + kopje diplome). Diplomat e paraqitura për këta 3 punonjës, rezultojnë fotokopje të panoterizuara. Gjithashtu, OE ka paraqitur listëpagesat e muajve Prill, Maj dhe Qershor, ndërkohë në ftesën për ofertë kërkohen për 3 muajt e fundit. Në kushtet kur procedura zhvillohet ditët e fundit të muajit Dhjetor 2024, do duhet që OE të paraqiste listëpagesat e muajve Shtator, Tetor dhe Nëntor 2024.
Sa më sipër, oferta e këtij BOE nuk duhej kualifikuar dhe shpallur fitues.
Mangësitë e mësipërme që lidhen me hartimin e kritereve dhe vlerësimin e ofertave, janë në kundërshtim me nenin 77 dhe 92 pika 3 të LPP dhe nenin 41 pika 2 dhe 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është lidhur kontrata me nr. 90 prot., datë 14.01.2025, me afat realizimi për 7 ditë pune nga momenti i lidhjes së saj.
Me urdhër nr. 90/1 prot., datë 20.01.2025 të Titullarit, është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të punimeve i përbërë nga K.D., A.P. dhe B.M..
Është mbajtur procesverbali me nr. 296/1 prot., datë 13.02.2025 për marrjen në dorëzim të punimeve, ku përcaktohet se punimet kanë filluar me datë 15.01.2025 dhe mbaruar me datë 22.01.2025. Rezulton e paargumentuar se pse procesverbali është mbajtur 3 javë pas përfundimit të punimeve, dhe jo në momentin e përfundimit të tyre.
Sipas procesverbalit, punimet përmbushin kushtet e kontratës së punimeve.
Është lëshuar fatura tatimore nr. 8/2025, datë 06.02.2025, likuiduar me Urdhër Transfertën datë 04.03.2025 në një bankë të nivelit të dytë.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Blerjeve të Vogla, E.P., E.Ç., A.XH., I.D. dhe E.D..

<u>Viti 2025</u>
-Sipas regjistrave të realizimit të dërguar në APP, për vitin 2025 janë zhvilluar 13 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit pa tvsh për vlerën prej 8,590 mijë lekë, dhe vlerën e kontratës prej 7,049 mijë lekë (82% e fondit limit), me një diferencë nga fondi limit prej 1,540 mijë lekë.

- Për vitin 2025, është ngritur Komisioni për blerjet e vogla me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor z. SH.L. me nr. 3091 Prot., datë 30.12.2024, me përbërje si vijon:

1. E.P. – Kryetar
2. E.D. – Anëtar
3. I.D. – Anëtar

U krye testimi i disa prej procedurave të ndjekura si vijon:

1-Me urdhër prokurimi nr. 23, datë 24.07.2025 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Uniforma dhe veshje të tjera pune speciale".***

Administrohet kërkesa nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse me nr. 1378 prot., datë 03.07.2025 me objekt "Uniforma dhe veshje të tjera speciale", miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm Sh.L, kërkesa të mbështetura në Vendimin e Asamblesë së Përgjitshme të UKK Sh.A me nr. 7, datë 18.12.2024 "Për miratimin e planit ekonomiko – financiar të vitit 2025".

Me urdhër nr. 1378/1 prot., datë 07.07.2025 është ngritur komisioni për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga K.D., N.M. dhe A.M..

Është hartuar procesverbali me nr. 1378/2 prot., datë 22.07.2025 për argumentimin dhe miratimin e e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit, sipas të cilit janë administruar 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, mesatare e të cilave ka rezultuar 1,008,733 lekë. Në vijim, bazuar në këtë mesatare, komisioni ka përcaktuar përfundimisht vlerën **1,000,000 lekë** të fondit limit.

Është hartuar procesverbali i datës 24.07.2025 për argumentimin dhe miratimin e kritereve kualifikuese, i cili është ngarkuar edhe në SPE.

Është hartuar ftesa për ofertë, me nr. 1378/7 prot., datë 24.07.2025 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 25.07.2025.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 24 OE, nga të cilët 19 OE janë kualifikuar, ndërsa 5 OE janë s'kualifikuar, konkretisht 1 OE për ofertaë nën 50% të fondin limit dhe 4 OE për mungesë të objektit të aktivitetit në QKB.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	As.	500,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	I.H.	650,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	2.G.	650,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	M.	697,500	***Kualifikuar / Skualifikuar***
5	G.	734,000	***Kualifikuar / Fitues***

I rendituri në vend të parë, As. nuk është paraqitur duke njoftuar tërheqjen.

I rendituri në vend të dytë dhe të tretë të cilët kanë oferta të njëjta, nga verifikimi nuk rezulton të jetë njoftuar hedhja e shortit për shpalljen e fituesit, në kundërshtim me pikën 16 të Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

Është njoftuar i rendituri në vend të dytë, I.H., e cila nuk është paraqitur duke mos njoftuar tërheqjen.

I rendituri në vend të tretë, 2AK është tërhequr duke njoftuar.

I rendituri në vend të katërt, Melbertex, është paraqitur, por pas verifikimit të mostrave, ka rezultuar se nuk përputheshin me specifikimet teknike të vendosura, pasqyruar me procesverbalin e datës 01.08.2025.

I rendituri në vend të pestë dhe i shpallur fitues, subjekti Grelek, ka dorëzuar dokumentacionit i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit.

Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se:

"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6.", si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Është lidhur kontrata me nr. 1378/8 prot., datë 11.08.2025 me afat 20 ditë nga momenti i lidhjes së saj.
Me urdhër nr. 1378/9 prot., datë 12.08.2025 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave i përbërë nga P.L, V. P. dhe M. B.. Mallrat janë marrë në dorëzim me procesverbalin nr. 1378/10 prot., datë 25.08.2025, sipas të cilit malli i plotëson specifikimet e kërkuara. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me FH nr. 25, datë 25.08.2025.
Është lëshuara fatura me nr. 9/2025, datë 25.08.2025, likuiduar me Urdhër Tranfertën e datës 12.11.2025 nga një bankë e nivelit të dytë.

2- Me urdhër prokurimi nr. 27 prot., datë 20.08.2025 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Blerje licencë për Program Faturimi dhe Arkëtimi, migrim të dhënash historike, dhe mirëmbajtja e tij".***
Është administruar kërkesa me nr. 1793 prot., datë 14.08.2025 nga Departamenti Ekonomik drejtuar Sektorit Ligjor dhe Prokurimeve për kryerjen e procedurës me objekt "Blerje licence dhe program faturimi dhe arkëtimi, migrim të dhënash historike dhe mirambajtja e tij", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
Me urdhër nr. 1793/1 prot., datë 15.08.2025 është ngritur komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit i përbërë nga V. P., F. Xh. dhe E. K..
Me procesverbalin nr. 1793/2 prot., datë 18.08.2025 është mbajtur relacioni për specifikimet teknike
Me procesverbalin me nr. 1793/3 prot., datë 18.08.2025 është miratuar fondi limit, sipas të cilit janë marrë 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, mesatare e së cilit ka rezultuar 1,046,666 lekë, dhe grupi i punës ka vendosur përcaktimin final në vlerën **1,000,000 lekë.**
Është hartuar procesverbali për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikuese, i cili është ngarkuar edhe në SPE.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 1829/1 prot., datë 20.08.2025 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 21.08.2025.
Lidhur me kriteret e vendosura, rezulton se ato janë hartuar nga KBV, ku asnjëri nga anëtarët e tij nuk është specialist fushe që lidhet me IT ose shërbime të tilla. Konstatohet se kriteri i pikës 4 i cili kërkon 4 punonjës të diplomuar në fushën IT, specifikon që duhet të paktën të disponojë,

a) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ne gjuhën qe është ndërtuar programi që do të ofertohet;
b) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar per Certified SOA Professional (profesionist i certifikuar per arkitekture orientuar nga sherbimet) ose ekuivalent;
c) Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente);
d) Të paktën 1 (një) punonjës te Certifikuar per Implementimin dhe Menaxhimin e Sistemeve të Sigurisë së Informacionit (CISM ose ekuivalent).

Kriteri i mësipërm, nuk ka argumenetim të plotë dhe shterues për nevojën për 4 punonjësit e

mësipërm. Gjithashtu, kërkesa që të paraqiten formularët E-Sig të 3 muajve të fundit, e cila kërkohet për disponimin 3 muajt e fundit të këtij stafi, nuk është në përputhje me nenin 41 pika 4 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën për të kërkuar fuqinë punëtore, pa përcaktuar periudhën se kur duhet të disponohen në listëpagesa.
2.GJithshtu, rezulton se në pikën 8 të Ftesës për Ofertë, është kërkuar që OE duhet të kenë realizuar të paktën 2 kontrata shërbimi të ngjashme me objektin e prokurimit të realizuara gjatë 2 viteteve të fundit. Kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 41 pika 3 të VKM-së nr. 285, cituar më sipër, e cila përcakton se për kërkesat për përvojën e mëparshme duhet të paraqitet një ose disa kontrata të realizuara përgjatë 3 viteteve të fundit. Sa më sipër, kërkesa e hartuar nga KBV është në kundërshtim me kuadrin rregullator.
Mbi hapjen e procedurës nuk ka procesverbal të mbajtur, por është printuar nga sistemi klasifikimi përfundimar, ku rezulton se kanë marrë pjesë 3 OE.

Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	P. Al.	570,000	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	K.	970,000	***Kualifikuar/ Fitues***

I renditur në vend të parë, P. A., rezulton sipas procesverbalit të mbajtur për kalimin tek OE i radhës, se është skualifikuar për shkak se nuk plotëson kriterin e pikës 4 germa (b) për të paktën 1 punonjës të certifikuar për Certified SOS Profesional. Kjo kërkesë nuk përmbushet nga OE P. A. në bashkëpunim me N. A. C. shpk, pasi OE nuk ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm për certifikatë SOA ose ekuivalente të saj pasi dokumentacioni i paraqitur është një kurs profesional online dhe jo një certifikatë e standartizuar profesionale e lëshuar nga institucione të akredituara, si dhe germën (d) për të paktën një punonjës të certifikuar për implementimin dhe menaxhimin e sistemeve të sigurisë së informacionit (CISM ose ekuivalente). Edhe për këtë pikë, OE ka paraqitur një certifikatë pjesëmarrje në kurse online dhe jo një certifikatë CISM. Gjithashtu, OE nuk ka dorëzuar formularët E-SIG për periudhën 3 muajt e fundit.
Mbi vlerësimin e mësipërm, është mbajtur edhe procesverbali i datës 25.08.2025, ndërkohë që nuk ka asnjë procesverbal tjetër të mbajtur për vlerësimin e OE fitues, i cili është i renditur në vend të dytë, KreatX.
Mbi shkaqet e skualifikimit, rezulton se nga BOE P. A. & N. A. C., është paraqitur ankesë drejtuar AK.
Në këtë ankesë, BOE sqaron se lidhur me shkaqet e skualifikimit, janë paraqitur këto certifikata edhe gjatë vitit 2025 të paktën në dy raste ku për kërkesa të njëjta janë vlerësuar të rregullta nga KVO. Për 1 punonjës të certifikiuar për implementimin dhe menaxhimin e sistemeve të sigurisë së informacionit (CISM ose ekuivalente), është propozuar punonjësi G. M. pse të cilin është paraqitur certifikata Netëork Security, kjo referuar termit ekuivalent, dhe ju nuk mund të kufizoni burimet e marrjes/ sigurimit të certifikimeve të stafit të OE.
Lidhur me Formularët E-SIG 25, sqarohet se janë paraqitur formularët e gjeneruar nga sistemi i DPT të cilët janë konsideruar të rregullt në çdo procedurë tjetër të realizuar. Duke qenë se procedura është zhvilluar me datë 21.08.2025, nënkuptohet se janë shlyer detyrimet e tatimeve, kontributet e muajit Korrik 2025 brenda datës 20.08.2025. Lidhur me sa më sipër, OE kërkon revokimi i vendimit të KVO.
Lidhur me këtë ankesë, është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1873 prot., datë 28.08.2025 , sipas së cilës njoftohet OE se ankesa e paraqitur është në kundërshtim me ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 148 (ky nen është cituar gabim pasi nuk ekziston), si dhe VKM nr. 285,

datë 19.05.2021, pasi afati për paraqitjen e ankesës është brenda dy ditëve nga data e publikimit të njoftimit të fituesit në SPE, dhe kjo ankesë është paraqitur jashtë afatit.

OE fitues, K., ka paraqitur dokumentacionin i cili nuk është administruar nëpërmjet zyrës së protokollit por dorëzuar dorazi dhe administruar për vlerësim nga anëtarët e KBV. Kjo praktikë e administrimit vjen në kundërshtim me *"Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"*, neni 17 i cili përcakton se *"Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Bëhet shënimi në to i numrit të protokollit e data e marrjes, i jepen titullarit ose zëvendësit të tij dhe, sipas destinacionit, shpërndahen në sektorët përkatës kundrejt firmës (Mod. 1)"*, si dhe nenin 19 pika 1 i cili citon se: *"Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshtetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen: 1. Në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshtetëror, me përjashtim të atyre të përmendura në nenin 6."*, si dhe pikës 17 të Udhëzimit nr. 5 e cila përcakton se se *Dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në Ftesën për Ofertë, duhet të dorëzohet nga operatori ekonomik fitues, në Zyrën e protokollit të autoritetit/entit kontraktor.*
Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:
-OE nuk përmbush kriterin e pikës 5 për certifikatat ISO të kërkuar. Konkretisht, për certifikatat ISO 9001:2015, ISO/ IEC 20000-1:2018 dhe ISO/IEC 27001:2022, ku rezulton se janë paraqitur këto certifikata të lëshuara nga subjekti CertiË, subjekt i cili nuk është i akreditуar nga organi akreditues i Republikës së Shqipërisë, dhe nuk ka gjithashtu akreditimin nga organizma ndërkombëtar akreditues. Kjo certifikatë rezultone lëshuar nga LATAK i cili është organi akreditues i Letonisë.
Sa më sipër, rezulton se ky OE nuk plotëson kriteret e vendosura, dhe kualifikimi i tyre është bërë në kundërshshtim me nenin 92 pika 3 të LPP dhe nenin 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Gjithashtu, theksohet se për mangësi vogla të cilat sipas grupit të auditimit kanë ardhur edhe për shkak të kritereve, është skualifikuar oferta me e favorshme, ajo e OE P.Al. me vlerë 570,000 lekë, ndërkohë që është kualifikuar oferta ekonomike e OE K. me vlerë 970,000 e cila rezulton me mangësi në plotësimin e kritereve. Si pasojë e këtyre vendimmarrjeve, është shkaktuar shpenzim pa ekonomicitet për buxhetin e UK Kamëz në vlerën 400,000 lekë.
Është lidhur kontrata me nr. 1829/5 prot., datë 03.09.2025.
Me urdhrin e brendshëm me nr. 1829/6 prot., datë 04.09.2025 është ngritur komisioni për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës i përbërë nga B. M., E. K. dhe M. M.. Nuk ka procesverbal për marrjen në dorëzim të programit.
Është lëshuar fatura tatimore me nr. 932/2025, datë 18.09.2025, likuiduar me urdhër xhirimi datë 28.10.2025.

3-Me urdhër prokurimi nr. 36, datë 17.09.2025 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Kolaudim punimesh për objektin "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Fruti Kulturës Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz".***
Është administruar kërkesa nga Departamenti Teknik me nr. 1988 prot., datë 11.09.2025 "Kolaudim punimesh për objektin "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Fruti Kulturës Valias i Vjetër, Bashkia Kamëz", miratuar nga Titullari i AK.
Përllogaritja e fondit limit është bërë nga inxhinierët B.H, E.S. dhe D.N., bazuar në neni 39 pika b

dhe d të VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave të shërbimit në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", duke përcaktuar vlerën maksimale 9805,202 lekë) dhe minimale (686,505 lekë).
Është hartuar procesverbali oër argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikuese, i cili është ngarkuar edhe në SPE.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 1988/2 prot., datë 26.09.2025 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 29.09.2025.
Lidhur me kriteret e vendosura, përgjithësisht janë në përputhje me objektin e procedurës, por theksohet se kërkesa e pikës 7 e cila kërkon stafin e inxhinierëve të jenë 3 muajt e fundit në listëpagesa, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 41 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, pasi nuk përcaktohen në këtë nen afate për punonjësit por vetëm disponueshmëria e tyre. Për AK duhet të mjaftohet me disponimin muajin e fundit.
Mbi hapjen e procedurës për vlerësimin e ofertave, nuk ka procesverbal të mbajtur, por vetëm kopje nga klasifikimi përfundimtar sipas sistemit, ku evidentohet se kanë marrë pjesë 18 OE, nga të cilët 12 OE janë kualifikuar dhe 6 OE janë skualifikuar për oferta poshtë vlerës minimale sipas VKM-së nr. 254 cituar më sipër.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	I.-18	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	2. H. S.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	A. 2.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
4	A. C.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
5	B.Y.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
6	B. P.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
7	L.-Ge.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
8	P.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
9	R.95.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
10	T. V.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
11	V. E.	686,505.54	***Kualifikuar / Skualifikuar***
12	Xh&M.	686,505.54	***Kualifikuar / Fitues***

Janë 12 OE me oferta të njëjta, të cilët janë njoftuar për hedhjen e shortit i cili mbahet me datë 30.09.2025. Është mbajtur procesverbali për hedhjen e shortit, ku është pasqyruar se kanë marrë pjesë 10 OE, dhe në vend të parë është renditu OE Xh&M.
Rezulton se dokumentacioni i OE fitues është dorëzuar pranë AK me nr. 2168 prot., datë 01.10.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 1988/3 prot., datë 08.10.2025 me afat 30 ditë nga dita e përfundimit të punimeve nga firma ndërtuese.
Është lëshuar fatura tatimore me nr. 29/2025, datë 19.12.2025, e cila nuk është likuiduar.

4-Me urdhër prokurimi nr. 11, datë 12.02.2025 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Blerje pjesë këmbimi auto dhe shërbim mjete transporti".***
Është administruar kërkesa nga Departamenti Teknik me nr. 332 prot., datë 12.02.2025 për "Blerje pjesë këmbimi auto dhe shërbim mjete transporti", miratuar nga Titullari i AK.
Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Titullari me dokumentin nr. 332/3 prot., datë 12.02.2025.
Është hartuar preventivi ku përcaktohen nevojat e shërbimit për 4 mjete vlera e të cilit është **1,000,000 lekë.** Për përcaktimin e kësaj vlere, është hartuar procesverbali me nr. 332/5 prot., datë 12.02.2025, ku komisioni ka administruar 3 oferta nga subjkete që kanë për aktivitet objektin e

prokurimit duke nxjerrë mesataren e tyre, të cilat administrohen në dosje.
Është hartuar procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve kualifikuese, por rezulton se ky procesverbal nuk është ngarkuar në SPE, në kundërshtim me nenin 78 pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 332/7 prot., datë 12.02.2025 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 18.02.2025.
Kriteret përgjithësisht janë minimale.
Në këtë procedurë rezulton se kanë marrë pjesë 25 OE nga të cilët 14 OE janë kualifikuar dhe 11 OE janë skualifikuar, nga të cilët 10 OE për mungesë të objektit të shërbim apo servis automjetesh në QKB dhe 1 OE për ofertë anomalisht të ulët.
sipas pikës 15 germa (a) të Udhëzimit nr. 5.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	C.	550,120	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	J.	848,000	***Kualifikuar / Fitues***

I renditur në vend të parë, CRF, është tërhequr nga oferta duke njoftuar por pa dhënë shkaqet e tërheqjes.
I renditur në vend të dytë, J., ka dorëzuar dokumentacionin e administruar me nr. 332/8 prot., datë 21.02.2025.
Është lidhur kontrata me nr. 332/9 prot., datë 25.02.2025 me afat zbatimi 7 ditë nga data e lidhjes së kontratës (neni 3). Në nenin 7 të kontratës "Sanksionet", përcaktohet se nëse nuk përfundim kontrata brenda afatit të parashikuar në nenin 3 ose nuk njofton AK për arsyet e vonesat, nuk garanton cilësinë apo kur AK konstaton se nuk përmbushet cilësia e parashikuar, atëherë kontrata zgjidhetr
Në këtë nen nuk përcaktohet penalitete tjera për kamatvonesa që lidhen me mos zbatimin e afatit 7 ditë.
Me urdhër nr. 332/10 prot., datë 19.03.2025 është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mjeteve i përbërë nga T. D., P.L dhe E.B..
Rezulton se është mbajtur procesverbali për marrjën në dorëzim të shërbimit për mjetet me nr. 332/11 prot., datë 26.03.2025 nga komisioni i mësipërm. Sipas këtij procesverbali përcaktohet se mbajtja e tij është bërë me datë 19.03.2025. Konstatohet se marrja në dorëzim e mallrave është bërë jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në nenin 3 të kontratës. Sa më sipër, kontrata rezulton se është vonuar me 2 javë në raport me përcaktimin se procesverbali është mbajtur me datë 19.03.2026 dhe është vonuar me 3 javë në raport me protokollimin e procesverbalit. Nuk dokumentohet arsyet e mospërmbushjes brenda afatit të kësaj kontrate. Është lëshuar fatura tatimore me nr. 11/2025, datë 19.03.2025, likuiduar me urxhër xhirimin e datës 27.03.2025.

5- Me urdhër prokurimi nr. 16, datë 06.03.2025 *është urdhëruar nisa e procedurës së prokurimit me objekt* ***"Mirëmbajtjen e sistemeve të pompimit në Valias, Laknas dhe Bovillë".***
Është administruar kërkesa me nr. 397 prot., datë 25.02.2025 nga Departamenti Teknik për kryerjen e procedurës me objekt "Mirëmbajtjen e sistemeve të pompimit në Valias, Laknas dhe Bovillë", e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.
Me urdhër nr. 397/1 prot., datë 26.02.2025 është ngritur komisioni për përllogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike i përbërë nga F.XH, F.K dhe L.B.. Me procesverbalin me nr. 397/2 prot., datë 04.03.2025 është përllogaritur fondi limit ku bazuar në testimin e tregut janë marrë 3 oferta nga subjekte që kanë për aktivitet objektin e prokurimit, duke përcaktuar fondin

limit në vlerën 1,000,000 lekë.
Është hartuar procesverbali për argumentimin e specifikimeve dhe kritereve të kualifikimit, i cili është ngarkuar në SPE.
Është hartuar ftesa për ofertë me nr. 397/6 prot., datë 07.03.2025 e cila përcakton datën e zhvillimit të procedurës me 11.03.2025.
Kriteret përgjithësisht janë në përputhje me objektin e procedurë, por theksohet se kërkesa për inxhinierët të cilët të fiturojnë në listëpagesa **3 muajt e fundit**, sqarohet se kjo kërkesë nuk është në përputhje me nenin 41 pika 4 germa (c) të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, e cila përcakton të drejtën e AK për të kërkuar fuqinë punëtore për ekzekutimin e objektit të prokurimit, pa përcaktuar afate se kur duhet të figurojnë nëpër listëpagesa. Për AK do ishte më e arsyeshme të kërkohej stafi i mësipërm i cili të figurojë minimalisht në listëpagesën e fundit të shoqërisë. Kriteri i hartuar sipas formës së mësipërme mund të kufizojë pjesëmarrjen e OE që kanë kapacitetet e nevojshme, por stafi i tyre nuk është 3 muajt e fundit në listëpagesa, por gjendet të paktën muajin e fundit në listëpagesë.
Në këtë procedurë, rezulton se kanë marrë pjesë 11 OE, nga të cilët 5 OE janë kualifikuar dhe 6 OE janë skualifikuar nga të cilët 4 OE për mungesë objekti të aktivitetit në QKB, 1 OE për ofertët mbi FL dhe 1 OE me ofertë nën 50% të FL.
Për efekt hapësire tabela pasqyron ofertuesit deri tek OE fitues.

Nr	***Shoqëria OE/BOE***	***Oferta Lekë PA TVSH***	***Kualifikuar***
1	A.	927,700	***Kualifikuar / Skualifikuar***
2	T.T	948,900	***Kualifikuar / Skualifikuar***
3	E. G.	978,000	***Kualifikuar/ Fitues***
4	A.-A.	978,000	***Kualifikuar***

I rendituri në vend të parë dhe të dytë janë tërhequr nga oferta duke njoftuar nëpërmjet SPE.
Të renditurit në vend të tretë dhe të katërt, me oferta të njëjta, janë njoftuar për hedhjen e shortit i cili është mbajtur me datë 17.03.2025. Në hedhjen e shortit është paraqitur vetëm OE E. Gr. me të cilin rezulton se është lidhur edhe kontrata.
OE fitues, E. Gr., ka paraqitur dokumentacionin i cili është administruar me nr. 397/7 prot., datë 18.03.2025.
Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultuan mangësi si më poshtë:
OE nuk përmbush kriterin e pikës 5 të Ftesës për Ofertë e cila kërkon disponimin e 1 inxhinieri Elektrik dhe 1 Inxhinier Elektronik. Rezulton se ka paraqitur një kopje të diplomës për inxhinierin elektrik Enejd Skarra, e cila është fotokopje e panoterizuar si dhe mungon libreza e punës. Për inxhinierin elektrik, rezulton se është paraqitur një diplomë në emër të Amarilda Tufa, e cila rezulton diplomë për master profesional në Automatizim Industrie, ndërkohë që në Ftesën për Ofertë kërkohet inxhinier elektrik. Gjithashtu, kjo diplomë rezulton se panoterizuar si dhe mungon libreza e punës.
Mangësitë e mësipërme që lidhen me vlerësimin e ofertave, janë në kundërshshtim me nenin 92 pika 3 të LPP dhe nenin 82 pika 2 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.
Është lidhur kontrata me nr. 397/8 prot., datë 25.03.2025.
Me urdhër nr. 397/9 prot., datë 22.04.2025 është ngritur komisioni për zbatimin e kontratës i përbërë nga K.D., V. P. dhe P.L.
Është lëshuar fatura tatimore me nr. 25/2025, datë 23.07.2025 dhe nr. 36/2025, datë 07.11.2025, likuiduar me urdhër xhirimet e datës 25.08.2025 dhe 03.12.2025.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Blerjeve të Vogla, E.P., I.D. dhe E.D..

Dosjet e procedurave

-Lidhur me dosjet e procedurave të mësipërme, rezultojnë të pa inventarizuara dhe pa numerizuar, në kundërshtim me *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH", neni 8 germa (g) ku citohet se:

"...Organizimi i brendshëm i dosjes (sistemin) përfshin renditjen e dokumenteve brenda dosjes sipas disa kritereve që janë të njëjta me ato të krijimit të njësisë së ruajtjes. Kriteri i objektit përdoret kur dosja është krijuar me koncept të gjerë dhe dokumentet grupohen me nënçështjeje. Kur volumi i dokumenteve është i konsiderueshëm dhe ka të bëjë me emra personash, përdoret edhe kriteri alfabetik, më pas bëhet numërimi i dokumenteve. Të gjitha fletët e dosjes (përveç fletëve të bardha) numërohen me laps të zi grafiti në këndin e djathtë, pa cenuar tekstin".

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.6.2 ZBATIMI I PUNIMEVE

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit në UK Kamëz, nisur nga evidenca e realizimit të investimeve, me gjithsej 6 objekte, jane audituar objektet si më poshtë:

Nr	Objekti	Vlera e kontratës (me TVSH)	Sipërmarrësi	Mbikëqyrësi	Kolaudatori
1	Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a	18,714,976	OE "B." SHPK& "C." SHPK	Nuk ka	Nuk ka
2	"Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku", Kamëz	60,983,375	OE "N.S." SHPK	OE "R.95." SHPK	"G. C. Engeenering" SHPK
3	"Rehabilitim KUN-je, Rr Argjinatura deri tek Azii i Pleqëve (Rr. "Teuta", Kamëz)	17,975,340	OE "UD." SHPK	OE "R.95." SHPK	"R.S." SHPK
4	"Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz"	24,547,746	BOE "B." SHPK & "N." SHPK & "N." SHPK lekë	OE B..	A.2E" SHPK
5	"Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i vjetër Kamëz"	595,097,496	BOE "E" SHPK & "2T" SHPK	OE "Ta." SHPK	"XH&M." SHPK

1. "Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a".

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 444/7 prot., datë 29.04.2025, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz (UKK), të përfaqësuar nga administratori i UK Kamëz z. SH.L. dhe të OE "B" SHPK, me përfaqësues ligjor S. A., me licencë profesionale NZ 6671/6. Formulari i ofertës tregon se ofertuesi fitues për realizimin e këtij objekti, është BOE

“B.” SHPK & “C.” SHPK. Vlera e kontratës 18,714,976 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 90 ditë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
Nga auditimi i dosjes teknike të sipërcituar me objekt “Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a”, rezulton se punimet e ndërtimit janë ndjekur nga z. M.H., personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës, bazuar në shkresën nr. 444/10, datë 09.05.2025 të Titullarit të AK.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me nr. 2596, datë 13.11.2025, të nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, si dhe nga përfaqësuesit e investitorit, Administratori z. SH.L. dhe komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje znj. M. K., z. K.D. dhe znj. B.N, ngritur me Urdhrin me nr. 2303 prot., datë 14.10.2025. Personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës, me shkresën nr. 444/10, datë 09.05.2025 është caktuar z. M.H., me profesion inxhinier topograf.

Projektpreventivi
- Për këtë objekt, në dosje nuk administrohet leje ndërtimi. Është dhënë përgjigje nga administratorët e Lagjes Administrative nr. 1 dhe Lagjes Administrative Bathore, respektivisht me shkresat nr. 788/1 prot, datë 19.05.2025 dhe 866/1 prot, datë 19.05.2025, të cilët i janë drejtuar UKK me shkresat me lëndë “Ndërhyrje/punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi”, pa specifikuar se për kë objekt. Ky mosveprim është në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11.
- Projektpreventivi është hartuar nga Drejtoria teknike e UKK-së (B.H, D.C., R.Z. dhe M.H.).

Ky objekt është realizuar në zbatim të Marrëveshjes së Furnizimit me objekt “Mbështetje për realizimin e projekteve bashkiake infrastrukturore nëpërmjet formave të bashkëpunimit të përbashkët – materiale dhe lëndë të parë pune, për realizimin e punimeve për projektin “Ndërtimi i rrjetit KUN, rruga Nënë Tereza, Bashkia Kamëz” të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Në zbatim të kësaj marrëveshje, Kryetari i Bashkisë Kamëz ka autorizuar z. Sh.L, në cilësinë e Administratorit të UKK-së, që të ndërmarrë të gjitha veprimit ligjore procedurale, me qëllim ngritjen e Urdhrave dhe marrjen e masave në zbatim të marrëveshjes së sipërcituar.
Administratori i UKK-së z. Sh.L, ka urdhëruar nëpërmjet shkresës me nr. 2964/1, datë 10.12.2024 marrjen në dorëzim të mallrave nga komisioni i përbërë nga E. Sh., kryetar, R.Z., L.B., A.K. dhe M. B., anëtarë. Ky komision ka marrë në dorëzim 2,435 ml tuba betoni me d=1500 ml dhe 2,435 ml tuba të brinjëzuar me d=600 mm, me procesverbalet e mbajtur respektivisht në datat 10.12.2024 dhe 24.12.2024

Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 19.05.2025 dhe kanë përfunduar me datë 14.09.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.
Në dosje administohet një shkresë me nr. 1023 prot., datë 23.05.2025 “Procesverbal ndërprerje punimesh”, nënshkruar nga administratorët e UKK dhe sipërmarrësit, në të cilën citohet që do të pezullohen punimet deri në ndryshimin e projektit dhe përcaktimit të sasisë së tubave me d=600 mm, që do të marrë Bashkia për investimin në krahun verior të rrugës “Nënë Tereza”. Me shkresën nr. 1023/1 prot., datë 26.05.2025 “ Kërkesë për shtyrje afati të punimeve” sipërmarrësi ka njoftuar pezullimin e punimeve për shkak të mosmarrëveshjeve të krijuara mes shoqërisë “B.” SHPK dhe “L.” SHPK, e cila është kontraktuar nga Bashkia Kamëz për ndërtimin e rrugës për linjën e KUN-

së së krahut verior të rrugës “Nënë Tereza”. Pas kësaj kërkese, është bërë argumentimi teknik për shtyrjen e afatit të punimeve nga Drejtori Teknik i UKK-së z. B.H, i cili ka dhënë mendimin për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 1 muaj me shkresën nr. 1023/3 prot., datë 23.06.2025. Është hartuar Amendamenti i kontratës me nr. 1023/4 prot., datë 26.06.2025, për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 1 muaj.
Në dosje administrohet projekti i ndryshuar, i pashoqëruar me relacion teknik, me autor ing. B.H dhe ing. M.H., i hartuar pas kërkesës së bërë nga kontraktori për shtimin e numrit të pusetave me nr. 1023/2, datë 26.05.2025.
Është hartuar preventivi i rishikuar, i cili është nënshkruar nga administratorët e UKK dhe sipërmarrësit, me vlerë 18,714,698 me TVSH, i shoqëruar me tabelën e ndryshimeve të volumeve “Punimet që hiqen dhe shtohen”, ku janë shtuar /zbritur punime me vlerë 3,734,384 lekë pa TVSH. Kanë rifilluar punimet në datën 23.06.2025.

Ditari i punimeve është i nënshkruar vetëm nga përfaqësuesi i Kontraktorit, ndërsa libri i masave dhe situacioni përfundimtar është i nënshkruar nga përfaqësuesi i Kontraktorit dhe administratori i UKK z. Sh.L, në kundërshtim me pikat 3.2 dhe 3.3 dhe shtojcat e UKM Nr.1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a”				
14.Lidhja e kontratës Nr. 444/7 prot., datë 29.04.2025	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 18,714,976 lekë **BOE kontraktor “B.” SHPK & “C.” SHPK**		**16.Likuiduar** deri dt 03.12.2025 14,000,000 lekë me TVSH	
17- Situacioni Përfundimtar **Vlera me tvsh 18,714,698 lekë**	**18.Afati i kotratës në dite** Parashikuar 90 ditë, Zbatuar 115 ditë. Fillimi punimeve: 19.05.2025 Perfundimi punimeve : 14.09.2025		**19. Zgjatja e kontratës** Amendamenti i kontratës me nr. 1023/4 prot., datë 26.06.2025, shtyrja 1 muaj.	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** ----	Licenca Nr:	-	-	-
21. **Kolaudatori i punimeve** -----	Licenca Nr:	-	-	-
22.Akt Kolaudimi Nuk ka	**23**.**Certifikata e përfundimit të punimeve** dt 13.11.2025		**-**	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, projektpreventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **203,200 lekë pa tvsh**.

Tabela nr. 1

	Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	**Vlera**

C		**Linja KUN, rruga Lekaj, tuba brinjëzuar d=600 mm**							
	III.2	Shtresë zhavorr lumi t=20 cm, me cilindrim poshtë tubave me d=1500 mm	m^2	400	508	508	0	508	203,200
								Total	**203,200**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

B. Linja KUN, rruga Lekaj, tuba brinjëzuar d=600 mm

2. Zëri III.2 Shtresë zhavorr lumi t=20 cm, me cilindrim poshtë tubave me d=600 mm. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 508 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 508 m^2. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 508 m^2 (644 ml gjatësi e tubit x 0.79 m gjerësi). Nga verifikimi i librit të masave, preventivit dhe projektit bazë, të paraqitur në dosjen teknike, rezulton se ky zë pune nuk është parashikuar të kryhet, pasi është i përfshirë në zërin II.2 "Mbushje, rrafshin me zhavorr lumi + pjesë e dheut të shkrifët të gërmuar". Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 203,200 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi komisioni i marrjes së përkohshme në dorëzim të objektit, me përbërje M. K., z. K.D. e znj B.N dhe Personi përgjegjës për ndjekjen e kontratës z. M.H..

2. "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku", Kamëz.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1326/14 prot., datë 25.09.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz (UKK), të përfaqësuar nga administratori i UK Kamëz z. SH.L. dhe të OE "N.S." SHPK, me përfaqësues ligjor Hekuran Hoxha, me licencë profesionale NZ 7584/10. Vlera e kontratës 60,983,375 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 120 ditë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 1326/12 prot., datë 31.07.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "R.95." SHPK me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1506/12, përfaqësuar nga Administratori znj. R. N., me vlerë të kontratës 1,487,300 lekë.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 1009/4 prot., datë 09.06.2025, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "GB C. E." SHPK, me licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 2812/4, me vlerë 185,913 lekë.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, në dosje nuk administrohet leje ndërtimi. Është dhënë përgjigje nga administratori i Lagjes Administrative Bathore, me shkresën nr. 1462/1 prot, datë 23.10.2024, i cili

i është drejtuar UKK me shkresën me lëndë “Ndërhyrje/punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi”, pa specifikuar se për kë objekt. Ky mosveprim është në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neni 11 dhe ngarkon me përgjegjësi Administratorin e UKK z. Sh.L.
- Projektpreventivi është hartuar nga shoqëria “A.2E” SHPK, bazuar në Aktmarrëveshjen ndërmjet kësaj shoqërie dhe UK Kamëz, me nr. 1058 prot., datë 12.06.2023.
- Për këtë objekt është bërë oponenca nga Instituti i ndërtimit, e dërguar me shkresën nr. 1485/2 prot., datë 17.10.2023, në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 3/2020, datë 30,01,2020, neni 6.
Në oponencën teknike (faqe 6/13) është cituar që *përdorimi i tubit OD 500mm dhe PN 16 atm është i panevojshëm, pasi tubi me OD 500 mm dhe PN 10 atm i plotëson kërkesat teknike për transmetimin e ujit në destinacion dhe me presionin e duhur. Kjo do të bënte të mundur edhe zvogëlimin e ndjeshëm të kostos së ndërtimit të kësaj linje*.
Gjithashtu, në lidhje me preventivin, oponenca ka dhënë mendimin që *duhen riparë çmimet e ajruesve dhe tubacioneve, duke marrë tre propozime nga prodhuesit e tyre*.

Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 30.10.2024 dhe kanë përfunduar me datë 30.04.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.
Në dosje administrohet dy shkresa të dërguara nga mbikëqyrësi i punimeve respektivisht me nr. 326/1 prot., datë 10.02.2025 dhe me nr. 09 prot., datë 28.03.2025, të cilat shoqërohen me procesverbalet me datë 07.02.2025 dhe 28.03.2025 të nënshkruara nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe titullari i UK Kamëz “Mbi ditët që nuk është punuar”. Në këto procesverbale citohet se nuk është punuar gjithsej 39 ditë në afatin kontraktual të përfundimit të punimeve dhe 18 ditë në muajin mars 2025, jashtë afatit kontraktual të përfundimit të punimeve. Në dosje nuk gjendet asnjë shkresë (amendament) që të ketë formalizuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve, në zbatim të pikës 1.2.3 “Modifikimi” të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës”. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi ndjekësit e kontratës B.H, D.C. dhe A.C..

Në dosje administrohet projekti i ndryshuar, i shoqëruar me relacion teknik, i nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe kontraktori, i hartuar pas kërkesës së bërë nga kontraktori për ndryshimin e gjurmës së tubacionit me nr. 531 prot., datë 12.03.2025.
Është hartuar preventivi i rishikuar, i cili është nënshkruar nga administratorët e UKK dhe sipërmarrësit, me vlerë 60,983,000 me TVSH, i shoqëruar me tabelën e ndryshimeve të volumeve “Punimet që hiqen dhe shtohen”, ku janë shtuar/zbritur punime me vlerë 12,040,748 lekë pa TVSH, duke përdorur fondin rezervë me vlerë 1,479,867 lekë pa TVSH (miratuar nga UK Kamëz me procesverbalin e datës 04.04.2025). Ky preventiv është hartuar në bazë të projektit të rishikuar, i bërë me kërkesën e investitorit (shkresa me nr. 531 prot., datë 12.03.2025), duke përfshirë projektuesin, por pa marrë përgjigje prej tij, në kundërshtim me marrëveshjen për hartimin e projektit, neni 5, duke ngarkuar me përgjegjësi ndjekësit e kontratës.
Është bërë analiza e çmimeve për 43 zëra të rinj.
Në dosje administrohet dosja e analizave të çmimeve të zërave të rinj, ku testimi i tregut për nënzërin “material” është marrë vetëm nga një shoqëri (“A.” SHPK). Ky veprim mbart riskun për llogaritje të pasaktë të çmimeve të zërave të rinj dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve dhe ndjekësit e kontratës B.H dhe D.C..

Në aktin e kolaudimit citohet që në datën 29.09.2025 është lënë detyrë që brenda 15 ditëve të bëhet testimi me ngarkesë i tubacioneve të vendosura në vepër, në prani të përfaqësuesve të UKK. Testimi i bërë nga shoqëria "H." SHPK, pas kontratës me kontraktorin e punimeve "N.S." SHPK datë 07.11.2025, nuk është bërë në prani të përfaqësuesve të UKK (raporti i testimit është i nënshkruar nga mbikëqyrësi, kontraktori dhe shoqëria "H." SHPK). Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i punës për ndjekjen e kontratës.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga imbianti i Bovillës –Depo Maloku", Kamëz"				
14.Lidhja e kontratës Nr. 1326/14 prot., datë 25.09.2024	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 60,983,375 lekë **OE kontraktor "N.S." SHPK**		**16.Likuiduar** deri dt 31.12.2025 57,934,204 lekë me TVSH	
17- Situacioni Përfundimtar **Vlera me tvsh 60,983,000 lekë**	**18.Afati i kotratës në dite** Parashikuar 120 ditë, Zbatuar 180 ditë. Fillimi punimeve: 30.10.2024 Perfundimi punimeve : 30.04.2025		**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka amendamenti të kontratës por vetëm procesverbal për ditët që nuk është punuar	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** "R.95." SHPK	Licenca OE Nr: MK 1506/12	Kontrata me nr. 1326/12 prot., datë 31.07.2024	-	-
21. **Kolaudatori i punimeve** "GB Civil Engeenering" SHPK	Licenca Nr: MK 2812/4	Kontrata me nr. 1009/4 prot., datë 09.06.2025	-	-
22.Akt Kolaudimi Datë 24.12.2025	**23**.**Certifikata e përfundimit të punimeve** dt 31.12.2025		**-**	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, projektpreventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **889,600 lekë pa tvsh**.

Tabela nr. 1

	Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	**Vlera**
1		**Punime gërmimi**							
	1	Gërmim dheu ekskavator , në kanale me gjerësi 2 m, tokë e zak, kat III	m^3	1500	2315	2315	2055	260	390,000
2		**Punime shtresash**							
	4	Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës	m^3	1300	1280	1280	998	282	366,600
	5	Shtresë çakulli mbeturinë kavet-20 cm	m^2	700	1740	1740	1550	190	133,000

								Total	**889,600**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Punime gërmimi

1. Zëri 1.1 Gërmim dheu ekskavator , në kanale me gjerësi 2 m, tokë e zak, kat III. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 2280 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 2315 m^3, ose 35 m^3 më shumë se në preventivin bazë. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 2315 m^3 (1160 ml, linja depo Maloku – L=1160 ml x 1 m gjerësi x 1.5 m lartësi + 1150 ml linja 2 copë me d= 90 mm x 0.5 m gjerësi x 1 m lartësi). Nga verifikimi i librit të masave, projektit bazë të zbatimit (i pandryshuar për detajin e gërmimit) dhe projektit të rishikuar, rezulton se lartësia e gërmimit duhej marrë 1.35 m për tubin me d=500 mm dhe 0.85 m për tubat me d=90 mm, pasi heqja e shtresës së çakullit prej 15 cm është marrë në zërin 2.3 të situacionit. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 2055 m^3, ose 260 m^3, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Punime shtresash

2. Zëri 4. Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur ngjeshur me makineri. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 1231 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1280 m^3, ose 49 m^3 më shumë se në preventivin bazë. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 1280 m^3 (1160 ml x 1 m gjerësi x 1 m lartësi + 120 m^3 për mbushje anash pusetave). Nga verifikimi i librit të masave, projektit bazë të zbatimit (i pandryshuar për detajin e gërmimit dhe mbushjes) dhe projektit të rishikuar, rezulton se nuk është hequr volumi i tubit (1160 x 0.25^2 x 3.14). Nga rillogaritja volumi i këtij zëri pune është 998 m^3, ose 282 m^3, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 5. Shtresë çakulli mbeturinë kave, t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 30 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1740 m^2, ose 1740 m^2 më shumë se në preventivin bazë. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 1740 m^2 (1160 ml x 1.5 m gjerësi). Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të rishikuar, rezulton se nga puseta e lidhjes në Impiantin e Bovillës, prog 0+000, deri në pusetën e shkarkimit, prog 0+127, gjurma e tubacionit kalon në tokat e banorëve dhe nuk ka shtresë çakulli. Nga rillogaritja volumi i këtij zëri pune është 1550 m^2 ((1160 – 127) x 1.5m), ose 190 m^2, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 889,600 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "R.95." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

2) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1326/12 prot., datë 31.07.2024.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** BOE "GB C. E." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, <u>ku përcaktohet se:</u>

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

2) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>ku përcaktohet se</u>:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

3) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 1009/4 prot., datë 09.06.2025

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Znj. R. N., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. G. B., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

<u>3. "Rehabilitim KUN-je, Rr Argjinatura deri tek Azili i Pleqëve (Rr. "Teuta", Kamëz).</u>

<u>*Kontratat*</u>
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1377/16 prot., datë 04.11.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz (UKK), të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i UK Kamëz z. SH.L. dhe të OE "U." SHPK, me përfaqësues ligjor A. Ç., me licencë profesionale NZ 5434/10. Vlera e kontratës 17,975,340 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 2593/5 prot., datë 14.11.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "R.95." SHPK me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1506/12, përfaqësuar nga Administratori znj. R. N., me vlerë të kontratës 603,381 lekë.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 306/1 prot., datë 22.05.2025, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "R.S." SHPK, me licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 1996/9, me vlerë 80,000 lekë.
Për marrjen në dorëzim të përkohshëm të objektit është ngritur grupi i punës me përbërje D.C., M. K. dhe V. P. Është hartuar Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të objektit, me shkresën me nr. 515/3 prot., datë 18.07.2025.
Projektpreventivi
- Për këtë objekt, në dosje nuk administrohet leje ndërtimi. Është dhënë përgjigje nga administratori i Lagjes Administrative Bathore, me shkresën nr. 1462/1 prot, datë 23.10.2024, i cili i është drejtuar UKK me shkresën me lëndë "Ndërhyrje/punime që nuk kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi", pa specifikuar se për këë objekt. Ky mosveprim është në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar, neni 11 dhe ngarkon me përgjegjësi Administratorin e UKK z. Sh.L.
- Projektpreventivi është hartuar nga grupi i punës nga Drejtoria Teknike e UK Kamëz, me përbërje B.H, E.S., D. N. dhe M. H. në vitin 2024.
- Për këtë objekt nuk është bërë oponenca nga Instituti i ndërtimit, në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Ligjin nr. 3/2020, datë 30.01.2020, neni 6.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 11.12.2024 dhe kanë përfunduar me datë 10.03.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.
Në dosje gjendet Amendamenti me nr. 306 prot., datë 10.02.2025, që ka formalizuar shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 30 ditë, deri në datën 10.03.2025.

Në dosje administrohet projekti i ndryshuar, i shoqëruar me relacion teknik, i nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe kontraktori, i hartuar pas kërkesës së bërë nga kontraktori për ndryshimin e gjurmës së tubacionit me nr. 531 prot., datë 12.03.2025.
Pas procesverbalit datë 07.02.2025 për ndryshimin e volumeve, është hartuar preventivi i rishikuar, i cili është nënshkruar nga administratorët e UKK, mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi, me vlerë 17,975,340 me TVSH, i shoqëruar me tabelën e ndryshimeve të volumeve "Punimet që hiqen dhe shtohen", ku janë shtuar /zbritur punime me vlerë 4,587,296/4,597,796 lekë pa TVSH, (miratuar nga UK Kamëz).
Është bërë analiza e çmimeve për 7 zëra të rinj. Nga verifikimi i këtyre analizave rezulton se:
- Në zërin e punimeve "Ndërtim pusete", në nënzërin "material", janë marrë në mënyrë të paargumentuar teknikisht "bazamente betoni + gizë" në njësinë matëse "copë" dhe sasinë për një pusetë që varion nga 40.18 copë (!!) deri në 120 copë.
Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve dhe personi i ngarkuar për ndjekjen e kontratës z. D.C..
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

14.Lidhja e kontratës Nr. 1377/16 prot., datë 04.11.2024	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 17,975,340 lekë **OE kontraktor "U." SHPK**		**16.Likuiduar** deri dt 22.10.2025 14,000,000 lekë me TVSH	
17- Situacioni Përfundimtar **Vlera me tvsh 17,975,340 lekë**	**18.Afati i kotratës në dite** Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 90 ditë. Fillimi punimeve: 11.12.2024 Perfundimi punimeve : 10.03.2025		**19. Zgjatja e kontratës** Amendamenti i kontratës me nr. 306 prot., datë 10.02.2025, shtyrja 1 muaj.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "R.95." SHPK	Licenca OE Nr: MK 1506/12	Kontrata me nr. 2593/5 prot., datë 14.11.2024	-	-
21. Kolaudatori i punimeve "R.S." SHPK	Licenca Nr: MK 1996/9	Kontrata me nr. 306/1 prot., datë 22.05.2025	-	-
22.Akt Kolaudimi Pa datë	**23.Certifikata e përkohshme e marrjen në dorëzim të punimeve** nr. 515/3 prot., datë 18.07.2025		-	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, projektpreventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **421,920 lekë pa tvsh**.

Tabela nr. 1

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
1I		**Punime gërmimi**							
	2	Mbushje, rrafshim ngjeshje me tokmak, tokë e zakonshme	m^3	400	1537	1537	1241	296	118,400
1II		**Punime shtresash**							
	1	Mbushje me çakull e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri	m^3	2800	672.49	672.49	564.09	108.4	303,520
								Total	**421,920**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

II. Punime gërmimi

1. Zëri 2 Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak çdo 30 cm, tokë e zakonshme. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 1562 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1537 m^3, ose 25 m^3 më pak se në preventivin bazë. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 1537 m^3 (859.77 m^3 mbushje kanali mbi tubin me d=600 mm – 167.38 m^3 volumi i tubit + 1142.17 m^3 mbushje kanali mbi tubin me d=800 mm – 397.47 m^3 volumi i tubit). Nga verifikimi i librit të masave, rezulton se sipërfaqja e zbritshme e tubave është llogaritur respektivisht 0.28 m^2 dhe 0.5 m^2, nga 0.5 m^2 dhe 0.785 m^2 që duhet në fakt. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1241 m^3, ose 296 m^3, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

III. Punime shtresash

1. Zëri 1 Mbushje me çakull e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 423 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 672.49 m^3. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 672.49 m^3, i detajuar sipas piketave, me trashësi 12 cm. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit bazë, të pandryshuar për këtë zë pune, rezulton se është marrë trashësia mesatare e mbushjes 12 cm, nga 10 cm që duhet në fakt. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 564.09 m^3, ose 108.4 m^3, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 421,920 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "R.95." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

3) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

4) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2593/5 prot., datë 14.11.2024.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** BOE "R.S." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

4) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, <u>*ku përcaktohet se:*</u>

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

5) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>*ku përcaktohet se:*</u>

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

6) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 306/1 prot., datë 22.05.2025

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Znj. R. N., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. H. K., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4. <u>"Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz".</u>

<u>Kontratat</u>

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 529/5 prot., datë 16.06.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz (UKK), të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i UK Kamëz z. SH.L. dhe të BOE "B." SHPK & "N." SHPK & "Nd." SHPK, me përfaqësues ligjor Sh. A., me licencë profesionale NZ 6671/4. Vlera e kontratës 24,547,746 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 1014/2 prot., datë 19.06.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE B.Y.PF me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3877, me vlerë të kontratës 645,709 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 1687/1 prot., datë 06.09.2023, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "A.2E" SHPK, me licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 3609/1, me vlerë 83,800 lekë.

Për marrjen në dorëzim të përkohshëm të objektit është ngritur grupi i punës me përbërje D. N., R.Z. dhe S.P.. Është hartuar Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të objektit, me shkresën me nr. 1866/1 prot., datë 11.10.2023.

<u>Projektpreventivi</u>

- Për këtë objekt, në dosje administrohet Vendim i Bashkisë Kamëz për miratimin e deklaratës për kryerje punimesh në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar.
- Projektpreventivi është hartuar nga shoqëria "R.S." SHPK në vitin 2023.
- Për këtë objekt nuk është bërë oponenca nga Instituti i Ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Ligjin nr. 3/2020, datë 30,01,2020, neni 6, veprim që ngarkon me përgjegjësi ish drejtuesin e institucionit z. E.M..

<u>Zbatimi i punimeve</u>

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 23.06.2023 dhe kanë përfunduar me datë 16.08.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

Në dosje administrohet projekti i ndryshuar, i shoqëruar me relacion teknik, i nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe kontraktori, i hartuar pas procesverbalit për ndryshimet në punimet e objektit, datë 15.08.2023.

Është hartuar preventivi i rishikuar, i cili është nënshkruar nga administratorët e UKK dhe sipërmarrësit, me vlerë 24,547,746 me TVSH, i shoqëruar me tabelën e ndryshimeve të volumeve "Punimet që hiqen dhe shtohen", ku janë shtuar /zbritur punime me vlerë 1,257,201 lekë pa TVSH, (miratuar nga UK Kamëz).

Është bërë analiza e çmimeve për 1 zë të ri pune "FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25 mm, t=2.0 mm, Pn 10", i cili është marrë më i ulët se çmimi i manualit në fuqi (nr. an. 2.791/b).

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz"				
14.Lidhja e kontratës Nr. 529/5 prot., datë 16.06.2023	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 24,547,746 lekë **BOE kontraktor "B." SHPK & "N." SHPK & "Nd." SHPK**		**16.Likuiduar** deri dt 24.09.2025 24,547,746 lekë me TVSH	
17- Situacioni Përfundimtar **Vlera me tvsh 17,975,340 lekë**	**18.Afati i kotratës në dite** Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 90 ditë. Fillimi punimeve: 11.12.2024 Perfundimi punimeve : 10.03.2025		**19. Zgjatja e kontratës** Amendamenti i kontratës me nr. 306 prot., datë 10.02.2025, shtyrja 1 muaj.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve B.Y.PF	Licenca OE Nr: MK 3877	Kontrata me nr. 1014/2 prot., datë 19.06.2023	-	-
21. Kolaudatori i punimeve "A.2E" SHPK	Licenca Nr: MK 3609/1	Kontrata me nr. 1687/1 prot., datë 06.09.2023	-	-
22.Akt Kolaudimi Datë 27.09.2023	**23.Certifikata e përkohshme e marrjen në dorëzim të punimeve** nr. 1866/1 prot., datë 11.10.2023		**-**	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, projektpreventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **470,300 lekë pa tvsh**.

Tabela nr. 1

	Nr	**Zëri i punimeve**	**Njësia**	**Çmimi i ofertës**	**Situacioni përfundimtar**	**Libri i masave**	**Fakti**	**Diferenca në +**	
								Vol.	**Vlera**
1		**Rrjeti shpërndarës i ujësjellësit**							
	9	Mbushje, me rërë nën dhe mbi tub për mbrojtjen e tij	m^3	1000	629.14	629.14	581.14	48	48,000
	11	Shtresë çakulli mbeturunë kave t=20cm	m^2	700	1570	1570	1450	120	84,000
	14+15	Shtresë binderi 6 cm + shtresë asfaltobetoni 4 cm	m^2	2800 (1500 + 1300)	1619.89	1619.89	1,546.64	73.25	205,100
	22	FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25 mm, t=2.0 mm, PN 10	ml	185	1782	1782	1062	720	133,200
								Total	**470,300**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

I. Rrjeti shpërndarës i ujësjellësit

1. Zëri 9. Mbushje, me rërë nën dhe mbi tub për mbrojtjen e tij. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 506 m^3. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune

figuron në sasinë 629.14 m^3. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 629.14 m^3, i detajuar sipas linjave. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë marrë 144 m^3 mbushje me rërë në linjat për lidhje familjare (200 copë x 6 ml gjatësi për çdo lidhje x 0.12 m^2 sipërfaqja e mbushjes), kur në fakt, gjysmat e lidhjeve të familjarëve ishin 2 ml dhe jo 6 ml. Nga rillogaritja, rezulton se gjatësia e linjave të lidhjeve familjare nuk është 1200 ml por 800 ml (100 x 6 ml + 100 x 2 ml) dhe volumi i këtij zëri pune është 581.14 m^3, ose 48 m^3, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 11. Shtresë çakulli mbeturunë kave t=20cm. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 1811 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1570.09 m^2. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 1570.09 m^2, i detajuar sipas linjave. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë marrë 360 m^2 shtresë çakëlli në linjat për lidhje familjare (200 copë x 6 ml gjatësi për çdo lidhje x 0.3 m gjerësi), kur në fakt, gjysmat e lidhjeve të familjarëve ishin 2 ml dhe jo 6 ml. Nga rillogaritja, rezulton se gjatësia e linjave të lidhjeve familjare nuk është 1200 ml por 800 ml (100 x 6 ml + 100 x 2 ml) dhe volumi i këtij zëri pune është 1450 m^2, ose 120 m^2, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 14+15. Shtresë binderi me granil gur kave t=6 cm + shtresë asfaltobetoni me granil gur kave t=4 cm. Në preventivin bazë, sasia e këtyre zërave pune është 1588 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, këto zëra pune figurojnë në sasinë 1619.89 m^2. Në librin e masave sasia e këtyre zërave pune është 1619.89 m^2, i detajuar sipas linjave. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se janë marrë 50.75 m^2 në linjën 2 dhe 22.5 m^2 në linjën 3, kur në fakt, linjat 2 dhe 3 nuk ishin të asfaltuara. Nga rillogaritja, rezulton se volumi i këtij zëri pune është 1,426.64 m^2, ose 193.25 m^2, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Zëri 22. FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25 mm, t=2.0 mm, PN 10. Në preventivin bazë, ky zë pune nuk është i preventivuar. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1782 ml. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 1782 ml, i detajuar sipas linjave për lidhje familjare (257 lidhje me 6 ml + shtesë 40 lidhje me 6 ml. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se, janë bërë gjithsej 235 lidhje dhe jo 297. Nga rillogaritja, rezulton se gjatësia e linjave të lidhjeve familjare nuk është 1782 ml por 1062 ml (118 x 6 ml + 118 x 3 ml), ose 720 ml, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 470,300 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE B.Y.PF nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1014/2 prot., datë 19.06.2023.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** OE "A.2E" SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, <u>ku përcaktohet se:</u>

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 <u>ku përcaktohet se</u>:

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 1687/1 prot., datë 06.09.2023

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
1. Z. B.Y., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E. M., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Në dosjen e zbatimit administrohet Formulari i Vlerësimit të këtij objekti, në të cilën është cituar edhe % e pjesëmarrjes në BOE, "B." SHPK 49%, "N." SHPK 11% dhe "Nd." SHPK 40%, kur nga kontrata e bashkëpunimit % e pjesëmarrjes në BOE është "B." SHPK 40%, "N." SHPK 11% dhe "Nd." SHPK 49%. Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi, ish-Drejtori i Përgjithshëm i UKK z. E.M..

5. "<u>Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i vjetër Kamëz".</u>

<u>*Kontratat*</u>

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1408/11 prot., datë 08.08.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz (UKK), të përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i UK Kamëz z. SH.L. dhe të BOE "E" SHPK & "2T" SHPK, me përfaqësues ligjorë respektivisht S. Ç. dhe A. S., me licenca profesionale NZ 2657/22 dhe NZ 2657/. Vlera e kontratës 595,097,496 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 365 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 1419/6 prot., datë 01.08.2024, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE "T." SHPK me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0919/12, me vlerë të kontratës 5,492,044 lekë me TVSH.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 1988/3 prot., datë 08.10.2025, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi shoqëria "XH & M." SHPK, me licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK 1322/9, me vlerë 686,506 lekë.
Për marrjen në dorëzim të përkohshëm të objektit është ngritur grupi i punës me përbërje L.B., kryetar, K.D. dhe Vilson Puci, anëtarë. Është hartuar Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të objektit, me shkresën me nr. 1934/1 prot., datë 29.12.2025.

Projektpreventivi
- Për këtë objekt, në dosje administrohet Vendim i Bashkisë Kamëz për miratimin e lejes infrastrukturore në përputhje me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e territorit", i ndryshuar.
- Projektpreventivi është hartuar nga shoqëria "E." SHPK në vitin 2023.
- Për këtë objekt është bërë oponenca nga Instituti i ndërtimit, e dërguar me shkresën nr. 1591/2, datë 15.11.2023, në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar me Ligjin nr. 3/2020, datë 30.01.2020, neni 6.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 06.09.2024 dhe kanë përfunduar me datë 06.09.2025, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.
Në dosje administrohet projekti i ndryshuar, i shoqëruar me relacion teknik, i nënshkruar nga kontraktori dhe i përcjellë nga mbikëqyrësi tek UKK, me shkresën nr. 1881, datë 29.08.2025, i hartuar pas procesverbalit për ndryshimet në punimet e objektit, datë 01.08.2025.
Është hartuar preventivi i rishikuar, i cili është nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi i punimeve dhe administratori i UKK, me vlerë 595,092,450 me TVSH, i shoqëruar me tabelën e ndryshimeve të volumeve "Punimet që hiqen dhe shtohen", ku janë shtuar /zbritur punime me vlerë 54,633,150/26,300,220 lekë me TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerë 23,614,980 lekë pa TVSH, miratuar me procesverbalin datë 01.08.2025.
Është bërë analiza e çmimeve për 1 zë të ri pune "FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=32 mm, t=2.4 mm, Pn 10", të pashoqëruar me testim tregu.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i vjetër Kamëz"		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1408/11 prot., datë 08.08.2024	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 595,097,496 lekë **BOE kontraktor "E" SHPK & "2T" SHPK**	**16.Likuiduar** deri dt 31.12.2025 542,833,188 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar **Vlera me tvsh 595,092,450 lekë**	**18.Afati i kotratës në dite** Parashikuar 365 ditë, Zbatuar 365 ditë. Fillimi punimeve: 06.09.2024 Perfundimi punimeve : 06.09.2025	**19. Zgjatja e kontratës** Nuk ka

20. Mbikëqyrësi i punimeve "T." SHPK	Licenca MK 0919/12	Kontrata me nr. 1419/6 prot., datë 01.08.2024	-	-
21. Kolaudatori i punimeve "XH&M." SHPK	Licenca Nr: MK 1322/9	Kontrata me nr. 1988/3 prot., datë 08.10.2025	-	-
22.Akt Kolaudimi Datë 18.11.2025	**23.Certifikata e përkohshme e marrjen në dorëzim të punimeve** nr. 1934/1 prot., datë 29.12.2025		-	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, projektpreventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **843,700 lekë pa TVSH**.

Tabela nr. 1

	Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
								Vol.	Vlera
9		**Analiza teknike**							0
	29+30	Shtresë asfaltobetoni 4 cm +shtresë binderi 6 cm	m^2	3050 (1450+ 1600)	23,739	23,739	23,545	194	591,700
12		**Analiza jashtë liste**							
	35	Prerje asfalti t=3cm	m^2	210	59,575	59,575	58,375	1,200	252,000
								Total	**843,700**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

9. Analiza teknike

1. Zëri 29+30 Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave t=4 cm + shtresë binderi me granil gur kave t=6 cm. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 23,739 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 23,739 m^2. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 23,739 m^2, i detajuar sipas linjave të ujësjellësit në rrugë, si prodhim i gjatësisë se linjave me gjerësinë e kanalit. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimi në terren, rezulton se në rrugën "Ali bej Toptani" me gjatësi 970 ml është marrë gjerësia e shtresës respektivisht 1.2 m dhe 1.0 m nga **0.8** m që është në fakt. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 23,545 m^2, ose **194 m^2**, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

12. Analiza jashtë liste

2. Zëri 35 Prerje asfalti t=3cm. Në preventivin bazë, sasia e këtij zëri pune është 59,575 m^2. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 59,575 m^2. Në librin e masave sasia e këtij zëri pune është 59,575 ml, i detajuar sipas linjave të ujësjellësit në rrugë, si prodhim i gjatësisë se linjave me numrin e prerjeve, në njësinë matëse ml (dhe jo m^2). Nga verifikimi i librit të masave, rezulton se në disa nga gjatësitë e prerjeve është vënë sasia 4 copë prerje, nga 2 që duhet të jetë në fakt. Nga korrigjimi i kësaj sasie rezulton që të jetë librezuar/situacionuar më tepër 1,200 ml prerje asfalti. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 843,700 lekë pa TVSH** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- **Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE "T." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

5) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:*

"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."

6) Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1419/6 prot., datë 01.08.2024.

- **Nga ana e kolaudatorit të punimeve** OE "Xh & M." SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

7) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:*

"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"

8) Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*

Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes

9) Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 1988/3 prot., datë 08.10.2025

Vlen të theksoj gjithashtu, se ky objekt shumë i rëndësishëm i realizuar për qëllime jetike për komunitetin, ende nuk është vënë në funksionim të plotë. Nuk janë bërë lidhjet e rrjetit me familjarët, në mënyrë që furnizimi me ujë i komunitetit të bëhet nëpërmjet këtij ujësjellësi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. D. Q., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. Xh. D., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:

*Nga auditimi i **5 (pesë)** kontratave për punë publike për periudhën e auditimit, në vlerën totale* 717,318,933 lekë me TVSH, *u konstatuan problematikat si vijon:*

►*Në **5 (pesë)** raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **2,828,720 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me*

Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, **Kreu III, neni 7**, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, **respektivisht:
***- Vlera 203,200 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a" me nr. 444/7 prot., datë 29.04.2025 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "B." SHPK.*
***- Vlera 889,600 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku" me nr. 1326/14 prot., datë 25.09.2024, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "N.S." SHPK.*
***- Vlera 421,920 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Rehabilitim KUN-je, Rr Argjinatura deri tek Azili i Pleqëve (Rr. "Teuta", Kamëz" me nr. 1377/16 prot., datë 04.11.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "U" SHPK.*
***- Vlera 470,300 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz" me nr. 529/5 prot., datë 16.06.2023, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve BOE "B." SHPK & "N." SHPK & "Nd." SHPK.*
***- Vlera 843,700 lekë pa TVSH,** përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën për punë publike me objekt: "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i vjetër Kamëz" me nr. 1408/11 prot., datë 08.08.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz dhe sipërmarrësit të punimeve BOE "E" SHPK & "2T" SHPK.*
*- Në **një** rast, konkretisht për objektin "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, Lagjja Zallmner" nuk është marrë oponenca teknike;*
*- Në **tre** raste dhe konkretisht për objektet "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, Lagjja Zallmner", "Rehabilitimi i KUN, Rruga "Argjinatura" – Azili i pleqve (Rruga "Teuta")" dhe "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga imbianti i Bovillës –Depo Maloku", nuk është marrë leje ndërtimi/infrastrukturore.*

2.7. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe funksionimi i strukturës së auditimit të brendshëm.

- Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":

"Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike".

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili siguron vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit. Mjedisi i kontrollit përmban:

a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;

b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës;

c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

ç) politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

d) aftësitë profesionale të punonjësve.
Institucioni Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a, aktualisht vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me vendimin nr. 8, datë 18.08.2025 e cila është ndryshuar përgjatë viteve paraardhëse deri në rregulloren e mësipërme.
Në këtë dokument, janë përcaktuar objektivat, parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit.
Bazuar në rregulloren e miratuar, institucioni Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a ka hartuar Kodin e etikës të miratuar me vendimin nr. 7, datë 18.08.2025 i cili përcakton qëllimin, fushat e veprimit, parimet etj. Gjithashtu, rezulton se përpara miratimit të këtij Kodi, UKK ka pasur Kodin Etik të miratuar me Vendimin nr. 15, datë 26.12.2023.
Rezulton se nuk është hartuar dhe miratuar Rregullore e Posaçme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike për gjithë stafin e UKK, por është mjaftuar vetëm me përcaktimin e konfliktit të interesit në 2 nene (neni 5 dhe 6) të Kodit Etik të Institucionit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike*" i ndryshuar neni 4, pika 1/d, Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 "*Për rregullat e etikës në administratën publike*" Kreu II, neni 4; Ligjin nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, neni 9 pika 4/e, etj.
Politika menaxheriale dhe stili i punës:
Punësimi në Institucionin e Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a bëhet në zbatim të Ligjit nr. 7961 /1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar.
- Sektori i burimeve njerëzore është përgjegjës për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit, referuar nenit 81 të Rregullores se Brendshme, e cila përfshin përzgjedhjen e aftësimit profesional të stafit, administrim të dokumentacionit, sigurimi e kushteve të punës, dërgimi për publikim të vendeve të lira në faqen e UKK Sh.a, korrespodencën me Zyrën e Punës, ndjekjen e ecurisë disiplinore, ndjekjen e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës dhe afatet me punëmarrësit, etj.
-Rezulton se punësimet në UKK, përgjithësisht nuk ndjekin procedura transparente. Nuk ka komisione për pranimin në punë të punonjësve apo komisione testimi. Nuk kryhen publikime në faqen e web-it të UKK. Në shumë dosje të punonjësve ka mangësi të dokumentacionit të punonjësve, përfshirë kontratat e punës dhe përshkrimin e punës. Nuk disponohet asnjë vlerësim 6 mujor ose 1 vjeçar i performancës së punonjësve në punë, pavarësisht se në pyetësorin e vetëvlerësimit, raportohet se në zbatim të urdhrit nr. 186 prot., datë 23.01.2024 është bërë vlerësimi i punonjësve.
Konstatohet se UKK nuk ka asnjë plan trajnimesh për stafin.
-Lidhur me masat disiplinore, sipas rregullores së Brendshme të Institucionet dhe Kontratave Individuale përcaktohen 6 nivele, konkretisht Qortimi, Vërejtje, Vërejtje me Shkrim, Zbritje në detyrë deri në 6 muaj, Vërejtje me Paralajmërim për Largim nga Punë dhe Largim nga Puna (neni 8, Rubrika B e Rregullores). Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Zyra e Burimeve Njerëzore, janë ngritur komisionet me nr. 665 prot., datë 20.05.2021. Me urdhër nr. 2605 prot., datë 01.11.2024 është ngritur komisioni për disiplinën në punë, shqyrtimit të masave administrative dhe ankesave, i ndryshuar me urdhër nr. 2892 prot., datë 19.12.2025. Përgjithësisht, konstatohet se procedurat e dhënies së masës, sidomos në rastet e largimeve nga puna, nuk kanë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm për respektimin e afateve.
- *Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.*

Me vendimin nr. 4, datë 02.12.20199 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.A", është vendosur miratimin i strukturës dhe miratimi i nivelit të pagave. Numri total i punonjësve sipas këtij vendimi është 191 punonjës.
Për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2025 janë bërë ndryshime në strukturë.
Me vendimin nr. 11, datë 01.12.2022 "Për disa shtesa dhe në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 280.
Me vendimin nr. 13, datë 18.12.2023 dhe nr. 9, datë 19.12.2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 290.
Me vendimin nr. 11, datë 23.12.2024 dhe nr. 8, datë 27.12.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 299.
Me vendimin nr. 5 dhe 7, datë 18.08.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a, të ndryshuar. Sipas këtij vendimi, numri i punonjësve shkon në 309.
Konstatohet se për çdo ndryshim të ndodhur në Strukturë, është shoqëruar me rritjen e numrit të punonjësve të saj.
Vendimet e mësipërme janë miratuar nga Këshilli Administrativ si dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, e cila përbëhet nga ortaku i vetëm, Kryetari i Bashkisë Kamëz.
- Strukturat organizative janë shoqëruar me organigramën përkatëse. Organigrama si një paraqitje grafike e strukturës organizative, pasqyron një informacion të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë, mbi pozicionet, klasifikimin por edhe mbi numrin e personelit të planifikuar dhe atë faktik.
Konstatohet se ndryshimet në Strukturë nuk janë shoqëruar në çdo rast me ndryshimet në Rregulloren e Brendshme.

Përcaktimi i përgjegjësive

Në UKK Sh.a, ndarja e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësive përcaktohet në Rregulloren e brendshme funksionale të Institucionit, me Vendimin nr. 8 datë 18.08.2025 "Për organizimin dhe funksionimin e Ujësjellës Kanalizime Kamëz" Sh.a.
Referuar nenit 16 të Rregullores, Administratori ka të drejtë të delegojë disa detyra nëpërmjet kalimit të përgjegjësisë operacionale dhe/ose vendimmarrëse punonjësve të tjerë brenda strukturës së varësisë. Delegimi i detyrave jepet me shkrim, në formë shkresore ose me e-mail zyrtar. Dokumenti shkrimor ku i deleguari merr detyrën dhe përgjegjësinë duhet të përmbajë datën e hyrjes në fuqi të delegimit dhe kërkesat për raportimin për realizimin e detyrave të ngarkuara.

Aftësitë profesionale të punonjësve.

-Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësive dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm. Administratori i Shoqërisë, ka miratuar dhe firmosur një dokument të politikave të punësimit, ku për secilin pozicion pune, përcakton edhe arsimimin e nevojshëm. Konstatohet se përgjithësisht, për shumicën e vendeve të punës, janë përcaktuar disa lloj arsimimesh të nevojshme, por në fund përcaktohet edhe prapashtesa (etj). Kjo prapashtesë, mund të krijojë interpretim ku për këto pozicione pune mund të rekrutohen edhe punonjës të cilën nuk kanë profilin e nevojshëm për këto pozicione.

-Nga auditimi i dosjeve të personelit, u evidentuan mangësi në mbajtjen e dosjes, dokumentacionit bashkëlidhur, si dhe raste të caktuara ku punonjësit e emëruar nuk kishin profilin arsimor të nevojshëm për pozicionin e punës.
- Në UK Kamëz nuk është hartuar "Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore", për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.
- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Institucioni nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.
- Për UK Kamëz Nëpunësi Autorizues është Administratori, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.
- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Financës.
Sa më sipër, Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz sha nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore efektive për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t'i kryer me efikasitet ato dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e Shoqërisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim "Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Kapitulli III, pika 3.1.

Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".
-Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë mbikëqyrëse mbi performancën e Shoqërisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
-Për vitin 2025, Institucioni i Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, ku janë planifikuar aktivitetet e kontrollit, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit. Janë dy dokumente të miratuara, konkretisht Urdhri me nr. 3004 prot., datë 16.12.2024 që shtrin efektet për vitin 2025, dhe urdhri nr. 2432 prot., datë 28.10.2025.

Raportet e Monitorimit 2024
Është hartuar Raporti Vjetor "Mbi funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm...." për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2024" me nr. 440 prot., datë 28.02.2025, për të cilën është përgatitur Deklarata për Cilësinë e Sistemit me nr. 440/1 prot., datë 28.02.2025, dërguar Ministrisë së Financave me shkresën nr. 440/2 prot., datë 28.02.2025.

II.Komponenti "Menaxhimi i Riskut"
2.1 Vendosja e objektivave
Procesi i vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike duhet të drejtohet nga titullari dhe t'u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë. Të gjitha njësitë publike (drejtoritë dhe sektorët) duhet të zhvillojnë objektivat e tyre dhe t'i vendosin në linjë me objektivat e vendosur në nivelet më të larta të njësisë.
Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

Grupi i Menaxhimit të Riskut (GMR)

Për periudhën objekt auditimi, disponohet vetëm një Urdhër për ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Riskut, konkretisht ngritur me urdhrin nr. 1827/4 prot., datë 26.07.2024 i përbërë nga E.P. - Kryetar, D. K., B.H, E.S., A.XH. – Anëtar, dhe S.P. –Sekretare Grupit, të ndryshuar disa nga anëtarët në vijim.
GMR është organ monitorimi dhe koordinimi midis linjës së parë dhe të dytë mbrojtëse. NA si Koordinator i MFK është kryetar i GMR, por mund të jetë dhe një person i deleguar prej tij. Kryetari i GMR adreson risqet prioritare dhe masat e kontrollit për vendimmarrje në mbledhjet e GMS si dhe raporton te titullari i njësisë.
Aktivitetet e monitorimit të GMR përfshijnë tre kategoritë e objektivave: operacionale, të raportimit, të përputhshmërisë.
GMR si organ koordinues dhe komunikimi përbëhet nga përfaqësues të caktuar nga menaxherët e çdo strukture të njësisë publike, përgjegjësitë e të cilëve përfshijnë:

- Ndihmë për drejtuesit operacional në hartimin dhe zhvillimin e proceseve dhe kontrolleve për menaxhimin e risqeve;
- Përcaktimin e aktiviteteve për tu monitoruar dhe mënyrën se si të matet performanca krahasuar me pritshmëritë e menaxhimit;
- Monitorimin lidhur me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e aktiviteteve të kontrollit të brendshëm. (Ky funksion i caktohet kryetarit të GMR nga NA si i deleguari i tij për koordinimin e Menaxhimit financiar dhe kontrollit);
- Adresimin e çështjeve kritike, risqve të emergjencës;
- Sigurimin e kuadrit rregullator për proceset dhe risqet e lidhura (manualet e procedurave, gjurmët e auditimit, regjistrin e risqeve, planet e menaxhimit të risqeve, si dhe planet e trajtimit të masave për risqet);
- Identifikimin dhe monitorimin e çështjeve që prekin risqet dhe kontrollet e njësisë;
- Dhënien e udhëzimeve dhe trajnimin e personelit lidhur me menaxhimin e risqeve dhe proceset e kontrollit.[3]

-Është vënë në dispozicion Regjistri i Riskut për vitet 2023 dhe 2024, i cili është hartuar nga Drejtori Ekonomik, dhe mbulon vetëm aktivitetin e Drejtorisë Ekonomike dhe Sektorët e tij.
Për pjesën tjetër të Drejtorive/ Sektorëve, nuk disponohet regjistër risku.
Me vendimin nr. 12, datë 23.12.2024 të Këshillit të Administrimit, është miratuar plani i menaxhimit të riskut/regjistrit të riskut për vitin 2025 të UK Kamëz Sh.a.
Pavarësisht hartimit të Regjistrit të Riskut për 2 Departamentet e cituara më sipër, mungon një Strategji nga Titullari i Njësisë Publike, sipas përcaktimit të neni 21 pika 2 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

- Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH", si dhe ligjit nr. 90 datë 27.09.2012 "Për organizimin e administratës shtetërore" si dhe janë njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës

[3] Mënyra e funksionimit dhe afatet përkatëse janë të përcaktuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 'Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike'

Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues plotësojnë kriteret e kërkuara nga ligji si: (kriteri i varësisë NA-NZ, kriteri i arsimimit dhe kriteri i nivelit menaxherial.
-*Grupi i Menaxhimit Strategjik*
-Për periudhën objekt auditimi, janë vënë në dispozicion të grupit audituesUrdhri nr. 1827/3 prot., datë 26.07.2024 "Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit të Strategjik të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.A i përbërë nga SH.L.– Kryetar, dhe anëtarët V. Xh., E.P., D. K., B.H, E.S., A.XH. – Anëtar, dhe S.P. – Sekretare e Grupit.

-Me urdhër nr. 2278 prot., datë 24.09.2024 është ndryshuar GMS ku vendosen D.C. në vend të E.S., I.D. në vend të A.XH., H.B. në vend të S.P..

Me urdhër nr. 2431 prot., datë 28.10.2025, është bërë ndryshim i GMS, ku zëvendësohet Sonila Gjyshi në vend të D.K. dhe B.M. në vend të V. Xh..

Për periudhën që përfshin vitin 2023 deri më 26.07.2024, nuk disponohet asnjë urdhër për ngritjen dhe funksionimin e GMS.

Mungesa e funksionimit të GMS për periudhën e mësipërme, është në kundërshtim me nenin 8 germa (b) të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Lidhur me urdhrin për ngritjen e GMS, përcaktohen krahas emrave edhe lista nominale e menaxherëve përkatës, ndërsa në mungesë të Përgjegjësit të Auditit të Brendshëm pozicion i cili është vakant, përfaqësohet nga Specialisti i cili është pa të drejtë vote.
GMS nuk ka hartuar planin vjetor dhe grafikun e takimeve, nuk ka dokumentuar takimet e realizuara, rrjedhimisht nuk ka përpiluar as raporte vjetore të aktivitetit të tij, të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar dhe Manualin e MFK Kap. II/2.2.6.

III.Komponenti: "Aktivitetet e Kontrollit"
Veprimtaritë e Kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.
Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: *të përshtatshme; efektive nga pikëpamja e kostos; të gjithanshme; të dokumentuara qartë etj.*
Veprimtaritë e kontrollit, përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Lidhur me kontrollet e brendshme të cilat duhet te realizohen nga NjAB, rezulton se nuk ka aktivitetet kjo njësi, e cila aktualisht nuk ka asnjë punonjës nga 3 të cilët janë sipas organikës. Konstatohet se në pyetësorin e vetëvlerësimit, raportohet se Titullari i Njësisë merr opinione nga Auditi i Brendshëm, ndërkohë rezulton se për periudhën objekt auditimi, nuk ka asnjë angazhim dhe Raport Auditimi nga kjo njësi, e cila siç u citua më sipas nuk është funksionale.
Lloji i kontrollit që zbatohet në UKK është ai parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit duhet të realizohen nga *NJAB (e cila nuk funksionon)* dhe nga *KLSH dhe Audituesit Privat të Pavarur*, pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit.

-Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a ka hartuar “Planin Vjetor të Punës për Menaxhimin e Riskut” për periudhën Janar – Dhjetor 2025. Plani rezulton i pa firmosur nga të gjithë anëtarët, drejtues/përgjegjës të njësive dhe është i pamiratuar nga Administratori i Shoqërisë.
Titullari i Institucionit ka ngritur urdhrin me nr. 2432 prot., datë 28.10.2025 “Për hartimin e planeve vjetore dhe manualeve të proceseve të punës për menaxhimin financiar dhe kontrollin në Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.A për vitin 2025. Është vënë në dispozicion të grupit një dokument “Manual i Proceseve të Punës për Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.A, dokument i cili rezulton gjithashtu jo i firmosur nga të gjithë drejtuesit/përgjegjësit e njësive kryesore, si dhe i pamiratuar nga Administratori i Shoqërisë.
-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Shefi i Sektorit të Financës dhe Kontabilitetit (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Shefi i Sektorit të Financës dhe Kontabilitetit, hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.
-Të gjitha angazhimet financiare të shoqërisë miratohen gjithmonë nga NA dhe NZ.
- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve.
- Ka një regjistër të parashikimit të prokurimeve i cili përditësohet gjatë vitit në përputhje me ndryshimet e fondeve ne dispozicion te Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a.
- Dokumentacionet të ndodhura pranë arkivit të institucionit ruhen, përdoren dhe arkivohen sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe nenit 25 të "normave tekniko-profesionale dhe metodologjike" te Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.
-Në Rregulloren e Brendshme <u>për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë</u>, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar. Në UKK <u>*nuk rezulton*</u> të jetë hartuar një rregullore “Për menaxhimin dhe administrimin e aktiveve” apo “Strategji për menaxhimin e aktiveve”.
-Aktivet e rëndësishme dhe aktivet afatgjata ruhen nga përdorimi i paautorizuar.

UKK ka miratuar Rregulloren me nr. 2477 prot., datë 30.10.2025 “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit dhe mbrojtjen nga hakmarrja në Ujësjellës Kanalizime Kamëz” Sh.A në përputhje me Ligjin nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, neni 13, pika 10; Me urdhër nr. 2478 prot., datë 30.10.2025 është krijuar njësia përgjegjëse ku është caktuar edhe personi përgjegjës për sinjalizimin.
Për vitin 2025, nuk raportohen raste të sinjalizimit, për të cilat është njoftuar edhe ILDKPKI me shkresën nr. 93 prot.,datë 16.01.2026.
Për periudhën përpara nxjerrës së urdhrave të mësipërm, grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion urdhri nr. 84, datë 23.11.2021 “Për krijimin e njësisë përgjegjëse”, me vendimin nr. 1, datë 13.01.2022 është miratuar rregullorja dhe me shkresën nr. 70 prot., datë 13.01.2023 shkresa drejtuar ILDKPKI ku raportohet se nuk ka raste të sinjalizimit për vitin 2022. Për vitin 2023 dhe 2024 nuk ka asnjë dokument apo raportim për raste sinjalizimi si dhe kush janë personat përgjegjës pranë kësaj njësie.
-UKK <u>*nuk ka hartuar*</u> “Rregulloren e Parandalimit të konfliktit të interesave”;
- Për periudhën objekt auditimi, rezulton se në UKK nuk ka patur raste konflikti interesi në procedurat e realizuara në punë publike, mallra e shërbime;

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a. Gjithashtu arkëtimet kryhen edhe nëpërmjet Arkës ku në total janë 7 pika pagesash "Arke" ne territorin e Bashkisë Kamëz, të cilat mblidhen çdo ditë ose një herë në dy ditë nga Koordinatori i Arkave.
-Për periudhën objekt auditimi, Titullari i Shoqërisë U.K.K. sh.a nuk ka miratuar e arkivuar gjurmën e auditimit. *Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.* Kjo bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
Rezulton se me urdhrat nr. 186, 187, 188, 189, 190, Prot., datë 30.01.2026, janë hartuar Gjurmët e Auditimit për "Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm", "Për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore", "Për prokurimet me vlera të larta dhe të vogla", "Për menaxhimin e aktiveve" dhe "Për arkivën dhe protokollin".

"*Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë*".
-Institucioni i UK Kamëz, disponon një sistem informatik për faturimin dhe arkëtimin e faturave të ujit, të ardhurat dytësore, si dhe faturimin e taksave që mblidhen për llogari të Bashkisë Kamëz, sipas Akt Marrëveshjeve vjetore respektive. Sistemi që operon UK Kamëz, është programi financiar i licencuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale dhe i regjistruar në organet tatimore me emrin "OX.", i cili bën dhe fiskalizimin përkatës të faturës.
-Drejtoritë e tjera nuk punojnë me aplikacione dhe programe të posaçme për menaxhimin e të dhënave, por vetëm me programet Word/Excel, duke krijuar hapësirë për cenimin e integritetit të dhënave që institucioni menaxhon dhe përpunon.
Institucioni nuk ka procedura për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë së punës nëpërmjet një sistem rezervë (back-up) TI të përshtatshëm, plan rikuperimi nga fatkeqësitë të testuar në praktikë. Planet e emergjencave janë vënë në zbatim në mënyrë testuese pasi deri tani nuk ka pasur asnjë situatë emergjence reale.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.
Stafi i UKK nuk është përfshirë në trajnimet mbi Ligjin *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Mungesa e realizimit/dokumentimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit "*Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" dhe Manualin MFK, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve si dhe ndërmjet sektorëve me personin përgjegjës për çështjet ligjore, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësive brenda strukturës së UKK apo UKK me institucione të tjera publike dhe jo vetëm. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal.
a. Në UKK, pjesë e kabinetit të Administratorit janë 3 pozicione pune për mediat. Pavarësisht se na faqen web të institucionit, përcaktohet si Koordinator për të drejtën e informimit punonjësja Esmeralda Dalti nuk ka asnjë vendim apo urdhër që përcakton këtë punonjëse si Koordinator, sipas përcaktimit të nenit 2 pika 6 dhe nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Konstatohet se, pavarësisht se janë 3 punonjës për mediat, të cilët sipas nenit 18 të Rregullores së Brendshme përgjigjen për përditësimin dhe mbajtjen konstante të vizibilitetit dhe publikimit të punës dhe veprimtarisë së shoqërisë nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar, faqes zyrtare të internetit..., rezulton se kjo e fundit, pra faqja e internetit ëëë.ukk.al, faqe e cila nuk pasqyron thuajse asnjë aktivitet apo përditësim të çështjeve/punëve/aktivitetet/vendime këshilli etj. Sa më sipër, stafi i medias pranë Administratorit nuk ka aktivitetin që kërkohen sipas rregullores.
b. Kërkesat mbi nevojat buxhetore përcillen në të gjitha nivelet e njësisë;
c. Nuk dokumentohen analizat vjetore të arritjes së objektivave të UKK.
d. Institucioni dispononin e-mail zyrtar si mjet komunikimi për mbarëvajtjet e punës;
e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë verbale dhe rrallëherë në rrugë elektronike.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficiente me kalimin e kohës.

5.1 Monitorimi i vazhdueshëm

Mos hartimi i gjurmëve të auditimit dhe i hartës së proceseve të punës, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv, pasqyruar kjo: në aktivitetin e kufizuar të GMS dhe rrjedhimisht në hartimin e raporteve vjetore vetëm për përgatitjen e PBA; të mungesës së dokumentimit të analizave dhe të raporteve periodike jo rregullisht të menaxherëve të nivelit të ulët dhe të mesëm tek titullari i njësisë mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë (UKK), si dhe identifikimin e atyre fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Raportimet bëhen nga personi përgjegjës i çdo sektori tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS.

5.2 Vetëvlerësimi

Aktet administrative të UKK **nuk** publikohet në faqen zyrtare të saj - Programi i Transparencës sipas Ligjit nr. 119/2014 "*Për informimin publik*" i ndryshuar.

Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të UKK-së, rezulton se për aktivitetin e vitit 2024 janë hartuar Pyetësorët e Vetëvlerësimit për komponentët e MFK, dhe dërguar zyrtarisht në MF me shkresën me nr. 440/2 datë 28.02.2025.

5.3 Auditimi i Brendshëm

UKK, ka ngritur Njësinë e Auditimit të Brendshëm, sipas VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik", pasqyruar me Vendimin nr. 13, datë 18.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 04, datë 02.12.2019 "Për miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.A" i ndryshuar. Sipas këtij vendimi, nga 1 punonjës, ndryshohet dhe bëhet Sektor i Auditit të Brendshëm me 1 Përgjegjës dhe 2 Auditues. Pavarësisht, konstatohet se aktualisht kjo strukturë nuk ka asnjë punonjës të emëruar, duke i munguar si hallkë e kontrollit të brendshëm të njësisë, si dhe për vitet objekt auditimi, nuk disponohet asnjë raport nga kjo njësi. Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

2.8. Auditimi i zbatimit të standardeve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë të ndotur.

Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë, sipas Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë "është:

- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij.
- Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm.
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve.
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

Shoqëria ka organizimin e duhur për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Nisur nga organigrama e Ujësjellës Kanalizimeve Kamzë, e organizuar sipas strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Administrimit sipas Vendimit nr. 8 datë, 18.08.2025 dhe Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve, sipas Vendimit nr. 5 datë, 18.08.2025,[4] ka në përbërjen e saj, një nga departamnetet kryesorë, Departamentin Teknik të përbërë nga 8 sektorë, si më poshtë:

- Sektori Inxhinierik
- Sektori Kimiko-Baktereologjik
- Sektori Operacional
- Sektori i Transportit dhe Makineri të Rënda
- Sektori K.U.N
- Sektori i Riparimeve,Nderhyrjeve në rrugë dhe Punimeve Ndërtimore
- Sektori i Manovrimeve dhe Sigurisë në Depo
- Sektori i Kordinimit te projekteve të Huaja

Në lidhje me auditimin për zbatimin e standardeve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë të ndotur, grupi i auditimit auditoi veprimtarinë e Sektorit Kimiko-Baktereologjik si dhe Sektorit të Manovrimeve dhe Sigurisë në Depo.

Objekti i punës së Departamentit Teknik është:

a. Drejtimi, mbikëqyrja dhe monitorimi i të gjithë aspekteve teknike të aktivitetit të Shoqërisë.

b. Hartimi i projekteve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotura për zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a, ku përfshihen projekte për investime të reja në rrjet, projekte për pikat e lidhjeve dhe pikat e shkarkimit si dhe projekte për rikonstruksione dhe rehabilitime të këtij rrjeti dhe objekteve që i shërbejnë aktivitetit parësor të shoqërisë.

Drejtori i Departamentit Teknik, veç të tjerash ka për detyrë:

- Detajimin e planit vjetor në plane mujore dhe ndjekjen e zbatimin e tyre nga strukturat e varësisë.
- Është përgjegjës për ecurinë e proçesit të përditësimit të rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura.

[4] Për periudhën në auditim, ka pasur ndryshime në strukturën organizative të UKK, por në lidhje me sektorin Kimiko bakteorologjik nuk ka pasur ndryshime dhe për këtë arsye i referohemi strukturës së fundit.

- Merr masa të menjëhershme për eliminimin e ndotjeve të ujit të pijshëm në zonën e shërbimit, etj.

Nga verifikimi i dokumentacionit, u konstatua se nuk kishte plane mujore nga ky departament dhe rrjedhimisht mungonte edhe vlerësimi për punën e kryer sipas muajve dhe detyrave funksionale, veprime në kundërshtim me nenin 27, të Rregullores me nr. 8, date 18.08.2025, si dhe ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 16, pika 2, ku citohet se:

2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Auditimi i veprimtarisë së sektorit kimiko bakteorologjik dhe bashkëpunimi me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në lidhje me cilësinë e ujit.

Shoqëria UKK sha ka në fokus sigurinë fizike të burimeve dhe depove të ujit që është edhe monitorimi i vazhduar i cilësisë së ujit të pijshëm. Ujësjellësi realizon mbrojtjen higjieno-sanitare të rezervuarëve, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri te përdoruesi, sipas standardit kombëtar të ujit të pijshëm: VKM nr. 379, datë 25.5.2016 dhe 16 rekomandimeve për cilësinë e ujit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Ujësjellësi duhet të marrë masa në mënyrë të vazhdueshme për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit dhe garantimin e popullatës më ujë në 24 orë. Një nga sektorët që ka këtë detyrë funksionale është Sektori Kimik-Bakteriologjik që në UKK përbëhet gjithsej nga 5 punonjës, si më poshtë:

- Përgjegjësi i Sektorit (1)
- Kimist (3)
- Laborantë (1)

Struktura fakt nuk ka vakanca.

Tabela: Përshkrimi i zonave dhe pajisjeve

Ujësjellës Kanalizimeve Kamëz	
Zona e mbulimit	Kamzë, Paskuqan, Babrru, Bathore, Valias, Laknas
Pajisje testimi dhe mjete pune	Ph-meter, Klorometër Turbitimeter, Fotometer,Termometer uji,Aparat konduktiviteti

Burimi: UK Kamëz

Objekti i punës së Sektorit Kimik-Bakteriologjik, sipas nenit 39 të Rregullores me nr. 8, datë 18.08.2025, ndër të tjera, është:

a) Kryerja e analizave të plota fiziko-kimike dhe baktereologjike për të gjitha burimet e furnizimit me ujë (puse dhe burime).

b) Bën analiza periodike për klorin mbetës në pikat fundore të përcaktuara e miratuara edhe nga (Inspektoriati Shtetëror sanitar).B.SH.P

c) Në bashkëpunim, me struktura të tjera të shoqërisë është përgjegjëse për eleminimin e ndotjeve, organizojnë marrjen e mostrave për të saktësuar treguesit ndotës të ujit në pikat ku është konstatuar ndotja, dhe e ndjekin deri në eleminim të plotë të ndotjes.

d) Kontrollon, sipas një grafiku të miratuar nga Drejtori i Departamentit për punën e kryer në qendrat e klorinimit.

e) Propozon vendosjen e masave administrative, për personelin klorinues të depove për mos zbatim të rregullave Higjeno – Sanitare të miratuara nga Inspektoriati Shtetëror

Shëndetsor.

f) Zbaton me përpikmëri dhe përgjigjet për zbatimin e procedurës në rastet e ndotjeve të ujit të pijshëm në rrjetin e Tiranës.

g) Ndjek me përgjegjësi të plotë dhe me analiza konkrete laboratorike çdo sasi të re të furnizimit me hipoklorit dhe jep raport me shkrim tek Drejtori i Departamentit për përqindjen mesatare të klorit aktiv që përdoret për dizifektim.

Për të siguruar që uji i pijshëm plotëson, kërkesat e rregullores, kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm duhet të kryhet:

a) në pikat e marrjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të përcaktuara për prodhimin e ujit të pijshëm;

b) në pikën ku uji del nga vepra e trajtimit apo rezervuari i ujit,

c) në rrjetin e shpërndarjes.

Në këtë rast, pikat e marrjes së kampionëve të ujit vendosen nga administratori i shoqërisë nën mbikëqyrjen e strukturës rajonale të shëndetit publik.

Ujësjellësi, për të garantuar cilësinë e ujit të pijshëm kryen analiza ditore në pika të caktuara në rrjetin shpërndarës nëpërmjet sektorit kimik bakteriologjik si dhe analiza periodike në burime, të cilat kryhen nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH).

• Treguesit që ekzaminohen në ujin e pijshëm duhet të jenë në përputhje me VKM nr. 379, datë 25.5.2016 *"Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm"*, i cili është njëherësh dhe standardi shqiptar i treguesve fiziko-kimik të ujit të pijshëm. Ujësjellësi bën dezinfektimin (klorinimin) e ujit të pijshëm sipas VKM nr. 379, datë 25.5.2016 *"Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm".*

Sipas informacioneve të marra në mënyrë elektronike dhe intervistave të kryera, ka rezultuar se:

Kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm përfshin:

a) monitorimin e brendshëm

1. Janë kryer nga SKB në UKK, **21,541** analiza për klorin mbetës për periudhën në auditim. Mostrat për analizat ditore janë marrë në 22 pika fundore për periudhën nga janari 2023 deri në tetor 2024. Nga tetori 2024 janë shtuar dhe 3 pika fundore në zonën Zallmner dhe në total rezultojnë 25 pika fundore për të cilat kryhet monitorim i përditshëm në lidhje me sasinë e klorit të lirë mbetës si dhe Konduktiviteti e PH, të cilat maten një herë në javë.


Tabela: Të dhënat e detajuara statistikore

Muaji	**Viti 2023**	**Viti 2024**	**Viti 2025**
JANAR	551	570	654
SHKURT	580	630	660
MARS	590	630	660
PRILL	588	570	594
MAJ	493	620	693
QERSHOR	638	630	622
KORRIK	630	600	660
GUSHT	660	716	759
SHTATOR	690	660	693
TETOR	658	600	693
NENTOR	620	784	
DHJETOR	551	594	
Totali	**7249**	**7604**	**6688**

Burimi i të dhënave, SKB, përpunoi grupi i auditimit.

Të dhënat e nxjerra nga analizat ditore dhe analizat që kryhen një herë në javë për sasinë e klorinimit, nga SKB mbahen në mënyrë manuale në një regjistër sipas tabelës nr. 1.

Tabela nr. 1. Rregjistër i laboratorit për pranimin e analizave.



RREGJISTER TIP I LABORATORIT për pranimin e analizave

Mars 2025 — Prill 2025

Nr.	Data	Emri, Mbiemri	Cl/ Mosha 19.03.25	Cl/ F 20.03	Cl/ Pranimi 21.03.25	Diagnoza Cl/ Sal 22.03.25	Cl/ Sht 28.03.25	Cl/ Emri i Inicit 27.03.25	Cl/ Nr. i mandatit 27.03.25	Cl/ 01.04.25	Nr. i librezës së punës Lib. Konsultorit 02.04.25	Cl/ 03.04.25	Cl/ 04.04.25	Adresa Cl/ 07.04.25	Cl/ 08.04.25
1	StC	Pompimi Valias	0,93	0,94	0,95	0,96	0,97	0,95	0,96	0,97	0,98	0,99	0,98	0,99	0,92
2	Depo	Hoxha Bathore	0,85	0,84	0,83	0,82	0,81	0,8	0,82	0,81	0,8	0,82	0,81	0,83	0,84
3	Depo	3000m³ Maloku Bathore	0,75	0,74	0,73	0,72	0,71	0,74	0,75	0,74	0,73	0,74	0,75	0,76	0,75
4	Depo	Hoxha Paskugan	0,73	0,72	0,71	0,70	0,69	0,72	0,73	0,72	0,71	0,73	0,74	0,75	0,74
5	Depo	Allushi Paskugan	0,77	0,76	0,76	0,75	0,74	0,73	0,72	0,71	0,73	0,74	0,75	0,76	0,77
6	Depo	Llanexc Paskugan	0,74	0,73	0,72	0,71	0,70	0,72	0,71	0,70	0,72	0,73	0,74	0,75	0,76
7	Depo	Bexill e Vjetër	0,87	0,86	0,88	0,90	0,92	0,93	0,94	0,95	0,96	0,97	0,98	0,99	0,98
8	Depo	2000m³ Babrru	0,85	0,84	0,83	0,85	0,84	0,75	0,73	0,72	0,74	0,75	0,76	0,77	0,76

Burimi: UKK SHA


2. Për 8 Depot dhe pikat e monitorimit mujor, nga NJVSHK, janë analizuar **295** kampione uji për treguesit fiziko-kimik (shije, erë, ngjyrë, turbullirë, amoniak, klor i lirë mbetës, temperature, pH, fortësi e përgjithshme, përcjellshmëri elektrike) dhe analizat bakteriologjike në tregues (E.Coli, Coliforme totale dhe enterokoki). Këta analiza kryhen pranë Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tiranë, detajuar në vijim:

Tabela: Analizat pranë NJVKSH Tiranë

Viti	**2023**	**2024**	**2025**
Analiza Fiziko-Kimike	23	49	73
Analiza Mikrobiologjike	27	50	73
Totali	**50**	**99**	**146**

Burimi i të dhënave, UKK, përpunoi grupi i auditimit.

Për çdo analizë të kryer, nga NJVKSH, mbahet raport analize tip, çdo muaj, me treguesit përkatës mbi rezultatet pas verifikimit në formatin si më poshtë vijon, një kopje e të cilit dorëzohet në UKK.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
DREJTORIA RAJONALE TIRANË
NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR TIRANË

Rrethi Tiranë Datë 04/10/2023

RAPORT ANALIZE NR. 1248 0003012

Për mostrën Ujë në Depo 2000 m3
Subjekti: U.K. Kamëz
Personi Fizik/ Juridik Mirela Domi NIPT L72320034A
Adresa: Babrru
Marrja e mostrës në datë 02/10/2023 Me proces-verbal Nr. 254 nga Fjorida Balla
Sasia e produktit:
Datë prodhimi: datë skadencë:

ANALIZA FIZIKO – KIMIKE / ~~TOKSIKOLOGJIKE~~ TË MOSTRËS 432

Nr	ANALIZA	REZULTATI		NORMA	
1	pH	7,72	6,5-9,5	Klorure	250
2	TDS	157mg/l	1200	HCO_3	180mg/l
3	NH_4	0	0-0,1	SO_4	18,37mg/l 250
4	NO_2	0	0-0,5	Fetal	0 0,293
5	FAT	8,74%	15-20	Zare	0,99mg/l 3
6	Co	42,0 Bq/l	200	SiO_2	0,2mg/l 2,5
7	Mo	11,55 Bq/l	50	Ferrobakt	2/3 vështrim 2500
8	NO_3	3 mg/l		Klori	0,38mg/l 0,3-0,5
9		Rezultati analizës vlen vetëm për mostrën
10		e marrë, të testuar në laborator.

Analizoi Gjystela Selo, datë 04/10/2023
Emër, Mbiemër Nënshkrimi

ANALIZAT MIKROBIOLOGJIKE / ~~ETNOMOLOGJIKE~~ TË MOSTRËS Nr. 994

Nr	ANALIZA	REZULTATI	NORMA
1	MPN Coliform total	0	0
2	MPN Escherichia Coli	0	0
3	MPN Streptococcus faecal	0	0
4			
5			
6	Për 100 ml ujë. Raporti vlen vetëm për mostrën
7	e ardhur dhe ekzaminuar në laborator.
8			
9			
10			

Analizoi Dr. Rexhep Mujа, datë 04/10/2023
Emër, Mbiemër Nënshkrimi

Vlerësimi Higjenik dhe vendimi:

Specialisti DREJTORI

Adresa: Rr. Dritan Hoxha, Ndërtesa Gurrapi, Kati Gurrapi, Tiranë, Albania. Tel: +355 4347439, nivkshtirane@shendetesia.gov.al

Kontrolli analitik i ciklit të integruar të ujit përfshin monitorimin e vazhdueshëm të funksionimit të impianteve të trajtimit të ujit të destinuar për konsum njerëzor si dhe të ujërave të burimeve alternative, si dhe karakteristikat e ujit të shpërndarë dhe të kthyer në mjedis.
Mostrat kryesore që i janë nënshtruar testimit kanë të bëjnë me ujin e destinuar për konsum njerëzor.
Çdo fillim muaji nga Sektori Kimik Bakteriologjik dërgohen 8 mostra mikro biologjike dhe 8 mostra për analizë fiziko kimike. në NJVKSH.

Tabela: Analizat Fiziko kimike dhe mikrobiologjike të ujit të realizuara çdo muaj.

Nr	Treguesit Fiziko -Kimikë	Komente	Treguesit Mikrobiologjikë	Komente
1	Klori I lirë total	Laboratori Ukk dhe Nj.V.K.SH-ja Tiranë	E.Coli	Nj.V. K.SH-ja Tiranë
2	SiO2	Nj.V.K.SH-ja Tiranë	Total Coliforms	Nj.V.K.SH-ja Tiranë
3	Fe total	Nj.V.K.SH-ja Tiranë	Streptococcus Faecalis	Nj.V.K.SH-ja Tiranë
4	NH_4	Nj.V.K.SH-ja Tiranë		
5	NO_2	Nj.V.K.SH-ja Tiranë		
6	NO_3	Nj.V.K.SH-ja Tiranë		
7	Konduktiviteti	Laboratori Ukk dhe Nj.V.K.SH-ja Tiranë		
8	Fortësi e përgjithshme	Nj.V.K.SH-ja Tiranë		
9	PH	Laboratori Ukk dhe Nj.V.K.SH-ja Tiranë		

Burimi i të dhënave: UKK, Sektori Kimiko-Bakterologjik;

Në UKK ka një mini laborator në të cilin kryhen analiza të përditshme për matjen e klorit, konduktivitetit, PH si edhe analiza fiziko të pjesshme me spektofotometër, ku analizohen fosfatet, sulfatet etj.
Aktualisht laboratori është duke u zgjeruar në pajisje dhe reagentë (furra, mikroskop, spektofotometër) konkretisht në dhjetor 2025, është kryer edhe furnizimi me pajisje të tjera si mikroskop, spektofoto metër të cilat ndikojnë në rritjen e monitorimit të cilësisë së ujit.
Ky laborator është i pa akreditуar si dhe nuk ka nevojë një plan vjetor për trajnimin e sektorit kimik, i cili do të parashtronte nevojat reale për trajnim të punonjësve dhe do të sillte rritje të cilësisë në punë.

Konkluzione
- Shoqëria e Ujësjellës Kanalizime Kamzë, ka mungesë të akreditimit laboratorik sipas standardeve ISO 17025;
-Analizat janë të pjesshme (vetëm parametra bazë).
-Ka mungesë të frekuencës së monitorimit pasi nuk ka një grafik *të miratuar nga Drejtori i Departamentit për punën e kryer në qendrat e klorinimit..*
Nëse ka devijime nga standardet nuk ka reagim nga UKK apo masa masave administrative, për periudhën në auditim, për personelin klorinues të depove për mos zbatim të rregullave Higjeno – Sanitare të miratuara nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.
-Analizat kryhen edhe nga NJVKSH, por UKK mbetet përgjegjësi kryesor për cilësinë e ujit të pijshëm, pasi nuk ka mekanizma të formalizuar monitorimi dhe ndjekje duke krijuar vakum përgjegjësie duke sjellë dobësi në kontrollin e brendshëm dhe në menaxhimin e riskut.
-Nuk evidentohet një marrëveshje e formalizuar bashkëpunimi midis UKK dhe NJVSHK që të përcaktojë qartë detyrimet, parametrat, frekuencën dhe mënyrën e raportimit.
- Ka edhe mangësi në disa rajone në lidhje me numrin e mostrave të testuara dhe ekzekutimin e analizave të plota, prandaj, është e nevojshme që të gjithë operatorët e ujësjellësve të përmirësojnë praktikat dhe kapacitetet për testimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

II. Auditimi mbi Sigurinë e Burimeve Ujore, Stacioneve të Pompimit dhe Depove të Ujit
Siguria e burimeve ujore, stacioneve të pompimit dhe depove të ujit është një faktor kyç për garantimin e furnizimit të sigurt dhe të pandërprerë me ujë për qytetarët. Përveç ruajtjes së cilësisë së ujit, është e domosdoshme të merren masa për të mbrojtur këto infrastruktura kritike ndaj rreziqeve natyrore dhe veprimeve të qëllimshme.
Baza Ligjore:
- VKM nr. 379, datë 25.5.2016 Për Miratimin e Rregullores *"Cilësia e Ujit Të Pijshëm"*
- VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 *"Për miratimin e modelit të Rregullores "Për Furnizimin Me Ujë Dhe Për Kanalizimet në Zonën e Shërbimit Të Ujësjellës-Kanalizimeve* Sh A*."*.
Perimetri i Sigurisë dhe Masa Mbrojtëse
Për të mbrojtur burimet dhe stacionet e pompimit, si dhe depot e ujit, është e nevojshme të përcaktohet një perimetër sigurie rreth këtyre zonave. Në këtë zonë duhet të jetë e kufizuar qasja e personave të pa autorizuar dhe të merren masa për sigurinë fizike, ndër te cilat përmendim:
- Rrethimi i stacioneve të pompimit dhe depove të ujit me rrethim mbrojtës;
- Instalimi i kamerave të sigurisë dhe ndriçimit të jashtëm për të parandaluar qasjen e paautorizuar;
- Kontrolli i hyrjeve dhe daljeve me masa strikte për monitorimin e personave që hyjnë në zonat e mbrojtura;

- Mbrojtja e Burimeve Ujore: Bazuar në legjislacionin në fuqi për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, mbrojtja e burimeve ujore duhet të sigurojë jo vetëm integritetin fizik të burimeve, por edhe cilësinë e tyre nga ndotja.

Sipas nenit **61/ Sektori i manovrimeve dhe sigurisë në depo** është strukturë në varësi të Departamentit Teknik, në UKK.

Objekti i veprimtarisë së Sektorit të Manovrimeve dhe Sigurisë në Depo është:

a. Monitorimi i procesit të prodhimit të ujit dhe procesit të punës në Puset, Burimet e pavarura, Stacionet e Pompimit, Depot e ujit në zonën e shërbimit të Drejtorisë Rajonale.

b. Sigurimi i cilësisë së ujit që futet në rrjetin shpërndarës për të garantuar ujë higjenikisht të pastër.

c. Mirëfunksionimin e gatishmërinë e sistemit të klorinimit të depove dhe burimeve.

d. Eliminimin e ndotjeve të ujit të pijshëm në bashkëpunim me sektorin e mirëmbajtjes.

e. Sigurimi dhe respektimi i kushteve higjenosanitare për çdo objekt të prodhimit të ujit.

Sektori i Manovrimeve dhe Sigurisë në Depo në Ujësjellës Kanalizime Kamzë, përbëhet nga 33 punonjës gjithsej:

a. Shef Sektori, (1)

b. Manovrator në Depo. (32)

Nuk ka vakanca në këtë sektor.

Situata aktuale e depove të ujit nga informacionet e marra në mënyrë elektronike, si dhe në disa zona nga këqyrja në terren, rezultoi si më poshtë:

Bazuar në legjislacionin aktual objektet që duhet të ruhen me roje të armatosura 24 orë janë burimet, depot dhe stacionet e pompimit. Shoqëria Ujësjellës kanalizime Kamzë, SH.A, ka 8 objekte. Kryesisht këto objekte janë të investuara në 10 vitet e fundit dhe kanë rrethime deri diku të përshtatshme.

Paraqesim si më poshtë disa foto ilustruese në vijim duke sjellë në vëmendje edhe trajtimet që janë bërë nga ana e Shoqërisë UKK sha:

STACIONI I POMPIMIT' 4 PUSET VALIAS



STACIONI I POMPIMIT' 4 PUSET VALIAS

Stacioni i pompimit Valias - Furnizon të gjitha njësitë zonale Kamzë, Valias dhe një pjesë të vogël të zonës Laknasit. Ky stacion merr uë të pa trajtuar nga 4 pus-shpimet që ndodhen pranë

Stacionit te pompimit Valias dhe bëhet trajtimi automatik i ujit me Hipoklorit natriumi NaOCl gjatë gjithë kohës. Në dy stacionet e klorinimit në Kamzë dhe Bovillë janë të instaluara në sistemet e klorinimit, pompa klorinimi Grundfos të tipit : DMH12/16AR.
Gjatë 24 orëve zona është e mbikëqyrur nga punonjës, pjesë e stafit të UK Kamzë, të cilët ruajnë zonën përreth dhe bëjnë manovrimet e ujit.
Konstatohet që pas klorinimit sasia e klorit në Stacionin e pompimit Valias varion në vlerat 0.8-1mg/l -1mg/l vlerë e cila është brenda parametrave sipas VKM-së, nr. 379 datë 25.05.2016 për "Cilësinë e ujit të Pijshëm".

1. **Burimi Bovillë e Vjetër**

Furnizon zonën e Babrroit, Bathores dhe Zall-Herr gjatë 24 -orëve. Bovilla përbëhet nga tre Burime.




BOVILLE", 3 BURIMET BOVILLE

Ky stacion merr ujë të pa trajtuar nga 3 burime dhe bëhet trajtimi automatik i ujit me Hipoklorit natriumi NaOCl. Në dy stacionet e klorinimit në Kamzë dhe Bovillë janë të instaluara në sistemet e klorinimit, pompa klorinimi Grundfos të tipit : DMH12/16AR.
Këto burime janë të survejuara 24 orë nga punonjës të trajnuar për përdorimin e sistemit të injektimit të klorit ku mbikëqyret gjatë gjithë kohës dhe ruan zonën.
Sasia e klorit ne impiantin e Bovillës varion në vlerat 0.8-1mg/l -1mg/l vlerë e cila është brenda parametrave sipas VKM-së, nr. 379 date 25.05.2016 për "Cilësinë e ujit të Pijshëm".

2. Depo Maloku i Ri 3.000m^3



Siguria Në Depo

- Kjo depo merr ujë të trajtuar nga impianti i Tiranës dhe nga uji i Bovillës. Zona e parë, zona imediate ose e rreptësisë së mbrojtjes sanitare, në këtë depo furnizimi është e rrethuar me kangjella hekuri. Sipërfaqja brenda rrethimit është e mirëmbajtur.
Sipërfaqja e pronës S=6.581m2; Gjurma e ndërtimit se depos Maloku I Ri : S=848 m2.
Kjo depo furnizohet me ujë të trajtuar nga impianti i Tiranës si edhe ujë i trajtuar nga burimi i Bovillës.

3. DEPO, HOXHA BATHORE (Bulqesh), kapaciteti 1500 m^3

Sipërfaqja e Pronës S= 6.320 m$^{2;}$ Gjurma e ndërtimit së depos 1: S=422 m$^{2.}$ Godina = 94 m^2.
Kjo depo merr ujë të trajtuar nga Impianti i Tiranës dhe ujë të trajtuar nga Bovillë e vjetër (tre burimet).

Siguria Në Depo
Në këtë depo furnizimi, zona e rreptësisë e mbrojtjes sanitare është e rrethuar me kangjella hekuri. Sipërfaqja brenda rrethimit është e mirëmbajtur. Në këtë depo mbikëqyrja e zonës së depos furnizuese realizohet nga katër punonjës (manovratorë) të cilët bëjnë edhe manovrimet në oraret e përcaktuara.




DEPO UJI 'DEPO HOXHA 1500m^3 BATHORE(BULQESH)

4. DEPO LLANI 1000 m3 (Llanëve) Paskuqan 2
- Siperfaqja e Pronës S= 674 m^2
- Gjurma e ndërtimit se depos : S=318 m^2
- Godinë 1 kat (Vendorja)= 12 m^2

Kjo depo merr ujë të trajtuar vetëm nga Impianti i Tiranës.

Siguria Në Depo: Në këtë depo furnizimi zona e rreptësisë e mbrojtjes sanitare është e rrethuar me kangjella hekuri. Sipërfaqja brenda rrethimit është e mirëmbajtur.
Në këtë depo mbikëqyrja e zonës së depos furnizuese realizohet nga katër punonjës (manovratorë) te cilët bëjnë edhe manovrimet në oraret e përcaktuara.

DEPO UJI ‘ DEPO LLANI 1000m^3 PASKUQAN’

5. DEPO UJI, BABRRU (SHPRESA-AL) 2000m^3.

Furnizon zonën e Babrroit; Orari i mbushjes 23:00; Orari i shfrytëzimit 14:00 – 18:00.

Kjo depo merr ujë të trajtuar nga Impianti i Tiranës dhe ujë të trajtuar nga Bovillë e vjetër (tre burimet) .




Investimi në këtë depo është kryer në pesëvjeçarin e fundit, si dhe ambienti ku rrinë manovratorët është brenda kushteve normale, është e rrethuar me kangjella hekuri dhe është larg qendrave të banimit duke eliminuar në këtë mënyre risqet e ndotjes përreth.

6. DEPO ALLUSHI 1500m^3 PASKUQAN ‘KODER KUQE’.

Sipërfaqja e Pronës S= 905 m^2; Gjurma e ndërtimit se depos : S=381.4 m^2 ; Godinë 1 katësh (Vendorja)= 24 m^2; Orari i mbushjes 18:00 –22:30; Orari i komandimit 05:00 – 06:00 një herë në 24 orë.

Furnizon zonën e Bathores dhe një pjesë të zonës të Paskuqanit (Vreshtën). Kjo depo merr ujë të trajtuar nga Impianti i Tiranës.

Siguria Në Depo

Në këtë depo furnizimi, zona e rreptësisë e mbrojtjes sanitare është e rrethuar me kangjella hekuri. Sipërfaqja brenda rrethimit është e mirëmbajtur.

Në këtë depo mbikëqyrja e zonës së depos furnizuese realizohet nga katër punonjës (manovrator) te cilët bëjnë edhe manovrimet në oraret e përcaktuara.

Monitorimi i brendshëm mbahet me regjistër ku në të hidhen matjet e parametrave që i bëhen ujit si dhe ecuria e punës dhe gjendja e depos .







7. DEPO HOXHA 1000m^3 PASKUQAN

Sipërfaqja e Pronës S= 873 m^2; Gjurma e ndërtimit së depos: S=292.6 m^2 ; Godinë 1 katësh = 16.2 m^2; Orari i mbushjes 18:30 – 22:00; Orari i komandimit: 05:00 –10:00, një herë në 24 orë; Furnizon zonën Kodër Paskuqan; Kjo depo merr ujë të trajtuar nga Impianti i Tiranës.



Siguria Në Depo

Në këtë depo furnizimi, zona e rreptësisë e mbrojtjes sanitare nuk është e rrethuar me kangjella hekuri. Është afër qendrave të banimit. Sipërfaqja brenda rrethimit rezultoi e mirëmbajtur.
Në këtë depo mbikëqyrja e zonës së depos furnizuese realizohet nga katër punonjës (manovrator) te cilët bëjnë edhe manovrimet në oraret e përcaktuara.
Monitorimi i brendshëm bëhet me regjistër ku në të hidhen matjet e parametrave që i bëhen ujit si dhe ecuria e punës dhe gjendja e depos.

Konkluzion: Pra, si ilustrohet edhe në fotot e objekteve më lart, pjesa më e madhe e burimeve dhe depove nuk kanë rrethime perimetrale të përshtatshme, mungojnë sistemet e monitorimit me kamera, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 379, Shtojca VI, Zonat e Mbrojtjes Sanitare, për më tepër është e pamundur që të gjithë objektet të ruhen me roje.

Si kemi evidentuar më sipër, janë rreth 8 objekte dhe kostot sipas çmimeve të Ilirian Guard për një vend roje është rreth: 5 persona në muaj * 88.000 lekë/person = 440.000 lekë në muaj për një objekt.
Kosto totale për ruajtjen e 8 objekteve me roje do të ishte **440,000*12*8=42,240,000 lekë/vit.**
Një shumë kjo e papërballueshme për shoqërinë e UK, Kamzë, e cila trashëgon probleme të borxheve dhe tarifave të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e operimit.
Për shkak të këtyre kostove që janë tej mundësive të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, janë kryer zgjidhje të pjesshme prej tyre, me staf roje të punësuar brenda shoqërisë, por të pa armatosur. Aktualisht në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime janë të punësuar 32 personel në detyrën Manovratorë të ndarë 4 Manovratorë për 8 Depo.
Rëndësia e Sigurisë për Furnizimin me Ujë: Siguria e burimeve ujore dhe infrastrukturës së lidhur me to (stacionet e pompimit dhe depot e ujit) është esenciale për garantimin e furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm për qytetarët. Kjo përfshin jo vetëm mbrojtjen e cilësisë së ujit nga ndotja, por gjithashtu mbrojtjen e këtyre burimeve nga rreziqe natyrore (si përmbytjet, tërmetet) dhe veprime të qëllimshme (si vandalizmi, vjedhjet dhe sabotazhi). Pa një siguri të mirë organizuar, ka rrezik që këto burime të bëhen të papërdorshme ose të ndotura, duke cenuar sigurinë e furnizimit me ujë për qytetarët.
Masa Mbrojtëse dhe Zbatimi i Legjislacionit: Për të mbrojtur burimet ujore dhe infrastrukturën që lidhet me to, është e nevojshme që të merren masa të forta mbrojtëse. Këto përfshijnë krijimin e një perimetri sigurie rreth burimeve dhe stacioneve të pompimit, duke kufizuar qasjen për persona të paautorizuar. Ndër masat mbrojtëse janë:

- Rrethimi i stacioneve dhe depove të ujit me rrethime të forta dhe mbrojtëse.
- Instalimi i sistemeve të kamerave të sigurisë dhe ndriçimit të jashtëm për të parandaluar hyrjet e paautorizuara.
- Kontrolli rigoroz i hyrjeve dhe daljeve, duke monitoruar çdo person që hyn në këto zona të mbrojtura. Këto masa janë të përcaktuara nga legjislacioni, si VKM Nr. 379/2016, që kërkon zbatimin e standardeve për mbrojtjen dhe sigurinë e burimeve ujore.

Kjo situatë përbën risk për kontaminim sekondar të ujit të pijshëm dhe shëndetin publik si dhe ekspozim ndaj përgjegjësive ligjore dhe reputacionale.

Nga auditimi u konstatua se:

- Laboratori që kryen analizat nuk është i akreditуar sipas ISO 17025;

- Një pjesë e analizave kryhen nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, pa marrëveshje të formalizuar bashkëpunimi që përcakton përgjegjësitë dhe frekuencën e analizave;
- Shoqëria administron 8 depo uji, në të cilat mungon survejimi me kamera, si dhe në 3 prej tyre rrethimi nuk është i sigurt sipas perimetrave mbrojtës dhe standardeve të sigurisë duke shtuar riskun për akses të pakontrolluar.
- Nuk evidentohet një plan i dokumentuar mirëmbajtjeje dhe dezinfektimi periodik.
- Nuk ka plane vjetorë trajnimi si për punonjësit e sektorit kimik bakteriologjik ashtu edhe për sektorin e Manovrimeve dhe Sigurisë në Depo.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për rekrutimin e punonjësve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, rezultoi se Administratorët e UK Kamëz për periudhën nën auditim, nuk kanë hartuar dhe miratuar një procedurë për rekrutimin e punonjësve.
Lidhur me emërimin e punonjësve të UK Kamëz, rezultoi se në 15 raste rekrutimi i tyre është kryer në mospërputhje me kriterin e arsimit, ndërkohë mungojnë procedurat transparente të rekrutimit. Faqja web e institucionit pavarësisht se ka një hapësirë për vende të lira pune, nuk përditëson shpalljet për vendet e lira.
Dokumenti i cili përcakton pozicionet e punës dhe nivelin arsimor, të punonjësve, krahas nivelit arsimor që kërkohet ka përcaktuar në fund edhe pjesën (etj.), i cili është përcaktim evaziv pasi mund të justifikohet në emërime të papërshtatshme të stafit.
Për periudhën objekt auditimi, u konstatuan mangësi të dosjeve të punonjësve, si mungesa e diplomës ose diploma fotokopje të panoterizuara, mungojnë vërtetimet nga gjykata, prokuroria, dëshmitë e penalitetit, mungojnë librezat e punës ose janë fotokopje të panoterizuara, kërkesat për punë janë të pafirmosura, të paprotokolluara ose nuk disponohen në dosje. Në disa raste mungojnë kontratat individuale të punës.
Për periudhën objekt auditimi, përgjithësisht mungojnë vlerësimet vjetore të punonjësve, ndërsa evidentohen edhe raste ku mungojnë përshkrimet e punës të tyre, ose janë të pa firmosura.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 9, pika 5 germa (a), nenin 21 "Forma e kontratës së punës" pikat 1, 2, 3, 4, dhe nenit 202 pika 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenet 20 dhe 22, të Ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe pikën 3.1 dhe 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016; VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", neni 1, 2, dhe elementët e dosjet përcaktuar në Lidhjen 1 të këtij vendimi, dhe dokumenti i përcaktimit të

pozicioneve të punës dhe nivelit arsimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA të marrë masa për:

- hartimin dhe miratimin e një procedure të standardizuar për rekrutimin e punonjësve të shoqërisë, e cila të garantojë respektimin e parimeve të barazisë së mundësive, transparencës në çdo fazë të procesit dhe ndalimit të çdo forme diskriminimi në të drejtën për punësim;
- rekrutimin e punonjësve me profilin e duhur, ku kriteri i punësimit të përputhet me arsimin e tij;

1.2. Rekomandimi: Përgjegjësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore, të përditësojë dhe plotësojë me të gjitha dokumentet e nevojshme dosjet e personelit.

1.3. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA në bashkëpunim me Njësinë e Burimeve Njerëzore, të kryej vlerësimet periodike vjetore, për të përcaktuar performancën e punonjësve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, miratimin, realizimin dhe raportimin e programeve ekonomike u konstatua se:

- Për vitet 2024 dhe 2025 nuk janë respektuar afatet kohore "brenda datës 1 dhjetor të çdo viti" për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve.
- Hartimi i programeve ekonomikë të zhvillimit të shoqërisë nuk është kryer për periudha afatmesme dhe afatgjata bazuar në objektivat e caktuara nga organet drejtuese.
- Programet e zhvillimit të shoqërisë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës, nuk janë miratuar pranë ministrisë përgjegjëse për sektorin e furnizimit me ujë e të kanalizimeve dhe Prefektit të Qarkut.
- Për disa zëra shpenzimesh planifikimet nuk janë bazuar në realizimet e viteve paraardhëse, duke u programuar jo sipas nevojave reale, pasi kanë rezultuar me mosrealizime të theksuara. Raportimet mujore dhe vjetore janë thjesht realizimi i shpenzimeve dhe të ardhurave në formë tabelare, të cilat nuk shoqërohen me relacionet shpjeguese të ecurisë së shoqërisë. Pra mungon një analizë e hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë me tregues analitik për nivelin e arritjeve të treguesve cilësor të prodhim furnizimit, shpërndarjes dhe arkëtimit të ardhurave.
- Raportimi në Entin Rregullator të Ujit (ERRU) mbi realizimin e treguesve ekonomik e financiar dhe të performancës për vitet 2023 dhe 2024 me email-et përkatëse të datave 04.01.2024 dhe 23.01.2025 nuk përputhet me raportimin vjetor financiar dhe jo financiar që paraqitet në Këshillin Administrimit në kundërshtim me Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neni 17 dhe 18.
- Paketa fiskale e miratuar me vendimet nr. 6 dhe 7, datë 01.11.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve "Për miratimin e tarifave të shërbimeve, i ndryshuar për vitin 2024 dhe në vazhdim të Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA" nuk është miratuar në Entin Rregullator të Ujit (ERRU).

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror" Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1, 2, 3 dhe 4, me VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" i ndryshuar, Kreu I pika 8, Lidhja nr.1, neni 18, pika 7/ç, me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" i ndryshuar nenet 14/b, f,

20 dhe 31/1.a, 22, me "Rregulloren e licencimit për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (e ndryshuar)", miratuar me vendim të (Komisionit Kombëtar Rregullator) KKRR nr. 29, datë 08.12.2009, i ndryshuar, nenet 17, 29, 30, me "Kontratën për shërbime Ujësjellës-Kanalizime e përditësuar" miratuar me vendim të KKRR nr. 25, datë 08.07.2015", nenet 7, 8 dhe 10. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 31-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Departamentin Ekonomik të marrin masa që programet ekonomike të hartohen për periudha afatmesme, ndërsa ato vjetore të paraqiten në afat për miratim në Këshillin e Administrimit, pranë Ministrisë përgjegjëse dhe Prefektit të Qarkut. Raportimi periodik dhe ai vjetor i ecurisë së shoqërisë, i realizimit të treguesve ekonomiko-financiar dhe i performancës të paraqitur pranë Këshillit të Administrimit dhe ERRU, të jetë i përditësuar dhe i përputhur, si dhe i mbështetur me analizë faktoriale.

- Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, të marrë masa për miratimin pranë ERRU të paketës fiskale me tarifat e shërbimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programit ekonomiko financiar të shoqërisë UK Kamëz SHA, u konstatua se në programet ekonomike për vitet 2023 - 2024 - 2025 është parashikuar zëri i shpenzimeve *"Fondi i veçantë për të përndjekurit politik"* në shumën 3,500 mijë lekë në vit, në total 10,500 mijë lekë, shumë e cila nuk është transferuar për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë, në kundërshtim me shkronjën "b" të nenit 1 të Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë" dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 "Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 15-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Departamentin Ekonomik të marrin masa që fondet e planifikuara në programet ekonomike për zërin "Fondi i veçantë për të përndjekurit politik" të transferohen për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, miratimin, realizimin dhe raportimin e programeve ekonomike u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk ka programe zhvillimi të hartuara, bazuar në treguesit historik, në iniciativat, perspektivat e investimeve, por kanë patur prioritet vetëm treguesit e prodhimit, faturimit dhe arkëtimit duke i planifikuar me rritje, por pa argumentuar nga ana sasiore apo cilësore, pa një analizë të hollësishme për aftësinë paguese të shoqërisë. Në relacionet dhe në raportet mbi realizimin e programit ekonomik nuk jepen shpjegime të sakta mbi arsyet dhe faktorët e realizimit ose mosrealizimit të treguesve të planifikuar, ku niveli i realizimit në total i programeve ekonomike paraqitet respektivisht, në vitin 2023 në masën 84%, në vitin 2024 në masën 82% dhe në vitin 2025 në masën 88%. Nuk ka përllogaritje të sasisë së ujit që humbet nga lidhjet e paligjshme që janë në rrjetin aktual që administrohet nga shoqëria, pasi janë futur në humbje dhe shpërdorimet e ujit nga lidhjet e paligjshme dhe nga mosfaturimi i ujit, të cilat janë konsideruar si humbje tekniko-

ekonomike në masën 60 -70%. Pavarësisht se arkëtimi koherent kundrejt faturimit është në nivele të larta rreth 98% dhe debitë janë në nivele të larta, rezultoi se arkëtimet e detyrimeve të prapambetura janë në nivele të ulëta rreth 8%. Edhe pse norma e arkëtimit për mbulimin e kostove direkte të operimit & mirëmbajtjes dhe kostos totale është në nivel të pranueshëm të përcaktuar nga ERRU, duhet theksuar se kostot e punës, ku përfshihen shpenzimet për paga, shtesa e kontribute për punonjësit janë në nivele të larta nga rritja e numrit të punonjësve nga viti në vit. Këto shpenzime zënë rreth 56-69% të kostos direkte O/M dhe rreth 45-56% të kostos totale dhe me një koeficient të numrit të punonjësve në 1000 lidhje të UK prej 4.93-5.54 mbi nivelin prej 4.6 të përcaktuar nga ERRU. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Kreu III, Udhëzimin nr.15, datë 02.05.2018 "Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror", Kapitulli I, pikat 2,5 dhe 6, Kapitulli II, pikat 1 dhe 2 dhe Kapitulli III, pikat 1, 2, 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 15-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit i Shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Kamëz" SHA, nëpërmjet të dhënave të ardhura nga Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Teknik, të analizojë treguesit ekonomiko-financiar dhe rezultatet e arritura, për të hartuar programe ekonomike referuar mundësive dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të shoqërisë, duke synuar uljen e kostos, minimizimin e humbjeve, rritjen e të ardhurave me qëllim përmirësimin e performancës së saj, arritjen e objektivave të përcaktuara, si edhe kërkesat e përcaktuara në "Strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime për vitet 2022-2030".

Në vijimësi

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, rezultoi se anëtarit të Këshillit të Administrimit z. R. H. i ka mbaruar mandati 3 vjeçar, ndërkohë që vijon të jetë në detyrë jashtë mandatit ligjor.

Gjithashtu, konstatohet se në nenin 16 pika (a) të Statutit të Shoqërisë përcaktimi se mandati i anëtarëve të Këshillit të Administrimit përfundon me mbarimin e mandatit të administratorit nuk është i argumentuar dhe mbështetur në ligj, pasi mandati i anëtarit nuk lidhet drejtpërdrejtë me mandatin e administratorit.

Veprimi i mësipërm, është në kundërshtim me nenin 155, pika 2, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 13-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, të marrë masa për:

- marrjen e vendimit për konstatimin e përfundimit të mandatit të anëtarit R. H. të Këshillit të Administrimit dhe ndërprerjen e ushtrimit të funksionit jashtë mandatit, duke proceduar me emërimin e anëtarit të ri ose ri-emërimin e këtij anëtari sipas procedurave ligjore dhe statutore në fuqi.
- rishikimin dhe ndryshimin e nenit 16, pika (a) të Statutit të Shoqërisë, duke eliminuar varësinë e funksionalitetit mes mandatit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe mandatit të administratorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i proceseve gjyqësore për marrëdhëniet e punës për largimet nga puna për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, u konstatuan 6 kërkesa padie ndaj UK Kamëz për ndërprerje të padrejtë të marrëdhënies së punës së ish-punonjësve. Nga këto, 3 padi janë

pranuar nga gjykata, të cilat janë ankimuar nga institucioni, dhe 3 padi janë në pritje për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.
Konstatohet se përgjithësisht nuk janë zbatuar afatet e njoftimit nga Institucioni për këta punonjës, sipas përcaktimeve në nenin 141,142, 143, 144, 145 dhe 146 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 44-57, të Projekt Raport Auditimit*).
6.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i APR, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, të bashkërendojnë punën dhe sigurojnë një praktikë në përputhje me Kodin e Punës, Rregulloren e Brendshme të Institucionit dhe kontratat individuale të punësimit, për ndjekjen e procedurës së rregullt ligjore për procedurat e lirimit të punonjësve, për të përcaktuar standardizimin e një procesi të dhënies së masave disiplinore dhe respektimit të afateve ligjore, për të bërë të mundur shmangien e proceseve gjyqësore nga lirimet e punonjësve nga puna.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se në mbyllje të vitit 2024 paraqiteshin me teprica debitore:
- llogaria *421 "Paga e shpërblime punonjësish"* në vlerën 497,729 lekë, e cila përfaqëson kreditimin e punonjësve në formë paradhënie për paga dhe jo për udhëtime e dieta, të cilat nuk janë kthyer brenda afatit ligjor.
- llogaria *423 "Paradhënie për punonjësit"* në vlerën 707,729 lekë, e cila përfaqëson paradhënie për punonjësit, e pa kthyer, e trashëguar që para viteve 2022.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kreu "Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave më vlerë" pikat 64 dhe 66. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 45-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
7.1. Rekomandimi: Departamenti Ekonomik të marrë masa që paradhëniet e pakthyera në shumën totale prej 1,205,458 lekë të kthehen nga punonjësit dhe të kryhen veprimet përkatëse në kontabilitet për mbylljen e këtyre llogarive.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se llogaria 467/7 "Debitorë për furnizime" paraqitet me tepricë si në mbyllje të vitit 2023 ashtu edhe në mbyllje të vitit 2024 në të njëjtën vlerë prej 2,500,000 lekë, e cila përfaqëson kryerjen e shpenzimeve me mbërritjen e faturës për blerje blloqe betoni për mbyllje të gropave të hapura që nga viti 2021, sipas kontratës përkatëse të këtij viti. Nga UK Kamëz SHA ky mall nuk është tërhequr deri në fund të vitit 2025 nga furnitori "AF G." SHPK, pasi nuk ka patur nevojë. Për këtë vlerë edhe pse kanë kaluar 4 vite nga UK Kamëz dhe shoqëria furnizuese nuk është ndërmarrë asnjë hap për mbylljen e këtij detyrimi, e drejtë për kthim UK Kamëz SHA. Kjo nënllogari vazhdon të rezultojë dhe pas 4 vitesh me tepricë debitore, pa arsyetim kontabël, duke mos u kryer asnjë veprim sistemimi, ndërkohë që edhe vlefshmëria e kontratës është tejkaluar për furnizimin me këtë mall. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK 1, pika 10, 25, 26, me Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 5 dhe neni 11/1. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 45-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
8.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe në bashkëpunim me Departamentin Ekonomik të marrë masa që në marrëveshje me furnitorin "AF G." SHPK, të kryejnë veprimet e furnizimit

dhe likuidimit nëse është e mundur me këtë mall apo tjetër në këtë vlerë dhe në fund të kryhen sistemimet kontabël për mbylljen e kësaj llogarie.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në datën 31.12.2024 shoqëria paraqet detyrime afatshkurtra në vlerën 1,526,210,243 lekë, me rritje prej 119,107,014 lekë (8%) krahasuar me vitin 2023. Pjesën më të madhe të tyre e zënë detyrimet e papaguara tregtare, të cilat, ndonëse kanë pësuar ulje krahasuar me vitin paraardhës, mbeten në nivel të lartë dhe përqendrohen kryesisht ndaj UK Tiranë SHA, Bashkisë Kamëz dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU).
Gjithashtu, shoqëria paraqet detyrime afatshkurtra ndaj institucioneve të kredisë në vlerën 59,623,009 lekë, si dhe detyrime tatimore në vlerën 68,664,655 lekë. Në të njëjtën kohë, aktivet afatshkurtra nuk mbulojnë detyrimet afatshkurtra, çka tregon mungesë të likuiditetit dhe vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të maturuara.
Kjo situatë evidenton paaftësinë financiare të shoqërisë për mbulimin e detyrimeve afatshkurtra, e cila mund të sjellë pasiguri për vijimësinë e aktivitetit, si rezultat i pamundësisë së kryerjes së pagesave të detyrimeve që aktualisht i kanë tejkaluar afatet ligjore, por edhe përballjen me kosto shtesë si rezultat i çështjeve gjyqësore që mund të drejtojnë palët e treta ndaj saj. Sa më sipër është kundërshtim me Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" nenet 3/7, 7, 11, 15 me SKK nr.1 "*Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare*" pikat 69-76; me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenet 1 e 12; me SKK nr.1 pikat 46, 47 "Parimi i vijueshmërisë".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 45-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1. Rekomandimi: Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, nëpërmjet organeve drejtuese dhe strukturave përgjegjëse, të hartojë dhe zbatojë një plan masash për përmirësimin e likuiditetit, uljen graduale të detyrimeve të papaguara dhe shlyerjen në afat të detyrimeve ndaj kreditorëve, institucioneve financiare dhe organeve tatimore. Njëkohësisht, të forcojë administrimin e arkëtimeve dhe monitorimin periodik të detyrimeve, me qëllim garantimin e vijimësisë së aktivitetit dhe minimizimin e kostove financiare e ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e prokurimit publik për periudhën 2023-2025, rezultoi se dosjet e prokurimeve nga struktura përgjegjëse për prokurimet, nuk ishin të inventarizuara, të numerizuara dhe të arkivuara duke sjellë si pasojë, parregullsi në administrimin e dokumentacionit të tenderit. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 42 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandimi: Personi përgjegjës për prokurimet të marrë masa për inventarizimin, numerizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit, me qëllim sistemimin arkivor të dokumentacionit, minimizimin e riskut të cenimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 17 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2023-31.12.2025 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 10 raste, u konstatuan mangësi

që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit të prokurimit, apo të paargumentuara teknikisht, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 77 dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", e ndyshuar, nenet 39, 40 dhe 41. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Administratori i UK Kamëz, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 8 raste dhe konkretisht:

1. "Blerje automjetesh për UK Kamëz SHA, viti 2025", me fond limit 13,150,000 lekë pa TVSH, fituar nga OE "S. 32" SHPK me ofertë 12,980,000 lekë pa TVSH,
2. "Blerje karburanti, viti 2025", me fond limit 12,000,000 lekë pa TVSH, fituar nga OE "E.D." SHPK me ofertë 11,553,638 lekë pa TVSH,
3. "Blerje materiale për ujësjellësin dhe KUZ, viti 2025", me fond limit 27,000,000 lekë pa TVSH dhe shumatore të çmimeve njësi 5,643,431 lekë pa TVSH, fituar nga OE "A." SHPK me ofertë shumatoren e çmimeve njësi 3,677,430 lekë pa TVSH,
4. "Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a", Bashkia Kamëz, me fond limit 18,000,000 lekë pa TVSH, fituar nga BOE "B." SHPK & "C." SHPK me ofertë 15,595,813 lekë pa TVSH,
5. "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, Lagjja Zallmner", Bashkia Kamëz, me fond limit 22,420,437 lekë pa TVSH, fituar nga BOE "." SHPK, "N." SHPK & Nd." SHPK me ofertë 20,456,455 lekë pa TVSH,
6. "Rehabilitimi i KUN, Rruga "Argjinatura" – Azili i pleqve (Rruga "Teuta")", Bashkia Kamëz, me fond limit 17,429,918 lekë pa TVSH, fituar nga OE "U." SHPK me ofertë 14,979,450 lekë pa TVSH,
7. "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku", Bashkia Kamëz, me fond limit 63,014,765.5 lekë pa TVSH, fituar nga OE "N.S." SHPK me ofertë 50,819,479 lekë pa TVSH,
8. "Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës Frutikulturës, Valias i Vjetër", Bashkia Kamëz, me fond limit 508,336,290 lekë pa TVSH, fituar nga BOE "E" SHPK & "2 T" SHPK me ofertë 495,914,580 lekë pa TVSH,

kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së disa kritereve të përcaktuara në DST, veprime jo në përshtatje me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 92 dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, nenin 82, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të vlerësohen objektivisht kriteret e vendosura në DT dhe të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2025, u konstatua se nga UK Kamëz janë zhvilluar gjithsej 41 procedura prokurimi me vlerë të vogël me fond limit 21,899 mijë lekë dhe vlerë kontrate 18,399 mijë lekë ose 84% e fondit. Nga grupi janë vlerësuar për auditim 16 procedura me fond limit 13,202 mijë lekë dhe vlerë kontrate 11,086 mijë lekë, nga ku ka rezultuar se:
- Në 3 procedura mungon në dosje procesverbali për hartimin dhe argumentimin e kritereve;
- Në 3 procedura, procesverbali për argumentimin e kritereve nuk është ngarkuar në SPE;
- Në 13 procedura, rezultojnë disa kritere jo në përputhje me objektin e procedurës si dhe nuk kanë argumentimin teknik përkatës;
- Në 11 procedura, rezultuan disa mangësi të dokumentacionit të OE fitues, të cilat nuk janë në përputhje me Ftesën për Ofertë. Mangësitë konsistojnë në certifikata ISO të pa akredituara, dokumente/vërtetime jashtë vlefshmërie, mos paraqitje dokumentacioni për punonjësit etj.
- Në 12 procedura, rezulton se dokumentacioni i OE fitues nuk është dorëzuar nëpërmjet zyrës së Protokoll – Arkivës, por është dorëzuar dorazi pranë AK;
- Në 1 procedurë nuk dokumentohet me procesverbal marrja në dorëzim e mallit/shërbimit;
- Në 1 procedurë, mallrat janë marrë jashtë afatit të përcaktuar në kontratë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", neni 77, neni 92, pika 3, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 2 pika 2 germa (ç), neni 40, pika 3, neni 41 pika 2, neni 78 pika 5, neni 82 pika 2, Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" pika 17, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar, pika 35 germa (b), *Normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë,* neni 17, 19, 21 dhe Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 *"Për miratimin e rregullores së njësuar me dokumentet në autoritete publike të RSH",* neni 8 germa "g". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.1 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa për forcimin e kontrolleve në administrimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, duke siguruar dokumentimin e plotë të çdo faze të procedurës, hartimin dhe publikimin në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) të procesverbaleve për argumentimin e kritereve, përcaktimin e kritereve të kualifikimit në përputhje me objektin e prokurimit dhe me argumentimin teknik përkatës, verifikimin e plotë të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë sipas kërkesave të Ftesës për Ofertë, administrimin e dokumentacionit nëpërmjet Protokoll–Arkivës, si dhe dokumentimin e rregullt të marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve dhe monitorimin e zbatimit të afateve kontraktore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike me objekt "Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz", me nr. 529/5 prot., datë 16.06.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA dhe sipërmarrësit të punimeve BOE "B." SHPK & "N." SHPK & "Nd." SHPK me vlerë të objektit 24,547,746 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 90 ditë, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor UK Kamëz nuk është marrë Oponenca Teknike, veprim në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e

punimeve të ndërtimit", neni 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Titullari i UK Kamëz të marrë masa që të pajiset me Oponencë Teknike çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes fizike të zbatimit të kontratave për punë publike me objekte "Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz", "Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës –Depo Maloku" dhe "Rehabilitim KUN-je, Rr Argjinatura deri tek Azili i Pleqëve, Rr. "Teuta", rezultoi se nuk kanë qenë të pajisur me leje ndërtimi/deklaratë paraprake punimesh, në kundërshtim me Ligjin nr.107, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Titullari i UK Kamëz, në bashkëpunim me grupet e punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave, të marrin masat, që për çdo kontratë të lidhur, të sigurojë pajisen me lejen e nevojshme për kryerjen e punimeve, me qëllim kryerjen e punimeve sipas përcaktimeve ligjore të legjislacionit të displinimit të punimeve dhe planifikimit të territorit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se UK Kamëz nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka takime të dokumentuara të GMS dhe nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike. Njësia e Auditit të Brendshëm, pavarësisht se është në strukturë, është jo funksionale duke mos kryer asnjë aktivitet si dhe duke mos pasur asnjë punonjës në strukturë, duke i munguar si hallkë e kontrollit të brendshëm të njësisë, si dhe për vitet objekt auditimi, nuk disponohet asnjë raport nga kjo njësi. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 189-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për funksionalizimin efektiv të sistemit të MFK-së, duke siguruar zbatimin e kërkesave ligjore, aktivizimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe dokumentimin e këtyre takimeve.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të

ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

16.2. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të hartuar programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezulton se Njësia e Auditit të Brendshëm, pavarësisht se është në strukturë, është jo funksionale duke mos kryer asnjë aktivitet si dhe duke mos pasur asnjë punonjës në strukturë, duke i munguar si hallkë e kontrollit të brendshëm të njësisë, si dhe për vitet objekt auditimi, nuk disponohet asnjë raport nga kjo njësi. Si pasojë, institucioni ka funksionuar pa një mekanizëm të pavarur vlerësimi dhe monitorimi të efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të menaxhimit të riskut dhe të proceseve të qeverisjes. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. *10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 20, 22; Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, neni 2, 3, 5, 6.*

17.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, të marrë masa për funksionalizimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm, duke siguruar plotësimin e strukturës me personel të kualifikuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Njësia duhet të hartojë dhe zbatojë plane vjetore auditimi, të kryejë misione auditimi dhe të prodhojë raporte periodike, në mënyrë që të garantohet funksionimi efektiv i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi i rreziqeve në institucion.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se laboratori që kryen analizat e ujit të pijshëm në Ujësjellës Kanalizime Kamzë nuk është i akreditуar sipas standardit ISO 17025, ndërkohë që analizat e kryera janë të pjesshme dhe nuk mbulojnë të gjithë parametrat e kërkuar, në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm" dhe Standardin ndërkombëtar ISO 17025 mbi kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues. Ka mungesë të masave konkrete nga struktura drejtuese për akreditimin e laboratorit dhe mosplotësim të kapaciteteve teknike, çka ul besueshmërinë e analizave dhe mos garantim e monitorim të plotë të cilësisë së ujit të pijshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 198-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA të marrë masa për akreditimin e laboratorit sipas ISO 17025 dhe sigurimin e analizave të plota sipas kërkesave ligjore.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 8 depot e administruara mungojnë sisteme survejimi dhe në 3 raste rrethimi nuk përmbush standardet e sigurisë, duke mos garantuar kontroll të aksesit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 379/2016 "Kërkesat për mbrojtjen e infrastrukturave kritike dhe burimeve ujore". Konstatohet se ka mungesë investimesh në fushën e sigurisë së këtyre objekteve, e cila sjell rritje të mundësisë së hyrjes së paautorizuar në objektet e furnizimit me ujë dhe rrezik për kontaminim të ujit të pijshëm dhe ndërprerje të furnizimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 198-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Departamenti Teknik në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës në Ujësjellës Kanalizime Kamzë, të marrë masa për planifikimin në Projekt Buxhetet Afatmesme respektive të fondeve të mjaftueshme për instalimin e sistemeve të sigurisë dhe përmirësimin e rrethimit të depove sipas standardeve.

Brenda vitit 2026

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Departamenti Teknik nuk disponon plane të dokumentuara të mirëmbajtjes dhe dezinfektimit periodik të depove të ujit, mungesë të planifikimit dhe formalizimit të procedurave, si dhe procese të pa standardizuara të cilat nuk mund të verifikohen, në kundërshtim me nenin 27, të Rregullores me nr. 8, date 18.08.2025, të UKK-së si dhe Ligjin nr. 110/2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Kreu II, neni 8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 198-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandimi: Drejtuesi i Departamentit Teknik të marrë masa dhe të hartojë, çdo fillim viti plane vjetorë si dhe plane periodikë konkretë sipas detyrave funksionale të secilit sektor në varësi, me qëllim monitorimin dhe dokumentimin e punës të kryer nga punonjësit për arritjen e qëllimit kryesor garantimin e cilësisë së ujit të pijshëm për qytetarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë hartuar plane të trajnimit si për personelin teknik dhe të sigurisë në Sektorin e Manovrimeve dhe sigurisë në Depo ashtu edhe për Sektorin Kimiko-Bakteriologik, duke sjellë një menaxhim jo efektiv të proceseve dhe kapacitete të pamjaftueshme profesionale të stafit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pika 20. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 198-212 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandimi: Drejtuesi i Departamentit Teknik në bashkëpunim me përgjegjësit e sektorëve në varësi dhe konkretisht Sektorit të Manovrimeve dhe Sigurisë në Depo si dhe Sektorit Kimiko - Bakteriologjik, të marrë masa dhe të hartojë plane vjetorë trajnimi dhe të monitorojë zbatimin e tyre për rritjen e kapaciteteve të personelit.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e Kontrollit të Lartë të Shtetit, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 98-102, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 93, nga **Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,828,720 lekë pa TVSH,** sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Gërmim dheu, shtrim linje KUN-je, puseta b/a*", Bashkia Kamëz me nr. 444/7 prot., datë 29.04.2025 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA dhe

sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "B." SHPK, me vlerë të objektit 18,714,976 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 90 ditë, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Shtresë zhavorr lumi t=20 cm, me cilindrim poshtë tubave me d=1500 mm; Shtresë zhavorr lumi t=20 cm, me cilindrim poshtë tubave me d=600 mm", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e UK Kamëz, në vlerën **203,200 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **203,200 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "B." SHPK për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 444/7 prot., datë 29.04.2025.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rikonstruksioni i rrjetit të furnizimit të ujësjellësit, nga impianti i Bovillës – Depo Maloku*", Bashkia Kamëz me nr. 1326/14 prot., datë 25.09.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "N.S." SHPK, me vlerë të objektit 60,983,375 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 120 ditë, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Gërmim dheu ekskavator , në kanale me gjerësi 2 m, tokë e zak, kat III; Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës; Shtresë çakëlli mbeturinë kavet-20 cm", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e UK Kamëz, në vlerën **889,600 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Titullari i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **889,600 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "N.S." SHPK për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1326/14 prot., datë 25.09.2024.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rehabilitim KUN-je, Rr Argjinatura deri tek Azili i Pleqëve (Rr. "Teuta", Kamëz),* me nr. 1377/16 prot., datë 04.11.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA dhe sipërmarrësit të punimeve shoqërisë "U." SHPK Kamëz me vlerë të objektit 17,975,340 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 60 ditë, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Mbushje, rrafshim ngjeshje me tokmak, tokë e zakonshme; Mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e UK Kamëz, në vlerën **421,920 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **421,920 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria "U." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1377/16 prot., datë 04.11.2024.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit "Lagjja Zallmner, Kamëz",* me nr. 529/5 prot., datë 16.06.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA dhe sipërmarrësit të punimeve BOE "B." SHPK & "N." SHPK & "Nd." SHPK me vlerë të objektit 24,547,746 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 90 ditë, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Mbushje, me rërë nën dhe mbi tub për mbrojtjen e tij; Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20cm; Shtresë binderi 6 cm + shtresë asfaltobetoni 4 cm; FV tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=25 mm, t=2.0 mm, PN 10", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e UK Kamëz, në vlerën **470,300 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **470,300 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE "B." SHPK & "N." SHPK & "Nd." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 529/5 prot., datë 16.06.2023.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "*Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë dhe të KUZ të zonës së Frutikulturës, Valias i vjetër Kamëz",* me nr. 1408/11 prot., datë 08.08.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA dhe sipërmarrësit të punimeve BOE "E" SHPK & "2T" SHPK, me vlerë të objektit 595,097,496 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 365 ditë, rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me volumin e situacionuar për zërat e punimeve "Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave t=4 cm + shtresë binderi me granil gur kave t=6 cm; Prerje asfalti t=3cm", me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e UK Kamëz, në vlerën **843,700 lekë** pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe 12, si dhe kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.2 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Titullari i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **843,700 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE "E" SHPK & "2T" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1408/11 prot., datë 08.08.2024.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtim linje ujësjellësi transmetimi dhe shpërndarje dhe rrjet kanalizimesh në Laknas dhe Valias" me fond limit 5,557,330 lekë pa TVSH, u konstatua se është skualifikuar padrejtësisht nga KVO-ja OE "A & E E" SHPK, i cili rezulton të ketë paraqitur në SPE dokumentacionin konform dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Pas skualifikimit të këtij OE, është bërë lidhja e kontratës me një OE tjetër, i cili ka dhënë ofertën ekonomike **260,407 lekë pa TVSH** më të lartë se OE "A & E E" SHPK, me pasojë efekt financiar negativ në këtë vlerë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 75-189 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHAtë analizojë arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, duke rritur ekonomicitetin e përdorimit të fondeve publike.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me bankë u konstatua se gjatë vitit 2023 shoqëria ka kryer pagesë në vlerën 1,152,899 lekë në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, si pasojë e largimit të parregullt nga puna të një punonjësi. Gjithashtu, në pasqyrat financiare të vitit 2024 është përllogaritur fondi në llogarinë 49211 "Zhvlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve gjyqësore" në vlerën 18,200,000 lekë, që përfaqëson detyrime të pritshme nga procese gjyqësore në vijim, kryesisht për pavlefshmëri të titujve ekzekutivë dhe zgjidhje të marrëdhënieve të punës.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenin 1, nenin 8 pika 1 dhe nenin 12 pika 3, germa "a", si dhe me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 141, 143/4, 144, 153 dhe 155;; me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar neni 1, neni 8 pika 1, neni 12 pika 3 germa "a".
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 69-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHAtë analizojnë shkaqet e humbjes së proceseve gjyqësore, të evidentojnë përgjegjësitë administrative për rastet e largimeve të parregullta nga puna dhe të marrin masa për respektimin e legjislacionit të punës dhe forcimin e kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e shpenzimeve të panevojshme dhe mbrojtjen e fondeve të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi deklarimin dhe administrimin e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe kreditorëve u konstatua se shoqëria nuk ka respektuar afatet ligjore për deklarimin e detyrimeve tatimore, si dhe nuk ka shlyer në afat detyrimet kontraktuale ndaj UKT SHA, duke sjellë kosto shtesë dhe efekt negativ financiar në shumën 397,453,373.56 lekë në buxhetin e shoqërisë.

Konkretisht, për periudhën 2023–2025, shoqëria ka likuiduar 170,000 lekë gjoba administrative, nga të cilat 50,000 lekë për deklarime të vonuara të tatimit të mbajtur në burim dhe 120,000 lekë për deklarime të vonuara të pasqyrave financiare pranë QKB-së. Gjithashtu, si pasojë e moslikuidimit në afat të detyrimeve ndaj UKT SHA, janë paguar 502,434 lekë shpenzime përmbarimore, duke e çuar efektin negativ financiar në 672,434 lekë.
- Nga rakordimi i kryer ndërmjet UKK SHA dhe UKT SHA rezulton se në fund të vitit 2025 detyrimi për furnizimin me ujë ndaj UKT SHA është 397,283,373.56 lekë, nga të cilat 361,551,268.20 lekë përfaqësojnë detyrimin principal dhe 35,732,105.36 lekë kamatëvonesa. Kjo situatë tregon mangësi në administrimin e detyrimeve financiare dhe në planifikimin e likuiditetit, duke ekspozuar shoqërinë ndaj penaliteteve dhe kostove shtesë.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenin 1, nenin 8 pika 1 dhe nenin 12 pika 3, germa "a".
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 69-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
3.1.Rekomandimi: Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA të marrin masa për arritjen e një aktmarrëveshje me Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA lidhur me shlyerjen e detyrimit prej 397,283,373.56 lekë, në mënyrë që të shmanget vendosja e masës "sekuestro konservative" nga përmbarimi privat dhe krijimi i kamatëvonesave të tjera. Gjithashtu, nëpunësi zbatues të marrë masa për deklarimin në kohë të detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe të pasqyrave financiare në Qendrën Kombëtare të Biznesit për shmangien e penaliteteve që sjellin mbishpenzime për buxhetin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria analitike 411 "Klientë për mallra, produkte e shërbime" paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 867,558,586 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 941,493,879 lekë. Pra kërkesat për arkëtim në vitin 2024 kanë pësuar rritje prej 73,935,293 lekë ose në masën 8.5 % krahasuar me vitin 2023, ku peshën kryesore të debitorëve ndaj UK Kamëz SHA e zënë abonentët familjarë në masën 97 %, privatët dhe institucionet shtetërore në masën 3 %.
Vlera e klientëve prej 941,493,879 lekë i përket detyrimeve që kanë 63230 abonentë ndaj UK Kamëz SHA në datën 31.12.2024, ku vlera prej 556,887,070 lekë është trashëguar që para vitit 2020 në momentin e transferimit nga UKT SHA në UKK SHA, ndërsa vlera prej 384,606,809 lekë është akumuluar gjatë viteve 2020 - dhjetor 2024, në të cilën është përfshirë edhe vlera prej 362,220,001 lekë e debitorëve nga mosarkëtimet e abonentëve për taksa dhe tarifa vendore ndaj Bashkisë Kamëz. Për llogaritë e arkëtueshme neto, nuk ka të dhëna për kohën kur këto debitorë janë krijuar dhe sa janë vonesat për secilin prej tyre, që përbën një risk të shtuar lidhur me saktësinë dhe plotësinë e shumës neto për llogaritë e arkëtueshme në datën 31.12.2024 si dhe për mbledhjen dhe zhvlerësimin e tyre.
Mosarkëtimi i detyrimeve është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenet 1 e 12.
Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të administratës së Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA në drejtim të arkëtimit të të ardhurave nga uji i pijshëm në kundërshtim me VKM nr. 236, datë 10.5.1993 "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jo familjarë", i ndryshuar me VKM nr. 96, datë 21.2.2007 dhe me Udhëzimin e nr. 3, datë

28.07.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”, pika 6. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 45-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kamëz SHA të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, si dhe në bashkëpunim me Departamentin Ekonomik të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumave debitore të abonentëve, duke evidentuar vonesat në kohë të pagesave dhe penalitetet për to.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa c); Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 37 “Masa disiplinore” dhe Kontratës individuale të punës, i rekomandojmë **Ujësjellës Kanalizime Kamëz (UKK Sh.A)** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të nisë procedurat për dhënien e masave disiplinore.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT